monumentet



DOWOTE
SOBY

59/2020

DO NOT COPY

Monumentet

DO NOT COPY

MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
TIRANË

DO NOT COPY

Monumentet

59/2020

Redaksia

Prof. Dr.	Pirro Thomo	Kryeredaktor
	Arta Dollani	Zv. Kryeredaktor
Dr.	Rudina Zoto	Anëtar
	Daniel PIRUSHI	Anëtar
Prof. Dr.	Florian NEPRAVISHTA	Anëtar
Prof. Dr.	Gjerak KARAISKAJ	Anëtar
Prof. Dr.	Iris POJANI	Anëtar
Dr.	Era XHAFERAJ	Anëtar
	Marsela PLYKU	Anëtar
	Mimoza ZERECI	Anëtar
	Joli Mitrojorgji	Anëtar

ISSN 0253-1607

Copyright: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

Botim i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore
Tiranë, 2020

Në kopertinë: Fragment nga ikona “Mbledhja e Kryeengjëjve”, marrë nga kisha e Shën Mëhillit në Mingul të Gjirokastrës. Fondi i ikonave të Muzeut Historik Kombëtar

SHTËPIA BOTUESE

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ

Faqe

Arta DOLLANI
55-vjetori i themelimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës
“Gani Strazimiri” 11

Prof. Dr. Pirro THOMO
Ark. Rest. Arben SPAHO
Ing. Rest. Alfred ÇOMA
Restaurimi i Kishës së Shën Marisë në Peshkëpinë e Sipërme, Gjirokastër 17

Gentian VOKOPOLA
Restaurimi i disa ikonave 55

Eduard SHEHI
Evoluimi i linjës juglindore të fortifikimeve të Durrësit dhe datimi i “torrës veneciane”..... 67

Dr. Dorian KOÇI
Punimet prej argjendi të Lunxhërisë në Muzeun Historik Kombëtar.
Mbulesa prej argjendi e ikonës së Shën Premtes së Selckës dhe mbulesa prej argjendi e ikonës së Shën Gjergjit së Nokovës 109

Dritan ÇOKU
Kulla e Sahatit në Kalanë e Krujës …….....119

Sokol ÇUNGA
Përshkrimi i Mitropolisë së Beratit nga Anthim Aleksudhi si burim historik 139

TABLE OF CONTENTS

ARTICLES

Page

Arta DOLLANI
55th anniversary of the founding of the Institute of Cultural Monuments
“Gani Strazimiri”..... 14

Prof. Pirro THOMO
Ark. Rest. Arben SPAHO
Ing. Rest. Alfred ÇOMA
Restoration of the Church of St. Mary in Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër 53

Gentian VOKOPOLA
Restoration of some icons 65

Eduard SHEHI
Evolution of the southeastern line of Durrës fortifications and dating of the
“venetian tower”.....106

PhD. Dorian KOÇI
The silver works of Lunxhëria in the National Historical Museum.
The silver cover of the icon of Saint Paraskevi in Selca and of the
icon of Saint George in Nokova 115

Dritan ÇOKU
The Clock Tower in the Castle of Kruja 138

Sokol ÇUNGA
A description of the Metropoly of Berat from Anthimos Alexoudes as
a historical source 151

Renald META
Objektet e punuara në stelat funerare të periudhës klasike dhe helenistike të
Apolonisë dhe Epidamn-Dyrrahut 153

Ina VANDENBERGHE
As. Prof. Dr. Frederik STAMATI
Një studim (material teknik) për konservimin e flamurit të Kongresit të Lushnjës 177

As. Prof. Dr. Armand VOKSHI
Projektet e arkitektëve dhe inxhinierëve italianë në Vlorë
gjatë periudhës 1916-43..... 189

Prof. Dr. Aleksandër MEKSI
Recencë: Pirro Thomo, Përmbledhje Studimesh e Kumtesash, Tiranë, 2020 207

Dr. Era XHAFERAJ
Recencë: Dritan Çoku, Genci Samimi, Kishat e Kalasë së Beratit.
Arkeologji – Histori – Arkitekturë – Restaurim, Botimet “Pegi”, Berat, 2019..... 211

DO NOT COPY

Renald META
Crafted objects in funerary steles of Classical and Hellenistic Period from Apollonia and Epidamn-Dyrrachium 175

Ina VANDENBERGHE
Prof. Asoc. Frederik STAMATI
A (technical material) study for the conservation of the Flag of the Congress of Lushnja 186

Prof. Asoc. Armand VOKSHI
Projects of Italian Architects and Engineers in Vlora during the Period 1916-43.....205

Prof. Aleksandër MEKSI
Recence: “Collection of articles and papers 1991-2015”, authored by Prof. Dr. Pirro Thomo, Tirana, 2020 210

PhD. Era XHAFERAJ
Recence: “Churches of the Castle of Berat. Archeology - History - Architecture - Restoration”, authored by Dritan Çoku, Genci Samimi 214

DO NOT COPY

Arta DOLLANI
Drejtor i Përgjithshëm
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

55 VJETORI I THEMELIMIT TË INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS “GANI STRAZIMIRI”

Numri i ri i revistës Monumentet koincidon me 55-vjetorin e themelimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK), çka na jep shkas të bëjmë një vështrim retrospektiv të rrugëtimit të Institutit në këto 55 vite.
Fillimisht Instituti i Monumenteve të Kulturës u krijua me bazë Sektorin e Mbrojtjes e të Restaurimit të Monumenteve të Grupit të Kulturës Materiale, një organizëm që përveç këtij sektori përbëhej edhe nga Sektorët e Arkeologjisë dhe të Historisë së Artit dhe Arkitekturës. Ky organizëm varej nga Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, dhe ishin pjesë e Universitetit Shtetëror të Tiranës.
Dalja më vete e Institutit të Monumenteve të Kulturës shënoi një ngjarje të rëndësishme kulturore për vendin. Pavarësia që fitoi nga varësia e trefishtë, nga Grupi i Kulturës Materiale, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë dhe Universiteti i dha një hov të veçantë mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve, e cila u duk në çdo aspekt organizativ: në vështirësitë për plotësimin e organikës me specialistë të nevojshëm, në organizimin e ekspeditave me mjete transporti, kur Universitetit me mjete të kufizuara i duhej të plotësonte kërkesat e shumë sektorëve, të arkeologjisë, të gjeologjisë, të shkencave natyrore etj. Po kështu edhe laboratorit fotografik i duhej të plotësonte kërkesat e po këtyre sektorëve. Ndërhyrjet në monumente siguroheshin nga një strukturë adekuate, nga një Institut me sektorët përkatës për çdo gjini apo periudhë historike, si Sektori i Monumenteve antiko-mesjetarë, i Qendrave Historike e Banesave Popullore, Sektori i Veprave të Artit, i Moumenteve Historike, i dokumentacionit tekniko-shkencor, Sektorin e Financës dhe të Planit, Degëve e Atelieve të rretheve Gjirokastër, Berat, Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë e Sarandë. Duke i shtuar këtij organizimi dhe një rrjet të dendur kujdestarësh, që sinjalizonin në çdo rast gjendjen e monumenteve, kujdesi për trashëgiminë ishte i shpërndarë në mënyrë kapilare dhe me një planifikim fondesh për fuqi punëtore e bazë materiale. Falë këtij organizimi u arrit që, nga viti në vit, dëmtimet në monumentet të pakësoheshin.
Fuqizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore mbetet një nga synimet kryesore të punës së Institutit. Rritja e kualifikimit profesional të kuadrove të reja filloi të japë rezultate të prekshme. Ekspeditat e gjurmimit në terren të ndërtimeve me vlerë sollën rritjen e numrit të monumenteve të vëna në mbrojtje të shtetit. Krahas ndërtimeve antike, kalave, ndërtesave të kultit, vëmendja u përqendrua edhe te

gjini pak të prekura më parë, si banesat fshatare apo ndërtimet inxhinierike, ura, vepra hidraulike etj. Krahas qendrave historike të Gjirokastrës e Beratit, u vunë në mbrojtje të shtetit qendrat historike të Korçës, Elbasanit, Vlorës, fshatrat e Bregut, Himarës, Dhërmiut, Vunoit e Qeparoit, Voskopojës e Bilishtit.
Falë kompetencës shkencore në përgatitjen e dosjeve u arrit të viheshin në mbrojtje të UNESCOs si Pasuri Kulturore Botërore Parku i Butrintit (1992), Qyteti-muze i Gjirokastrës (2005), Qyteti-muze i Beratit (2008) dhe është dorëzuar dosja për përfshirjen në listën e pasurive botërore në mbrojtje të UNESCOs edhe të pjesës shqiptare të rajonit të Ohrit.
Viti 1967 pati pasoja tronditëse në fushën e monumenteve. Ndalimi i ushtrimit të fesë u ndoq nga shkatërrimi i një numri të konsiderueshëm objektesh kulti, duke i sjellë një dëm të pakthyeshëm pasurisë së kulturës kombëtare dhe asaj botërore. U kërkua gjithashtu dhe reduktimi i numrit të objekteve të kultit të vëna në mbrojtje me cilësinë e Monumenteve të Kulturës. Ishte rezistenca e vendosur e një grupi të vogël studiuesish, sigurisht jo pa rrezik për atë kohë, që me një nivel të lartë profesional e shkencor argumentuan vlerat historike, arkitektonike e artistike të monumenteve dhe dëmin që mund të sillnin prishja e tyre. Si rezultat u arrit që, në fazën e parë dhe me të egër, të mbaheshin në listë 140 monumente nga 214 që përmbante lista, të cilat me kalimin e kohës u shtuan. Për këtë ngjarje që shënoi një njollë të errët në historinë e mbrojtjes së monumenteve dhe veçanërisht gjinisë së objekteve të kultit, duhet të shpreh mirënjohjen time dhe të gjithë gjeneratave në vijim për ata që bënë të mundur shpëtimin e këtyre objekteve, Gani Strazimirit, Theofan Popës, Pirro Thomos e Aleksandër Meksit.
Shtimi i numrit të monumenteve dhe intensiteti i ndërhyrjeve restauruese krijoi kërkesën për hartimin e një baze ligjore për të mbështetur dhe ligjërisht këtë veprimtari, si dhe rregullimin e marrëdhënieve me organizmat e tjera të interesuara, me shtresën e pronarëve, organet e pushtetit vendor dhe atij shtetëror. Me shtimin e problematikës së mbrojtjes dhe, sidomos, me ndërrimin e kushteve mbas ndërrimit të sistemin, kjo bazë ligjore pësoi modifikime e përmirësime, për t'ju përgjigjur më mirë problemeve të reja. Risitë në legjislacion dhe që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen dhe restaurimin janë hartimi i projekteve të restaurimit jo vetëm nga punonjësit e Institutit, por dhe nga specialistë të licensuar në këtë fushë. Tjetër e re është dhe njohja e kontributeve të organizatave, enteve e forume private kombëtare e ndërkombëtare për mbrojtjen e monumenteve. Rezultatet e këtyre bashkëpunimeve, si me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), me Delegacionin Evropian, me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, me Agjencinë Turke të Kooperimit dhe Koordinimit (TIKA) etj., rritën së tepërmi vëllimin e ndërhyrjeve në Qendra Historike, Ansamble e monumente të veçanta.
Veprimtaria shkencore e popullarizuese ishte edhe kjo një tregues i pjekurisë profesionale të punonjësve të Institutit.
Ishte në vitin e hershëm 1971 që pa dritë botimi i numrit të parë të revistës Monumentet. Vit pas viti vijoi të botohej deri në ditët tona, duke numëruar sot numrin 59 të saj dhe duke u bërë një nga revistat më të kërkuara jo vetëm nga opinioni shkencor i vendit, por dhe ai ndërkombëtar. Sesionet e shumta shkencore u kthyen në tribuna ku u shpalos mendimi shqiptar i mbrojtjes dhe restaurimit, i vlerësuar me nota të larta nga specialistët ndërkombëtarë më me zë. Krahas tyre, një numër albumesh e monografish gjetën dritën e botimit.
U krijua kështu një bazë e shëndoshë arkivore e bibliografike që solli rritjen e interesit të shoqërisë civile për trashëgiminë kulturore. Kërkesa për rritjen e numrit të specialistëve të mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve solli hapjen për herë të parë në vitin 2016 të kursit pasuniversitar për Master Profesional të Restaurimit pranë Fakultetit të Urbanistikës e Arkitekturës të Universitetit Politeknik, i cili, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Monumenteve (sot IKTK), ka nxjerrë deri sot katër breza të diplomuarish. Gjithashtu nga viti në vit është shtuar numri kandidatëve për marrjen e gradës shkencore të Doktorit të Shkencave me teza doktorature mbi trashëgiminë kulturore, duke rritur ndjeshëm formimin e specialistëve të aftë për të çuar përpara misionin e shenjtë të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore kombëtare.

DO NOT COPY

Arta DOLLANI
General Director
National Institute of Cultural Heritage

55TH ANNIVERSARY OF THE FOUNDING OF THE INSTITUTE OF CULTURAL MONUMENTS "GANI STRAZIMIRI"

This new issue of "Monumentet" magazine coincides with the 55th anniversary of the founding of the Institute of Cultural Monuments (ICM), which gives us a reason to take a retrospective look at the Institute's journey in these 55 years.
Initially, the Institute of Cultural Monuments was established based on the Sector for the Protection and Restoration of Monuments, part of the Material Culture Group, an organization that in addition to this sector consisted of the Sectors of Archeology and the History of Art and Architecture. This body depended on the Institute of History and Linguistics, and was part of the State University of Tirana.
Exit by itself of the Institute of Cultural Monuments marked an important cultural event for the country. The independence gained from the triple dependence, from the Group of Material Culture, the Institute of History and Linguistics and the University gave a special impetus to the protection and restoration of monuments, which appeared in every organizational aspect: in the difficulties of completing the staff with the necessary and right specialists, in organizing expeditions by means of transport, in a time when the University, with its limited means, had to meet the requirements of many sectors, archeology, geology, natural sciences, etc.
The photographic laboratory had to meet the requirements of the same sectors, too. Interventions in monuments were provided by an adequate structure, by an Institute with relevant sectors for each genre or historical period, such as the Sector of Ancient-Medieval Monuments, Historic Centers and Folk Dwellings, Sector of Art Works, sector of Historical Monuments, of technical Scientific documentation, Finance and Planning Sector, Branches and Ateliers of Gjirokastra, Berat, Tirana, Korça, Shkodra, Vlora and Saranda districts.
Adding to this organization a dense network of caretakers, who signaled in each case the condition of the monuments, the necessary care for the heritage was distributed in a capillary manner and with a careful planning of funds for manpower and material base. Thanks to this organization, the damage to the monuments was reduced, from year to year.

DO NOT COPY

Strengthening of the scientific research activity remains one of the main goals of the work of the Institute. The professional qualification raise of the new staff began to yield tangible results. Field search expeditions of valuable constructions brought about an increase in the number of monuments placed under state protection. Next to ancient constructions, castles, cult buildings, attention was also focused on the areas that were slightly affected before, such as rural dwellings or engineering constructions, bridges, hydraulic works, etc. Next to the historical centers of Gjirokastra and Berat, the historical centers of Korça, Elbasan, Vlora, the villages of Bregu, Himara, Dhërmi, Vuno and Qeparo, Voskopoja and Bilisht were placed under state protection.
Thanks to the scientific competence in the preparation of the files, Butrint Park (1992), the City-Museum of Gjirokastra (2005), the City-Museum of Berat (2008) were put under the protection of UNESCO, as the World Cultural Heritage. The dossier for the inclusion in the list of world assets under the protection of UNESCO of the Albanian part of the Ohrid region has been submitted, too.
The year 1967 had shocking consequences in the field of monuments. Prohibition of practicing religion was followed by the destruction of a considerable number of cult objects, causing irreversible damage to the asset of national and world culture. A reduction in the number of protected cult objects, which were qualified and put under protection as Cultural Monuments was also requested. It was the determined resistance of a small group of scholars, certainly not without risk for the time, who gave powerful arguments, with high professional and scientific level for the historical, architectural and artistic values about the monuments and the damage that their demolition could bring.
As a result, 140 monuments were kept on the list during the first and the wildest phase, out of the 214 the list contained, list which increased over time. For this event that marked a dark stain in the history of the protection of monuments and especially in the history of protection of cult objects, I must express my own gratitude and that of all following generations to those who made possible the salvation of these objects, Prof. Gani Strazimiri, Prof. Theofan Popa, Prof. Pirro Thomo and Prof. Aleksander Meksi.
Increased number of monuments and the intensity of restoration interventions created the demand for drafting a legal basis to legally support this activity, as well as the relations regulation with other interested bodies, with the owners, with local and state government bodies. This legal basis underwent modifications and improvements, in order to better respond to new problems, as the protection issues increased and the conditions changed after the change of political system. Innovation in legislation, directly related to protection and restoration is the drafting of restoration projects not only by the staff of the Institute, but also by licensed specialists in this field.
The recognition of the contributions of organizations, entities and private national and international forums for the protection of monuments is another innovation. The results of these collaborations, such as with the Orthodox

Autocephalous Church of Albania, the Albanian-American Development Foundation (AADF), the European Delegation, the Albanian Development Fund, Turkish Cooperation and Coordination Agency (TIKA), etc., increased tremendously the volume of interventions in Historic Centers, Ensembles and Special Monuments.

The scientific and popularizing activity was also an indicator of the professional maturity of the employees of the Institute.

It was in the early year 1971 that the publication of the first issue of the magazine "Monumentet" was published. Year after year it continued to be published to this day, counting today its number 59 and becoming one of the most sought after journals not only by the scientific opinion of the country, but also the international one. Numerous scientific sessions turned into tribunes where the Albanian opinion of protection and restoration was unveiled, always evaluated with high marks by the most vocal international specialists. Alongside them, a number of albums and monographs found the light of publication.

This created a sound archival and bibliographic basis that increased civil society interest in cultural heritage. Demand for increasing the number of specialists for the protection and restoration of monuments led to the opening for the first time in 2016 of the postgraduate course for Professional Master of Restoration at the Faculty of Urban Planning and Architecture of the Polytechnic University of Tirana, which, in close cooperation with the Institute of Cultural Monuments (today NICH), has produced to date four generations of graduates.

From year to year the number of candidates receiving the scientific degree of Doctor of Science with doctoral theses on cultural heritage has increased, significantly raising the training of skilled specialists capable of advancing the sacred mission of protecting national cultural heritage.

DO NOT COPY

Prof. Dr. Pirro THOMO
Ark. Rest. Arben SPAHO
Ing. Rest. Alfred ÇOMA

RESTAURIMI I KISHËS SË SHËN MARISË NË PESHKËPINË E SIPËRME, GJIROKASTËR[1]

Kisha e Shën Marisë në Peshkëpinë e Sipërme ndodhet në krahinën e Dropullit, e cila shtrihet gjatë luginës së lumit Drinos, në rrëzë të Malit të Gjerë dhe të Stugarës (Fig. 1). Gërmimet arkeologjike dëshmojnë për një banim të hershëm të kësaj krahine. Pranë fshatit Sofratikë janë zbuluar rrënojat e një teatri, tempulli dhe nekropoli, të cilat mendohet se i përkasin qytetit antik të Hadrianopolit. Në këtë krahinë duhet kërkuar dhe selia e Peshkopatës së Drianopojës. Nuk është pa vlerë dhe hipoteza që e vendos Qendrën Peshkopale të Drianopojës në fshatin Peshkëpi, jo vetëm duke u nisur nga emri, por dhe nga ekzistenca e kishës së Shën Marisë, e cila përmban në apsidë sinthronin të formuar me tre radhë shkallësh me fronin peshkopal në mes.

Duke filluar nga shek. 16 u ngritën një numër i madh manastiresh në shpatin lindor të Malit të Gjerë, nga të cilat kanë arritur deri në ditët tona 8 prej tyre.



Fig. 1. Pozita gjeografike e kishës

[1] Projekti u hartua nga Instituti i Monumenteve, me autorë Ark. Arben Spaho, Ark. Artila Vavako, Ing. Endrita Mulleti, Ing. Isida Hondro, ndërsa modifikimi i projektit të restaurimit u hartua nga autori dhe u miratua me Vendimin nr. 220, dt. 18.04.2018 dhe nr. 401, dt. 26.09.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimit. Punimet u kryen nga Shoqëria AD-STAR me Administrator Ing. Alfred Çoma gjatë viteve 2018-19, nën drejtimin e autorit. Projekti i konservimit të pikturës murale dhe objekteve të tjera të artit u hartua nga G. Vokopola.

Fshatrat e Dropullit kanë një pozitë shumë piktoreske, të vendosura varg njëra pas tjetrës, të cilat shquhen gjithashtu dhe për urbanistikën dhe banesat solide.
Për sa i përket ndërtimit të kishës së Shën Marisë së Peshkëpisë së Sipërme kemi këto të dhëna. Një mbishkrim në murin lindor (Fig.2) bën fjalë për ndërtimin e kishës në kohën e Perandorit të Bizantit Aleks Komnenit në vitin 619. Sipas Theofan Popës kjo datë duhet të jetë një përsëritje e gojëdhënës për ndërtimin e kishës, sepse Perandori Aleks Komnenit ka sunduar gjatë viteve 1081-1118[2].
Në artikullin e tij mbi këtë kishë A. Meksi përmend udhëtarin anglez, Holland, i cili e



Fig. 2. Mbishkrim



Fig. 3. Planimetria

[2] Popa Th., Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë, 1998, mb. 519: Përkthimi: "Fillimi i diturisë është frika e Perëndisë. Ky tempull hyjnor dhe i hirshëm u ndërtua prej themeli në kohën e mbretit Aleks Komneni më 619. Prapë u rindërtua me kujdesin prill 1883. Prapë u rindërtua (riparua) me shpenzimet e shoqatës së peshkopiajsve, të Peshkopisë së Sipërme, në Konstandinopojë. Vepër e mjeshtrit V. Klemit".Mb. 764, "Prapë u ripërtëri me kujdesin e zotit Jan Guda 1883".



Fig. 4. Prerja aksonometrike

vizitoi kishën në vitin 1812 dhe se ai kishte lexuar një mbishkrim që rezultonte se kisha është ndërtuar nga Perandori Bizantin Manuel Komneni, që sundoi në vitet 1143-1180. Kjo e dhënë, sipas Meksit, bëhet e besueshme, pasi karakteristikat e ndërtimit në kompozimin planimetrik e volumor të brendshëm e të jashtëm, si dhe në trajtimin arkitektoniko-dekorativ, i përkasin periudhës nga fundi i shek. XI deri në mesin e shek. XII[3]. Kisha e Shën Marisë është e tipit në formë kryqi me kupolë me tri apsida në anën lindore, por tiparet e saj janë ende të pa formuara në mënyrë të plotë. Tipare ende të paformuara vërehen dhe në kompozimin volumor të jashtëm për sa i përket proporcioneve, si dhe në thjeshtësinë e përpunimit artikektoniko-dekorativ (Fig. 3, 4).

[3] Meksi A., "Dy kisha bizantine në rrethin e Gjirokastrës", Monumentet, nr. 9, 1979, fq. 82. Të njëjtin pohim të Holand e përmend dhe studiuesja greke A. Nerologou në artikullin e saj "The Byzantine Church of Sainte Mary in Upper Peshkëpi", Monumentet, nr. 57, 2018, fq. 52-53.

DO NOT COPY

Trajtimi i thjeshtë dekorativ i pamjeve të jashtme tenton të thyhet nga një dekoracion i përmbajtur në përpunimin rreth hapësirave të dritareve të apsidave, të rrethuara me harqe prej tullash, si dhe rreth dritareve të tamburit të kupolës, të cilat qarkohen me shirita prej tulle, qarkim që shkon gjatë gjithë perimetrit të tamburit (Fig. 5)

Në apsidën qendrore është ndërtuar ***sinthroni***, si karakteristikë e kishave peshkopale (Fig. 6).



Fig. 5. Pamja lindore



Fig. 6. Sinthroni

DO NOT COPY

Në brendësi dhe përreth kishës gjenden fragmente arkitektonike antike, si dhe fragmente pllakash të dekoruara. Me shumë gjasë këto të fundit janë pjesë të një ikonostasi, apo dhe fronit peshkopal[4] (Fig. 7, 8 9).

Në çiftin lindor të pilastrave është ngritur një ikonostas me mur guri dhe i pikturuar. Sipas mbishkrimit ky ikonostas është ndërtuar në vitin 1510[5]. Përpara këtij ikonostasi u ngrit një ikonostas prej druri.





Fig. 7, 8, 9. Fragmente relievesh

[4] Hobdari E., "Skulptura dhe instalimet liturgjike në kishën e Shën Mërisë në Peshkëpinë e Sipërme (Gjirokastër)", Iliria, nr. XXXIV, 2009-2010, fq. 331-363.

[5] Popa Th., vep. cit., mb. 520, 764. Përkthimi: "U pikturua ky ikonostas me kontributin dhe shpenzimet e peshkopit shumë pertëndidashës të Dhrinopojës, zotit Simeon, për shpëtimin e shpirtit të tij, në vitin 7019 (1510)".



Fig. 10. Fragment ikonostasi me mbishkrim

Krahu i majtë i mbishkrimit përsërit gojëdhënën e ndërtimit të kishës më 619, në kohën e Aleks Komnenit (Fig. 10).

Në një fazë të dytë, në anën jugore është shtuar një ambient i mbuluar me qemer cilindrik. Në ndryshim nga trajtimi i thjeshtë dekorativ i naosit, në ambientin e ri vërehet një dekoracion i pasur keramoplastik. Një mënyrë e tillë dekorimi dhe motivet e përdorura e datojnë ambientin si të shek. XIII-XIV (Fig. 11).

Gjendja e monumentit

Me kohë monumenti ka pësuar shumë dëmtime, përderisa përdoruesit e kishës janë detyruar t'i bëjnë godinës shumë përforcime, siç del dhe nga



Fig. 11. Dekoracioni i shtesës jugore



Fig. 12. Përforcimet e kryera në kohë

mbishkrimet (Fig. 12). Në brendësi përforcimet janë përqendruar në mbathjen e pilastrave, si dhe të një pjese të murit perëndimor, ndërsa nga jashtë i gjithë muri verior është kontraventuar. Edhe sot duket inklinimi që kanë pasur këto dy mure. Pavarësisht nga përforcimet e bëra, lënia pas dore dhe pa asnjë përkujdesje e monumentit ka shkaktuar dëmtime të konsiderueshme, të cilat do ta çonin atë drejt një rrënimi të pashmangshëm. Çarje të madhësive të konsiderueshme vëreheshin në muraturë (Fig. 13, 13.1, 13.2) dhe në sistemin e kurbëzuar të mbulesës (Fig. 14).

Një nga shkaqet që kanë shkaktuar dekompozimet e strukturave ka qenë dhe mbirja dhe zhvillimi i pemëve në këto struktura (Fig. 15, 16). Diametri që arritën këto bimësi është dhe ky një tregues i kohës jashtëzakonisht të gjatë e mungesës së përkujdesjeve (Fig. 17).







Fig. 13, 13.1, 13.2. Puntelime në pjesët e rrezikuara të muraturës

DO NOT COPY



Fig. 14. Dëmtimet e sistemit të mbulesës







Fig. 15, 16, 17. Mbirje pemësh në brendësi të kishës

DO NOT COPY



Fig. 18. Zbulimi i ndarjes së krahut të kryqit perëndimor me ambientin këndor JP



Fig. 19. Zbulimi i kornizës së ambientit këndor JP

Elemente të rëndësishme të zbuluara gjatë ndërhyrjeve restauruese

Zbulimi i çatisë, i nevojshëm për konsolidimin e strukturave të kurbëzuara shumë të dëmtuara, na dha një pamje shumë të qartë të ndërtimit struktural, si dhe detaje të rëndësishme arkitektonike e dekorative.

Zbulimi i çatisë nxori mbushjen tepër të rëndë me inerte dhe gurë mbi strukturë, e cila së bashku me mbulesën me rrasa guri, ushtronte një peshë tepër të konsiderueshme mbi konstruksionin, tashmë tepër të dëmtuar.

Mbushja kishte fshehur strukturën në formë kryqi të kompozimit vëllimor të jashtëm. Pastrimit në anën perëndimore zbuluan muret që ndanin krahët e kryqit me ambientet këndore (Fig. 18). Me këtë rast dolën në dukje elementet dekorative D1 (Fig. 19, 20), korniza dekorative në formë dhëmbësh sharre, e cilat janë tregues të kornizave të strehës të çatisë të ambientit këndor jugperëndimor dhe të çatisë të krahut jugor të kryqit D3 (Fig. 21), si dhe një fragment të dekoruar të murit jugor të fazës së dytë ndërtimore D2 (Fig. 22).



Fig. 20. Zbulimi i ullukut ndërmjet mbulesës së fazës së parë dhe shtesës jugore në anën perëndimore



Fig. 21. Zbulimi i kornizës së krahut të kryqit jugor



Fig. 22. Zbulimi i dekoracionit në kreun e anës perëndimore të shtesës jugore



Fig. 23. Konfiguracioni i mbulesës fillestare të anës perëndimore

Këto të dhëna na e japin të qartë formën e çatisë që ka pasur monumenti në fazën fillestare (Fig. 23).
Në pamjen lindore ruhen gjurmë, të cilat nuk janë gjë tjetër, veçse pjesët e kornizave të çative të ambienteve këndore (1) (Fig. 24. 25, 26), si dhe gjurmë të ullukut ndërmjet çatisë të ambientit këndor JL dhe çatisë të fazës së dytë të monumentit (2) (Fig. 27, 27.1).

Ashtu si dhe në anën perëndimore, të dhënat dhe elementet e anës lindore na sugjerojnë edhe këtu formën e çatisë që ka pasur monumenti në fazën fillestare (Fig. 28).
Në bazë të zbulimeve të kryera mund të ripërtërijmë kornizat e çative të ambienteve këndore dhe të krahëve të kryqit, të cilat na rezultojnë me një radhë në formë dhëmbësh sharre (Fig. 29).

DO NOT COPY







Fig. 24, 25, 26. Gjurmë të mbulesës fillestare të anës lindore





Fig. 27, 27.1. Gjurmë të ullukut ndërmjet mbulesës së fazës së parë dhe shtesës jugore në anën lindore



Fig. 28. Konfiguracioni i mbulesës fillestare të anës lindore

DO NOT COPY



Fig. 29. Detaj i kornizës me një radhë në formë dhëmbësh sharre







Fig. 30, 30.1, 30.2. Zbulimi i kornizave të mbulesës së shtesës jugore





Fig. 31, 31.1. Zbulimi i qypave në ndarjen e krahut të kryqit perëndimor dhe ambientit këndor JP



Fig. 32. Kompozimi vëllimor fillestar

Pastrimet e mëtejshme zbuluan gjithashtu dhe gjurmët e kornizave të fazës së dytë ndërtimore, të cilat rezultojnë dhe ato me një radhë tullash në formë dhëmbësh sharre (Fig. 30, 30.1)[6].
Të dhënat dhe elementet e zbuluara të mësipërme sugjerojnë një formë çatie, e cila i përgjigjet konceptit klasik kompozicional bizantin, pra kompozimit të shkallëzuar piramidal, në krye kupola mbi tambur që lartësohet mbi krahët e kryqit që projektohen me frontone trekëndore dhe poshtë tyre ambientet këndore të mbuluara me çati njëujëse (Fig. 32).

PROPOZIMET

1. Mbi mbulesën e çatisë së kishës

Nga vrojtimet e herëpashershme ishte konstatuar prania e tjegullave në kupolën e kishës (Fig. 33, 33.1). Këto të dhëna të çojnë në mendimin se mos kemi të bëjmë edhe këtu me të njëjtin dukuri si në rastet e shtatë kishave të periudhës bizantine (Kosinë, Berat, Zervat, Zvërnec, Mborje, Apolloni, Labovë), ku

[6] Gjatë pastrimin të mbushjeve ndërmjet krahut perëndimor të kryqit dhe ambientit këndor jugperëndimor u zbuluan një sasi qypash, shumë nga të cilët ishin të plotë (Fig. 31, 31.1). Mbasi u inventarizuan u dhanë për ekspertizë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik (ASHA).

DO NOT COPY







Fig. 33, 33.1, 34. Zbulimi i mbulesës fillestare të kishës me tjegulla

DO NOT COPY



Fig. 35. Zbulimi i qypave nën mbulesën e çatisë



Fig. 36. Propozimi për mbulesën e çatisë me tjegulla

gjatë procesit të restaurimit nën mbulesën aktuale u zbuluan tjegullat e fazës fillestare ndërtimore të monumenteve.

Fotografimi me dron i monumentit para fillimit të punimeve zbuloi dhe masën e ruajtjes së mbulesës me tjegulla në kupolë (Fig. 34).

Sondazhet na zbuluan përmasat e tjegullave dhe se ato ishin të vendosura me llaç mbi strukturën e kupolës. Ky fakt na konfirmon përfundimin se kemi të bëjmë me mbulesën origjinale të kishës.

Mbështetur në këto të dhëna u propozua që mbulesa e monumentit e fazës së parë ndërtimore të realizohet me tjegulla të njëjta me ato të zbuluarat, ndërsa faza e dytë ndërtimore, e cila gjithashtu i përket periudhës bizantine, të mbulohet me tjegulla të ndryshme nga ato të zbuluarat, për t'i dalluar fazat ndërtimore nga njëra-tjetra[7] (Fig. 36).

2. Mbi kompozimin volumetrik të jashtëm

Elementet e përftuara nga zhveshjet dhe sondazhet na japin mundësinë që në mënyrë të pagabuar të përcaktojmë formën fillestare të çatisë. Ruajtja e kornizave të çative të ambienteve këndore dhe të krahëve të kryqit, gjurmët e ruajtura në murin lindor, gjurmët e mbetura në muraturat, na japin me saktësi kuotat e çative dhe dekoracionin që ato përmbanin.

Zbulimi i ullukëve ndërmjet çative të ambienteve këndore dhe të fazës së dytë, mënyra e ndërtimit dhe ruajtja e gjurmëve të daljes së tyre në muraturën e kishës na krijoi bindjen se pjesët lindore dhe perëndimore të fazës së dytë të monumentit ishin dyujëse.

[7] Në kupolë në mbushjen nën mbulesë u zbuluan edhe këtu qypa të njëjta me ato të anës jugperëndimore (Fig. 35).

Mbas këtyre zbulimeve ngrihet pyetja: a do të kishte kuptim rindërtimi i çatisë së kishës në formën e gjetur mbas çmontimit të detyrueshëm të saj për qëllime konstruktive, duke e ngarkuar sërish konstruksionin, qoftë me materiale të lehta? A do të ishte e drejtë të fshiheshin elementet e zbuluara? A mund të neglizhohet rezultati që do të përftohej nga rikonstruksioni i formës fillestare të çatisë?

Në rastin konkret mendojmë se rikthimi i formës fillestare gjen mbështetjen dhe në aktet ndërkombëtare, siç është Karta e Venecies, apo Udhëzimet e ICROM-it, UNESCO-s e ICOMOS-it, në të cilat rekomandohen rastet kur një fazë mund të hiqet[8].

Pra rikthimi i formës fillestare të monumentit është plotësisht i përligjur, sepse jo vetëm se të dhënat janë plotësisht të mjaftueshme për ta realizuar këtë formë me saktësi që nuk le shteg për dyshime, por do t'i kthenim monumentit tiparin tipologjik të tij. Tiparet ende të paformuara të kompozimit planimetrik në formë kryqi e klasifikojnë këtë kishë si të fazës kalimtare, në një kohë që kompozimi vëllimor i jashtëm, është tipik për kishat në formë kryqi me kupolë. Kjo dëshmon për një fazë të avancuar drejt përsosjes së tipit, duke përforcuar këtë fenomen që vërehet në shumë monumente të rajonit, si dhe në kishën e Shën Marisë të Kosinës në vendin tonë[9]. Nga ana tjetër na zbulon tiparet e arkitekturës bizantine, në këtë fazë tranzitore si në tipologji, ashtu dhe dekoracion (Fig. 37, 38, 39).



Fig. 37. Propozimi për pamjen perëndimore të kishës

[8] Karta e Venecies, 1964, neni 11 ("…Kur një ndërtim bashkëmbart shumë faza ndërtimi, nxjerrja në shesh e një faze paraardhëse justifikohet veçse si përjashtim dhe me kusht që elementet e hequra të paraqesin pak interes, që kompozimi i nxjerrë në dritë të përbëjë një dëshmi të një vlere të lartë historike arkeologjike ose estetike dhe që gjendja e konservimit të saj të konsiderohet e mjaftueshme..."); Organizatat Ndërkombëtare ICCROM, UNESCO dhe ICOMOS: B. M. Feilden, J. Jokilehto, Udhëzimet për menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore Botërore, CHëB, 2010: ("Riintegrimi modern, apo plotësimi i pjesëve munguese përgjithësisht është i pranueshëm për sa kohë që ekziston një unitet potencial që krijon baza të qëndrueshme, të cilat lejojnë të ndërmerren këto veprime. Trajtimi i pjesëve të humbura bazohet në një vlerësim të kontekstit të tyre dhe ato duhen riintegruar duke u bazuar në dokumentacion. Në se riintegrimi nuk e përmirëson unitetin potencial të tërësisë... atëherë ky nuk do të ishte një veprim i përshtatshëm").

[9] Thomo P. "Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare të shek. XI-XIV", Studime Historike, 4, 1972.



Fig. 38. Propozimi për pamjen lindore të kishës



Fig. 39. Propozimi për pamjen jugore të kishës

DO NOT COPY

Monumenti gjatë dhe mbas restaurimit

Mbas miratimit të propozimeve për modifikimin e projektit të restaurimit u kryen punimet për konkretizimin e këtyre propozimeve.

Ndërhyrjet konsistuan në shëndoshjen e konstruksionit për t'i kthyer atij aftësinë mbajtëse të kompromentuar ndër vite.

Shmangia e dëmtimeve

Mbirja e tri pemëve në brendësi të kishës, ndonëse nuk ishte ndër shkaqet kryesore të dëmtimeve, kishin dhe ato ndikime negative në dobësimin e aftësisë mbajtëse. Për eliminim e tyre u parapëlqye prerja e tyre pjesë-pjesë, duke hapur muret nga kalonin. Tharja e tyre me pesticide apo metoda popullore nuk u duk e përshtatshme se do të krijonte zgavra në muraturë që mund të sillnin pasoja në të ardhmen (Fig. 40).

Qepjet e të çarave

Çarjet e strukturës ishin shfaqjet më të shpeshta që vëreheshin si në mbulesën e kurbëzuar (Fig. 41, 42), qemerë, harqe e kupolë, ashtu dhe në muraturë (Fig. 43). Në muraturë ato ishin të shumta, por më të rrezikshme vëreheshin në murin lindor (Fig. 44, 44.1), kryesisht në apsidën qendrore, në qoshen veriperëndimore dhe jugperëndimore të fasadës perëndimore (Fig. 45, 46) dhe në muri kontraforcë në anën veriore (Fig. 47).



Fig. 40. Copa drurësh të prerë nga pemët e mbira në brendësi të kishës



Fig. 41. Çarjet në sistemin e mbulesës















Fig. 42. Dëmtimet e strukturës së kurbëzuar të mbulesës

DO NOT COPY



Fig. 43 Dëmtimet në muraturën e kishës



Fig. 44. 44.1 Çarjet në apsidën qendrore

Çarjet e murit lindor shkonin duke u mbyllur nga lart-poshtë, gjë që na bën të supozojmë se ato nuk kanë rrjedher për ndonjë cedim apo dëmtim themeli. Megjithatë për të vërtetuar shkakun, një nga sondazhet gjeologjike për ekzaminim bazamenti dhe themeli, u bë pikërisht në rrëzë të apsidës (Fig. 48). U vërtetua kështu që çarja nuk shkonte dhe gjatë themelit. Shkak i çarjeve në këtë zonë duhet kërkuar nga hapja e pareteve të apsidës nga shtytjet horizontale të konkës së apsidës që mund të ketë rrjedhur nga mungesa ose dëmtimi i tirandës. Vendosja e një tirande metalike Φ18 në nivelin e bazës së konkës së apsidës u mendua si masë efikase për të thithur shtytjen horizontale pikërisht të kësaj strukture të kurbëzuar (shih Fig. 28).

Dëmtimet e anës veriore të pamjes perëndimore duken se nuk kanë ndodhur për herë të parë. Pikërisht këtu janë bërë kohë më parë përforcime si brenda, ashtu dhe nga jashtë. Shkak mund të ketë qenë dhe ndonjë rrëzim i pjesshëm, për deri sa dhe rindërtimi i qemerit të ambientit këndor veriperëndimor është në një kuotë më të lartë se ambientet këndore të tjera.

Muri kontraforcë verior me shumë gjasë është ndërtuar për të përballuar dëmtimet që do të ketë pësuar muri verior i kishës, si shmangie nga vertikaliteti për pasojë të mungesës së tirandave. Por me dëmtimet që ky mur ka pësuar duket se nuk mund të luante më rolin e tij për të cilin ishte ndërtuar, duke shkaktuar çarjet e shumta në sistemin e mbulesës dhe të murit lindor. Mungesa e dëmtimeve të anës jugore të kishës dëshmon se shtesa e bërë në këtë anë e ka luajtur mirë rolin të një farë kontraforce për të ekuilibruar shtytje horizontale të sistemit të kurbëzuar të mbulesës.

DO NOT COPY





Fig. 45. 46. Çarjet në anën veriore dhe jugore të murit perëndimor



Fig. 47. Çarjet në murin kontraforcë verior



Fig. 48. Sondazhi në themelin e apsidës qendrore

BOTIMET

Konsolidimi i këtyre pjesëve më të rrezikshme për qëndrueshmërinë statike nuk do të mjaftonte vetëm me fugatimet, qofshin dhe të thella dhe me qepjet. Do te duhej të plotësoheshin këto ndërhyrje dhe me injektime të muraturave. Në pjesët ku mungonte piktura murale injektimi u bë me pompë me presion deri në 1 atm, ndërsa në ato pjesë që mund të përmbanin pikturë u realizuan me gravitacion.
Dëmtime të ndjeshme vëreheshin dhe në mbulesën e kurbëzuar të monumentit (Fig. 14, 41, 42). Ngarkesa e tej madhe e ushtruar mbi të nga mbushjet mbas rindërtimit të çatisë, plakja e konstruksionit, efekti shkatërrues i pemëve të mbira në brendësi kishin shkaktuar këtë gjendje. Por prania e çarjeve edhe në kyçet e harqeve e qemerëve na sugjeron dhe shkakun e krijimit të tyre nga mungesa e tiradave që do të thithnin veprimin e shtytjeve horizontale. Vendosja e tirandave metalike do të ishte një zgjidhje për konsolidimin e konstruksionit të mbulesës. Por vendosja e tyre në kompozimin aktual planimetrik e hapësinor mbas shtesave në anën jugore e veriore dhe përforcimeve me mbathje të muraturës e pilastrave, e bënte të vështirë dhe jo efikase vendosjen e tyre. Gjithashtu me konsolidimin e murit shtesë verior iu rikthye funksioni i tij i kontraforcës. Në këto rrethana u parapëlqye konsolidimi i strukturës me fibra karboni, mbasi e gjithë struktura e dëmtuar u shëndosh me qepje e fugatime (Fig. 49, 50, 51).
Për shmangien e çdo dëmtimi eventual në muraturën e tamburit u vendos një tirandë rrethore në krye të saj.
Mbi strukturën tashmë të shëndoshur u shtrua një shtresë llaçi horasan (Fig. 52, 53) dhe mbi të shtresa me tjegulla bizantine. Duke pasur modelin origjinal të tjegullave të gjendura në mbulesë, u prodhuan tjegulla në mënyrë artizanale me të njëjta forma, përmasa dhe përbërje (Fig. 54).

Studimi i kushteve gjeologo-inxhinierike

Duke studiuar patologjinë e monumentit me gjithë dëmtimet që ai kishte pësuar duhej sqaruar pyetja nëse këto dëmtime rridhnin edhe nga shkaqe të gjeologjisë së terrenit ku mbështetej kisha. Për







Fig. 49, 50, 51. Vendosja e fibrave të karbonit



Fig. 52. Vendosja e shtresës së horasanit



Fig. 53. Vendosja e shtresës së horasanit

këtë qëllim u krye një studim i kushteve gjeologo-inxhinierike i zonës për të përcaktuar karakteristikat fiziko-mekanike të dherave dhe shkëmbinjve të zonës ku mbështetej ndërtesa[10]. Studimi konsistoi në kryerjen e një rilevimi gjeologjik të detajuar, kryerjen e dy shpimeve gjeologjike me thellësi 10.0 m, kryerjen e një sondazhi për analizimin e thellësisë dhe gjendjes së themeleve, kryerjen e analizave laboratorike dhe, në bazë të tyre, përcaktimin e karakteristikave fiziko-mekanike të shtresave të ndryshme gjeologjike (Fig. 55).

Si përfundim tejet i rëndësishëm i studimit për shkaqet e dëmtimit të strukturës së kishës ka qenë dhe baza ku mbështeteshin themelet. Ajo përbëhej nga formacione argjilore, në të cilat kanë ndodhur fenomeni koloidal i materialeve argjilore, të cilat në prezencë të lagështisë fryhen dhe në prezencë të thatësisë çahen. Një luhatje e tillë duke ushtruar për vite një presion në themelet e kishës, dyshim do të sillte dhe pasojat negative në dëmtimet e strukturës së mureve dhe të mbulesës.

Sipas rekomandimeve të studimit përreth muraturës së themeleve u ndërtua një sistem drenazhimi, duke vendosur në anën e jashtme një shtresë çakulli dhe zhavorri. Kjo masë e marrë do të ruajë një lagështi konstante në zonën e themeleve dhe do të zvogëlojë ndikimin negativ të presionit të shtresës argjilore gjatë ndryshimit të gjendjes së tyre, nga thatësira dhe lagështira.

Një masë tjetër suplementare e ndërmarrë ishte dhe ndërtimi i trotuareve përreth monumentit dhe kunetës përbri tyre për largimin e ujërave sipërfaqësorë.

Gjatë hapjes së themeleve për ndërtimin e sistemit të drenazhimit na u dha mundësia e konsolidimit të themeleve të përgjithësi dhe, në mënyrë të veçantë u bënë përforcime aty ku ato kishin pësuar dëmtime të konsiderueshme.

Ripërtëritja e dekoracionit dhe e mobilimit të brendshëm

Krahas ndërhyrjes për shëndoshjen dhe konsolidimin statik të monumentit vëmendja u përqendrua dhe në nxjerrjen në dritë të veshjes dekorative të monumentit të jashtëm e të brendshëm.

Siç e kemi vënë në dukje dhe më sipër, përpunimi dekorativ i pamjeve të jashtme është tepër i përmbajtur, mbizotëron masa e muraturës së gurtë. Megjithatë nuk ka munguar krejtësisht përkujdesja dekorative. Ajo është përqendruar te elementet

[10] Studimi u krye nga "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000", kryesuar nga Ing. Gjeolog Skënder Allkja.





Fig. 54. Pamje gjatë procesit të vendosjes së tjegullave

Fig. 55. Pikat e sondazheve gjeologjike

DO NOT COPY



Fig. 56. Ripërtëritja e dekoracionit në fasadën lindore

më të spikatura të trajtimit arkitektonik dhe tepër të përdorshme në monumentet bizantine, siç janë dritaret dyshe në frontonet, tambur, madje në apsidë ato janë treshe e të shoqëruara me dritare të tjera anash asaj qendrore. Këto elemente paraqitës të fasadave janë të harkuara të ndërtuara me tulla e të kornizuara me një shirit po prej tullash (Fig. 56). Elemente të tjera të rëndësishme të trajtimit janë dhe kornizat që përfundojnë muraturat. Ato nuk realizohen me gurë, siç i gjejmë në shumë muratura prej guri, por, në përshtatje të arkitekturës bizantine, dhe ato janë realizuar me tulla: tamburi përfundon me një kornizë të fuqishme me dy radhë tullash të vendosura në formë dhëmbë share ndërmjet radhëve të drejta, ndërsa muraturat e krahëve të kryqit dhe të ambienteve këndore përfundojnë me



Fig. 57. Gjurmë të diafragmave në frontonin verior

korniza me një radhë në formë dhëmbësh sharre.
Një element tjetër me vlerë i mbetur në frontonin verior ishte dhe një pjesë e diafragmave të dritareve. Ato ishin të thjeshta, me një hapësirë rrethore, prej nga u mor modeli për prodhimin e diafragmave munguese (Fig. 57).
Një dekoracion i tillë i përmbajtur është një tjetër tregues i tipareve që e karakterizojnë këtë monument si të një faze tranzitore drejt formimit të tipit në formë kryqi me kupolë. Për të evidentuar më qartë këtë tipar të rëndësishëm, dekoracioni u pastrua dhe vende-vende u plotësua.
Në ndryshim me kishën, shtesa në anën jugore, si ndërtim i një faze më të vonë, i ka të gjitha pamjet të dekoruara pasurish: pjesa e poshtme e muraturës është ndërtuar me teknikën e kluasonazhit, ndërsa pjesët e sipërme janë te veshura me motive të shumëllojshme me tulla. Pastrimet dhe riparimet e pjesshme ishin ndërhyrjet që u bënë këtu për të nxjerrë në dukje këtë dekoracion (Fig. 58).
Në interier ndërhyrjet u përqendruan së pari në konservimin e pikturës të ikonostasit të gurtë, ndërtuar në vitin 1510[11]. Piktura kishte pësuar dëmtime të strukturës, si dhe një nxirje që e bënte të palexueshme atë. Sondazhet e kryera dëshmuan për vlerat artistike të pikturës, të cilat përcaktuan dhe

[11] Konservimi i pikturës së ikonostasit u krye nën drejtimin e Dr. Edlira Çaushit.

DO NOT COPY



Fig. 58. Ripërtëritja e dekoracionit të shtesës jugore

masat e ndërhyrjes konservuese. Ato konsistuan në konsolidimin e gruntit, fiksimin e pelikulit dhe në fund në pastrimin nga pluhurat e bloza deri në atë masë për t'i bërë më të lexueshme vlerat artistike që përmbante (Fig. 59, 60).

Ndërhyrje konservimi u kryen dhe në pajisjet e brendshme, ikonostasit prej druri, amvonit, fronit peshkopal, proskinitarëve, karriget e besimtarëve, që konsistuan në meremetimet e pastrimet e tyre (Fig. 61, 61.1, 62, 63).

Një kujdes i veçantë iu kushtua dhe pastrimit të sinthronit nga llaçrat e lyerjet me gëlqere për të evidentuar pamjen e tij, si elementin dallues të kësaj kishë si kishë peshkopale (Fig. 64).

DO NOT COPY





Fig. 59, 60. Konservimi i ikonostasit prej druri dhe i pikturës të ikonostasit të gurtë







Fig. 61, 62, 63. Konservimi i mobilimit të brendshëm

DO NOT COPY



Fig. 64. Ripërtëritja e sinthronit

Përfundime

Nga sa parashtruam më sipër ndërhyrjet në monument ishin të karakterit konsolidues dhe atij morfologjik.

Ndërhyrjet konsoliduese diktoheshin nga gjendja thuajse katastrofike e monumentit si pasojë e mungesës totale të mirëmbajtjes, por dhe e përbërjes së shtresave gjeologjike mbi të cilat ngrihej kisha. Eliminimi i shkaqeve të dëmtimeve, si prerja e pemëve që kishin mbirë në brendësi të kishës, apo marrja e masave për zvogëlimin e efekteve negative që ushtroheshin nga shtresat gjeologjike mbi themelet e ndërtesës, ishin masat e para të ndërmarra, para se të ndërmerreshin ndërhyrjet për shëndoshjen dhe konsolidimin të konstruksionit të muraturës dhe të mbulesës së kurbëzuar.

Diskutime pati dhe për propozimin e kthimit të kompozimit volumetrik të jashtëm në formën fillestare. Argumentet për këtë propozim ishin të bazuara, së pari, në procesin e ndërhyrjeve të detyruara. Konstruksioni i mbulesës së brendshme të kurbëzuar kishte rezultuar tejet i dëmtuar dhe për konsolidimin e saj detyrimisht do të çlirohej nga mbulesa e çatisë dhe e mbushjeve nën të. Rikthimi i mbulesës në formën e gjetur thjesht për ruajtjen e memories historike, ose të pretenduar fazë historike do të ishte krejtësisht formal, sepse do të kishim të bënim me një element tashmë të ri, ndërsa forma e re e mbulesës së çatisë nuk ishte bërë për ndonjë qëllim përmirësimi struktural që duhej të ruhej, por përkundrazi e kishte dëmtuar strukturën nga ngarkesa e madhe që ushtrohej mbi të. Se dyti, gjatë procesit të restaurimit u zbuluan kaq shumë elemente, sa që e bënin shumë të lexueshme kompozimin vëllimor të jashtëm. Fshehja ose zhdukja e këtyre elementeve do të ishte e palejueshme, sepse do të privonte studiuesit për njohjen e ekzistencës së tyre, por do

të ishin njëkohësisht dhe prova për të gjykuar mbi vërtetësinë e restaurimit.
Që të bëhet i plotë arsyetimi bazuar te Karta e Venecies, apo Udhëzimeve të ICCROM, UNESCO dhe ICOMOS, duhet të vërtetonim se çfarë rezultoi me heqjen e çatisë së gjetur.
Në studimet për këtë monument, ai është klasifikuar si i faze tranzitore drejt formimit të tipit në formë kryqi me kupolë, madje ky tipar ndërmjet të tjerave kishte shërbyer dhe si argument datimi. Fenomene të fazave tranzitore i ndeshim edhe në vendit tonë. Kështu në kishën e Shën Marisë të Labovës së Kryqit kemi kombinimin e tipit me plan qendror në brendësi dhe atij në formë kryqi me kupolë ne kompozimin e vëllimor të jashtëm. Në kishën e Shën Marisë së Kosinës shohin kompozim ende të paformuar planimetrik të tipit në formë kryqi me kupolë, në një kohë kur në kompozimin vëllimor të jashtëm tiparet e tipit në formë kryqi me kupolë janë tërësisht të plotësuara. Në të dy këto monumente struktura e jashtme në formë kryqi me kupolë nuk është cenuar nga meremetimet ose shtesat e bëra në ndërtesë. Përkundrazi në kishën e Peshkëpisë së Sipërme kjo strukturë është fshehur nga rindërtimi i çatisë. Duke rikthyer strukturën origjinale ne kemi fituar një monument të plotësuar me të gjitha tiparet karakteristike që ai ka pasur si pasqyrim i periudhës së ndërtimit (Fig. 65, 66, 67, 68).



DO NOT COPY







Fig. 65, 66, 67, 68. Pamje të monumentit mbas ndërhyrjeve konsoliduese dhe restauruese

DO NOT COPY

Prof. Pirro THOMO
Ark. Rest. Arben SPAHO
Ing. Rest. Alfred ÇOMA

RESTORATION OF THE CHURCH OF ST. MARY IN PESHKËPI E SIPËRME, GJIROKASTËR

The church of St. Mary in the village Peshkëpi e Sipërme is situated in the region of Dropull, which extends along the Drinos River valley, at the level area of the precipitous slope the Mali i Gjerë mountain chain and Stugara Mountain. This region is probably the place for the identification of the Seat of the Episcopate of Dryinoupolis. The hypothesis which places the seat of the Episcopate of Dryinoupolis in the village Peshkëpi is supported not only by the name of the village but also by the existence of the church of St. Mary, which distinguishes for its three - stage synthronon placed against the apse combining the bishop's throne in the center and the benches reserved for the clergy.
The inscription in the eastern wall mentions the construction of the church of St. Mary in Peshkëpi e Sipërme during the reign of the byzantine emperor Alexius Comnenus in 619. According to Theophan Popa, this date probably recalls the legend related to the construction of the church, given the known fact that Alexius I Comnenus was byzantine emperor from 1081 – 1118.
In his study dedicated to the church, A. Meksi quotes the data provided by the British traveller Sir Henry Holland, who during his visit of the church in 1812 had read an inscription mentioning the construction of the church from the byzantine emperor Manuel Comnenus, who reigned from 1143 – 1180. Based on the new data and also in the combination of the peculiarities that display the plan, the exterior and interior volumetric composition of the church and its architectural and decorative rendering, Meksi suggested a chronology around the end of 11th century till mid of 12th century which is probably closer to the truth.
The church of St. Mary is a cross – in – square type of church, with three apses in its eastern wall, but showing partially completed features. This is more evident in the proportions of the external volumetric composition and the simple architectural and decorative arrangement.
The simple decorative rendering of the exterior slightly tends to break by a restrained brick laid decoration that runs at the level of the springing of the apse windows arch, the cut – tile bands ornamenting the dome windows and the cloisonné brickwork patterns running around the dome surface.
Against the central apse took place the arrangement of the synthronon, a characteristic feature for the Episcopal churches.
Inside the church and its environments are preserved ancient architectural fragments, as well as ornamented pieces of slabs. Between the eastern pair of pilasters is constructed a walled iconostasis decorated with mural paintings. Its construction is securely dated to 1510 by an inscription. Close to the walled iconostasis was placed another wooden iconostasis.
In a second phase was made an extension consisting on a barrel vaulted space. Unlike the simple decorative rendering of the naos, this space shows

a rich ceramoplastic decoration. The decorative patterns and the motifs involved safely date this space in 13th – 14th century.

State of Monument

During its existence the monument was subjected to many damages, a fact sustained also by the substantial transformations underwent through centuries that affected its structure and reinforcement interventions, documented also by some of the preserved inscriptions. The reinforcement interventions of the interior were primarily concentrated to the consolidation of the pilasters and parts of the western wall, while to the exterior consisted in the contravention of the northern wall. In spite the interventions the longtime lack of the maintenance had caused considerable damages in the monument structure, which could bring the risk of collapse. Large fissures were visible in the walls and also in the domed covering system of the monument.

Important elements revealed during the restoration interventions

The dismantling of the roof was a necessary enterprise for the consolidation of the domed damaged structures providing also a clear panorama for the understanding of the structural arrangement of the building and other important information for the decorative and architectural rendering.

The dismantling of the roof discovered the filling of the structure with heavy inert material and stones, which combined with the stone slabs covering of the roof, exerted a considerable pressure to the already damaged construction. The inert filling had also hidden the original cross shape of the exterior volumetric composition.

THE PROPOSALS

1. The roof covering

Occasional observations of the monument have identified the presence of tiles over the dome of the church. Test pits conducted in this area discovered the dimensions of the tiles and the way they were laid with mortar over the dome structure. This fact also confirms that this was the original roof covering of the building. Based on the new data was proposed that the covering of the first phase of the monument with similar tiles, while for the second building phase, which also dates in byzantine period, was proposed the use of different tiles, in order to distinguish both constructive phases from each other.

2. The exterior volumetric composition

The elements obtained from the dismantling and small scale investigations provide secure data to determine the initial structure of the roof. Based on the international set of guidelines, as the Venice Charter, ICROM, UNESCO and ICOMOS principles, was proposed the restoring of the external volumetric composition of the church. Both proposals were approved by National Council of Restoration.

State of the monument before and after the restoration works

Following the approval of changes demanded in the initial restoration project the work continued according to the new proposals.

The interventions in the monument aimed primarily the consolidation and stability of the construction, assuring the compromised through years' solidity of the structure, and were also of morphological character in order to ensure the original exterior volumetric composition, the restitution of the decoration and of the other artistic values.

DO NOT COPY

Gentian VOKOPOLA

RESTAURIMI I DISA IKONAVE

Gjatë viteve të fundit, në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore janë kryer ndërhyrje me qëllim konservim – restaurimin e disa ikonave të fondit të Muzeut Historik Kombëtar. Njëra nga ikonat dhe konkretisht "Shën Athanasi" me autor Mihal Anagnostin, marrë nga Katedralja e Elbasanit me Nr. kartele 3688 ndodhet e ekspozuar në Pavionin e Artit Mesjetar në MHK. Tre ikonat e tjera, "Mandili i Krishtit", marrë po nga Katedralja në Elbasan me Nr.kartele 5468, "Shën Maria me Krishtin", marrë nga kisha Shën Qirjako e Julita në Dhuvjan të Gjirokastrës me Nr.kartele 5666 dhe "Mbledhja e Kryeengjëjve", marrë nga kisha Shën Mëhilli në Mingul të Gjirokastrës me Nr.kartele 5639, janë me autor anonim dhe bëjnë pjesë në fondin e ikonave po në MHK.

Procesi i konservimit të tyre u shoqërua dhe me kryerjen e analizave me metodën XRF, për t'i paraprirë proceseve të mëvonshme restauruese që do të kryheshin në to. Gjatë këtyre ekzaminimeve u kryen matje arkeometrike të cilat përfshijnë matjet që synojnë karakterizimin e pigmenteve të përdorura nga artisti.

Grupi i punës që restauroi këto ikona i përbërë nga specialistët e Sektorit të Veprave të Artit Enkelejda Nesturi, Spiro Laçka, Genci Treska dhe Gentian Vokopola, duke konstatuar shkallën e dëmtimit në ikonën "Shën Athanasi" dhe boshllëkun që ajo krijonte në Pavionin e Artit Mesjetar, vendosën që kjo ikonë të trajtohej e para nga katër ikonat.

Ikona "Shën Athanasi"

Në këtë ikonë është interpretuar figura e "Shën Athanasit të Aleksandrisë", i quajtur gjithashtu dhe "Athanasi i Madh", i cili lindi në fund të shek. III 296–298 dhe ndërroi jetë në 2 maj 373. Athanasi i Madh ishte Peshkopi i njëzetë i Aleksandrisë, një teolog i njohur i krishterë dhe mbrojtësi kryesor i trinitetit kundër arianizmit.

Duke studiuar teknikat e realizimit të kësaj ikone konstatuam që ajo është punuar me një suport me dru arre, një shtresë telajo e hollë mbi të cilën është aplikuar shtresa pregatitore me xheso dhe mbi të pelikuli i ngjyrës e shtresa e arit mbi bolo. Mbi shtresën e arit aplikohet një shtresë e trashë jeshile rezinate bakri në formë zmalti, ndërsa pelikuli i ngjyrës së kuqe, duket të jetë përzierje e të bardhës së plumbit me llakun e kuq.

Si pasojë e kushteve jo të përshtatshme në mikroklimën e pavionit ku qëndron ikona "Shën Athanasi", nga luhatjet e mëdha të temperaturave, u përballëm me shkëputje të shtresave përgatitore nga suporti të orientuara kryesisht vertikalisht. Ringjitja e këtyre shtresave u konsiderua një ndërhyrje e vështirë pasi paraqitej shumë e ndjeshme ndaj tretësve ujore por dhe e rrezikuar nga thyerjet apo fragmentimet. Zonat e shkëputura u zbutën me infiltrimin e alkolit të përzier me ujë (në proporcion 3:7) dhe më pas u injektua *Akril33* i holluar me ujë (në proporcion 70:30). Kjo lidhje e shtresave u bë nëpërmjet një presioni të lehtë me *termokauterio* mbi një letër *melinex* dhe më pas duke e lënë nën një peshë deri në tharjen e plotë. Disa vite më parë

për ikonën "Shën Athanasi" ishin kryer analizat diagnostikuese dhe ndërhyrje restauruese, kështu që ajo nuk paraqiste nevojë për pastrim nga verniku i dekompozuar apo për ndërhyrje të tjera me karakter të unifikimit piktorik (Fig. 1, 2).
Hartimi i dokumentacionit grafik dhe fotografik si dhe ndërhyrja konservuese për tre ikonat e tjera u shoqërua edhe me kryerjen e analizave me metodën XRF për verifikimin e materialeve të përdorura (grund, pigmente, papastërti), për t'i paraprirë kështu në mënyrë sa më të saktë ndërhyrjeve restauruese. Të gjitha analizat që do të shpjegojmë më poshtë, në mënyrë të detajuar sipas ikonave si dhe interpretimi i tyre janë kryer dhe dokumentuar nga Prof. Dr. Nikolla Civici, specialist në Institutin e Fizikës Bërthamore të Aplikuar, në bashkëpunim me specialistët restauratorë të artit në IKTK.

Ikona "Mandili i Krishtit"
Skena e interpretuar në ikonën "Mandili i Krishtit" paraqet portretin e Krishtit në një pëlhurë që mbahet nga dy engjëj. Frymëzimi për realizimin e



Fig. 1. Shkëputje nga suporti



Fig. 2. Pas restaurimit

DO NOT COPY

kësaj skene në ikonografi, ka ardhur nga historia e Shën Veronikës, e cila, e shtyrë nga keqardhja kur e pa Jezusin duke mbajtur kryqin e tij i dha vellon e saj që ai të fshinte ballin. Duke e pranuar këtë gjest Jezusi e mbajti velin në fytyrën e tij dhe ja ktheu përsëri por me imazhin e fytyrës së tij të fiksuar në të. Kjo copë pëlhurë u bë e njohur si Veli i Veronikës kurse në ikonografi quhet dhe Mandili (Shamia) i Krishtit.
Ikona paraqitej në një gjendje të keqe konservuese, e ndarë në dy pjesë dhe e mbuluar me një shtresë të trashë e mjaft të nxirë verniku të dekompozuar. Suporti i drurit ishte i dëmtuar nga sulmi i insekteve ksilofagë dhe me pelikulin e ngjyrës mjaft të dëmtuar.
Ndërhyrja në këtë ikonë filloi me disifektimin e suportit me *PERXIL* duke e aplikuar me furçë. Pasi u la për 20 ditë rresht e mbuluar me plasmas, ndërhyrja vazhdoi me ngjitjen e dy pjesëve me ngjitësin e drurit *Carpenters Wood Glue,* me ndihmën dhe të morsetave. Konsolidimi i suportit të drurit u krye me *Paraloid B72* 3% të tretur në *aceton*. Për bashkimin e dy pjesëve dhe përforcimin e saj u përdor dhe një traversë e re që ikonës i mungonte. Konsolidimi i pelikulit piktorik dhe grundit u krye me aplikimin e velinaturave me letër japoneze të cilat u shtrinë me kujdes me penel në të gjithë sipërfaqen e ikonës me *ngjitës lepuri* të shkrirë me ujë në raportin 1:13, velinatura të cilat u hoqën me kujdes me ujë të ngrohtë (Fig. 3).
Para se të kryeshin analizat, u kryen disa sondazhe për të përcaktuar vendet të cilat do t'i nënshtroheshin matjeve, pasi verniku i nxirë nuk lejonte shikueshmëri të mjaftueshme për kryerjen e tyre. Një nga këto sondazhe ishte *Testi i tretshmërisë Wolbers-Cremonesi*, i cili nuk dha rezultat. Duke vazhduar metodologjinë e pastrimit, u kryen dhe sondazhe me *Resin Soap DCA-TEA ph 8,5* dhe me *Solvent Gel fd 47* të cilat nuk dhanë rezultat të kënaqshëm. Në fund



Fig. 3. Velinatura me letër japoneze

të këtyre sondazheve u vendos që pastrimin e sipërfaqes së pikturuar ta vazhdonim me një përzierje *DMSO* dhe *Etilacetat* në raportin 50:50 në formë të lire, me tampona të vegjël pambuku e me kujdes, si dhe me neutralizim të shpejtë me *ligroinë*.
Gjatë kryerjes së analizave nuk u vunë re pjesë grundi të zhveshura që të kryheshin matje direkt, por prezenca e elementeve Ca dhe Sr tregon që pjesa e grundit të ikonës duhet të jetë përgatitur prej gëlqeres, megjithëse të dhënat nuk përjashtojnë dhe përdorimin e gipsit. Pigmenti i përdorur për ngjyrën e bardhë është e bardha e plumbit, kurse pigmenti i ngjyrës së kuqe është përdorur për ngjyrën kafe dhe të kuqe duke sugjeruar përdorimin e okrës së kuqe. Për ngjyrën jeshile duket të jetë përdorur jeshile e përzier me të bardhë apo të kuqe Pb. (Shih tabelën përmbledhëse Nr. 1).

Tabela përmbledhëse nr. 1

Nr.	Ngjyra	Elementet kryesore	Elementet minore	Pigmenti/Materiali
1	Okër e ndotur (Bardhë??)	Pb	Ca, Sr, Fe	Bardhë Pb
2	Kafe	Fe	Ca, Sr, Pb, Hg	Okër e kuqe
3	Verdhë	Au, Pb	Ca, Sr, Fe	Ar
4	Jeshil	Pb, Fe	Ca, Sr, Cu	Dhe jeshil + Bardhë Pb
5	Kuqe	Pb, Fe	Ca, Sr, Cu	Okër e kuqe + Bardhë/Kuqe Pb



Fig. 4. Para restaurimit



Fig. 5. Pas restaurimit

Pas pastrimit u krye stukimi me *Gesso di Bologna* dhe integrimi piktorik me teknikën e *tratteggios* me ngjyra akuarele (*Winsor & Newton*). Në përfundim të integrimit piktorik sipërfaqja e ikonës u vernikos me vernik *Lefranc & Bourgeos* (*Vernis a Retoucher J.G.Vibert*). (Fig. 4, 5)

Ikona "Shën Maria me Krishtin"

Ikona që ka të interpretuar Shën Marinë në paraqitjen ikonografike Orans (Lutje) me Krishtin Emanuel, paraqitej e ndarë në dy pjesë dhe binin në sy mungesa të shtratit pregatitor dhe pelikulit të ngjyrës. Edhe për këtë ikonë ndërhyrja filloi me disifektimin e suportit me *PERXIL* duke e aplikuar me furçë. Pasi u la për 20 ditë e mbuluar me plasmas ndërhyrja vazhdoi me ngjitjen e dy pjesëve me ngjitësin e drurit *Carpenters Wood Glue* me ndihmën dhe të dy morsetave si dhe u përforcua me vendosjen e dy traversave të reja të cilat i mungonin ikonës. (Fig. 6)

Konsolidimi i suportit të drurit u krye me *Paraloid B72* 3% të tretur në *aceton*. Konsolidimi i pelikulit

DO NOT COPY



Fig. 6. Dy pjesët e ikonës



Fig. 7. Ikona e ngjitur dhe velinatura

piktorik dhe grundit u krye me aplikimin e velinaturave me letër japoneze të cilat u shtrinë me kujdes, me penel në të gjithë sipërfaqen e ikonës, me *ngjitës lepuri* të shkrirë me ujë në raportin 1:13, velinatura të cilat u hoqën me kujdes me ujë të ngrohtë (Fig. 7). Puna vazhdoi me mbushjen e lakunave me *gesso di bologna* me lidhës *ngjitësin e lepurit* të shkrirë në ujë në raportin 1:9.

Për një ndërhyrje sa më profesionale u kryen dhe disa sondazhe paraprake të pastrimit të sipërfaqes së pikturuar. Një nga këto sondazhe ishte, *Testi i tretshmërisë Wolbers-Cremonesi*, i cili filloi të reagojë ndërmjet fd 77 dhe fd 47. Niveli optimal u konstatua ndërmjet mishelave *LA5* me fd 72 dhe *LA6* me fd 67. Duke vazhduar metodologjinë e pastrimit, u kryen dhe sondazhe me *Resin Soap DCA-TEA* ph 8,5 i cili nuk dha rezultat të kënaqshëm dhe me *Solvent Gel* fd 47, që rezultoi agresiv. Në fund të këtyre sondazheve vendosëm që pastrimin e sipërfaqes së pikturuar ta vazhdojmë me mishelën *LA5*, në formë të lirë me tampona të vegjël pambuku, pasi vepron në mënyrë selektive dhe të ngadaltë.

Në këtë ikonë nuk u matën pjesë të grundit pasi nuk ishim të sigurt nëse pjesët e zhveshura i përkisnin shtresës origjinale. Prezenca e elementeve Ca, S dhe Sr pothuaj në të gjitha pikat e matura na bën të mendojmë që pjesa e grundit të ikonës duhet të jetë pregatitur prej gipsi. Disa matje në pika të ndryshme me ngjyrë të verdhë tregojnë se ngjyra okër e zbardhur e ndotur, duket të jetë një përzierje e të bardhës së Ca me okër të verdhë e të kuqe dhe e verdha e Pb (masikot apo gialino), ndërsa ngjyra e verdhë e fortë në pikën Nr. 6 dëshmon përdorimin e të verdhës së Pb (masikot apo gialino) pothuaj të pastër. Ngjyra e kuqe evidenton Pb si element kryesor që sugjeron përdorimin e të kuqes me bazë plumbi. (Shih tabelën përmbledhëse Nr. 2).

Tabela përmbledhëse nr. 2

Nr.	Ngjyra	Elementet kryesore	Elementet minore	Pigmenti/Materiali
1	Kuqe	Pb	Ca, Sr, Fe	Kuqe Pb
2, 3	Okër e ndotur	Ca, Fe, Pb	S, Sr	Bardhë Ca + okër + Masikot (apo gialino)
4	Verdhë e ndotur	Ca, Fe, Pb	S, Sr	Bardhë Ca + okër + Masikot (apo gialino)
5	Verdhë e ndotur	Ca, Fe, Pb	Sr, S	Bardhë Ca + okër + Masikot (apo gialino)
6	Verdhë	Pb	Ca, Sr, S, Fe	Masikot (apo gialino)
7	Kuqe	Pb	Ca, Fe	Kuqe Pb

Pas pastrimit u krye stukimi me *Gesso di Bologna* dhe integrimi piktorik me teknikën e *tratteggios* me ngjyra akuarele (*Winsor & Newton*). Në përfundim të integrimit piktorik sipërfaqja e ikonës u vernikos me vernik *Lefranc & Bourgeos* (*Vernis a Retoucher J.G.Vibert*). (Fig. 8, 9, 10)



Fig. 8. Para restaurimit



Fig. 9. Gjatë restaurimit

DO NOT COPY



Fig. 10. Pas restaurimit

Ikona "Mbledhja e Kryeengjëjve"

Skena e interpretuar prezanton një pikturim të tetë kryeengjëjve me një medalion në qendër të ikonës me figurën e Krishtit në fron. Ikona paraqitej në gjendje mjaft të degraduar, me pothuaj gjysmën e poshtme të saj të fragmentarizuar nga thyerjet që shtresat pregatitore dhe pelikuli i ngjyrës kishin pësuar me kalimin e kohës, lëvizjet e tyre nga vendi i interpretimit dhe lakunat e krijuara nga humbja tërësore e të gjitha shtresave. Ikona duket se i ka mbijetuar një zjarri pasi ka shenja të suportit të djegur në disa zona. Rilidhja e shtresave përgatitore me suportin u konsiderua veçanërisht e vështirë në rastin e kësaj vepre. Ndërhyrja e parë emergjente ishte vendosja e fragmenteve në vendin e tyre dhe ringjitja e tyre, e cila u krye sipas rastit me *ngjitës lepuri* të shkrirë me ujë në raportin 1:13 apo dhe me *Akril33* i holluar me ujë (në raportin 70:30). Pas stabilizimit të gjendjes u krye konsolidimi pjesor i shtresës së ngjyrës duke aplikuar letër japoneze me *ngjitës lepuri* të holluar në ujë me raportin 1:13. (Fig.11, 12)

Edhe për gjendjen e suportit nuk mund të flitej për një gjendje të mirë të konservimit kështu që kryem disifektimin e ikonës me *PERXIL* dhe konsolidimin e drurit me *Paraloid B72* 3 % të tretur në *aceton*.



Fig.11. Velinatura me letër japoneze



Fig.12. Ngjitja me termokauterio

Edhe këtu metodologjia e pastrimit ndoqi shembullin e ikonës **"**Shën Maria me Krishtin**".** U kryen disa sondazhe paraprake të pastrimit të sipërfaqes së pikturuar. Një nga këto sondazhe ishte, *Testi i tretshmërisë Wolbers-Cremonesi*, i cili filloi të reagojë ndërmjet fd 72 dhe fd 47. Niveli optimal u konstatua ndërmjet mishelave *LA6* me fd 67 dhe *LA7* me fd 62. Duke vazhduar metodologjinë e pastrimit, u kryen dhe sondazhe me *Resin Soap DCA-TEA* ph 8,5 i cili nuk dha rezultat të kënaqshëm dhe me *Solvent Gel* fd 47, që rezultoi agresiv. Në fund të këtyre sondazheve vendosëm që pastrimin e sipërfaqes së pikturuar ta vazhdojmë me mishelën LA6, në formë të lirë me tampona të vegjël pambuku, pasi vepron në mënyrë selektive dhe të ngadaltë. (Fig.13)



Fig.13. Sondazhet e pastrimit

Gjatë fillimit të pastrimit të ikonës vumë re praninë e mjaft ndërhyrjeve të mëparshme si në mbushjen e shtresës pregatitore ashtu dhe në ripikturime të shumta, ndërhyrje këto që u konfirmuan dhe nga analizat e kryera. Këto ndërhyrje amatore e të një cilësie të dobët evidentohen qartë me përdorimin e *porporinës* (varakut) në zonat ku ka patur shtresë ari e cila me kalimin e kohës është dëmtuar, por dhe me kaligrafinë të interpretuar dukshëm nën nivelin e kaligrafisë origjinale.

Prezenca e elementeve Ca dhe S, e shoqëruar me përmbajtje të ulëta të Sr e Fe, të matura në pikën Nr. 2, grund i zhveshur, dëshmon që pjesa e grundit



Fig. 14. Para restaurimit

DO NOT COPY



Fig. 15. Gjatë restaurimit

të ikonës duhet të jetë përgatitur prej gipsit. Prania në mjaft nga pikat e matura e sasive të vogla të Zn, Ba, e Pb mund të shpjegohet me ekzistencën e një shtrese përgatitore të hollë prej lipotomi (përzierje e të bardhave të Pb, Zn e Ba). Nëse kjo është e vërtetë, të paktën ato pjesë të ikonës duhet të jenë ripikturime të fundit të shek. 19 apo fillimit të shek. 20. Në ikonë janë matur dhe disa pika me ngjyrë të



Fig. 16. Pas restaurimit

verdhë e me tonalitete të ndryshme, nga ku rezulton se në aureolat e engjëjve, për ngjyrën e verdhë është përdorur ar me karat të ulët (përqëndrim i lartë i Cu e Zn). Për ngjyrën e fytyrës duket të jetë përdorur një përzierje e okrës me pak cinabar. Disa nga nuancat e ngjyrës së kuqe evidentojnë në pikën 11, 12 si elementë Hg, me sasi më të ulët Pb, ndërsa në pikën 8 me ngjyrë të kuqe të errët elementin Pb. Ngjyra kafe në pikën 10 duket e përgatitur nga përzierja e okrës së kuqe me të bardhë apo të kuqe Pb. Në spektrat e matur me ngjyrë jeshile në pikat 1 dhe 3 sfond

Tabela përmbledhëse nr. 3

Nr.	Ngjyra	Elementet kryesore	Elementet minore	Pigmenti/Materiali
1	Sfond i errët (jeshil)	Cu, As	Ca, Sr, Fe	Emerald Green (1820)
2	Grund	Ca, S	Sr, Fe, Cu	Gips
3	Sfond i errët	Cu, As	Ca, Sr, Fe	Emerald Green
4	Okër e verdhë	Cu, Fe, Zn	Ca, Sr, Ba, Pb, Au	Okër + Aliazh Ar, Cu, Zn
5	Jeshil	Pb, Cr, Fe	Ca, Zn, Cu	Verdhë Kromi (Cr, Pb) + Indigo
6	Okër e verdhë	Cu, Fe, Zn	Ca, Sr, Ba, Pb, Au	Okër + Alizah Ar, Cu, Zn
7	Verdhxë	Au, Cu, Fe	Ca, Sr, Ba, Zn, Pb	Aliazh Ar, Cu, Zn
8	Kuqe	Pb	Ca, Sr, Ba, Zn, Fe	Kuqe Pb
9	Errët	Pb	Ca, Sr, Ba, Zn, Fe	Pigment i errët + Bardhë Pb
10	Kafe	Pb, Fe	Ca, Sr, Ba, Zn	Okër e kuqe/ Bardhë Pb
11	Kuqe	Hg	Ca, Sr, Ba, Zn, Fe, Pb	Cinabar
12	Kuqe	Hg	Ca, Fe, Pb	Cinabar
13	Errët	Pb	Ca, Sr, Fe	Pigment i errët + Bardhë Pb
14	Okër	Pb, Hg, Fe	Ca, Sr, Ba, Zn	Okër e verdhë + Cinabar + Bardhë Pb
15	Verdhë	Au, Cu, Zn	Ca, Sr, Fe	Aliazh Ar, Cu, Zn
16	Verdhë	Au, Cu, Zn	Ca, Sr, Fe, Pb	Aliazh Ar, Cu, Zn
17	Verdhë	Au, Cu, Zn	Ca, Sr, Fe, Pb	Aliazh Ar, Cu, Zn
18	Jeshil (ripikturim)	Zn, Ba, Pb	Fe, Ca, Sr	Pigment modern

i pjesës së poshtme të ikonës, vihet re prezenca e lartë e Bakrit (Cu) dhe Arsenikut (As) që sugjeron se kjo ngjyrë është përftuar nga pigmenti Emerald Green (arsenat bakri), që është përdorur për herë të parë në fund të shek. 18. Në spektrin e zonës jeshile me Nr. 5 shfaqen elementet Cr e Pb si dhe Fe, Ca etj. Pigmentet me bazë kromi kanë filluar të përdoren pas vitit 1840 dhe në rastin e ikonës tonë ka mundësi të jetë përdorur Oksidi i kromit jeshil i përzier me shtesa të tjera. Në zonat e pikave Nr. 5 e 18 me ngjyrë jeshile të errët dhe që duken se janë ripikturime të mëvonshme evidentohet përdorimi i pigmenteve modern, ku elementë kryesore janë Pb, Zn, Ba (të bardhat e këtyre elementeve të përziera me pigment jeshil organik). Në përgjithësi duket që ikona në gjendjen aktuale paraqet një strukturë komplekse me ripikturime të periudhave të ndryshme. Prezenca e pigmentit Emerald Green në një zonë që duket si origjinale vendos vitin 1820 si kufi të poshtëm të përgatitjes së ikonës, por prezenca në shumë pika e Zn e Ba e afron këtë periudhë në fund të shek 19. *(Shih tabelën përmbledhëse Nr. 3)*

Pas pastrimit u krye mbushja e një pjese të lakunave me *Gesso di Bologna* dhe në këtë rast menduam të mbushim ato lakuna ku kishte mundësi për rikuperimin e figurave. Mbushjet e vjetra vetëm u pastruan dhe u lanë në gjendjen e tyre për arsye se heqja e tyre mund të sillte dëmtim të buzëve të shtresës së pikturës. Integrimi piktorik u krye me teknikën e *tratteggios* me ngjyra akuarele (*Winsor & Newton*). Në përfundim të integrimit piktorik sipërfaqja e ikonës u vernikos me vernik *Lefranc & Bourgeos* (*Vernis a Retoucher J.G.Vibert*). (Fig. 14, 15,16).

Të gjitha ikonat e lartpërmendura ndodhen të restauruara në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar dhe përkatësisht Shën Athanasi e ekspozuar në Pavionin e Artit Mesjetar ndërsa tre të tjerat në fondin e këtij institucioni.

DO NOT COPY

Gentian VOKOPOLA

RESTORATION OF SOME ICONS

Over recent years, in the Artworks' Restoration Laboratory at the National Institute of Cultural Heritage, interventions have been carried out for the purpose of conservation-restoration of some icons, property of National Historical Museum fund.

One of the icons, specifically "St. Athanasius" by Mihal Anagnosti, taken from the Cathedral of Elbasan with no. card 3688, is on display in the Medieval Art Pavilion at the NHM.

The other three icons, "The Holy Mandylion of Christ", also taken from the Cathedral of Elbasan with card no. 5468, "St. Mary with Christ" taken from the church of "St. Qiriako and Julita" in Dhuvjan, Gjirokastra, with card no. 5666 and the "The Gathering of Archangels", taken from the church of "St. Michael" in Mingul, Gjirokastra, with card no. 5639, are by an anonymous author and also part of the icons fund in the NHM.

The working group that restored these icons consisted of specialists from the Art Sector, Enkelejda Nesturi, Spiro Laçka, Genci Treska and Gentian Vokopola, after ascertaining the degree of damage to the icon "St. Athanasius" and the blank it created in the Art Pavilion, decided that this icon should have priority and treated first of these four icons.

Consolidation interventions were carried out in this icon, as the problem encountered in this icon had to do with the detachment of the preparatory layers. Several years ago for the icon "St. Athanasius" diagnostic tests and restoration interventions were performed, so it did not present the need for cleaning from decomposed varnish or other interventions with pictorial unification character.

The drafting of graphic and photographic documentation as well as the conservation intervention for the other three icons was also accompanied by the performance of analyzes with the XRF method for the verification of the materials used (soil, pigments, impurities), in order to precede the restoration interventions as accurately as possible.

All analyzes for these icons, performed in detail, as well as their interpretation, were made and documented by Prof. Dr. Nikolla Civici, specialist at the Institute of Applied Nuclear Physics, in collaboration with Art Restoration specialists at NICH.

In the icons "The Holy Mandylion of Christ", "St. Mary with Christ" and "The Gathering of Archangels", the consolidation and resurfacing of the preparatory layers was initially done, followed by the disinfection and consolidation of the wood material (support), the resurfacing of the separated parts and cleaning of the painted surface. The filling of the gaps and the pictorial integration were finally done.

Today, all the above-mentioned restored icons are located in the National Historical Museum. "St. Athanasius" is exhibited in the Medieval Art Pavilion, while the other three are part of the fund of this institution.

Eduard SHEHI

EVOLUIMI I LINJËS JUGLINDORE TË FORTIFIKIMEVE TË DURRËSIT DHE DATIMI I "TORRËS VENECIANE"[1]

DO NOT COPY

Studimi i fortifikimeve të qytetit të Durrësit[1]ka qenë një nga temat e preferuara përgjatë dekadave ndër studiuesit që kanë punuar në këtë qytet, shqiptarë apo të huaj[2]. Diku në formë të plotë e diku shkurtimisht, tematikat e trajtuara janë lidhur kryesisht me përshkrimin e tyre dhe me përpjekjet për të datuar periudhat e ndryshme ndërtimore.

Ndër periudhat me rëndësi, por edhe problematike për këto fortifikime mbeten ato mesjetare dhe osmane. Këto periudha vazhdojnë të mbeten pak të njohura dhe me shumë paqartësira. Mungesat kanë ardhur si pasojë e një pamjaftueshmërie të dokumentacionit arkivor, por edhe si pasojë e dëmtimeve apo rrafshimit që kanë pësuar fortifikimet duke filluar nga viti 1913. Për rrjedhojë, nuk ka qenë e mundur të studiohen muret në lartësi apo të gërmohet nën nivelin modern të ecjes, të cilat më së shumti kanë qenë rrugë të shtruara.

Duke qenë se së fundmi patëm mundësinë të realizonim gërmime shpëtimi në linjën juglindore të këtyre fortifikimeve[3], kemi analizuar me kujdes një seri çështjesh që lidhen me këto periudha. Ajo çka kemi vënë re është mungesa e një analize të ndërthurur dhe të bashkërenduar e informacioneve të ndryshme që njohim deri më sot, të cilave shpesh herë u është dhënë pak rëndësi. Në këtë këndvështrim, besojmë se do të kontribuojmë duke hedhur dritë mbi disa aspekte të panjohura më parë, që krijojnë një tjetër imazh për evoluimin kronologjik dhe planimetrik të këtyre fortifikimeve. Fillimisht do të japim një përshkrim të kësaj linje, në gjendjen dhe zhvillimin planimetrik të para shkatërrimeve masive të viteve 20 të shekullit të kaluar. Për përshkrimin e tyre kemi marrë për bazë konturin e paraqitur nga L. Rey (Fig. 1), rimarrë nga studiues të tjerë më pas. Njohurive të përcjella më herët nga studiues të ndryshëm do t'i bëjmë disa shtesa detajimesh, bazuar tek imazhet fotografike të ruajtura në arkiva. Do të pasojë një analizë datuese e kullës « A » ("torra veneciane"), riparë në dritën e të dhënave dhe dokumenteve të reja arkivore. Në mbyllje, do të përdorim të gjitha të dhënat e paraqitura për të krijuar një imazh përmbledhës mbi evoluimin kronologjik të strukturave mbrojtëse. Duke qenë se ky evoluim është shumë kompleks, për të qenë sa më e qartë për lexuesin, do të fillojmë nga periudha më e vonë, që përkon me situatën e njohur në shek. XX, për të zbritur pas në kohë, deri në antikitetin e vonë.

---

[1] Falenderoj për ndihmesën bibliografike përgjatë përgatitjes së këtij artikulli Machiel Kiel, Pëllumb Xhufi, Adrian Anastasi, Rudenc Ruka, Georgia Pliaku, Robert Elsie, Etleva Nallbani, Flutura Açka.

[2] Hezey 1876, f. 353-360; Praschniker, Schober 1919, f. 32-39; Rey 1925, f. 33-48; Baçe, Karaiskaj 1975, f. 5-33; Karaiskaj 1977, f. 29-42; Hoti 1986, f. 268-269; Miraj 2013, f. 201-218; Gutteridge etj. 2001, f. 388-410; Gutteridge etj. 2003, f. 367-379; Gutteridge 2003, f. 19-65; Shehi 2007, f. 159-208; Shehi, Shkodra 2010, f. 325-336.

[3] Shiko Shehi etj. 2017, f. 227-260.



Fig. 1 Planimetri e fortifikimeve të Durrësit. Ripunuar sipas REY 1925

1.Përshkrimi i fortifikimeve të linjës juglindore. Linja juglindore e fortifikimeve (Fig. 2) fillon nga e ashtuquajtura "Torra Veneciane"[4] apo kulla A[5] dhe vazhdonte me kurtinën A-S[6]. Pjesërisht mbi të mbështetej një bastion i avancuar (mbi të cilën ishte ndërtuar më pas Konaku i mutesarifit), emërtuar S nga L. Rey. Pothuaj ngjitur me këtë bastion

[4] Kështu njihet ndër banorët e Durrësit.

[5] Emërtimi i kullave të qytetit me sistem alfabetik është përdorur për herë të parë nga Leon Rey, shiko REY 1925, f. 34. Ne po përdorim të njëjtin sistem, duke plotësuar emërtimet, kur është e nevojshme.

[6] Për të mos ngatërruar përshkrimin mes kurtinave të ndryshme, po përdorim sistemin e identifikimit individual të tyre, nëpërmjet germave të kullave apo bastioneve që këto kurtina lidhin.



Fig. 2 Planimetri e detajuar e linjës juglindore si ishte deri në vitin 1928

gjendej *Porta e Detit*[7], mbrojtur me një strukturë në formën e një kulle, emërtuar R. E gjithë kjo linjë është rrafshuar në vitet 1926-1928, pak pjesë të mbijetuara janë dëmtuar deri në vitet e fundit. Më tej shtrihej kurtina R-Q, pjesërisht gërmuar në vitet 2001-2002[8], ende e vizitueshme, bashkë me një kullë gjysmërrethore, pjesërisht e ruajtur. Kjo kullë gjysmë rrethore nuk është parë nga L. Rey dhe nuk është emërtuar. Për këtë arsye, në përshkrimet në vazhdim ne e kemi emërtuar Q1. Në mbyllje të kësaj linje gjendej bastioni këndor Q, shkatërruar në vitet 1925-1926 për t'i lënë vend ndërtimit të Bankës së Shqipërisë, sot BKT.

***"Torra veneciane"* ose kulla A**

Kjo kullë ka lartësi të ruajtur deri në gjoksore 9.60 m dhe diametër të jashtëm 16 m[9]. Ngrihet mbi një bazament trungkonik, kufizuar në pjesën e sipërme nga një kornizë (Fig. 3). Një tjetër kornizë është vendosur në pjesën e sipërme të murit, në nivelin

[7] Për një përshkrim të detajuar mbi historikun e kësaj hyrjeje, shiko GAGLIONE, SHEHI 2016, f. 31-66.

[8] HOTI *ETJ.* 2004, f. 139-143. Identifikuar në vetvete si Bastioni Juglindor.

[9] Ky diametër jepet nga KARAISKAJ 1977, f. 39. Ndërsa REY 1925, f. 33, jep 14 m diametër, po aq sa edhe KIEL 1990, f. 97. Ndoshta dallimi mes tyre qendron në pikën e matjes së diametrit, në pjesën më të gjerë të bazamentit apo në murin e kullës.



Fig. 3 "Torra veneciane". Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, viti 1908

e ndarës me gjoksoret. Muret janë ndërtuar me material të ripërdorur dhe kanë trashësi 3.70 m. Kati i vetëm i kullës mbulohet nga një kupolë sferike dhe ishte i pajisur me pesë pozicione artilerie, të baraslarguar mes njëri-tjetrit. Dalja në pjesën e jashtme realizohej me frëngji, me përmasa të kufizuara, të mbuluara me qemer. Kupola ishte ndërtuar me tulla, të lidhura me llaç të përzier me pluhur dhe copëra tullash. Muret në pjesën e brendshme të tyre janë përforcuar me trarë druri, me përmasa 0.20 m.[10] Datimi i saj në mesin e shek. XV është kryer fillimisht nga Leon Rey[11], i cili e krahason me kullën e Sed-ul-Bahr në Dardanele, kullat e Amida dhe kullën Gingirli në Selanik. Ky datim është rimarrë më pas edhe nga Gj. Karaiskaj[12], i cili e ngushton kohën e ndërtimit në vitin 1478. Të gjithë studiuesit e tjerë shqiptarë në vazhdim kanë qëndruar në këto datime, pa e parë me sy kritik.

Në imazhet e kohës vërehet se ndër shekuj relievi në pjesën e brendshme të mureve ishte ngritur në atë pikë, sa niveli i ecjes ishte pranë kornizës së sipërme. Në këto foto nuk vërehet prania e gjurmëve të gjoksoreve, të modeluara pas restaurimit, siç i shikojmë ne sot. Në fakt, struktura origjinale ka pasur mure të ulta, të gjatë, të rrumbullakosura nga jashtë dhe mes tyre frëngjitë e topave. Edhe lartësia e bazamentit trungkonik dallohet të ketë qenë më e lartë sesa është sot e shikueshme. Ajo është mbuluar nga ngritja e nivelit të ecjes ndër dekada.

Në pamjen e jashtme të kullës A vërehen qartësisht ndërhyrjet e ndryshme mirëmbajtëse. Bazamenti duket se është punuar me blloqe më të mëdhenj gurësh të ripërdorur, konturet e të cilëve janë qartësisht të dukshëm. Muri mbi të është punuar me blloqe më të vegjël dhe të larmishëm, duke dhënë një pamje më pak të njësuar sesa bazamenti. Gjysma e poshtme e murit, mbi kornizën ndarëse të bazamentit, duket të ketë një punim më cilësor, me veshje të bollshme llaçi. Këtu konturet e gurëve të përdorur dallohen me vështirësi nga njëri-tjetri. Gjysma e sipërme duket me punim më trashanik dhe më pak të kujdesshëm, ç'ka i bën gurët e përdorur të dallueshëm qartë nga njëri tjetri. Në pjesën

[10] KARAISKAJ 1977, f. 35.

[11] REY 1925, f. 35.

[12] KARAISKAJ 1977, f. 39.

PROOF COPY



Fig. 4 Pamje intra muros e "torrës veneciane" dhe kurtinave. Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, 1912

lindore dallojmë një ndërhyrje gjatësore restauruese. Duke krahasuar fotografi të ndryshme të saj (Fig. 3; Fig. 4), vërehen të tjera detaje që nuk janë përshkruar më parë në lidhje me këtë kullë. Pika e lidhjes së pjesës fundore të kurtinës A-S dhe e kurtinës perëndimore A-B[13] me kullën nuk duket të jenë përpendikular me të. Të dyja kurtinat futen pjesërisht brenda kullës si dhe kanë nga një kthesë 90°, orientuar nga brenda fortifikimeve, duke krijuar një hapësirë këndore. Në pjesën e poshtme të këtij këndi dallojmë praninë e një qemeri hyrjeje, punuar me tulla të lidhura me llaç. Për nga mënyra e ndërtimit duket sikur kjo vendosje e kurtinave të jetë një fazë më e hershme dhe në një moment të dytë i është shtuar kulla rrethore.

[13] Nga jashtë, pjesa fundore e këtij muri nuk ka një faqe vertikale por është lehtësisht e përkulur nga brenda.

Më pas, këto mure këndore janë veshur me mure të tjerë, duke mbuluar kthesat 90°, por vazhdonte të ishte i dukshëm qemeri i hyrjes. Prania e këtyre mureve mund të vërehet edhe në hartën topografike të vitit 1928, ku ato paraqiten si një linjë e harkuar. Ngjashmërisht vërehet kjo linjë e harkuar edhe në fotografi ajrore të pas vitit 1925, kur kishte filluar shkatërrimi i fortifikimeve.

Në fotografitë e përmendura vërehet edhe prania e një qemeri direkt nën kornizën e sipërme të kullës, e cila duket se mbulon një kamare mbi hyrjen aktuale që gjendet më poshtë. Sot nuk vërehet asnjë gjurmë e këtyre mureve, si pasojë e prishjeve të realizuara ndër vite si dhe nga ndërhyrjet restauruese. Nga fotografitë nuk është e qartë nëse me të vërtetë dy kurtinat lidheshin me njëra-tjetrën dhe kulla A u është mbështetur atyre apo i ka inkastruar pjesërisht. Pjesa ende e ruajtur e kurtinës A-S duket

se inkastrohet nga kulla A.

Prania e strukturës harkore që i ngjitet kullës A dhe lidhet me kurtinën A-B është tërësisht e paqartë për t'u interpretuar. Ndoshta kemi të bëjmë me mbetjet e një kulle më të hershme, më e futur nga brenda dhe struktura rrethore ishte gjurma e fundit e ruajtur e saj. Ose ishte një



Fig. 5 Fotografi e kurtinës « A-B », intra muros. Foto E. Shehi

shtesë e mëvonshme sesa vetë kulla.

Muri në vazhdim të kurtinës A-B, pjesë e të cilit ruhet ende sot, paraqet disa detaje që kanë shumë interes për t'u përshkruar dhe shpjeguar, megjithëse ka pësuar dëmtime të ndryshme përgjatë viteve. Afërsisht 17 m nga kulla A muri fortifikues i antikitetit të vonë[14], që zbret nga kodra me kuotë 59 m, ndërpritet. Trakti i murit në vazhdim, që e lidh me kullën A, paraqet disa elementë ndërtimor të shtuar në periudha të ndryshme kronologjike. Në pjesën e jashtme dallohet qartë një shtesë në formë të harkuar, në plan horizontal dhe me kënd të pjerrët në plan vertikal, që i mbështetet murit të brendshëm. Ky mur shmanget nga vazhdimësia e linjës së murit antik të vonë dhe pozicionohet më në

[14] Ky mur paraqet gjurmë të shumta meremetimesh, shpjegimi i të cilave do të ishte me shumë interes për njohjen e historisë së fortifikimeve të qytetit.

para ndërtimit të kullës A.

Kurtina A-S

Në të gjitha fotot e realizuara deri në vitin 1926 dallohet qartë prania e këtij muri, i cili niste nga kulla A dhe vazhdonte drejt lindjes. Fatkeqësisht nuk kemi përshkrime të detajuara të tij. Imazhet e kohës nuk janë shumë të qarta në detaje, por më së shumti vërehet përdorimi i materialeve ndërtimore të përziera. Nuk kemi asnjë të dhënë mbi lartësinë e tij, por në fotografitë e vitit 1914 kuptohet se arrinte deri pranë kornizës së sipërme të kullës rrethore A. Muri ka pasur gjoksore me lartësi pothuaj të një njeriu dhe një parapet të brendshëm lëvizjeje. Ky mur nuk ka qenë vertikal, por ka pasur një përkulje të lehtë nga jashtë.

Në të tjera foto të pas viteve 1920 vërehet hapja e një hyrjeje në muret e kësaj kurtine, pajisur me shkallë,

DO NOT COPY

të cilat kanë një kënd të lartë ngjitjeje nga brenda. Në të dy krahët e saj janë dy hapje të tjera. Nuk është e qartë nëse edhe këto janë hyrje anësore. Rrafshimi i kësaj kurtine nuk na jep mundësi të kuptojmë kohën kur është hapur kjo portë dhe nëse ka qenë pjesë e linjës që në ndërtim apo e mëvonshme. Gjurma e kësaj hyrjeje vërehet edhe në fotot ajrore, bashkë me një mur anësor terracimi në krahun perëndimor. Arsyeja e ndërtimit të tij duhet të lidhet me krijimin e një *terrapieno* si efekt mbrojtës ndaj artilerisë. Në krahun lindor dallohet gjurma e murit periferik të Pallatit të Drejtësisë, tashmë i rrënuar. Ndoshta është zgjedhur kjo pjesë, në mes të murit terracues dhe murit periferik të Pallatit të Drejtësisë për të hapur hyrjen e përmendur më lart, pasi kështu ishte e siguruar nga rrëshqitjet e terrenit.

Deri më sot është besuar gjerësisht se kjo kurtinë ishte një ndërtim bizantin, mbi të cilin më pas janë realizuar ndërhyrje mirëmbajtëse mesjetare[15]. Nëse shikojmë me kujdes teknikën e ndërtimit të pjesës së ruajtur të kurtinës pranë kullës rrethore A (Fig. 6), do të vërejmë disa detaje me rëndësi. Ky mur, me gjerësi 2.40/2.80 m, ka dallime të dukshme me muret bizantine. Në të janë përdorur blloqe me tulla dhe llaç, të marrë nga mure bizantine dhe të vendosur në mënyrë të çrregullt, deri edhe pjerrtazi. Krahasuar me imazhet e profileve të prera të mureve bizantine (Fig. 7), shikohet dallimi i qartë mes tyre. Kjo kurtinë vazhdonte në drejtim të *Portës Yalli*, në një linjë që nuk ka qenë e drejtë, por ka pasur kthesa të lehta, siç mund te kuptohet edhe nga planimetria e vitit 1928. Kjo dëshmohet edhe nga rezultatet e sondazhit 4 të gërmimeve të vitit 2017[16].

Mbi këtë kurtinë është mbështetur muri periferik jugor i Pallatit të Drejtësisë, rindërtuar në mes të viteve 1881-1882, përgjatë mbretërimit të sulltanit Abdylhamid II[17].



Fig. 6 Fragment i murit që ruhet ngjitur me kullën « A », pjesë e kurtinës A-S. Foto E. Shehi



Fig. 7 Fortifikimi bizantin i prerë në mes të kurtinës « B-C ». Foto E. Shehi

Bastioni S

Bastioni i avancuar drejt bregut të detit dhe me lartësi më të vogël sesa muri kryesor fortifikues

[15] Heuzey, Daumet 1876, f. 358, 369; Rey 1925, f. 46, 48; Karaiskaj 1977, f. 37; Gutteridge 2003, f. 45; Shehi, Shkodra-Rrugia 2010, f. 332.
[16] Shehi *etj*. 2017, f. 248-252.
[17] Kiel 1990, f. 100-101.



Fig. 8 Planimetri e gërmimeve të vitit 2017, sipas SHEHI etj. 2017

është ai që kemi gërmuar tani së fundmi[18] (Fig. 8). Ky bastion paraqitet me dy faza ndërtimore, por me të njëjtin koncept dhe planimetri.

Në fazën e parë është ndërtuar një bastion në formën e germës U, me kënde të kthyera 45°. Gjatësia e ballinës ishte 21 m, gjerësia e mureve 1.20 m, lartësia e themelit afro 0.70 m. Muret ishin ndërtuar me gurë të përmasave e llojeve të ndryshme, të lidhur me llaç. Bastioni ka qenë i pajisur me pesë frëngji artilerie, gjurmët e të cilave ruheshin ende në momentin e gërmimit. Tre gjendeshin në murin ballor dhe nga një në muret këndore.

[18] Shehi *etj*. 2017, f. 227-236.

Në një fazë të dytë është gjykuar e nevojshme të ndërtohet një tjetër strukturë, me të njëjtin funksion dhe planimetri, në pjesën e jashtme të murit ekzistues. Gjatësia e ballinës së bastionit të ri ishte 27 m, gjerësia e mureve 2.90 m, lartësia e themelit 0.77 m. Muret ishin ndërtuar me material të përzier, me shumë elementë të ripërdorur nga ndërtimet antike dhe antike të vona. Në brendësinë e mureve ishin vendosur trarë druri, në gjerësi (orientuar veri-jug) që u mbivendoseshin atyre gjatësore (lindje-perëndim). Këta të fundit ishin kuadratikë në profil, me përmasa 0.20x0.20 m dhe 1.2 m larg njëri-tjetrit. Bastioni ishte përforcuar me tre frëngji ballore dhe me nga një frëngji këndore.

Kemi shprehur mendimin se mundësitë për datim janë dy: faza e parë e bastionit mund të datohet në vitin 1565 ose pas vitit 1606, ndërsa faza e dytë dhe më masive e cilësore datohet pas vitit 1606[19]. Tipar kryesor i këtij ndërtimi është lartësia e ulët e tij (dëshmuar nga themelet e cekta), planimetria e veçantë, e pajisur me frëngji artilerie. Një element mbrojtës i konceptuar me lartësi të ulët dhe me përdorim të fuqisë së zjarrit të artilerisë tregon ndërtimin në periudha kronologjike kur zhvillimet e teknikave luftarake moderne kishin nxjerrë jashtë përdorimit strukturat murore që mbroheshin në lartësi dhe sisteme të reja fortifikimi duhej të evoluonin përkundër armëve me barut[20]. Një element i tillë, nxjerrja e një bastioni jashtë perimetrit të kurtinave, i pajisur me frëngji artilerie, nuk është i panjohur për ndërtimet mbrojtëse osmane, pasi është evidentuar në disa kështjella të perandorisë. Duke qenë se nuk është këtu vendi për një analizë të thelluar të teknikave ndërtimore fortifikuese osmane, po përmendim vetëm dy raste, më të ngjashme me bastionin e Durrësit. Kështjella e Anavarin-i cedid apo Niokastro[21]

[19] Për paraqitjen më të gjatë të gërmimeve dhe datimeve shiko Shehi *etj*. 2017, f. 227-260.
[20] Ágoston 1994, f. 17.
[21] Gjendet në pjesën jugore të gjirit me të njëjtin emër, pranë qytetit modern Pylos. Kështjella e re (qartësisht e dallueshme

DO NOT COPY

(ose Navarino e Re), ndërtim osman që nga viti 1573, është e pajisur me një bastion të madh, që del jashtë linjës së kurtinës, me drejtim nga deti, quajtur ΕΒΔΟΜΟΣ ose Santa Barba, pajisur me frëngji artilerie në faqen ballore dhe ato anësore, të cilat duhej të qëllonin "*at sea level*", ndërtuar përgjatë vitit 1576. Planimetria e saj është shumë e ngjashme me bastionin tonë. Dallimi kryesor mes tyre (përveç përmasave dhe numrit më të madh të frëngjive për artileri), qëndron tek brinja këndore e krahut perëndimore, e cila nuk është vendosur në 45° si brinja tjetër, lindore[22].

Një tjetër fortifikim që paraqet ngjashmëri planimetrike gjendet në Larnaca (Qipro). Kështjella më e hershme, me përmasa të kufizuara, rindërtohet pjesërisht dhe zgjerohet në vitin 1605-1606 nga Ferhat Pasha, bejlerbej i provincës së Qipros. Më pas, në vitin 1625 riparohet dhe riorganizohet nga Mehmet Pasha, bejlerbej i Rumelisë[23] (pjesë e së cilës ishte edhe Durrësi). Pas këtyre punimeve kështjella mer formën e germës U me kënde të prera në 45°. Pjesa më e gjerë, që përkon me krahun lindor, orientohet nga deti (e kundërta me bastionin e Durrësit). Hyrja gjendej në njërën nga brinjët e ngushta (si në rastin e bastionit të Durrësit), përkatësisht atë verior. Të gjitha këto të dhëna, bashkë me detajet e tjera të botuara më herët mbi aspektet stratigrafike, teknike të ndërtimit, burimet dokumentare, etj. qartësojnë më së miri datimin e bastionit të Durrësit.

Porta R

Me këtë germë identifikohet nga ana e L. Rey porta e linjës juglindore, emri i së cilës na përcillet nga L.Heuzey si *Porta Yalli*. Nga ana e arkeologëve francezë nuk kemi përshkrime të detajuara të saj. Po ashtu, edhe hartat e botuara, si ajo e L. Rey, si ajo topografike e vitit 1928 apo edhe harta e L. Heuzey e A. Daumet, botuar në vitin 1876, kanë mangësi në detaje. Nuk kuptohet saktë planimetria e strukturave dhe vendodhja e vetë portës. Forma e saj njihet qartësisht vetëm nga fotografitë e fillim shekullit 20, ndërsa konturi planimetrik nga harta topografike e vitit 1928. Pra, saktësitë topografike dhe planimetrike vijnë nga burime të shek. XX. Bëhej fjalë për një hyrje të gjerë dhe të lartë, të mbrojtur me një strukturë në formën e një kulle, shumë e ngjashme në planimetri, në mos identike, me hyrjen e fortifikuar të quajtur *Porta e Madhe* të periudhës osmane, në linjën veriore të fortifikimit. Duke krahasuar përmasat njerëzore në fotografitë e ruajtura, mund të përllogarisim me afërsi gjerësinë e hyrjes në pjesën e brendshme në 3.20-3.80 m dhe lartësinë në 4.80-5 m. Ka qenë e pajisur me një korridor të gjatë dhe dy porta në ekstreme[24]. Në pjesën e sipërme të korridorit vërejmë një tavan prej druri, që e ndante nga kati i sipërm. Në faqen veriore kishte një hyrje, që të drejtonte për tek shkallët e katit të sipërm, që mbulohej me çati. Dy dritare hapeshin në pjesën ballore (drejt jugut) dhe të pasme (drejt veriut) të katit të sipërm.

Bazuar tek imazhet fotografike të shek. XX dhe përcjelljen e emrit të saj nga burimet gojore dhe ato të shkruara, kjo strukturë është identifikuar me *Portën e Detit*. Për herë të parë e hasim përmendjen e një *Porta Maris* në një dokument të qershorit 1338 dhe më pas më 1 nëntor 1427[25]. Ky emër ka vazhduar të përdoret gjerësisht nga autorë të ndryshëm. Pozicioni i një hyrjeje në qendër të linjës juglindore të fortifikimeve jepet në hartën e vitit 1876 të L. Heuzey, emërtuar *Porta Yalli*[26].

Në gërmimet e vitit 2017 (sondazhi 3) u vërtetua prania e një muri në aksin e fortifikimeve, me shumë mundësi me funksion mbrojtës ose përforcimi të mbrojtjes, e datuar, me paqartësi, në shek. XII. Pamundësia e zgjerimit të gërmimit nuk na mundësoi të kuptonim planimetrinë e saktë që kapte kjo linjë muri.

Kurtina R-Q1 (quajtur Bastioni juglindor) (Fig. 9). Pjesë e saj është një hyrje, mbuluar me qemer, dhe fillimi i një hyrjeje tjetër, në krahun perëndimor. Në krahun lindor kjo kurtinë lidhet me kullën gjysmërrethore *Q1*. Ka një gjatësi të zbuluar prej



Fig. 9 Planimetri e gërmimeve pranë kurtinës « R-Q1 ». Sipas SHEHI 2014

25.20 m, lartësi 6.90 m dhe gjerësi maksimale prej 2.20 m. Gjurmët e zbuluara u përkasin periudhave të ndryshme kohore[27].

Pjesa e sipërme e murit, që është edhe më mirë e ruajtur, i përket periudhës bizantine, me funksion fortifikues, ndërtuar në dy faza të ndryshme, por në një kuotë me së paku 2 m më lart sesa ajo romake. Ky dallim dëshmon për krijimin e një relievi të ri në këtë zonë, ndoshta duke terracuar të gjithë sipërfaqen. Mbi strukturat bizantine ruhen ende blloqe gurësh shtufi, drejtkëndore, me përmasa mesatare, që u takojnë përforcimeve të periudhës së mesjetës së hershme[28].

Një mungesë shumë e madhe që kemi nga ekstremi perëndimor i kësaj kurtine është linja që ndiqte fortifikimi bizantin deri në pikëtakimin me linjën jugperëndimore të fortifikimeve të së njëjtës periudhë. Rrafshimet e mëdha dhe ulja e kuotave të ecjes në vitet 30 të shekullit të kaluar kanë zhdukur strukturat fortifikuese. Për të kuptuar më qartë linjën që ato ndiqnin, është i nevojshëm zgjerimi i gërmimeve në këtë zonë, drejt perëndimit, me shpresën se mund të ketë mbijetuar ndonjë gjurmë.

Kulla Q1

Bëhet fjalë për një kullë gjysmërrethore, e mbijetuar deri në ditët tona shumë e dëmtuar. Themelet janë ndërtuar me blloqe gurësh drejtkëndorë, me teknikën izodomike, me lidhje të thatë. Muri mbi themel është i dëmtuar dhe nuk kuptohet qartë, nëse ka pasur nivele ndërtimi të ngjashme me periudhat më të hershme të kurtinës R-Q1. Strukturat që vërehen ende sot janë muret me tulla dhe llaç të periudhës së shek. V-VI. Në pjesën e brendshme të saj, në vitin 2001, kemi vënë re se ishte e shtruar me dysheme tullash dhe në hapësirën harkore të kullës gjendej një bazament kolone, që të krijonte idenë e një mbajtëse tavoline. Niveli i ecjes së saj ishte afro 1.5-2 m më i ngritur nga niveli i ecjes së fortifikimit bizantin.

Kurtina Q1-Q

Për këtë strukturë nuk kemi asnjë përshkrim të ruajtur, por mund të japim disa të dhëna, bazuar tek fotografitë që kemi (Fig. 10) dhe tek planimetria e

nga kështjella mesjetare, e vendosur në bregun përballë të gjirit) u themeluar në vitin 1573 nga administrata osmane. Përgjatë viteve 1686-1716 meret nën kontrollin e Venedikut, për t'u rimarë përsëri nga venecianët. Hartat më të hershme, të viteve 1686-1715 paraqesin planimetrinë ekzistuese të kështjellës, sipas ndërtimeve të realizuara nga osmanët, shiko Κοντογιάννης 2010, f. 224.

[22] Κοντογιάννης 2010, f. 199-224. Përshkrim i gjerë mbi fortifikimin tek Bennet *etj*. 2005, 241-264. Bazuar mbi dokumentacionin osman, Kiel 2005, 265-281 jep detaje të ndërtimit, evoluimit të punimeve dhe problematikat e hasuara. Detajet më të rëndësishme mbi bastionin janë tek dokumenti nr. 28, f. 272. Duke pasur parasysh ngjashmëritë në planimetrinë mes dy bastioneve, në pozicionin përkundrejt bregut dhe portit, mundet që edhe elementët e artilerisë së përdorur në to, për të qëlluar « at sea level », të ishin të njëjtë: *kolomborna* dhe *bacaluşka-top*.

[23] Sinclair 2012, 424 dhe bibliografia përkatëse.

[24] Në kujtimet e të moshuarve në Durrës, përcillet ende kujtimi i prindërve të tyre për "portat e drurit që mbylleshin çdo mbrëmje", siç shkruan edhe Hahn 1855, f. 75.

[25] Gaglione, Shehi 2016, f. 32-37.

[26] Heuzey, Daumet 1876, f. 355, plan H.

[27] Shehi 2007, f. 164. Gjerësisht përshkrimi i këtyre mureve dhe analiza kronologjike e tyre janë ritrajtuar me ndryshime e përmirësime në Shehi 2017, f. 232-234.

[28] Hoti *etj*. 2004, f. 140-143; Shehi 2007, f. 163-165.

DO NOT COPY



Fig. 10 Pamje e bregdetit të Durrësit. Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, viti 1908

L.Heuzey. Bëhet fjalë për një linjë muri, që lidhte kullën gjysmërrethore Q1 me bastionin këndor Q. Ajo ishte e pajisur me gjoksore në pjesën e sipërme. Gjatësia e përafërt e saj ka qenë 30 m.

Bastioni Q

Me këtë germë është emërtuar bastioni këndor që mbyllte linjën juglindore të fortifikimeve dhe realizonte lidhjen me linjën lindore. Planimetria e tij ka pasur formë shumëkëndëshi, rezultat i ndërhyrjeve ndërtimore në periudha të ndryshme kohore. Deri në vitin 1918 ruhej e gjitha në këmbë, siç dëshmojnë edhe imazhet fotografike të kohës. Duket se ka pësuar dëme të konsiderueshme përgjatë Luftës së Parë Botërore, ndoshta nga bombardimi italian i 2 tetorit 1918[29], veçanërisht ekstremi lindor i saj, që, mesa duket, është rrënuar pothuaj i gjithi. Në vitin 1925 u rrafshua për t'i lënë vend ndërtimit të degës së Bankës së Shqipërisë.

Kjo kullë paraqitet në planimetrinë e L. Heuzey dhe A. Daumet si dhe në atë të L. Rey (Fig. 1). Në të dyja rastet, ka mungesë të detajeve të paraqitjes grafike dhe të përshkrimit. Për të tentuar një përshkrim të parë të saj duhet të bazohemi në fotografitë e viteve të parashkatërrimit. Duke kombinuar të dhënat e nxjerra nga disa fotografi ajrore (Fig. 11) dhe nga toka (Fig. 12) apo nga imazhet e ruajtura në muzeun Albert Khan (publikuar nga L. Rey 1925), mund të japim disa të dhëna të përgjithshme.

Planimetria e këtij bastioni ishte në formën e një shumëkëndëshi të çrregullt, me siguri pasojë e shtesave të realizuara përgjatë shekujve. Për qëllim studimi dhe përshkrimi ne e kemi thjeshtësuar planimetrinë e saj duke identifikuar 12 brinjë (Fig. 2). Prej tyre, kemi shumë pak pamje të qarta për të dhënë detaje.

Brinja **I** dilte nga linja e kurtinës Q1-Q me afro 5-7 m, orientuar drejt jugut. Duke qenë se këtu ka pasur ndërtesa në funksion të portit, nuk kemi asnjë fotografi që të na paraqesë një pamje ballore të saj, falë së cilës të kuptonim teknikën e ndërtimit dhe materialin e përdorur.

Brinja **II** orientohej drejt verilindjes dhe kishte gjatësi të përafërt 25-26 m. Në gjysmën e sipërme të murit ka qenë e paisur me 5 frëngji artilerie, me përmasa të mëdha, të mbuluara me qemer. Frëngjitë anësore kishin një hapje këndore, të ngjashme me ato të bastionit « S ». Në pjesën e sipërme muri ka pasur disa gjoksore. Lëvizja prapa gjoksoreve mund të realizohej nëpërmjet një shtegu kalimi të thjeshtë, si në rastet e linjave të tjera të fortifikimit, të ruajtura në qytet. Mbetet e paqartë si krijohej bazamenti i qëndrimit të artilerisë që vendosej në këto 5 frëngji. Teknika e ndërtimit të murit, me sa kuptohet nga fotografitë, ka qenë me material të përzier, të lidhur me llaç, e cila përngjason me ndërtimet osmane.

[29] Mbi këto ngjarje dhe dëmet që kanë shkaktuar shiko Sheh 2018, f. 98-99,104-105.



Fig. 11 Pamje ajrore e qytetit të Durrësit. Museo Centrale del Risorgimento, viti 1916



Fig. 12 Faqja perëndimore e kullës Q. Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, vitet 1910-1912

DO NOT COPY

Brinja **III** zgjatej në vazhdim të brinjës II, me një devijim të lehtë nga juglindja, me gjatësi të përafërt 4-5 m. Duket se ishte ndërtuar me material të përzier, të lidhur me llaç, ngjashme me brinjën II. Në pjesën e poshtme dallohet një bazament konik, me përmasa të cilat nuk mundemi t'i japim me siguri. Pikëtakimi me faqen vertikale të murit ishte i thjeshtë, pa asnjë element shtesë. Në pjesën e sipërme, në të gjithë gjatësinë e murit qëndronte një kornizë e rrumbullakosur, vazhdim i kornizës së brinjës IV dhe V. Mbi kornizë ngriheshin tre mure të ulta që krijonin një frëngji ballore dhe një frëngji këndore (kjo e fundit mund edhe të përllogaritet si element i brinjës IV). Këto mure ishin të rrumbullakosura nga jashtë. Frëngjitë kishin hapësirë drite më të madhe në pjesën e jashtme dhe më të vogël në pjesën e brendshme. Këto detaje (korniza dhe frëngjitë) ishin identike me ato të kullës A para restaurimit.

Brinja **IV** kthente drejt veriut dhe kishte gjatësi të përafërt 8-9 m. Teknika e ndërtimit dhe konturi i jashtëm (baza konike, korniza në pjesën e sipërme, forma e frëngjive dhe e mureve kufizuese të tyre) ishin identike me brinjën III dhe V. Kjo faqe ishte e pajisur me një frëngji artilerie ballore dhe dy me hapje këndore, të ngjashme me brinjën brinjën II dhe me bastionin S.

Brinja **V** kthente drejt perëndimit dhe kishte gjatësi të përafërt 3-4 m. Teknika e ndërtimit dhe konturi i jashtëm (baza konike, korniza në pjesën e sipërme, forma e frëngjive dhe e mureve kufizuese të tyre) ishin identike me brinjët III dhe IV.

Një kthesë e vogël, 1-2 m gjatësi, e lidhte brinjën V me brinjën VI, emërtuar si brinja **XII** (shiko në vazhdim).

Brinja **VI** orientohej drejt veriperëndimit dhe nuk duket se ishte tërësisht në linjë të drejtë. Nuk jemi të sigurtë nëse kishte një harkim të lehtë apo një kthesë me kënd të gjerë në mesin e gjatësisë. Imazhet ajrore në krahasim me fotografitë tokësore nuk përputhen qartësisht. Për rrjedhojë, për momentin jemi të detyruar ta trajtojmë si një linjë të vetme. Kishte gjatësi të përafërt 20 m. Teknika e ndërtimit ishte me tulla të lidhura me llaç, çka na detyron ta datojmë si ndërtim të shek. V-VI pas Kr., ngjashmërisht me muret e linjës perëndimore të qytetit. Në pjesën e sipërme të mureve dallohen 11-12 gjoksore, të ndërtuara me gurë të lidhur me llaç. Ndoshta ishin shtesë e vonë ose rindërtime të vona. Në gjysmën lindore të murit dallojmë me vështirësi praninë e harqeve brenda murit. Nuk është e qartë nëse kemi të bëjmë me frëngji (të ngjashme me ato të kullave B, C, D), këtu të mbyllura, apo me elementë me funksion tjetër (Dekorues? Shkarkues peshe?).

Në pjesën e poshtme të murit vërehet një ndërhyrje në strukturë, si të ishte një mbyllje e një hyrjeje të vogël, të mbuluar me qemer. Në ekstremin lindor të murit, në pjesën e poshtme, vërehet prania e një muri të dëmtuar, që të jep idenë e një kthese, e cila ndër shekuj është braktisur.

Në fundin e kësaj brinje duket se mund të kishte një kthesë të vogël, e cila realizonte lidhjen me brinjën **VII**. Kjo brinjë nuk është e qartë në përmasa, por duket se nuk ka qenë më shumë se 10 m gjatësi. Fotografitë e ruajtura tregojnë për një mur të ndërtuar me material të përzier, të lidhur me llaç. Në linjë të drejtë me të vazhdonte muri i kurtinës, i cili duket se ka qenë ndërtuar me të njëjtën teknikë. Teknika e ndërtimit që vërehet në fotografi, afron shumë me murin osman të linjës veriore të fortifikimeve të qytetit. Nuk mund të themi nëse muri i dukshëm i ishte mbështetur apo kishte veshur një mur më të hershëm në datim.

Në mesin e kësaj brinje dallohet prania e një dritareje (apo frëngji ?) të ngushtë, e lartë, e mbuluar me qemer. Në pjesën e sipërme muri duket se ka qenë i drejtë, pa gjoksore, së paku nga imazhet fotografike.

Në pozicion *intra muros*, me kthesë gati 90° nga brinja VII vazhdonte brinja **VIII**. Nuk mund të japim një gjatësi të përafërt të saj, pasi nuk dallohet qartë në fotografitë ajrore, por nuk duket të ketë qenë më shumë se 10 m. Kjo faqe muri dëshmon për një zhvillim *intra muros* të bastionit, e pajisur me të paktën një hyrje në krahun verior.

DO NOT COPY

Faqja e murit ishte e ndërtuar me blloqe guri drejtkëndorë, të lidhur me llaç, e lartësuar me dy kate. Hyrja për në katin e sipërm gjendej pothuaj në pjesën qendrore të murit dhe arrihej me anë të një shkalle. Mund të dallohen deri në 7 këmbë shkallë që i mbështeteshin një anëcaku të dalë si prag dere. Niveli i anëcakut ishte edhe niveli i ndarjes mes katit përdhes dhe katit të parë. Në të dy krahët e tij duket se ka pasur një kornizim të ndarjes mes kateve. Kjo kornizë na kujton ato të kullës A dhe kornizën e sipërme të brinjave III-IV-V të këtij bastioni.

Hyrja kishte shpatulla me blloqe guri të lëmuar dhe të prerë me kënd të drejtë. Mbulohej në pjesën e sipërme me një arkitra të prerë po nga i njëjti lloj guri, me kënde të drejta. Mbi arkitra dallohet një qemer i pjesshëm, i punuar me tulla të lidhura me llaç. Nuk është e qartë nëse ishte një shtesë e mëvonshme apo vetë muri me blloqe gurësh ishte mbështetur tek një mur më i hershëm me tulla. Hamendësimi i parë duket më i mundshëm. Mbi qemer ishte ngritur një mur i çrregullt, i mbuluar me çati me tjegulla.

Duke krahasuar teknikën e ndërtimit me strukturat e njohura deri më sot, mund të përjashtojmë ndërtimin në shek. V-VI si dhe në periudhën osmane. Ndërtimi i saj duhet të ketë ndodhur përgjatë shek. XI/XII-XIV, por me ndërhyrje (Riparime? Mirëmbajtjeje?) përgjatë periudhës osmane.

Në ekstremin perëndimor të brinjës VIII dallohet një kthesë me kënd të gjerë, e cila përbën brinjën **IX**. Me të dhënat në dispozicion nuk mund të themi gjë mbi përmasat e saj, por teknika e ndërtimit të murit të dukshëm (Fig. 12) ishte identike me atë të brinjës VIII. Kjo nënkupton praninë e një kati përdhes, si edhe për brinjën VIII. Nga një tjetër fotografi vërehet prania e një muri të fragmentuar, ndërtuar me gurë të lidhur me llaç, me një qemer tullash. Besojmë se ky mur duhet t'i përkasë katit përdhes të kësaj brinje, ndoshta hyrja në pjesën e poshtme (katit përdhes) të bastionit Q.

Se si vazhdonte muri mbyllës i bastionit, brinja **X**, nga ekstremi brinjës IX deri në fillimin e brinjës I, nuk kemi asnjë të dhënë për momentin.

Një tjetër detaj që vërehet nga fotot ajrore, por që mbetet për t'u verifikuar nga të tjera imazhe më cilësore, është prania e një linje të drejtë nga kurtina Q1-Q brenda bastionit, brinja **XI**. Arsyeja mund të lidhet më ndërtimin më të vonë të brinjëve I dhe II, duke iu mbështetur kurtinës në pjesën e jashtme.

Në ekstremin perëndimor të kullës dallojmë një tjetër linjë ndarëse, brinja **XII**, e ngritur në lartësi, e cila bashkonte brinjën III me brinjën V. Prania e këtij muri, qartësisht një ndarje mes dy vëllimeve të ndryshme, është një tjetër tregues për shtesa të realizuara herë pas here tek ky bastion.

Bastioni «Q» lidhej me linjën lindore të fortifikimeve. Dallojmë faqen e jashtme të murit të kurtinës të ndërtuar me gurë të lidhur me llaç. Ndoshta, kjo teknikë punimi mund edhe të ishte një veshje përforcuese e një muri më të hershëm, i cili duket me vështirësi në këndin majtas poshtë të fig. 16 (ngjashmërisht me veshjen e kurtinave antike të vona në linjën jugperëndimore). Në arkivin e L. Rey ruhet një foto e realizuar përgjatë prishjes së mureve në këtë zonë. Pjesa e mureve që ishte paralel me kishën e Shën Spiridhonit shfaqet e punuar me tulla të lidhura me llaç, punim tipik i antikitetit të vonë. Një datim i tillë është i sigurtë për traktin që gjendej përkundrejt kishës në fjalë. Më tej, për traktin që i afrohej bastionit Q nuk mund ta themi me siguri nëse i takonte të njëjtës periudhë kohore.

1.Datimi i kullës A ("*Torra veneciane*")

Është e nevojshme të ndalemi më gjatë veçanërisht në datimin e kullës A, të quajtur ndryshe si *torra veneciane*. Duke qenë se tashmë ajo është kthyer në simbolin e qytetit dhe banorët janë mësuar me përkufizimin "veneciane", vlerësojmë të nevojshme disa detajime kronologjike për të.

Për herë të parë kjo kullë cilësohet si veneciane nga

Leon Rey në vitin 1925[30], i cili e krahason me kullën e Sed ul-Bahr në Dardanele, me kullat e Amida dhe kullën Gingirli në Selanik. Më tej, kjo kronologji u kthye në ide mbizotëruese ndër studiuesit shqiptarë, por edhe ndër të huaj. Bazuar tek datimi i L. Rey dhe tek tiparet e kullës (që në fakt janë të pasrestaurimit, realizuar pjesërisht para vitit 1944[31] dhe më pas në vitet 60 të shek. XX), do të ishte Gjerak Karaiskaj, i cili përforcon idenë e datimit në shek. XV, për më tepër duke e ngushtuar datimin në vitin 1478[32]. Më pas ky datim është rimarrë nga të tjerë studiues, pa asnjë hezitim dhe shqyrtime të nevojshme. Megjithatë, L. Rey shkruante: "*Quant à la construction des tours A, F, G, H, I, on peut y voir, jusqu'à preuve de contraire, un travail vénitien bien que certains documents que je me propose de publier dans un prochain article, prouvent que durant le XV*ème *siècle, les fortifications de Durazzo étaient se délabrées que la ville se trouvait continuellement exposée aux attaques des Turcs*." Praktikisht L. Rey na vë në dukje kundërshtitë që bien ndesh mes datimit si veneciane të kësaj kulle bazuar tek krahasimet me ndërtime të ngjashme sipas njohurive të kohës përkundrejt situatës së përcjellë nga dokumentacioni arkivor mbi gjendjen tejmase të rrënuar të fortifikimeve të qytetit në shek. XV. Ndërsa L. Rey jep një datim të tillë me dyshim, studiuesit e tjerë më pas e kanë hequr dyshimin duke lënë vetëm datimin. Gj. Karaiskaj megjithëse vazhdon me një datim të ngjashëm, duke e ngushtuar në vitin 1478, në fundin e artikullit shprehet se masat fortifikuese të marra nga Venediku "*kishin një karakter të kufizuar*", ç'ka bie në kundërshtim me datimin e një ndërtimi kaq të rëndësishëm si kulla rrethore « A ».

Disa vite më herët sesa L.Rey, më 1919, Arnold Schober ka shprehur mendimin se kjo kullë duhej të datohej në periudhën osmane[33]. Ky vlerësim është injoruar dhe nuk ka gjetur përkrahës për afro 70 vjet. Ky studiues e ka bazuar një datim të tillë në një logjikë të thjeshtë dhe shumë të qartë: ripërdorimi i elementëve arkitektonikë romakë dhe bizantinë, tipar që mungonte tek ndërtimet veneciane. Ky tipar i ripërdorimit të elementëve më të hershëm, përmendet si një detaj i rëndësishëm i fortifikimeve osmane edhe nga L. Heuzey[34] si dhe nga K. Jireček[35].

Në vitin 1990 Machiel Kiel botoi një vepër të rëndësishme mbi arkitekturën osmane në Shqipëri, ku për herë të dytë përsëritet datimi osman i kësaj kulle (duke e emërtuar atë vazhdimisht si *bastion*). Tashmë, arsyet e një datimi në periudhës osmane, janë edhe më bindëse, duke na sjellë *"la preuve de contraire"* të përmendur nga L. Rey. M. Kiel ka provuar tashmë se kulla e Selanikut, që ka shërbyer si pikë referimi për L. Rey për të datuar kullën e Durrësit, është ndërtim osman. Për "*Gingirli kule*", njohur ndryshe edhe si "*Kuşhaklı kule*" apo "*Kulla Trigonion*", është gjetur prej tij dokumenti arkivor, i cili flet me detaje për kostot e ditëve të punës dhe të materialit ndërtimor, duke e datuar një vit para "*Kullës së Bardhë*" po të Selanikut[36]. Ndërsa kulla e Sed ul-Bahr i takon gjysmës së dytë të shek. XVII[37]. Për më tepër, njihen edhe ndërtime të tjera osmane, të ngjashme me kullën tonë gati në identike. E tillë është kulla në kështjellën e Kilîd'ül-Bahr në Dardanele[38], ndërtuar në kohën e sulltan Sulejmanit, në vitet 1541-1542. Ngjashmëri

[30] Rey 1925, f. 35.
[31] Një fakt i tillë është i dukshëm nëse krahasojmë imazhet e 7 prillit 1939 me fotot e mëvonshme, të viteve të pushtimit fashist.
[32] Karaiskaj 1977, f. 39.
[33] Praschinker, Schober 1919, f. 34.
[34] Heuzey, Daumet 1876, f. 358-359.
[35] Jireček 1916, f. 165-166.
[36] Komunikim personal nga Machiel Kiel. Ndërsa për Kullën e Bardhë është zbuluar mbishkrimi, i cili qëndronte mbi hyrjen e saj deri në vitin 1912. Në të dëshmohet ndërtimi me urdhër të sulltan Sulejmanit në vitin 942, që korrespondon në mes të datave 12 qershor 1535 dhe 19 qershor 1536. Shiko Kiel 1973, f. 325-357.
[37] Komunikim personal nga Machiel Kiel.
[38] Ayverdi, III, f. 171-187; Ayverdi, IV, f. 790-804; Kiel 1990, f. 97.

ka edhe me kullën në çitadelën e Koronit, në jug të Peleponezit, dhe me kalanë e Moresë pranë Patras[39], datuar më 1499-1500, si dhe me fortesën e Rhion në hyrje të gjirit të Korintit[40]. Sipas M. Kiel kulla e Durrësit bën pjesë tek grupi i ndërtimeve me përmasa mesatare, por ngjashmëritë më të mëdha i ka me kullën e Kilîd'ül-Bahr, e cila u përket ndërtimeve me përmasa të mëdha[41].

Bazuar tek këto të dhëna, osmanologu M. Kiel e cilëson kullën rrethore të Durrësit si një ndërtim osman dhe e daton menjëherë pas pushtimit osman të qytetit, në vitin 1501[42]. Me të drejtë, ky autor shprehet se edhe restaurimi i kullës është bërë tërësisht i gabuar, nëse e krahasojmë me fotot e pararestaurimit. Synimi ishte që t'i jepeshin kullës rrethore tipare më të hershme sesa datimi i vërtetë i saj, duke ngritur gjoksore, të cilat nuk ekzistonin para restaurimit. Restaurimet e para kjo kullë duket i ka pasur para vitit 1939, nëse interpretojmë drejtë fotografitë e kohës.

Për rrjedhojë, mjafton të krahasojmë një fotografi të kullës sonë, para restaurimit, me kullën e Kilîd'ül-Bahr në Dardanele (Fig.13) dhe kuptohet se kemi të bëjmë me struktura pothuaj identike mes tyre në të gjitha tiparet.

Ndërsa besoj me siguri të plotë për një datim osman të kësaj kulle, mendoj se duhet riparë datimi i dhënë nga M. Kiel "menjëherë pas pushtimit të vitit 1501". Janë një seri dokumentesh, të viteve



Fig. 13 Kulla e Kilîd'ül-Bahr në Dardanele, sipas AYVERDI IV

[39] Kiel 1990, f. 97 dhe bibliografia cituar prej ti
[40] Kiel 1990, f. 97 dhe bibliografia cituar prej tij.
[41] Kiel 1990, f. 98.
[42] Kiel 1990, f. 97-98; Kiel 1994, f. 522-524.

DO NOT COPY

të pas pushtimit, të cilat nuk mund ta linin jashtë vëmendjes një element kaq të rëndësishëm dhe mbresëlënës për kohën.
Në tetor të vitit 1502 në një dokument venecian shkruhej se "*hanno principia' far le fondamente in mezzo la terra, e vol levar uno muro e minuir la terra; e dove a la marina era do bombarde, al presente é stà posto bombarde sete, volze sete palmi l'una*"[43]. Në një dokument të tillë, ku përmenden masat fortifikuese të marra nga osmanët në Durrës, me muret veriore dhe artilerinë pranë portit, nuk ka asnjë fjalë për këtë kullë. Në ditaret e M. Sanuto, në 13 tetor 1504, përmenden fortifikimet e realizuara nga turqit në Zonchio ("*reduto in grandissima forteza, tutto reduto ne la sumità dil monte, serato di bone mure*") si dhe në Modon ("… *uno nobel turion, che score con le artilarie in ogni canto a pello di aqua*"), duke vazhduar më tej me përmendjen e Durrësit, por pa veçuar ndonjë strukturë ("*si che dove turchi meteno el piedi si sforzano fortifichar i lochi soi, come hanno etiam fato a Durazo etc.*")[44]. Ndërsa përmenden në detaje fortifikimet e tjera osmane në qytetet e sapopushtuara, për Durrësin kalohet shumë shkurt, pa përmendur në mënyrë specifike kullën rrethore, ngjashmërisht si me kullën e Modonit. Në vitin 1559 një grup anijesh veneciane hasën në anije pirate dhe iu vunë pas deri në portin e Durrësit, ku ato tentuan të strehoheshin. Venecianët nuk hezituan të ankoroheshin dhe të sulmonin qytetin me artileri[45], pa pasur asnjë drojë nga prania e një elementi mbrojtës shumë të fuqishëm, siç ishte kulla A. Për më tepër bindemi për një fakt të tillë nga një relacion anonim, tej mase i detajuar, i vitit 1570[46]. Ndërsa përshkruhen me detaje pozicioni gjeografik i qytetit, muret veriore, burimet e ujit etj., kurrsesi nuk do të ishte lënë jashtë vëmendjes kulla A. Në vazhdim të tekstit të mësipërm kemi një tjetër dokument, i cili hedh dritë më tej mbi gjendjen e fortifikimeve juglindore të qytetit. Kronisti A. Longo përshkruan sulmin venecian të 25 prillit 1571[47]. Përmenden dy kulla këndore, drejt të cilave sulmon flota venedikase. Këto kulla, të cilat përshkruhen si të mbushura me dhé, mbetën shumë të dëmtuara nga predhat e artilerisë detare. Ky përshkrim i kullave nuk korrespondon kurrsesi me strukturën e kullës A. Më 5 gusht 1606, 14 galera të komanduara nga markezi Santa Croce sulmuan Durrësin. Pasi i

[43] *Sanuto* IV, f. 368. Përkthyer në shqip nga Zamputi 1964, f. 123: "*kanë fillue të bajnë themelet në mes të qytetit ku duen me çue një mur dhe me e zvogëlue qytetin, dhe aty n'anë të detit ku ishin dy topa, tashti janë vendos shtatë topa, si thuhet shtatë pëllambësh secili*".
[44] *Sanuto* VI, f. 108.
[45] Braudel 1972, f. 129, nr. 89.
[46] *Starine* XII, f. 194-195, *Relazione dell' Albania e sue citta, fiumi, monti, laghi, piani,confini etc. fatta l'anno 1570.* Përkthyer në shqip nga *Burime* III, f. 159-160: "*… qyteti i vjetër i Durrësit, dymbëdhjetë mile larg nga bishti i Pallës, dhe ky qytet tashti është i vogël në krahasim me madhësinë e parë e të moçme të rrethit të vet. Ai gjendet në bregdet me mure të moçme e të ligështa por është bërë shumë i fortë me anën e dy fortifikimeve* [tek dokumenti origjinal përcaktuar si "*bastioni*" – E.Sh.] *të bëra : ai që është në anën e lindjes, pesë vjetë më parë, dhe ai që është në anën e perëndimit ; dhe pastaj është edhe më i fortë për shkak të pozitës që ka me shkëmbinj për rreth, në mënyrë që galeret nuk mund të ndalen veçse duke qëndruar larg për një copë [hapësirë] të madhe, dhe do të ishte e nevojshme të qiteshin njerëzit në tokë me barkë, dhe as këto nuk mund të shkarkojnë aty poshtë te këmbët [e qytetit] por do t'ju duhej të ecnin nëpër uj më shumë se një të hedhur shigjete. Ky qytet i Durrësit, që më parë ishte i sinjorisë fort të kthiellte, ka për rojë të vet dyqind jeniçerë, dyqind azabë dhe triqind të parregullt (?) turq, të gjithë të gatshëm dhe që besojnë se do të goditen prej kësaj flote të fuqishme të sinjorisë fort të kthiellte, dhe prandej kanë pregatitur çdogjë të nevojshme për të qëndruar dhe kanë qitur jashtë gra e fëmij. Megjithatë, ky qytet është i ligësht në anën e tokës, sepse ka kodrina prej dheu pa gurë, kaq afër, sa i rrijnë mbi kokë kështjellës, e cila, megjithëse ka një hendek, ky është i ngushtë e i cekët, dhe ngado mund të vendosen artileritë dhe mund të rrihen muret, të cilat nuk janë të fortifikuara, por të ngrëna (?) dhe shumë-shumë një hap të gjëra, të bëra me gurë të thatë e gëlqere. Ky qytet është i vendosur në përpjetë nga perëndimi në veri përmbi kodrina, dhe pastaj zbret poshtë dhe mbaron në det. Nuk ka lumenj as burime natyrore, por është i varfër për uj, dhe jashtë qytetit, një të shtënë pushke larg, ka një pus me uj ku mbush qyteti ; dhe më tutje gjëndet një krua me uj të rrjedhëshëm por me derdhje të pakë.*"
[47] Longo 1571, 252r-253v; Xhufi 2016, f. 842.

vunë zjarrin dhe e plaçkitën, morën me vete 150 skllevër dhe një arsenal të tërë topash të kështjellës. [48] Më pas, në vitin 1691, kemi të dhëna se një sulm venecian dështon përballë qytetit[49].
Më tej, me rëndësi është krahasimi i atyre pak hartave të qytetit, ruajtur në arkiva dhe që kemi pasur mundësi t'i konsultojmë. Kjo kullë rrethore mungon në hartën e vitit 1571 nga Giovanni Francesco Camocio[50] (Fig. 14), dhe në të tjerat që



Fig. 14 Hartë e Durrësit dhe prapatokës. Sipas CAMOCIO 1574

bazohen tek ajo. Nëse do të ishte një ndërtim i vitit 1478 si mund të mungonte në një hartë të realizuar paraqitur në çdo hartë lundrimi apo treguesi qytetesh. Raportimi i vitit 1571, ngjarja e vitit 1599 dhe pushtimi i vitit 1606 nuk do të kishin qenë të mundura, nëse do të kishte pasur një ndërtim si kulla rrethore menjëherë pas vitit 1501. Ndërsa pas 93 vitesh, e cila kishte në plan të parë pikërisht pozicionin ku gjendet kulla A.
Për herë të parë kjo kullë rrethore shfaqet në hartën e vitit 1723[51], parë nga deti (Fig. 15). Tashmë bie menjëherë në sy pozicioni dominues i kësaj kulle. Si mund të shpjegohet një mungesë e tillë, në mes dy hartave, me një diferencë kohore prej 152 vitesh? Ky ndërtim ishte strukturë shumë e rëndësishme për mbrojtjen e bregdetit dhe e nevojshme për t'u

[48] Xhufi 2016, f. 1214 dhe dokumentet e cituar prej tij.
[49] Rusch, Lucio 1723, f. 263; Xhufi 2016, f. 902 dëshmon për një tentativë sulmi të vitit 1690, të shtyrë për një vit më pas.
[50] Harta mban të shënuar vitin 1571, ndërsa botimi i takon vitit 1574, shiko Camocio 1574.
[51] Rusch, Lucio 1723, f. 263.

DO NOT COPY



Fig. 15 Hartë e Durrësit dhe prapatokës. Sipas RUSCH, LUCIO 1723

sulmi i dështuar venecian i vitit 1691 dëshmon se struktura mbrojtëse bregdetare e qytetit duhet të kishte marrë formë të plotë dhe efikase, çka jep shpjegim për paraqitjen në hartën e vitit 1723 të kullës rrethore dhe elementëve të tjerë mbrojtës.

Kulla rrethore nuk është një ndërtim i vetëm dhe nuk do të kishte vlerë si një element i shkëputur. Ajo ishte pjesë e një sistemi tërësisht të ri për mbrojtjen e bregdetit. Kjo kullë synonte qartësisht mbrojtjen e gjerë dhe në thellësi të Gjirit të Durrësit. Kjo mbrojtje do të ishte e pamjaftueshme pa dy strukturat e tjera: bastionin këndor Q si dhe bastionin e avancuar S. Bastioni këndor Q synonte mbrojtjen e pjesës fundore të Gjirit të Durrësit dhe brezin tokësor që lidhej me bregdetin. Bastioni i avancuar S mbronte *Portën e Detit* dhe bregdetin para fortifikimeve. Kjo strukturë mbrojtjeje, e bazuar në tri pika, na kujton sulmin venecian të 1571, i cili po ashtu u organizua në tri pika. Të trija këto struktura duhet të jenë ndërtuar njëkohësisht si pjesë e një konceptimi të vetëm të një sistemi mbrojtës shumë të fuqishëm, me disa elementë përbërës.

Ngjashmëri kanë edhe në teknikën e ndërtimit mes kullës rrethore A dhe bastionit S (veçanërisht fazës së dytë të tij). Të dyja strukturat janë ndërtuar duke ripërdorur një sasi shumë të madhe elementësh arkitektonikë antikë, të lidhur me llaç. Elementët arkitektonikë të ripërdorur janë me përmasa të mëdha në pjesën e poshtme dhe më të vegjël në pjesën e sipërme të mureve. Në të dy rastet hasim përdorimin e trarëve të drurit brenda mureve (tek kulla A janë breza druri të lidhur me breza tërthorë 0.20x0.20 m; te bastioni S janë breza druri gjatësorë 0.20x0.20 m të lidhur me breza tërthorë të rrumbullakët)[52]. Edhe numri i frëngjive për artileri, me të cilat janë pajisur strukturat, ka ngjashmëri

[52] Në murin verior, pranuar gjerësisht tashmë se i takon viteve menjëherë pas pushtimit osman, janë përdorur breza druri me seksion të rrumbullakët, me diametër 0.20 m. Shiko KARAISKAJ 1977, f. 36.

mes tyre – 5 pika zjarri në katin e parë të kullës, 5 në pjesën e sipërme. Gjithashtu, 5 frëngji kishte edhe bastioni S.

Ngjashmëri vërejmë edhe me bastionin Q, së paku në elementët që njohim. Profili i jashtëm i ekstremit lindor të këtij bastioni është shumë i ngjashëm me kullën A: bazamenti trungkonik, konturimi i sipërm i murit me një kornizë horizontale (mungon korniza në ndarjen e bazamentit trungkonik me murin).

Një tjetër element datues me shumë rëndësi që në një farë mënyre e vulos datimin osman në shek. XVII për kullën rrethore A është krahasimi me fortesën trekëndore të kanalit të Vivarit (Butrint). Bazuar tek forma trungkonike e bazametit të kullës kryesore të kësaj kështjelle Gj. Karaiskaj e ka barazuar me kullën rrethore të Durrësit. Duke u mbështetur në datimin e kullës së Durrësit ka datuar edhe kullën e kështjellës së Vivarit si një ndërtim venecian të shek. XV[53]. Në librin më të fundit të tij historiani Pëllumb Xhufi ka botuar një hartë dhe raport venedikas ku përshkruhet me detaje të territorit të Butrintit. Aty shkruhet qartazi se kështjella trekëndore ishte një ndërtim osman i vitit 1663 dhe kishte përfunduar në muajin shtator të atij viti[54]. Ngjashmëria mes dy kullave, e konstatuar nga Gj. Karaiskaj, vazhdon të jetë e vlefshme, por datimi i sigurtë i asaj në Vivar kthehet si një mbështetje e rëndësishme për propozimin tonë mbi kullën e Durrësit si një ndërtim i fillimit të shek. XVII.

Nuk duhet të lemë jashtë vëmendjes edhe faktin se linja fortifikuese perëndimore e periudhës bizantine ruan gjerësi standarde prej 3.47-3.50 m deri në afro 17 m nga pikëtakimi me kullën rrethore (Fig. 16). Pjesa tjetër e murit paraqet tipare tërësisht të ndryshme ndërtimi dhe përmasash, të cilat i përshkruam më lart.

Për këto arsye, jemi të mendimit se në pikën më fundore, ku mbaronte pjesa e gjerë e kurtinës jugperëndimore, ishte ekstremi jugor i fortifikimeve perëndimore bizantine. Pjesa tjetër e murit deri në kullën A është një shtesë e mëvonshme. Jemi të bindur se në pjesën ku ndërpritet muri bizantin, duhet kërkuar një kullë katërkëndore, e paraqitur në hartën e vitit 1571 (Fig. 14), e cila ka paraprirë ndërtimin e kullës A. Kjo ishte edhe arsyeja se përse në fushatën e vitit 2017 të bashkëpunimit shqiptaro-francez "Topografia e Epidamne-Dyrrachion" hapëm një sondazh në këtë pikë[55]. Si rezultat identifikuam një strukturë të orientuar lindje-perëndim, e cila është faqja veriore e kullës katërkëndore, që po e emërtojmë A1. Teknika e



Fig. 16 Pamje ajrore e fortifikimit perëndimor. Foto A.Hallvaxhiu

[53] KARAISKAJ 1983, f. 120, 121.
[54] XHUFI 2016, f. 164-165.
[55] ABADIE-REYNAL *ETJ*. 2017, f. 193-196.

DO NOT COPY

ndërtimit ishte tërësisht e ndryshme nga ajo e shek. V dhe nga ajo osmane, dhe i takon një ndërtimi mesjetar. Struktura, e cila vazhdon në vijë të drejtë me linjën antike të vonë, është mbetja e fundit e murit të brendshëm të kësaj kulle. Porta e bllokuar që ruhet në të jemi të bindur se i përket hyrjes së kullës A1 (Fig. 5). Mbetet e paqartë nëse ka pasur një hyrje më poshtë, që do të korrespondonte me katin e parë të kullës, apo disniveli i relievit në pjesën e brendshme ishte i tillë që mjaftonte vetëm një hyrje, pikërisht ajo që ruhet ende. Ndoshta, nëpërmjet saj kalohej në një sistem shkallësh dhe zbritej për në portën e jashtme, drejt faqes veriore të kullës.

Kështu, kulla A është pasuesja e një kulle më të hershme, A1, që i takon periudhës mesjetare. Sulmi venecian i vitit 1571 ka goditur dhe dëmtuar kullën A1, si edhe pjesën tjetër të linjës fortifikuese të periudhës në fjalë. Këto dëmtime duhet të jenë përsëritur gjatë plaçkitjes spanjolle të 1606, duke e bërë mbrojtjen bregdetare të qytetit tërësisht jofunksionale. Normalisht, ndërtimi i kullës A duhet të ketë qenë pjesë e një plani rifortifikimi të linjës juglindore, të realizuara pas plaçkitjes spanjolle të vitit 1606. Ndërtimi i saj është realizuar duke spostuar linjën e fortifikimeve me afro 25 m drejt jugut. Për ndërtimin e saj është rrafshuar kulla mesjetare A1 (apo ajo që kishte mbijetuar nga kulla) duke ruajtuar vetëm murin e brendshëm. Duke qenë se nuk ishte mjaftueshmërisht i sigurtë, një veshje nga jashtë i është shtuar këtij muri, në formë të pjerrët. Elementët e tjerë që përshkruam më lart, bazuar tek fotografitë, mbeten të paqarta në funksion dhe datim.

Nëse ka pasur një fazë më të hershme, gjithmonë osmane, të kullës A, që ka paraprirë ndërtimin e strukturës që njohim ne sot (ngjashmërisht me dy fazat e bastionit S), duhet të kihet në konsideratë, por nuk mund të provohet për momentin në aspektin arkeologjik.

Së fundmi, duhet të kemi parasysh edhe një aspekt tjetër të lidhur me kullën A. Ajo është qartësisht një element mbrojtës i orientuar drejt detit. Të gjitha dokumentet historike të njohura për periudhën e administrimit venecian të Durrësit tregojnë qartë se qyteti nuk ka pasur asnjëherë rrezik nga deti. Flota veneciane kishte kontroll të padiskutueshëm mbi Adriatik dhe jovetëm. Kjo situatë ka vazhduar edhe pas zgjerimit të pushtimeve osmane drejt veriut të Ballkanit. Për rrjedhojë, një investim kaq masiv venecian bie në kundërshti me realitetin historik. Në të kundërt, kontrolli osman i Durrësit ka pasur rrezik të vazhdueshëm vetëm nga deti, ndërkohë që kishte një kontroll të padiskutueshëm të prapatokës. Vetëm një situatë pasigurie dhe rreziku i ardhur nga deti justifikon ndërtimin e kullës A.

2.Evoluimi kronologjik i fortifikimit

Nga përshkrimi i mësipërm i elementeve përbërëse të fortifikimeve kuptohet qartë se linja juglindore e fortifikimeve, siç ka arritur deri në vitet 1925-1928, ka qenë rezultat i një seri ndërtimesh, rindërtimesh dhe meremetimesh të realizuara përgjatë periudhave të ndryshme kohore. Për aq sa kemi njohuri deri në këtë moment, mund të paraqesim një evoluim kronologjik të këtyre strukturave. Përveçse njohurive nga terreni do të mbështetemi edhe tek dokumentacioni arkivor e hartat historike të qytetit të Durrësit që kemi arritur të mbledhim. Ndër to, një rëndësi të veçantë kanë hartat osmane të shek. XIX, pasi na paraqesin detaje që mungojnë tek të gjitha të tjerat. Aktualisht është dorëzuar për botim një artikull kushtuar fortifikimeve osmane, ku analizohen me detaje tre harta të panjohura osmane, të qytetit të Durrësit[56], me shumë rëndësi për të njohur periudhën osmane dhe atë mesjetare. Në artikullin në fjalë ne trajtojmë me detaje të gjitha fortifikimet e qytetit. Këtu do të përdorim vetëm të dhënat që hartat në fjalë na ofrojnë për linjën juglindore. Megjithatë, në disa aspekte situata ka nevojë për njohuri më të plota, që shpresojmë të shtohen në të ardhmen.

[56] Shehi, Caka, Ruka, *së shpejti*.

Fortifikimet e shek. V-VI

Gjurmët e mbijetuara tek fortifikimet juglindore që i takojnë antikitetit të vonë janë të pakta. Për të tentuar paraqitjen e organizimit planimetrik të tyre, duhet të mbështetemi edhe tek gjurmët fundore të ruajtura tek dy linjat pranë saj, përkatësisht ajo jugperëndimore dhe ajo lindore.

Ekstremi jugor i kurtinës jugperëndimore të fortifikimit bizantin (kurtina A-B) paraqet një ndërprerje të menjëhershme në gjerësi, disa metra pa arritur kullën A (Fig. 2; Fig. 17). Pjesa në vazhdim që i është shtuar kurtinës deri në pikëtakimin me kullën A nuk paraqet asnjë ngjashmëri në teknikën e ndërtimit të antikitetit të vonë, duke përbërë qartësisht një shtesë të vonë. Një problem të ngjashëm vërejmë edhe për pjesën fundore të linjës lindore, shënuar tek njëra nga hartat osmane. Këtu, ekstremi lindor i murit tregon një ndërprerje të menjëhershme, ndërsa muri vazhdues, që i takon bastionit Q vazhdon me përthyerje nga brenda (orientimi juglindje).

Në vetë linjën juglindore periudhës së shek. V-VI i takojnë kurtina R-Q1 dhe kulla Q1, të gjitha këto të ngritura mbi struktura më të hershme. Vetë kulla gjysmërrethore Q1 ka origjinë pararomake, siç edhe e kemi përmendur më lart. Më tej, brinja VI e bastionit Q paraqet të gjitha tiparet e një ndërtimi të shek.V-VI. Ndërsa muri lidhës mes saj dhe kurtinës Q-P nuk duket i tillë. Në mes këtyre strukturave antike të vona na mungon lidhja që kanë pasur me njëra-tjetrën (Fig. 17). Nuk njohim as lidhjen e tyre me linjën jugperëndimore dhe atë lindore. Fatkeqësisht, rrafshimet e shek. XX nuk kanë lënë gjurmë të qarta, për të na mundësuar të kuptuarin e planimetrisë së këtyre mureve. Themeli i mureve antike të vona mbi strukturën romake në kurtinën S-Q1 dëshmon për një nivel ecjeje së paku 2 m më të lartë, si dhe konsiderueshëm më lart sesa niveli modern i ecjes. Ky është një tregues i qartë se rrafshimet e kryera në shekullin e kaluar jo vetëm kanë hequr muret por edhe kanë ulur kuotat në këtë zonë, duke krijuar dëme shumë të mëdha arkeologjike.



Fig. 17 Strukturat e njohura të shek. V-VI në linjën juglindore të fortifikimeve dhe propozime orientimi

DO NOT COPY

Nga ekstremi fundor i kurtinës A-B deri në ekstremin perëndimor të kurtinës R-Q1 është trakti më i vështirë për të hamendësuar. Nëse fortifikimi i antikitetit të vonë do të kishte ndjekur muret romake, me funksion jo fortifikues, të zbuluara në gërmimet e vitit 2017 (Fig. 17), do të krijohej një linjë me kthesë të gjerë, e cila më pas mund të lidhej me kurtinën A-B në formën e një bastioni të ekspozuar. Në këtë formë do të eleminohej edhe nevoja e një kulle këndore. Në një rast të tillë, fortifikimi i antikitetit të vonë do të duhej të mbështetej mbi një mur më të hershëm, jo fortifikues, gjerësia maksimale e të cilit shkonte 2-2.20 m. Vetë gjerësia e murit fortifikues bizantin ishte 3.50 m, që nënkupton një zgjerim të konsiderueshëm përtej bazës së periudhës romake, duke krijuar ndoshta probleme stabiliteti. Nga ana tjetër, gjurmimet e realizuara në zonë nuk paraqitën gjurmë të ekzistencës së një muri të tillë.

Për këto arsye, me të dhënat që kemi në dispozicion, forma më e mundshme që imagjinojmë, e shtrirjes së fortifikimit të antikitetit të vonë në këtë zonë, duhej të kishte një linjë që vazhdonte në aks me kurtinën R-Q1 (Fig. 17). Duke qenë një linjë e drejtë dhe me distancë të konsiderueshme, duhet të ketë pasur nevojë për një kullë përforcuese në mesin e gjatësisë.

Mbyllja e këndit jugperëndimor të kësaj kurtine mbetet e paqartë, nëse ka qenë realizuar me anë të një kulle apo rolin e saj mund ta luante një kthesë e murit. Pozicioni i kullës mesjetare A1 sugjeron një hapësirë boshe mes dy ekstremeve të linjave juglindore dhe jugperëndimore. Kjo na bën të besojmë më shumë ekzistencën e një kulle, megjithëse në gërmimin e vitit 2017 nuk u zbuluan gjurmë të tilla[57]. Një tjetër mundësi që duhet përmendur është edhe një mbyllje e ngjashme me murin verilindor, përballë shtegut lidhës me kontinentin, i cili lidhte në formë diagonale linjën veriore me atë lindore.

E paqartë mbetet situata edhe në krahun e kundërt, në pikëtakimin me linjën lindore. Prania e brinjës VI të bastionit Q, dhe detajeve të lidhur me të, dëshmon për një planimetri komplekse. Gjurmët e pakta të ruajtura këtu, si dhe vendosja e tyre, na bëjnë të besojmë mbi ekzistencën e një strukture fortifikuese këndore, që lidhte linjën juglindore me atë lindore. Ndoshta ka pasur një kullë (pesëkëndore ?) ose bastion të ekspozuar, vendosur në ekstremin e kurtinave. Si fakt mbështetës për këtë hamendësim është këndi që paraqet brinja VI e bastionit Q, e cila ngjason me faqet anësore të kullave B, C dhe D. Prania e një kulle këtu do të shpjegonte praninë e mundshme të dritareve të mbuluara me qemer (si ato të kullave B, C dhe D), si dhe praninë e një gjurme muri të rrënuar në ekstremin jugor të brinjës VI (Fig. 12). Nëse ky hamendësim do të ishte më i mundshmi, pjesa tjetër e kullës nuk duhet të ketë mbijetuar ndër shekuj. Brinja VI është më e gjatë sesa brinjët e të treja kullave (B, C, D) të shek. V-VI. Nëse do të kishim një kullë apo bastion këtu, atëherë duhet të ketë pasur përmasa më të mëdha sesa kullat që njohim sot.

Gjatësia e të gjithë linjës juglindore ishte e tillë që nevojitej një hyrje kryesore për t'u lidhur me skelën e qytetit. Porta e ruajtur në kurtinën A-B është shumë e vogël për të kryer një rol të tillë. Ajo duhet të ketë pasur funksion ushtarak ose ndihmues për qarkullimin. Ngjashmërisht edhe porta e mbyllur tek brinja VI duket se ishte me përmasa të kufizuara. Portat romake monumentale[58], në pozicion ballor përkundrejt kurtinës, gjendeshin nën kuotën e nivelit të ecjes së antikitetit të vonë dhe ishin të papërdorshme. Për rrjedhojë, jemi të bindur se në linjën juglindore të periudhës së antikitetit të vonë, ndoshta në mesin e gjatësisë së saj, duhet të ketë ekzistuar një portë kryesore për në qytet. Një hyrje e tillë mund të lidhej me nevojën për një strukturë fortifikuese në qendër të linjës, duke i dhënë jetë një hyrjeje të fortifikuar në formën e një kulle. Megjithatë, mundësia e

[57] Shehi *etj*. 2017, f. 227-260.

[58] Shehi *etj*. 2017, f. 245, 254; Shehi 2018, f. 238.

ekzsitencës së një porte të tillë, forma e saj dhe sistemi mbrojtës që mund të ketë pasur, mbeten tërësisht të panjohura deri më sot.

Fortifikimet mesjetare

Në terma të përgjithshëm, tashmë është pranuar gjerësisht se fortifikimet mesjetare kanë qenë mbështetur pothuaj në të gjithë linjën e tyre mbi perimetrin e vogël të fortifikimeve të antikitetit të vonë[59]. Këtu nuk bën dallim as linja juglindore. Në trajtimin e periudhës mesjetare, për arsye të mungesës së të dhënave të mjaftueshme, nuk kemi bërë ndarje në faza por e kemi grupuar së bashku të gjithë harkun kohor deri në momentin e pushtimit osman. Shpresojmë që në të ardhmen të identifikohen të dhëna të tjera për të realizuar një ndarje më të mirë brenda kësaj periudhe të gjerë.

Nga fortifikimet mesjetare në këtë zonë kemi disa elementë të shkëputur, të cilët mund t'i kombinojmë me burimet arkivore dhe me hartat, veçanërisht ato osmane, duke na ndihmuar për të dhënë një pamje sa më të qartë (Fig. 18). Në këtë formë mund të japim vlerësime të përgjithshme për ndërtimin e elementëve të veçantë, si p.sh. kulla apo porta, por jo në tërësinë e të gjithë linjës.

Tashmë mund të themi me siguri se linja juglindore fillonte nga kulla A1, e cila ishte në rolin e kullës këndore. Ndërtimi i saj është realizuar si shtesë në pjesën fundore të linjës jugperëndimore të antikitetit të vonë, ku u gjet edhe gjurma e faqes perëndimore të kullës. Nuk njohim ende përmasat e kësaj faqeje si dhe kthesën e faqes ballore (jugore) të kullës. Hyrja kryesore për në kullë gjendej në faqen veriore (Fig. 5). Për këtë arsye, fillimi i linjës juglindore duhej të lidhej me faqen lindore ose këndin verilindor të kullës A1, duke e vendosur



Fig. 18 Strukturat e njohura mesjetare në linjën juglindore të fortifikimeve dhe zhvillimi i mundshëm i linjës

[59] Heuzey, Daumet 1876, f. 358, 369; Rey 1925, f. 46, 48; Karaiskaj 1977, f. 37; Gutteridge 2003, f. 45; Shehi, Shkodra-Rrugia 2010, f. 332.

DO NOT COPY

normalisht hyrjen e kullës *intra muros* (Fig. 18). Nuk jemi ende të qartë nëse kjo kullë është ngritur në vendin e dikurshëm të një kulle antike të vonë ose mbi një kënd pikëtakimi të mureve antike të vona, ku nuk kishte asnjë kullë. Kronologjia që kemi deri më tani lidhet me bllokimin e kullës, në fundin e shek. XV – fillimi shek. XVI[60]. Datimi i kësaj kulle mund të lidhet me dy shekuj, atë të XII dhe të XIII. Në shek. XII ajo mund të lidhej me ndërtimet e realizuara në kuadër të masave fortifikuese të ndërmara nga perandori Aleksi I Komnen (1081-1118), i cili ishte informuar për synimet normane (të Boemundit), dhe kishte përforcuar para sulmit ndaj Durrësit deri edhe flotën ushtarake të qytetit[61]. Në të njëjtin shekull A. Ducellier vlerëson se perandori bizantin Isak II (1185-1195) ka rifortifikuar qytetin, pavarësisht se nuk ka prova për këtë fakt[62]. Një mundësi që nuk mund të lihet pa përmendur janë edhe ndërtimet fortifikuese të realizuara nga Despotati i Epirit, në shek. XIII.

Nga kulla A1 zgjatohej një kurtinë drejt hyrjes kryesore të linjës juglindore. Hamendësojmë se duhet të ketë qenë ende e ruajtur kurtina bizantine, e cila ka shërbyer si bazë fortifikuese edhe për murin mesjetar, por kjo mbetet për t'u provuar. Fakti i mosgjetjes së gjurmëve fortifikuese antike të vona jashtë linjës që hamendësojmë për antikitetin e vonë, përgjatë gërmimeve të vitit 2017[63], e bën edhe më bindës propozimin tonë.

Në krahun e kundërt, kjo kurtinë duhej të përfundonte tek porta kryesore e linjës juglindore. Ekzistenca e një porte të tillë, emërtuar *Porta e Detit* njihet nga dokumentet arkivore[64]. Pozicionin e saktë të kësaj hyrjeje nuk kemi arritur ta provojmë nëpërmjet gërmimeve arkeologjike. Arsyeja duhet lidhur me pozicionin që ka pasur në raport me kurtinën antike të vonë, më të spostuar drejt veriut përkundrejt gërmimeve arkeologjike të realizuara në zonë, praktikisht nën rrugën e asfaltuar moderne. Këtë pozicion të saj mund ta hamendësojmë nga të dhënat arkivore dhe më së shumti nga hartat që kemi në dispozicion. Në hartën e vitit 1571 (Fig. 14) strukturat fortifikuese në këtë pjesë na paraqiten të tilla: kulla A1 – kurtinë diagonale – portë e mbrojtur nga kullë. Duke pasur parasysh se kulla A1 e paraqitur në këto harta përkon me gjetjet në terren – kullë katërkëndore në fundin e linjës jugperëndimore, duhet të besojmë se edhe në rastin e *Portës së Detit*, harta e vitit 1571 ka paraqitur një strukturë që ka ekzistuar realisht. Porta ishte në katin përdhes, me sa kuptohet nga ilustrimi, në formën e një korridori të mbrojtur. Ekspozimi i kullës mbrojtëse të hyrjes është më i pakët nga jashtë mureve, duke u zhvilluar më së shumti *intra muros*. Dokumentet arkivore të periudhës mesjetare që përmendin *Portën e Detit* nuk ofrojnë asnjë të dhënë shtesë mbi ekzistencën e ndonjë elementi mbrojtës. Pozicioni i saktë i kësaj porte mbetet i paqartë, por një ndihmesë për këtë qëllim mund të jetë harta osmane e vitit 1865. Besojmë se porta e qytetit, e paraqitur në këtë hartë tek kurtina prapa bastionit S, duhej të ishte mbetja e fundit e portës mesjetare. Arsyet për një fakt të tillë do t'i shtjellojmë më gjerë në vazhdim tek trajtimi i periudhës osmane. Këtë portë po e emërtojnë R1, për ta dalluar nga portat e mëvonshme.

Nga porta R1 kurtina vazhdonte drejt bastionit Q (Fig. 18). Deri në traktin e murit të ruajtur (quajtur "bastioni juglindor"), nuk është e qartë si ka qenë muri. Besojmë se ka qenë përdorur në të gjithë gjatësinë linja e murit antik të vonë. Fatkeqësisht ky mur është rrafshuar. Një trakt muri mesjetar, zbuluar në vitin 2017[65] mbetet i paqartë në funksionin e tij. Besojmë se bëhej fjalë për një përforcim strukturash ose bllokues të hyrjeve romake dhe themel për superstrukturën. Për momentin

[60] Abadie *etj*. 2017, f. 196.
[61] Ahrweiler 1966, f. 195.
[62] Ducellier 1981, f. 101.
[63] Shehi *etj*. 2017, f. 242-243, sondazhi 2.
[64] Gaglione, Shehi 2016, f. 31-66.
[65] Shehi *etj*. 2017, f. 246, faza IV.1.

DO NOT COPY

planimetria se si zhvillohej ky mur mbetet e paqartë. Datimi që rezultoi nga gërmimi[66], mund të lidhet me të njëjtat rrjedha historike përgjatë së cilave u ndërtua edhe kulla A1.

Më tej, kemi përforcimet mesjetare mbi kurtinën antike të vonë, si dhe pjesërisht mbi kullën Q1 me përforcime në pjesën e sipërme me blloqe guri drejtkëndorë, të lidhur me llaç[67]. Përtej kullës Q1 duhet të ketë qenë po ashtu në përdorim kurtina Q1-Q. Kurtina vazhdonte deri tek bastioni Q.

Bastioni Q na paraqet një situatë shumë të komplikuar, jo vetëm sepse nuk ka asnjë strukturë të ruajtur (së paku në sipërfaqe), por edhe sepse bëhej fjalë për një ndërtim shumë kompleks. Ky bastion nuk paraqitet në hartën e vitit 1571. Arsyet mund të jenë të ndryshme. Mundet që këndi i pamjes së realizimit të hartës nuk lejonte shikim të bastionit në fjalë, ose nuk ekzistonte një strukturë e dalë përtej kurtinës, që të ishte e shikueshme. Besojmë se brinjët I dhe II të këtij bastioni duhen parë si ndërtime osmane (rikujtojmë praninë e frëngjive të mëdha për artileri). Ajo që nuk njohim është nëse këto mure janë një shtesë/veshje mbi mure më të hershme, apo ndërtime tërësisht të reja osmane. Zhvillimi i bastionit Q në pjesën e brendshme të fortifikimeve (brinjët VIII-IX-X) na bëjnë ta shikojmë organizimin planimetrik të bastionit Q në ngjashmëri me kullën e *Portës së Detit*. Mundet që edhe në këtë rast të ketë pasur një zhvillim të strukturës kryesisht brenda mureve (në mos tërësisht) dhe më pak të ekspozuar jashtë tyre, ndoshta si pasojë e mungesës së territorit. Rikujtojmë se kjo pjesë e fortifikimit gjendej në breg të detit.

Përmendja e dokumentit venecian, se aty ku gjendeshin dy topa janë vendosur shtatë, na tregon se struktura e bastionit Q deri në vitin 1501 nuk ishte e përshtatshme për më shumë elementë artilerie. Brinja II e bastionit Q paraqet pesë frëngji të mëdha për artileri, ndërsa tek brinja VII ka pasur një tjetër frëngji, e ndryshme nga ato të brinjës II: më e ngushtë dhe më e lartë. Besojmë se kjo duhej të ishte një frëngji e periudhës veneciane.

Në disa dokumente veneciane hasim të përmendur një kullë pranë portit, quajtur "*turrim Durachii a marina*" ose "*turrim que est portus a marina Durachii*"[68], të cilën Gjergj Topia ia dorëzon republikës në vitin 1388. Për mbrojtjen e saj konsiderohej e nevojshme prania e përhershme e 12 *balistarios*[69]. Më pas kjo kullë do të cilësohet si "*turris nostra Durachii*"[70], deri në marjen nën kontroll prej venecianëve të të gjithë qytetit në vitin 1392[71]. Të dhënat arkivore, hartat, fotografitë ajrore, gërmimi arkeologjik si dhe përbërja gjeologjike e terrenit dëshmojnë se bregdeti afrohej shumë pranë bastionit Q, ku gjendeshin edhe skela/skelat e limanit të Durrësit[72]. Sado që të kenë pasur luhatje vendndodhjet e skelave ndër shekuj, kanë qëndruar gjithmonë brenda kësaj hapësire, e cila rezulton më e favorshmja si në raport me relievin, ashtu edhe me gjirin e Durrësit dhe me erërat. Për rrjedhojë, ky bastion duhet identifikuar me *kullën e portit* në dokumentacionin venecian[73]. Fakti që flitet për rindërtim apo meremetim të saj dëshmon se kemi të bëjmë me një strukturë më të hershme në kohë sesa viti 1388. Gjithashtu, synimi për vendosjen në të të një skuadre balestarësh nënkupton se kishte mjaftueshëm hapësirë për të siguruar jetesën e tyre brenda kullës. Harta osmane e vitit 1865 duhet parë si më e afërta në kohë në transmetimin e planimetrisë së kullës

[66] Shehi *etj*. 2017, f. 246-247.
[67] Hoti *etj*. 2004, f. 143.
[68] *AAlb* 2, nr. 422, 424.
[69] *AAlb* 2, nr. 443.
[70] *AAlb* 2, nr. 443, 476.
[71] Šufflay 1924, f. 22.
[72] Jemi duke punuar mbi një analizë të detajuar të pozicionit të skelave në mesjetë dhe na rezulton se ky pozicion ka qenë gjithmonë më i përshtatshëm.
[73] Për një analizë të gjerë të kësaj situate jemi duke punuar një studim më vete.

veneciane. Mundet që kthinat e brendshme të kenë qenë ndërtime ose rindërtime veneciane, për vendosjen e kompanisë së balestarëve, që nga viti 1388.

Periudha Osmane

Të dhënat mbi riparime apo ndërtime të reja mbrojtëse përgjatë linjës juglindore nga ana e osmanëve pas pushtimit janë të copëzuara dhe të paqarta, ndërsa në terren strukturat kanë qenë shumë komplekse. Fatkeqësisht, na mungojnë të dhënat e detajuara për të pasur mundësinë e një rindërtimi tërësor kronologjik. Për këtë arsye, jemi përqëndruar në momentet kryesore të tyre. Në linja të përgjithshme, si momente të rëndësishme kufizuese për ndarjen e periudhave ndërtimore osmane të fortifikimeve juglindore, kemi përdorur dokumentacionin arkivor, ngjarjet e rëndësishme historike si dhe evolucionin e përdorimit të bastionit S nga strukturë mbrojtëse në Konakun e mutesarifit. Si rezultat, na shfaqen tre faza të ndryshme të periudhës osmane të kësaj linje fortifikuese[74].

Os. 1. Në këndin më jugor të linjës nuk mund të themi nëse ka pasur një kullë të ndërtuar nga osmanët në vitet që kanë pasuar pushtimin e qytetit, e cila ka paraprirë ndërtimin e kullës A. Për rrjedhojë, përsa kohë nuk kemi të dhëna të sigurta për një fakt të tillë, mbetemi të mendimit se ka qenë në përdorim kulla mesjetare këndore A1. Nga kulla këndore A1 vazhdonte një kurtinë tërthore, deri tek porta R1 e periudhës mesjetare. Besojmë se kurtina mesjetare (që përshkruam më lart), ka vazhduar të jetë në përdorim pas pushtimit osman. Gjithashtu, edhe *Porta e Detit* mesjetare, R1, duhet të ketë qenë ende funksionale, ndoshta duke u riparuar. Nga porta R1 vazhdonte kurtina e murit fortifikues deri tek kulla Q1. Nga këtu rimerte kurtina deri tek bastioni Q.

Për të identifikuar qartësisht linjën e kësaj faze na vijnë në ndihmë tre dokumente historike, relacioni venecian i vitit 1502, relacioni anonim i vitit 1570 dhe përshkrimi i sulmit venecian të vitit 1571. Harta e vitit 1571 tashmë është analizuar për të nxjerrë strukturën mesjetare të fortifikimeve, e cila vazhdonte të ishte funksionale në pjesën kryesore të saj.

Dokumenti i vitit 1502 përmend vendosjen e shtatë topave në bregdet/skelë[75] por nuk përmend ndërtim bastioni. Besojmë se pozicioni në fjalë duhet lidhur me bastionin Q, e cila ishte pjesa e vetme e kësaj linje në breg të detit. Nuk mund të themi me siguri nëse është përshtatur kurtina mesjetare me frëngji artilerie në këtë vit apo ka ndodhur ndërtimi i një faze të parë të brinjëve I, II, XII duke dalë *ekstra muros*. Këto brinjë kanë qenë të pajisura me pesë frëngji artilerie, siç është e dukshme tek hartat osmane dhe tek fotografitë e ruajtura.

Relacionin i vitit 1570 përmend një fortifikim/bastion lindor të ndërtuar në 1565 dhe një perëndimor, pa përmendur datim[76]. Bastionin perëndimor të këtij dokumenti mund ta lidhim me ndërtimin e fazës më të hershme të bastionit S (faza III.1), duke e mbështetur pjesën e pasme në faqen e jashtme të kurtinës mesjetare. Bastioni Q mund të jetë ai lindor i këtij dokumenti, ndërtuar në vitin 1565. Këtij viti mund t'i përkasin brinjët I, II dhe XII, të cilat dilnin *ekstra muros* nga kurtina. Në këtë formë, duke bashkërenduar të dhënat me informacionin e vitit 1502, do të kishim një fuqizim fillestar të bastionit Q me elementë artilerie dhe ndërtimin më pas të strukturave shtesë jashtë kurtinës (Fig. 19).

Kronika e sulmit venecian të vitit 1571 na ofron disa të dhëna shtesë por edhe problematike për interpretim dhe bashkërendim me dy dokumentet e mësipërme. Mësojmë se janë sulmuar dy kulla në kënde (që ishin të mbushura me dhera) dhe mes tyre "*cortina che caminava dall'uno all'altro torrione*". Në krahun lindor qartësisht është goditur bastioni

[74] Një ndarje e tillë në faza vlen vetëm për këtë linjë të fortifikimeve dhe jo për të gjithë ndërtimet osmane në qytet.

[75] *Sanuto* IV, f. 368. Përkthyer në shqip nga Zamputi 1964, f. 123.

[76] *Starine* XII, f. 194-195. Përkthyer në shqip nga *Burime* III, f. 159-160.



Fig. 19 Strukturat e fortifikimeve osmane, faza Os.1

Q, pjesa fundore e fortifikimit, përballë skelës. Fotografitë e viteve 1910-1912 (Fig. 10), paraqesin një kullë pjesërisht me hapësira boshe nga brenda. Për rrjedhojë, përshkrimi si i mbushur me dhera duhet të korrespondojë me një shtesë të strukturës (bastioni lindor i relacionit anonim të vitit 1570, ndërtuar në faqen e jashtme të bastionit Q). Kjo mbushje dallohet nga fotot e vitit 1918, deri në nivelin e poshtëm të frëngjive. Kurtina e goditur fillonte nga bastioni Q dhe vazhdonte deri tek elementi tjetër fortifikues, i cili mbetet i paqartë. Nuk mund të themi me siguri se cila ishte kulla tjetër e sulmuar, kulla A1, bastioni S apo porta mesjetare R1. Identifikimi se cila ka qenë kulla e sulmuar do të na ndihmonte në detajimet e kronologjisë së ndërtimeve osmane. Megjithatë, duhet të përmendim se bastioni S nuk ka qenë i mbushur me dhera në pjesën e brendshme, duke mos përkuar me tregimin e kronikës së vitit 1571. Vitet më të hershme të kësaj periudhe duhet të lidhen me paspushtimin osman dhe masat e para ndërtimore të ndërmara prej tyre, pra me vitet 1501-1502. Pas pushtimit, fillimisht ndërhyrjet përforcuese kanë qenë të kufizuara. Dokumenti venecian i vitit 1502 tregon vetëm për vendosje artilerie tek pjesa e fortifikimit që përkon me bregdetin[77], por nuk përmenden bastione.

Për ta përmbledhur, në këtë fazë është ndërtuar për herë të parë bastioni S. Duke qenë se gjerësia e mureve ishte me përmasa të kufizuara (1,20 m), nuk besojmë se ka qenë e vetmja masë mbrojtëse. Më shumë e shikojmë si një element shtesë të mbrojtjes së portës R1, e cila vazhdonte të funksiononte në formën mesjetare, e mbrojtur me një kullë. Elementi i shtuar osman nënkuptonte një bllokim të goditjes direkte ndaj saj me artileri, duke e paraprirë bastioni S. Me shumë mundësi kemi në këtë moment krjimin e një korridori hyrës anësor, në pjesën fundore të faqes së bastionit S, dhe paralel me kurtinën. Nuk kemi të dhëna të sakta për momentin, për të tjerë elementë përforcues, përveçse këtij korridori. Në pjesën që i takonte korridorit gërmimet e vitit 2017 zbuluan praninë e dy varreve me mbulesë tjegullash në formë çatie dyujëse. Këto varre nuk mund të datoheshin

[77] *Sanuto* IV, f. 368; përkthyer në shqip nga Zamputi 1964, f. 123.

DO NOT COPY

në një periudhë të ngushtë kohore, por duke qenë se ishin të dëmtuara nga ndërtimet e mëvonshme, i takonin një periudhe *ante quem* shek. XVI[78]. Duke krahasuar me gjetet e tjera në qytet, i takojnë një periudhe që shkon *post quem* shek. VI-VII deri në *ante quem* shek. XIV. Po në këto gërmime një varr i ngjashëm u datua në shek. XIV[79]. Në periudhën mesjetare kjo hapësirë *ekstra muros* ka qenë përdorur si nekropol (ngjashmërisht me linjën jugperëndimore) dhe nuk mund të kishte vendosje këtu të një korridori hyrës që të drejtonte për nga porta e qytetit. Për rrjedhojë, ky korridor është qartësisht një ndërtim i periudhës osmane.

Përgjatë kësaj faze besojmë se ka ndodhur një fuqizim i bastionit Q, duke dalë jashtë linjës së kurtinës mesjetare, dhe duke vendosur elementë artilerie në të.

Si moment i fillimit të kësaj faze kemi pushtimin osman të Durrësit. Kufiri i sipërm kohor i saj është, për ne, viti 1606, për arsye të cilat i përmendëm në analizën e kronologjisë së kullës A (torrës veneciane) dhe që do ta rimarim tek faza pasuese.

Os. 2. Përgjatë kësaj faze kanë ndodhur ndryshimet më të mëdha në linjën juglindore të fortifikimeve. Elementi bazë i kësaj periudhe mendojmë se është finalizimi i trinomit: kullë A (Fig. 20) – faza dytë e bastionit S – përforcime të bastionit Q.

Kulla mesjetare A1 nuk mund të luante më rol të rëndësishëm mbrojtës të kësaj pike kyçe për qytetin. Teknikat e reja të luftimit duket se e kanë kthyer në një strukturë të vjetëruar. Për rrjedhojë, duke u spostuar me disa metra drejt jugut është ngritur një



Fig. 20 Strukturat e fortifikimeve osmane, faza Os.2

[78] Shehi *etj*. 2017, f. 251.
[79] Shehi *etj*. 2017, f. 247.

model i ri kulle, rrethore, masive në strukturë, për t'i rezistuar artilerisë me barut. Për më tepër, pjesa e sipërme e saj lejonte një kënd goditjeje deri në 260° [80]. Për ndërtimin e saj arkitekti osman është spostuar nga struktura e kullës mesjetare, duke u afruar më shumë drejt bregut. Arsyet e një vendimi të tillë mund të jenë sa të lidhura me stabilitetin e ndërtimit të ri, po aq edhe të lidhura ndoshta me krijimin e një brezi më të gjerë tokësor përballë bregut, mbrojtja e të cilit nuk ishte më e mundur nga pozicioni ku ngrihej kulla mesjetare.

Ndërsa është rrënuar kulla A1 gjurmë të së cilës vëreheshin ende me vështirësi në muret e viteve 1900 (Fig. 3), shiko këndin e poshtëm majtas), kulla e re praktikisht dilte jashtë mureve, duke rrezikuar mbrojtjen e saj. Për këtë arsye, kurtina A-B është zgjatur me një tjetër mur. Në këtë formë jo vetëm është krijuar një lidhje e vazhdueshme me kullën e re, duke e bërë pjesë organike të fortifikimit, por edhe është përforcuar muri i brendshëm i kullës A1[81].

Lëvizja e kullës së re jashtë perimetrit të fortifikimit pararendës ka bërë të nevojshme që edhe kurtina mesjetare që lidhte kullën A1 me linjën juglindore (në përdorim përgjatë fazës Os.1), në këto vite të braktiset. Kurtina e re fillonte nga kulla A, duke realizuar bashkimin e saj me pjesën tjetër të linjës juglindore, që nuk është spostuar. Rindërtimi i bastionit S është mbështetur mbi këtë linjë të re të murit fortifikues në krahun jugor. Tek hartat osmane emërtohet "Bastioni i ulët"[82]. Ky emërtim përkon tërësisht me vlerësimin që kemi bërë më parë mbi të[83].

Përgjatë kësaj faze, bastioni S ka qenë në funksion si element mbrojtës i shtuar përkundrejt Portës së re të Detit R2, duke kanalizuar kalimin nëpërmjet një korridori të mbrojtur. Organizimi planimetrik dhe funksional i strukturave të bastionit S dhe R2 për këtë fazë del qartazi vetëm nga hartat osmane, veçanërisht ajo e vitit 1865[84]. Ato na dëshmojnë ndryshime të rëndësishme në formën e funksionimit të hyrjes për në qytet dhe të vetë bastionit S. Në këtë fazë është realizuar kalimi nga bregdeti brenda në qytet, nëpërmjet një sistemi kompleks hyrjesh, mbrojtur nga bastioni S. Planimetria e portës R2 kishte një kalim të parë, i mbrojtur me kullë, me korridor të mbuluar; më pas një korridor i gjatë; pasonte porta fundore, e inkastruar tek kurtina e fortifikimeve. *Porta Yalli* në formën që njohim nga dokumentacioni i shek. XX (emërtuar R nga L. Rey) nuk ekzistonte ende.

Kalimi i parë, i mbrojtur me kullë, ishte ndërtuar paralel me kurtinën e fortifikimeve. Hyrja këtij kalimi gjendej në pjesën fundore të faqes veriore të bastionit S, paksa e futur në thellësi. Ky detaj mund të ketë pasur si synim shmangien e goditjeve të drejtpërdrejta me artileri nga anijet armike. Sipas të dhënave nga hartat osmane, kjo strukturë ishe në formën e një kulle me dy kate. Në katin përdhes ishte korridori i mbuluar, me dy porta në ekstreme. Besojmë në ndërtimin përgjatë kësaj faze të kësaj hyrjeje-kullë R2 si një element që kompensonte nga ana tjetër rrënimin e hyrjes-kullë mesjetare R1 sipas hartës së vitit 1571.

Korridori që pasonte krijohej nga kurtina e fortifikimeve dhe nga një mur i brendshëm i bastionit S. Në këtë formë krijohej një ambient i sigurtë, ku edhe nëse arrihej të thyhej mbrojtja e portës me kullë R2, sulmuesit gjendeshin në goditje nga dy krahët.

Në pjesën fundore të këtij korridori gjendeshin dy porta. Ajo nga jugu lidhej me oborrin e brendshëm të bastionit S. Porta nga perëndimi lidhej me qytetin. Kjo portë besojmë se ishte elementi i fundit i ruajtur nga porta mesjetare R1. Pjesa tjetër e strukturës

[80] Kiel 1990, f. 97.
[81] Gjurmët e ruajtura sot dëshmojnë jo vetëm përforcim nga jashtë por edhe një ngritje në lartësi, duke na treguar, ndoshta, gjendjen që kishte kulla A1 në vitet e pushtimit osman të qytetit.
[82] Shehi, Caka, Ruka, *së shpejti*.
[83] Shehi 2018, f, 230, 232-233, fig. 77.
[84] Shehi, Caka, Ruka, *së shpejti*.

DO NOT COPY

besojmë se është rrafshuar (ngjashmërisht me kullën A1), me shumë mundësi si pasojë e dëmeve të pësuara. Jemi të bindur se edhe në këtë rast është përdorur e njëjta logjikë me binomin kullë A1 – kullë A, që nënkupton dublimin e strukturës së vjetër duke ngritur një element të ri fortifikues, paska më të spostuar si dhe transferimin e emrit të saj nga struktura e vjetër drejt së resë.

Nga bastioni S dhe porta R2 kurtina e murit vazhdonte në vijë të pandërprerë tek kulla Q1 dhe përtej deri tek bastioni Q. Fuqizimi i linjës juglindore ka prekur edhe këtë bastion. Në këtë fazë (Os.2) është realizuar një shtesë e re në ekstremin lindor të bastionit Q. Muri fundor i bastionit deri në këtë moment ka qenë brinja XII. Në këndin lidhës mes kësaj brinje dhe brinjës II gjendej një frëngji artilerie me hapje anësore. Një vendosje e tillë do të kishte kuptim vetëm nëse këtu do të ishte muri fundor i bastionit. Shtesa e re (brinjët III-IV-V), në formën e një minikulle, ka pasur disa synime. Falë saj është zgjatur më shumë perimetri i bastionit, është realizuar një strukturë murore më e fortë në pikën më të ekspozuar si dhe janë vendosur elementë artilerie shtesë në një nivel më të ngritur sesa ato të faqes II. Profili i ndërtimit të ri (bazament trungkonik dhe faqe vertikale, të ndara nga një kornizë harkore) dhe forma e frëngjive kanë qenë shumë të ngjashme me kullën A. Teknika e përthyer e bazamentit trungkonik siguronte një rezistencë më të madhe përkundrejt zjarrit armik. Fotografitë e pasbombardimit të vitit 1918 dëshmojnë për një strukturë të mbushur në pjesën e poshtme, pa hapësira apo ambiente si ajo e kullës A. Në këtë formë rritej rezistenca e saj përkundrejt artilerisë. Një profil të ngjashëm të kullës së kësaj faze e kemi parë tek fortifikimi i vitit 1573 të Anavarin-i cedid[85].

Vendosja e frëngjive të artilerisë ka pasur ngjashmëri me bastionin S. Ndërtimi i saj jo vetëm ka shtuar fuqinë e zjarrit të bastionit me pesë elementë të rinj artilerie duke krijuar një mbulim më të gjerë drejtuar edhe nga pjesa e brendshme të Gjirit të Durrësit. Pozicioni i këtyre frëngjive ishte më i ngritur në raport me ato që gjendeshin në brinjën II të bastionit Q. Për rrjedhojë, ky pozicion më i ngritur mundësonte një flurudhë më të gjatë për artilerinë, duke bllokuar kështu afrimin e anijeve armike në distancë të rrezikshme.

Pjesa tjetër e bastionit mendojmë se nuk ka ndryshuar, ndoshta duke u mjaftuar me përforcime. Besojmë se pesë frëngjitë e brinjës II duhet të jenë zgjeruar në këtë periudhë, për t'u përshtatur me teknikën e re të mbrojtjes, e cila prodhonte artileri me kalibër më të madh (ngjashmërisht me ndërhyrjen tek frëngjitë e fazës së parë të bastionit S, që janë zgjeruar).

Masat ndërtimore tek linja juglindore kanë krijuar një sistem mbrojtës shumë të fuqishëm. Ky sistem kishte dy tipare bazë: mbrojtje të përqëndruar në tre pika dhe mbulim me zjarr në tre breza. Brezi më i ulët vinte nga pesë topat e bastionit S, tre ballorë dhe dy këndorë, përqënduar në qendër të mbrojtjes. Ky brez i poshtëm zjarri ishte orientuar kundër varkave dhe këmbësorëve (të zbarkuar ose në proces zbarkimi) që synonin portën e qytetit. Brezi i mesëm i zjarrit vinte nga pesë topat e vendosur në brinjën II të bastionit Q si dhe nga pesë topat e vendosur tek kati i vetëm i kullës A. Ky brez zjarri ishte orientuar kundër anijeve në thellësi të gjirit që mund të godisnin me artileri muret, mund të synonin afrimin drejt skelës ose mund të lëshonin varka me ushtarë për zbarkim. Brezi i sipërm i zjarrit krijohej nga pesë topat mbi kullën A dhe nga pesë të tjerë mbi shtesën e re në bastionin Q. Me këtë brez mbulohej thellësia e Gjirit të Durrësit, në hyrjen e tij (nga kulla A) dhe në brendësi të tij (nga bastioni Q).

Momenti i fillimit të realizimit të këtyre ndërtimeve besojmë se është viti 1606. Pushtimi dhe plaçkitja spanjolle e qytetit[86] duhet të ketë shërbyer si mësim

[85] Mbi detajet për këtë kështjellë shiko citimin nr. 22.

[86] Biron 1889, f. 76, cit. 3; *Dokumente* 3, nr. 9, f. 43-49, nr. 19, f. 63-64, nr. 165, f. 247-255; Xhufi 2016, f. 798.

për osmanët, jo vetëm për idenë e përgjithshme të nevojës së shtimit të mbrojtjes, por edhe për modelin konkret që duhej të përdorej në këtë rast. Ky element bazë i fuqizimit është shoqëruar paralelelisht me rrafshimin e elementëve të mëparshëm mbrojtës që nuk mund të riparoheshin më. Arsyeja mund edhe të lidhet më shkatërrimet e fortifikimeve nga ana e spanjollëve, përmendur nga burimet historike[87]. Për aq pak sa kohë sa kanë pushtuar spanjollët qytetin nuk mund të shkatërronin gjithçka, por vetëm pikat më kyçe të mbrojtjes, dhe këtë fat ndoshta mund ta kenë pasur elementët më të rëndësishëm të linjës juglindore.

Vitet e fundit të kësaj faze lidhen me daljen jashtë funksionit të bastionit S.

Os.3. Faza më e vonë e funksionimit të linjës juglindore, ajo *post quem* ndërtimi i Konakut, është linja që përshkruam në pjesën e partë të këtij artikulli (1. Përshkrimi i fortifikimeve të linjës juglindore), dokumentuar nga L. Rey dhe së cilës i janë kushtuar pjesa më e madhe e studimeve moderne (Fig. 2). Shkurtimisht, kjo linjë vazhdonte në lidhjen e kullës A – Konaku – *Porta e Detit* apo R – kulla Q1 – bastioni Q. Duke qenë se tashmë kemi dhënë pështkrime të detajuara të këtyre elementëve dhe planimetrinë e saktë, nuk do të zgjatemi më tej. Ajo që është me rëndësi për t'u nënvizuar është se pas identifikimit të bastionit S si vendi i përshtatshëm për ngritjen e Konakut të mutesarifit, dilte problemi i eleminimit të kompleksit të hyrjes kryesore R2 nga skela për në qytet. Natyrshëm është shfaqur nevoja e hapjes së një tjetër hyrjeje. Si zgjidhja më e përshtatshme është vlerësuar një ndërtim i ri i një hyrjeje të mbrojtur. Për ndërtimin e saj duket të jetë përdorur një planimetri e ngjashme me portën-kullë të fazës Os.2. Rezultati ka qenë hyrja që njohim nga fotografitë e fillimshekullit XX si dhe nga harta topografike e qytetit e vitit 1928, e identifikuar me germën R nga L. Rey.

Në aspektin kohor nuk kemi hasur deri më sot asnjë të dhënë mbi ndërtimin e saj. Megjithatë, ajo lidhet ngushtë me ndërtimin e Konakut mbi bastionin S, për të cilën jemi shprehur më herët sa ka filluar pas vitit 1839, ndërsa të dhënat e tjera anësore na kishin shtyrë drejt një vlerësimi jo të saktë të vitit të përfundimit të punimeve[88]. Së fundmi, kemi konsultuar njoftimet e konsullit austro-hungarez në Durrës, ku shënohet se punimet për ndërtimin e godinës qeveritare kishin filluar në 29 shtator 1881 dhe deri 1884 nuk kishte përfunduar ende[89]. Normalisht që qyteti të kishte një portë funksionale duhej që punimet për ndërtimin e strukturës së re (R) të kishin përfunduar para se të bllokohej porta e vjetër (R2). Kështu, data 29 shtator 1881 – fillimi punimeve për ndërtesën qeveritare dhe bllokimin e portës së vjetër, duhet marrë si moment kur Porta e Detit R që njohim nga fotografitë kishte përfunduar së ndërtuari.

3.Fuqia goditëse e artilerisë si element datues.

Një tjetër element ndihmës që na ndihmon për të qartësuar më mirë datimin strukturave ndërtimore të periudhës osmane (Os.1 dhe Os2), e veçanërisht të trinomit kulla A, bastioni A e bastioni Q (qoftë së bashku, qoftë individualisht) është një analizë krahasimore e artilerisë mesjetare. Për të realizuar një analizë të tillë është e nevojshme trajtimi i frëngjive të këtyre strukturave. Për këtë qëllim do të përqëndrohemi tek bastioni S pasi këtu kemi të dhënat parësore të lidhura me detajet ndërtimore. Të dhënat nga kulla A dhe bastioni Q janë elementë ndihmës në këtë analizë. Kjo analizë do të bazohet në tre tipare të frëngjive: kalibri i artilerisë që mund të përdorej tek bastioni S; këndi i flurudhës së artilerisë që mundësonin frëngjitë e këtij bastioni; sasia e elementëve të artilerisë që mund të vendosej tek bastioni në fjalë.

[87] Biron 1889, f. 87.

[88] Shehi 2018, f. 35-36.

[89] *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien*, në Arkivin e Institutit të Historisë, Vj. 3-2-300 dhe Vj. 32-1-103. Për një analizë më të detajuar të situatës shiko Shehi, Caka, Ruka, *së shpejti*.

DO NOT COPY

Kalibri i artilerisë.
Nga bastioni i fazës së parë ishin ruajtur gjurmët e plota të vetëm njërës frëngji nga pesë që ka pasur. Gjerësia e saj në faqen e jashtme të murit ishte 1.20 m. Gjerësitë e pesë frëngjive të bastionit të fazës së dytë në faqen e jashtme të tyre luhateshin nga 1.05 në 1.70 m. Cili kalibër artilerie ishte i përshtatshëm për këto përmasa?
Në fundin e shek. XIV përmasat e artilerisë ishin ende të kufizuara. Bombardat më të vogla të prodhuara në Raguzë ishin 16 deri 42 cm të gjata, ndërsa spingardat më të vogla peshonin vetëm 14 kg[90]. Përgjatë viteve teknologjia e prodhimit të artilerisë shkoi duke u përmirësuar, fuqia e tyre duke u shtuar dhe pesha duke u rritur. Në vitin 1480 një *bombardë* e kalibrit të madh kishte diametër prej 420 mm, dhe përdorte gjyle guri me peshë 300 libbre (102 kg). *Mortaro* kishte diametër 365-420 mm dhe përdorte gjyle guri me peshë 200-300 libbre (68-102 kg). *Mezzana* kishte diametër 230 mm, dhe përdorte gjyle guri me peshë 50 libbre (17 kg). Elementët e tjerë janë me përmasa më të kufizuara (*Cortana* 245-190 mm; *Passavolante* 105 mm; *Basilisco* 170 mm etj.)[91]. Bazuar tek këto krahasime për vitin 1480, frëngjitë e të dyja fazave janë shumë të gjera edhe për kalibrin më të madh të mundshëm të bombardave prej 420 mm.
Sipas klasifikimit të artilerisë të vitit 1540 kalibrat ndaheshin sipas gjatësisë së grykës. Ato me grykë të gjatë ishin: *colubrine*, me kalibër 135-140 mm; *mezze colubrine*, me diametër 110-120 mm; *sagri*, me diametër 85-95 mm. Për artilerinë me grykë me gjatësi mesatare ishin: *cannoni*, me kalibër 170-180 mm; *mezzi cannoni* me kalibër 135-140 mm; *quarti cannoni* me kalibër 110-120 mm. Për artilerinë me grykë të shkurtër ishin: *petrieri* me kalibër 120-175 mm; *mortai* me kalibër 320 mm[92].
Bazuar tek klasifikimi i artilerisë të vitit 1540 tek frëngjitë e bastionit S mund të përdoreshin kalibrat më të mëdhenj të mundshëm të topave me grykë të gjatë apo të mesme prej 140 mm. Mortajat me grykë të shkurtër (320 mm) nuk mund të përdoreshin pasi mbulesa e frëngjive me qemer nuk e lejonte këndin e tyre të goditjes.

Këndi i flurudhës së artilerisë.
Pozicioni i frëngjive tek të dyja fazat ndërtimore të bastionit ishte në nivelin e ecjes. Nuk kishte asnjë ngritje strukturore ku të vendoseshin topat. Praktikisht nga këto frëngji mund të goditej në nivelin e sipërfaqes së ujit dhe për rrjedhojë distanca efektive e gjyleve ishte e kufizuar. Duke pasur frëngji relativisht të larta ishte e mundur të ngrihej goditja me disa gradë. Megjithatë, është e qartë se pozicionit të zjarrit tek këto frëngji u mungonte avantazhi i lartësisë. Një element i tillë ishte i parallogaritur pasi synimi i artilerisë këtu ishte mbrojtja e bregdetit dhe jo goditja në thellësi të Gjirit të Durrësit. Për këto arsye nëse ky bastion do të ishte një element i shkëputur i mbrojtjes do të ishte praktikisht i paefektshëm. Artileria e anijeve sulmuese mund të godiste nga larg (me kënd më të lartë zjarri, nga kuotë më e ngritur dhe nga pozicione të cilat nuk mbuloheshin dot nga frëngjitë e bastionit) pa u rrezikuar aspak nga zjarri i mbrojtësve të pozicionuar tek bastioni « S ». Funksioni i këtij bastioni ka kuptim vetëm si pjesë përbërëse e një sistemi më kompleks mbrojtjeje, i formuar nga disa struktura. Secila strukturë duhej të kishte qëllime të veçanta, duke mbuluar me zjarr distanca të ndryshme dhe të gjitha së bashku të mbulonin bregdetin e qytetit në tre breza largësie: të gjatë, të mesëm dhe të shkurtër.

Sasia e elementëve të artilerisë.
Bastioni S i fazës Os. 1 ishte i pajisur me pesë frëngji, por edhe në këtë rast ai ishte element i shtuar në mbrojtje dhe ka funksionuar bashkë me bastionin Q dhe ndoshta kullën A1. Faktet historikë të përmendur më lart kanë dëshmuar se nuk ka rezultuar i mjaftueshëm për të realizuar një mbrojte efektike por ka pasur nevojë për përforcime shtesë, të realizuara në fazën Os. 2 (kulla A dhe përforcimi i bastionit Q). Kështu, bastioni S, megjithëse me një

[90] Ágoston 2005, f. 105
[91] Gianni Ridella 2013, f. 14.
[92] Gianni Ridella 2013, f. 24-25.

përqëndrim zjarri të konsiderueshëm, ishte i mangët (për arsyet që përmendëm më lart) pa strukturat e tjera të linjës juglindore. Për rrjedhojë, të gjithë këta elementë së bashku do të kishin një përqëndrim zjarri artilerie prej 20 grykash (bastioni S, pesë frëngji; kulla A, pesë në katin e parë, pesë në katin e sipërm; bastioni Q, pesë në fazën e parë - nuk po llogarisim katër frëngji të tjera të shtuara në fazën e dytë) për një linjë mbrojtjeje me gjatësi prej vetëm 162 m.
Kalojmë tani tek të dhënat historike mbi sasitë e elementëve të artilerisë ndër vite në qytete të ndryshme, pasi të dhënat për Durrësin janë të kufizuara. Tek krahasimet do të marim raste të ngjashme me Durrësin dhe jo raste përjashtimore, si p.sh. Beogradi, i cili ishte në qendër të përpjekjeve të Perandorisë Osmane për të zgjeruar territoret nën kontroll drejt thellësisë së Ballkanit dhe njëkohësisht konsiderohej si magazina kryesore e armatimit për ushtrinë osmane në fushatat kundër Hungarisë dhe Austrisë[93] apo sasinë prej 12 topash të përdorura në vitin 1453 përgjatë rrethimit të Stambollit nga ushtria osmane[94], sigurisht me kalibra të përmasave më të mëdha të mundshme, që mund të shkonin në 640 mm apo 680 mm[95].
Në vitin 1351 Senati i Raguzës jep një kontratë për të derdhur një *spingarda*[96]. Kjo është përmendja e parë e një elementi artilerie për këtë qytet. Në vitet 1362-1363 qyteti kishte disa të tilla[97]. Në gusht të vitit 1378 garnizoni i kështjellës së Kotorit përdori kundër flotës venedikase tre bombarda[98]. Në shtator 1378 qyteti i Raguzës përdorte bombarda për t'u mbrojtur në shtatë pika të ndryshme të qytetit, dhe secila skuadër kishte një kapiten dhe shtatë ushtarë[99]. Falë këtij dokumenti kemi edhe sasinë e ushtarëve që duheshin për të përdorur një bombardë. Kalibri dhe fuqia e këtyre bombardave, deri në fundin e shek. XIV ishte ende e kufizuar[100].
Në vitin 1452 arsenali i Danjës numëronte 7 bombarda dhe 6 bombardellas[101]. Nga këto, bombardellat paraqesin elementë me kalibër shumë të vogël dhe praktikisht të pallogaritshëm si artileri efektive. Për rrjedhojë mbetet të llogariten vetëm 7 bombarda. Përgjatë rrethimit të Shkodrës nga osmanët në 1478 qyteti u bombardua nga 11 bombarda të kalibrit të madh[102]. Këto data janë më afër në kohë me përllogaritjen e kalibrit të artilerisë në vitin 1480. Për rrjedhojë, bombardat mund edhe t'i përllogarisim si të kenë qenë ato me kalibër të madh prej 420 mm.
Në dhjetor të vitit 1565 inventari i kështjellës së Budvas numëronte: dy *basiliskos* që hidhnin gjyle prej 22 okësh; dy *basiliskos* që hidhnin gjyle prej 18 okësh; dy *basiliskos* që hidhnin gjyle 16 okësh; katërmbëdhjetë *basiliskos* që hidhnin gjyle prej 14 okësh[103]. Në total ishin 20 elementë artilerie të kalibrave të ndryshëm që godisnin me gjyle që peshonin nga 17,2 kg në 27 kg[104]. Në vitin 1690, kur pushtohet Vlora dhe Kanina nga ana e venedikasve në të dyja kështjellat bashkë u gjetën 150 topa të kalibrave të ndryshëm[105].
Informacionet mbi Durrësin janë të pjesshme. Njëri lidhet me vitin 1502 kur thuhet se pas pushtimit të

[93] Ágoston 1994, f. 44-45.
[94] Ágoston 1994, f. 30, sipas raportimeve të Nicolo Barbara.
[95] Ágoston 2013, f. 130.
[96] Në vitin 1480 *spingarda* përdorte gjyle guri prej 10-15 libbre (3,5-5 kg), me kalibër 135-155 mm, shiko Gianni Ridella 2013, f. 14..
[97] Ágoston 1994, f. 21-22. Për kalibrin shiko Gianni Ridella 2013, f. 14.
[98] Ágoston 1994, f. 21; Ágoston 2005, f. 104. Për bombardat shiko më lart klasifikimin e tyre sipas vlerësimeve të vitit 1480, sipas Gianni Ridella 2013, f. 14.

[99] *Monumenta Ragusina* IV, f. 166. Ágoston 1994, f. 22.
[100] Ágoston 2005, f. 105
[101] Радонић 1942, dok. nr. 31, date 4 gusht 1452. Për kalibrin e bombardave shiko Gianni Ridella 2013, f. 14. Termin bombardella nuk e kemi hasur tek studimet që kemi kontrolluar mbi artilerinë mesjetare. Bazuar tek emri duhet të kuptojmë një lloj artilerie me kalibër konsiderueshëm më të vogël sesa bombardat.
[102] Barletius 1504, lib. IV.
[103] Ágoston 1994, f. 38. Mbi kalibrin e basiliskos në vitin 1480 shiko Gianni Ridella 2013, f. 14.
[104] 1 okkë=1.2288 kg, sipas Ágoston 1994, f. 34, cit. nr. 105. Për rrjedhojë, pesha e tyre do të ishte përkatësisht 27 kg, 22,1 kg, 19,6 kg dhe 17,2 kg.
[105] Contarini 1710, f. 258.

DOI JOT

qytetit, osmanët kishin filluar punimet fortifikuese dhe në bregdet, aty ku më parë ishin dy bombarda ato kishin vendosur shtatë të tillë, shtatë pëllëmbë secila[106]. Duke qenë se ishin artileri e sjellë nga osmanët klasifikimet e përmendura më lart nuk ndihmojnë për të kuptuar me saktësi kalibrin e tyre. Nëse do të përdorim njësitë matëse veneciane, ku 1 pëllëmbë është e barabartë me 37,74 cm, do të kishim një bombardë me gjatësi 264,18 cm. Nëse do t'i krahasonim me artilerinë osmane, 7 pëllëmbë mund të ishte edhe gjerësia e tyre, e barabartë me 49-63 cm, të ngjashme me bombardat e mëdha të përdorura në vitin 1456 përgjatë rrethimit të Beogradit[107]. Treguesi tjetër është ai sasior. Praktikisht, linja juglindore, në dokument identifikuar "pranë bregdetit", deri në vitin 1501 kishte vetëm 2 bombarda. Duke përllogaritur me përafërsi këtë sasi për gjatësinë e linjës në fjalë, do të kishim 10 deri në 12 bombarda për të gjithë perimetrin e fortifikimeve të Durrësit përgjatë periudhës së administrimit venedikas. Të dhënat mbi numrin e artilerisë së gjetur në vitin 1606 nga trupat spanjolle në qytet janë të ndryshme: u gjetën 30 topa, prej të cilëve u morën ato me kalibër të vogël, të mëdhatë u lanë në vend të dëmtuara[108]; u gjetën 200 pjesë artilerie[109]. Pavarësisht mosrakordimit të të dhënave bëhet fjalë për sasi jo të pakët të artilerisë që gjendej në qytet në vitin 1606.

Nëse do të pranonim idenë se strukturat fortifikuese të linjës juglindore të pajisura me frëngji artilerie (bastioni i ulët S, kulla A, bastion këndor Q) i takojnë një periudhe më të hershme[110] sesa datimet e propozuar nga ne[111], do të kishim një përqëndrim prej 20 grykash zjarri të kalibrit më të madh të mundshëm vetëm në linjën juglindore. Teorikisht, aq sa kishte frëngji artilerie vetëm linja juglindore e fortifikimit të Durrësit më 1478, kishte topa Budva e vitit 1565 (pas 87 vitesh), duke përfshirë edhe artilerinë e kalibrit të lehtë[112]. Kjo sasi ishte e shpërndarë në të gjithë perimetrin e fortifikimit të Budvës. Danja e vitit 1452 kishte 7 bombarda dhe 6 bombardella për të gjithë perimetrin e fortifikimeve.

Perimetri i fortifikimeve të Durrësit në vitin 1478 ishte ai i rrethimit të vogël bizantin, me shtirje veriore deri në linjën që zbriste nga kodra e Stanit. Sulmet ndaj qytetit përgjatë të gjithë shek. XV kanë ardhur nga prapatoka dhe linjat më të rrezikuara ishin ato veriore dhe verilindore. Nëse do të pranonim se linja juglindore me 20 gryka artilerie do ti takonte vitit 1478, në raport proporcional fortifikimi i Durrësit në të njëjtën periudhë do të duhej të kishte së paku 100 topa të kalibrave të mëdhenj. Një koncept i tillë bie qartësisht në kundërshtim me informacionin mbi praninë e vetëm 2 bombardave në bregdet deri në vitin 1501.

Për rrjedhojë, përsa shpjeguam më lart, një kronologji e ulur për strukturat mbrojtëse në fjalë nuk përkon me realitetin e shek. XV. Një sasi e tillë e frëngjive që paraqet linja juglindore e fortifikimeve të Durrësit[113], dhe kalibri që mund të përdorej në to gjen shpjegim vetëm me periudha kohore, kur prodhimi i artilerisë kishte arritur një nivel profesional të tillë, që kishte ulur kostot e kishte rritur sasinë, si në shek. XVI e në vazhdim[114], dëshmuar nga sasia e lartë e artilerisë në 1690 në Vlorë e Kaninë.

4.Përfundime

Të dhënat e parashtruara më lart na dëshmojnë qartë se pjesa jugore e fortifikimeve të qytetit të Durrësit nuk është rezultat i një planifikimi të vetëm në një periudhë të caktuar. Strukturat e dokumentuara që nga fundi i shek. XIX kanë qenë rrjedhojë e një seri ndërhyrjesh, të realizuara ndër shekuj, reflektim i evolucionit që ka pësuar relievi në këtë zonë. Kjo lidhet veçanërisht me ndryshimin e topografisë së bregdetit, por nuk duhen harruar edhe situatat gjeo-politike që rajoni ka kaluar. Nëse në fundin e shek. IV-III p. Kr. ka qenë konsideruar i nevojshëm ndërtimi i një linje mbrojtëse, me shumë mundësi e kufizuar në përmasa, *Pax Romana* e ka bërë të panevojshëm atë.

Problemet e mëdha që kishin kufijtë e Perandorisë Bizantine, risollën nevojën urgjente të rifortifikimit të qytetit të Durrësit. Linja fortifikuese bizantine e gjysmës së dytë të shek. V është mbështetur pjesërisht mbi struktura më të hershme, duke i përdorur si bazament. Realizimi i këtyre ndërtimeve ka sjellë rikonceptimin tërësor të zonës, duke e ndryshuar rrënjësisht mikro-relievin. Këto punime masive bizantine janë ruajtur në njëfarë mënyrë deri në ditët e sotme.

Ndoshta në shek. XII duket se është konsideruar e nevojshme një tjetër ndërhyrje për të përforcuar dhe risistemuar linjën mbrojtëse të qytetit. Këto punime deri më sot mund të identifikohen tek kulla këndore A1 dhe ndoshta deri diku bastioni Q. Mbetet e paqartë situata me portën mesjetare R1 apo *Portën e Detit*.

Përgjatë periudhave të mëvonshme ndërhyrjet në fortifikime kanë konsistuar në mirëmbajtje dhe përforcime të strukturave ekzistuese, pa ndërtime të reja masive. Nuk ka asnjë të dhënë mbi ndërtime të reja nga feudalët vendas. Përkundrazi, të dhënat që kemi, tregojnë për një rrënim të fortifikimeve përgjatë viteve të administrimit të Topiajve. Periudha veneciane e administrimit të qytetit karakterizohet nga "arnime të fortifikimeve", siç shkruhet nga M. Šufflay[115] dhe raportohet nga dokumente të kohës, të cituara më lart. Nuk ka asnjë dëshmi të besueshme se venecianët kanë ndërmarrë punime masive fortifikuese. Nga ana tjetër, ndërhyrjet e tyre riparuese janë bërë edhe për të përshtatur strukturat mbrojtëse me teknikat moderne luftarake të kohës.

Në shekujt e administrimit të qytetit nga Perandoria Osmane është realizuar një rikonceptim tërësor i sistemit fortifikues të linjës juglindore të fortifikimeve të qytetit, duke u përshtatur me realitetet e reja të kohës. Ndër arsyet më urgjente për të tilla ndërhyrje kanë qenë fuqizimi i artilerisë me barut, mbushja e bregut të detit duke sjellë spostim drejt jugut, si dhe përplasjet mes fuqive të kohës për kontrollin e Adriatikut. Ndërtimi i tri strukturave masive mbrojtëse (faza ndërtimore e pas vitit 1606), janë rezultat i një koncepti të vetëm arkitektonik, i cili ka rezultuar efikas dhe e ka kthyer pjesën bregdetare të qytetit të papushtueshme.

Ky koncept fortifikues ka arritur të mbijetojë deri në vitet 1925-1928. Idetë e reja për "modernizimin" e qytetit sollën rrafshimin e kësaj pjese me të vërtetë shumë të bukur të qytetit, duke i dhënë tipare tërësisht të reja urbane, por aspak më të këndshme. Të tilla tendenca vazhdojnë edhe në ditët e sotme.

Identifikimi i kullës A1 dëshmon se paraqitja grafike e qytetit në hartën e vitit 1571 nuk është rezultat i fantazisë, por është bazuar në realitetin e terrenit. Mungesa e dy bastioneve (i krahut lindor, ndërtuar ndoshta në vitin 1565, dhe i krahut perëndimor para vitit 1570, sipas dëshmisë së raportit anonim të vitit 1570) na tregon se harta ose është rezultat i skicave të realizuara më herët sesa viti 1565, ose është riprodhim i një harte më të hershme, e cila nuk është ruajtur. Megjithatë, shkëputja e kullës së Teodor Komnenit nga qyteti i fortifikuar, e vendos hartën *post quem* 1502. Në këtë vit ka filluar ndërtimi i murit verior osman[116].

Rasti i historikut të datimit të kullës rrethore A të Durrësit është shembulli konkret se si një mendim i shprehur në origjinë me shumë dyshime, ndër vite merr përmasat e një "aksiome". Më tej është shumë e vështirë që një "aksiomë" e tillë të zhbëhet, jo vetëm në aspektin popullor, por edhe në atë arkeologjik, pavarësisht dëshmive që ofrohen.

[106] *Sanuto* IV, f. 368.
[107] Ágoston 2013, f. 133.
[108] *Fra Paolo Sarti*, f. 100; *Dokumente* 3, nr. 19, f. 63-64.
[109] Biron 1889, f. 87.
[110] Sipas Gj. Karaiskaj, kulla A i takon vitit 1478, shiko citimin nr. 12.
[111] Shiko më lart datimet përkatëse për bastionin S dhe kullën A.
[112] Shiko citimin 104.
[113] Për fazën Os. 1 duhet të mos llogarisim ekzistencën e kullës A (10 frëngji artilerie), e cila shtohet në fazën pasuese, Os. 2.
[114] Shiko Ágoston 2005, f. 115, tab. 4.1 për prodhimin e artilerisë në Perandorinë Osmane përgjatë shek. XVI.
[115] Šufflay 1922, f. 22.
[116] Kiel 1990, f. 97-99; Karaiskaj 1977, f. 38.

DO NOT COPY

BIBLIOGRAFIA

AAlb 2 — L. de Thallóczy, C. Jireček, E. de Sufflay, *Acta et Diplomata Res Albanaie Mediae Aetatis Illustrantia, vol. II (annos 1344-1406)*, Vindobonae MCMXVIII.

Abadie-Reynal *etj.* 2017 — C. Abadie-Reynal, A. Lefebvre, E. Shehi, B. Shkodra-Rrugia, Topografia e Epidamne-Dyrrachion. Fushata e vitit 2017, *Candavia* 2017, f. 173-207.

Ágoston 1994 — G. Ágoston, Ottoman artillery and European military technology in the fifteenth and seventeenth centuries, *Acta Orientalia Academiae Scientiarum Hungaricae*, 47, 1/2, 1994, f. 15-48.

Ágoston 2005 — G. Ágoston, Begind the Turkish War Machine: Gunpowder Technology and War Industry in the Ottoman Empire, 1450-1700, në B. D. Steele, T. Dorland (bot.), The Heirs of Archimedes: Science and the Art of War Through the Age of Enlightenment, MIT Press 2005, f. 101-133.

Ágoston 2013 — G. Ágoston, War-winning weapons? On the decisiveness of ottoman firearms from the siege of Constantinople (1453) to the battle of Mohács (1526), *Journal of Turkish Studies* 39, 2013, f. 129-143.

Ayverdi III — E. H. Ayverdi, *Osmanli Mi'mârîsinde Fâtih Devri*, Istanbul 1973.

Ayverdi IV — E. H. Ayverdi, *Osmanli Mi'mârîsinde Fâtih Devri 855-886 (1451-1481), IV,* Istanbul 1976.

Baçe, Karaiskaj 1975 — A. Baçe, Gj. Karaiskaj, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në kohën e vonë antike, *Monumentet*, 9, 1975, f. 5-26.

Barletius 1504 — M. Barletius, *De obsidione Scodrensi*, Venetia 1504.

Bennet *etj*. 2005 — J. Bennet, J.L. Davis, D. K. Harlan, The Fortress of Anavarin-i Cedid, në F. Zarinebaf, J. Bennet, J. L. Davis (bot.), *A Historical and Economic Geography of Ottoman Greece. The Southwestrn Morea in the 18th Century*, Hesperia Suppelement 34, The American School of Classical Studies at Athens 2005, f. 241-264.

Biron 1889 — J. de Gontaut-Biron, *Ambassade en Turquie de Jean de Gontaut-Biron, Baron de Salignac : 1605 à 1610. Correspondance diplomatique et documents inédits*. Publiés et annotés par le Comte Théodore de Gontaut Biron, Paris 1889.

Braudel 1972 — F. Braudel, *The Mediterranean and the Mediterranean world in the age of Philip II*, London 1972.

Burime III — I. Zamputi, S. Naçi, Z. Shkodra, *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. III. Shqipëria nën sundimin feudal-ushtarak otoman (1506-1839)*, Tiranë 1962.

Camocio 1574 — G. F. Camocio, *Isole famose, porti, fortezze, e terre maritime sottoposte alla Ser.ma Signoria di Venetia, ad altri Principi Christiani, et al Sig.or Turco*, Venice 1574.

Contarini 1710 — C. Contarini, *Istoria della Guerra di Leopoldo Primo Imperadore e de' Principi Collegati Control il Turco, dall anno 1683 fino alla pace*, Parte Seconda, In Venezia MDCCX.

Dokumente 3 — *I. Zamputi,* Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë, vëllimi III (1603-1621), Tiranë 1989.

Fra Paolo Sarpi — M. D. Busnelli, G.Gambarin (bot.), *Fra Paolo Sarpi: Istoria dell'Interdetto e altri scriti editi e inediti*, volume primo, Bari 1940.

Gaglione, Shehi 2016 — M. Gaglione, E. Shehi, "La «Porta del Mare» nella cinta muraria di Durazzo e la chiesa di S. Maria degli amalfitani: ipotesi di identificazione del sito". In *Rassegna del Centro di Cultura e Storia Amalfitana,* Gennaio-Dicembre 2016, Nuova Serie Anno XXVI, f. 31-66.

Gelcich 1896 — J. Gelcich (bot.), *Monumenta Ragusina. Libri Reformationum IV. A. 1364—1396*. (Monumenta spectantia historiam Slavorum Meridionalium XXVIII.) Zagreb 1896.

Gianni Ridella 2013 — R. Gianni Ridella, L'evoluzione strutturale nelle artiglierie di bronzo in Italia tra XV e XVII secolo, në C.Beltrame, M.Morin (bot.), *I Cannoni di Venezia. Artiglierie della Serenissima in Turchia, Grecia e Dalmazia*, Firenze 2013, f. 11-126.

Gutteridge 2003 — A. Gutteridge, Cultural geographies and "The ambition of Latin Europe". The city of Durres and its fortifications c. 400-c. 1501, *Archeologia medievale*, 30, 2003, f. 19-65.

Gutteridge *etj*. 2001 — A. Gutteridge, A. Hoti, H. R. Hurst, The walled town of Dyrrachium (Durres): settlement and dynamics, *JRA* 14, I, f. 391- 410.

Gutteridge *etj*. 2003 — A. Gutteridge, A. Hoti, P. Reynolds, The walled town of Dyrrachium, Durres. New light on the early defences, *JRA* 16, f. 367-379.

Hahn 1854 — G. von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena 1854.

Heuzey, Daumet 1876 — L. Heuzey, A. Daumet, *Mission archéologique de Macédoine*, vol. 2, texte et planches, Paris 1876.

Hoti 1986 — A. Hoti, Gërmimet arkeologjike të vitit 1986, Durrës-Kalaja,

DO NOT COPY

Iliria 2, 1986, f. 268-269.

Hoti *etj*. 2004 A.Hoti, E. Metalla, E. Shehi, Gërmime arkeologjike Durrës 2001-2003, *Candavia* 1, 2004, f. 139-172.

Jireček 1916 K. Jireček, Die Lage und Vergangenheit der Stadt Durazzo in Albanien, në L. v. Thallòczy (ed.), *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Munchen und Leipzig 1916, f. 152-167.

Karaiskaj 1977 Gj. Karaiskaj, Kalaja e Durrësit në mesjetë, *Monumentet* 13, 1977.

Karaiskaj 1983 Gj. Karaiskaj, *Butrinti dhe fortifikimet e tij*, Tiranë 1983.

Kiel 1973 M. Kiel, A Note on the Exact Date of Construction of the White Tower of Thessaloniki, *Balkan Studies*, 14, 1973, f. 325–357.

Kiel 1990 M. Kiel, *Ottoman Architecture of Albania* (1389-1912), Istanbul 1990.

Kiel 1994 M. Kiel, Draç (Durrës, Durazzo), në *Turkish Islam Ansiklopedisi*, vol 9, 1994, f. 522-524.

Kiel 2005 M. Kiel, Construction of the Ottoman Castle of Anavarin-i Cedid, në F. Zarinebaf, J. Bennet, J. L. Davis (bot.), *A Historical and Economic Geography of Ottoman Greece. The Southwestrn Morea in the 18th Century*, Hesperia Suppelement 34, The American School of Classical Studies at Athens 2005, f. 265-282.

Κοντογιάννης 2010 Ν. Κοντογιάννης, Το Νιόκαστρο Πύλου μέσα από τα σχέδια των στρατιωτικών μηχανικών του 17ου-19ου αιώνα, në Ανταπόδοση. Μελέτες προς τιμήν της Ελένης Δεληγιάννη-Δωρή, Αθήνα 2010, f. 199-224.

Longo 1571 A. Longo, *Historia delle guerra tra Turchi e la Republica di Venetia*, 1571.

Miraj 2013 L. Miraj, Some new data on the construction date of Dyrrachium's Byzantine walls, *Nish i Vizantija X*, 2013, f. 201-218.

Praschiker, Schober 1919 C. Praschniker, A. Schober, *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien 1919.

Радонић 1942 Ј. Радонић, Ђураћ Кастриот Скендербег и Арбанија у xv веку, Београд 1942.

Rey 1925 L. Rey, Les remparts de Durazzo, *Albania I*, 1925, f. 33-48.

Rusch, Lucio 1723 E. Rusch, G. Lucio, *Gründliche Beschreibung des Königreichs Dalmatien: in welcher alle und jede historische Merkwürdigkeiten von den ältesten bis auf die neuesten begriffen...,* Nürnberg 1723.

Sanuto IV N. Barozzi (ed.), *I diarii di Marino Sanuto*, tomo IV, Venezia MDCCCLXXX.

Sanuto VI G. Berchet (ed.), *I diarii di Marino Sanuto*, tomo VI, Venezia MDCCCLXXXI.

Sinclair 2012 T. Sinclair, The Muslim monuments of Larnaca, në E. Balta, T. Stavrides, I. Theocharides (bot.), *Histoires of Ottoman Larnaca*, Istanbul 2012, f. 419-432.

Shehi 2007 E. Shehi, Contributo sulla topografia di Dyrrachium, *Journal of Ancient Topography,* XVII, 2007, f. 159-208.

Shehi 2017 E. Shehi, Rishikim mbi topografinë e Durrësit antik në dritën e të dhënave të reja arkeologjiko-historike, *Iliria* XLI, 2017, f. 229-289.

Shehi 2018 E. Shehi, *Konaku i Durrësit*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2018.

Shehi, Caka, Ruka *së shpejti* E. Shehi, E. Caka, R. Ruka, Fortifikimet osmane të Durrësit, *Së shpejti*.

Shehi, Shkodra 2010 E. Shehi, B. Shkodra, Le front nord des fortifications de Dyrrhachium. Données nouvelles et hypothèses, në J-L. Lamboley - M.P. Castiglioni (ed.), *L'Illyrie Méridionale et l'Èpire dans l'antiquité, V. Actes du Ve colloque international de Grenoble (10-12 octobre 2008)*, Paris 2010, f. 325-336.

Shehi *etj*. 2017 E. Shehi, E. Çekrezi, E. Hasa, K. Velo, C. Abadie-Reynal, Rezultatet e sondazheve arkeologjike të realizuara para hyrjes së portit të Durrësit, *Candavia* 2017, f. 227-260.

Šufflay 1924 M. v. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich wahrend des Mittelalters*, në Denkschriften, Band 63, Wien und Leipzig 1924, f. 1-65.

Starine XII *Starine na sviet izdaje*. Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Knjiga XII, Zagrebu 1880.

Zamputi 1964 I. Zamputi, Kontribut për historinë e Shqipnisë bregdetare në fillim të shekullit të XVI-të, *Studime Historike* 1, 1964, f. 95-126.

Xhufi 2016 P. Xhufi, *Arbërit e Jonit*, Tiranë 2016.

DO NOT COPY

Eduard SHEHI

EVOLUTION OF THE SOUTHEASTERN LINE OF DURRËS FORTIFICATIONS AND DATING OF THE "VENETIAN TOWER"

This article deals with the chronological evolution of the southeastern line of fortifications in the city of Durres. A description of this line is first given, in the state and planimetric development before the mass destruction of the 1920s. Their description is based on the contour presented by Leon Rey, retrieved by other researchers afterwards. To the knowledge previously passed on by various scholars, some additional details have been made, based on photographic images stored in archives. A dating analysis of tower A ("Venetian tower") follows, revisited in the light of new archival data and documents, supporting the idea of its construction in the Ottoman period. In conclusion, a summary image on the chronological evolution of the structures is presented. It begins with the fortifications of the 5th-6th centuries and the traces preserved from this period. The Medieval and Ottoman fortifications are based on the structures of late antiquity. In support of the ideas presented on the chronology of various structures, the issue of artillery used in these fortifications has been analyzed. For this purpose, historical sources and structural traces related to the use of artillery have been treated.
The presented data clearly prove that the southern part of the fortifications of the city of Durrës is not the result of a single planning in a certain period. The structures as they were visible at the end of the 19th century have been the result of a long series of interventions, realized over the centuries. This is especially related to the changing topography of the coast, but we should not forget the geopolitical situations that the region has gone through.
If at the end of the 4th-3rd centuries has been considered necessary the construction of a defensive line, with many possibilities limited in size, Pax Romana has made it unnecessary.
The great problems that the borders of the Byzantine Empire had, brought back the urgent need of the fortification of the city of Durrës. Byzantine fortification line of the second half of the 5th century is based partially on earlier structures, using them as a foundation. The realization of these constructions has brought the complete reconception of the area, radically changing the micro-relief. These massive Byzantine works have been preserved in some way to the present day.
Probably in the 12th century could be dated another intervention, considered necessary to strengthen and resettle the defensive line of the city. These works to date can be identified at the corner tower A1 and perhaps to some extent the bastion Q. The situation with the medieval gate R1 or the Sea Gate remains unclear.
During later periods, interventions in fortifications consisted of maintenance and reinforcement of existing structures, without new massive constructions. There is no record of new construction by local feudal lords. On the contrary, the data we have show a ruinous state of fortifications during the years of Topiaj administration. The Venetian period of city administration is characterized by "fortification patches", as written by M. Šufflay and reported by documents of the time, cited above. There is no credible evidence that the Venetians undertook massive fortification works. On the other hand, their repair interventions were also made to adapt the defensive structures to the modern combat techniques of the time.
During the centuries of city administration by the Ottoman Empire, a complete reconception of the fortification system of the southeastern line of fortifications was realized, adapting to the new realities of the time. Among the most urgent reasons for such interventions have been the strengthening of gunpowder artillery, the filling of the sea shore moving southward, as well as clashes between the powers of the time for control of the Adriatic. The construction of three massive defensive structures (construction phase after 1606), are the result of a single architectural concept, which has proved efficient and has turned the coastal part of the city into impregnable.
This fortifying concept has managed to survive until the years 1925-1928. New ideas for the "modernization" of the city brought the flattening of this really beautiful part of the city, giving it completely new urban features, but by no means more pleasant. Such trends continue to this day.
The identification of the A1 tower proves that the graphic representation of the city on the map of 1571 is not the result of fantasy, but is based on the reality of the terrain. The absence of two bastions (east wing, probably built in 1565, and west wing before 1570, according to the anonymous report of 1570) tells us that the map is either the result of sketches made earlier than 1565, or is a reproduction of an earlier map, which has not been saved. However, the detachment of Theodore Komnenos tower from the fortified city, puts the map post quem 1502. In this year has begun the construction of the northern Ottoman wall.

DO NOT COPY

Dr. Dorian KOÇI

PUNIMET PREJ ARGJENDI TË LUNXHËRISË NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR MBULESA PREJ ARGJENDI E IKONËS SË SHËN PREMTES SË SELCKËS DHE MBULESA PREJ ARGJENDI E IKONËS SË SHËN GJERGJIT SË NOKOVËS

DO NOT COPY

Në pavijonin e ikonave pasbizantine të Muzeut Historik Kombëtar janë të ekspozuara disa objekte liturgjike, si kryqe, mbulesa ikonash, kapakë ungjilli etj. Këto objekte prej ari dhe argjendi janë punuar nga argjendarët vendas. Nga mbishkrimet që gjenden të skalitura mbi to, vërtetojmë se i përkasin shek. XVII-XVIII. Nga një punë e detajuar në fond në vitin 2016 u arrit të evidentohen dy mbulesa prej argjendi. E para i përket ikonës së Shën Gjergjit, e cila ka qenë e vendosur në proskinitarin e kishës së Shën Gjergjit (Fig. 1) në Nokovë të Lunxhërisë, Gjirokastër, ndërsa mbulesa e dytë i përket ikonës së Shën Premtes, (Fig. 2) që ka qenë e vendosur në proskinitarin e kishës së "Shën e Premtes" në Selckë të Lunxhërisë, Gjirokastër.

Në objektet e ekspozuara duket shija e hollë dhe mjeshtëria e lartë e argjendarëve, të cilët kanë realizuar kompozime të stolisura me elementë të shumtë dekorativë. Miniaturistët e punimit të objekteve prej argjendi në shumicën e rasteve kanë mbetur anonimë. Vetëm disa prej tyre kanë shkruar emrin dhe datën e punimit mbi objektet që kanë realizuar. Objektet e ekspozuara dallohen për shijen e hollë dhe mjeshtërinë e lartë të argjendarëve. Deri më tani është folur shumë për punimin e argjendit në Prizren, Shkodër, Voskopojë, Berat apo dhe në Elbasan si qendra të mëdha urbane gjatë shekujve XVII-XVIII dhe XIX por, pak dihet për punimet e



Fig. 1. Mbulesa e ikonës së Shën Gjergjit

argjendit në zona e krahina të veçanta të lidhura me besimin ortodoks si Zagoria dhe Lunxhëria. Fakti që në fondet e Muzeut Historik Kombëtar ka dy



Fig. 2. Mbulesa e ikonës së Shën e Premtes

mbulesa proskinarësh nga Lunxhëria na shtyn të mendojmë se ka pasur një traditë të konsoliduar të punimit në argjend në këtë krahinë ose në Gjirokastër e Janinë. Konsulli francez në Janinë shkruan në vitin 1881 se punimet e filigranit të Shqipërisë së jugut u përngjisnin atyre të Prizrenit dhe konsistonin në punimin e gojëzave të çibukëve, të zarfeve të filxhanëve dhe të pjatave me ëmbëlsira etj, të cilat në Gjenevë janë më delikate dhe të çmuara, megjithëse përmbajnë më pak argjend[1]. Karakteristikë e veçantë e punimeve me argjend të Voskopojës, Beratit e Lunxhërisë është fakti se ato përdoren dhe në dekorimet e artit kishtar postbizantin.

Në fakt, krahina e Lunxhërisë ka pasur një aktivitet të rëndësishëm ekonomik gjatë periudhës osmane. Gjeografikisht ajo ndahet në dy pjesë: Nga lumi i Suhës e deri në Erind shtrihet krahina e Lunxhërisë, ndërsa prej Erindit deri në Kodër është krahina e Rrëzës. Vendbanimet e krahinës së Lunxhërisë janë: Antigonea, Asim Zeneli, Dhoksati, Erindi, Gjati, Gjonoshati, Kakozi, Karjani, Këllëzi, Krina, Minguli, Nokova, Qestorati, Saraqinishta, Selcka, Stegopuli, Suha dhe Tranoshishta; ndërsa vendbanimet e krahinës së Rrëzës (Odries) janë: Andon Poçi, Hundëkuqi, Labova dhe Tërbuqi. Në Lunxhëri kalonte një degëzim i rrugës së Vjosës, që e lidhte këtë krahinë me qytetet e mëdha si Gjirokastra, Janina, Berati e Vlora. Rruga e luginës së Vjosës ishte një nga rrugët më të rëndësishme të Shqipërisë së Jugut. Ajo lidhte skelën e Vlorës me një varg krahinash në thellësi, si me Mallakastrën, me Tepelenën, me luginën e Drinosit (degëzim nga Tepelena), me Përmetin e me Greqinë tek Tri Urat. Nga Përmeti, rruga e luginës së Vjosës lidhej me rrugën e Kolonjës, që çonte në Korçë e prej këndej në Maqedoni e Greqi. Rruga e luginës së Vjosës kalon majtas lumit nëpër këto pika: Vlorë-Kishbardhë-Shushicë, tek Ura e Penkovës-Peshkëpi-Gorisht-Sefaj-Hani i Sevasterit-Hani i Shkozës-Gryka e Ylenecit-Dorëz-Sinanaj-Martalloz-Fusha e Salarisë-Dukaj-Turan-Veliqot-Tepelenë. Nga Tepelena një degë ndiqte luginën e Drinosit nëpër Hundëkuq-Kaziun-Valare-ura e Lunxhërisë-Gjirokastër[2].

Sipas albanologut Johan Georg von Hahn në librin e tij "Studime Shqiptare" , banorët e Lunxhërisë merreshin kryesisht me zejtari ose shkonin në kurbet, sepse tokat nuk janë edhe aq pjellore. Burrat shkojnë në kurbet dhe vijnë rrallë në fshatin e tyre. Lunxhotët janë kasapë, kopshtarë dhe zejtarë të

[1] Shkodra, Zija., *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Akademia e Shkencave të R.P.S.SH, Instituti i Historisë, Tiranë 1984, fq. 154.

[2] Shtylla, Valter., *Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri*, Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 1998, fq. 86.

SCAN NOT COPY

mirë. Disa lunxhotë janë mjeshtër rremash uji, sepse prej kohësh kanë pasur në mbikëqyrje ato. Këta gëzonin privilegje ndaj të tjerëve, të siguruara me anën e fermanëve sulltanorë. Banorët e Rrëzës janë tregtarë vogëlsirash. Ka të tjerë që merren me endjen e pëlhurave. Për shembull, labovitët dikur kanë qenë të gjithë pëlhurendës. Disa prej lunxhotëve ushtrojnë mjeshtërinë e xherahut[3]. Ekzistenca e shumë njerëzve që ushtronin profesionet e lira dhe tregtinë bëri të mundur që krahina e Lunxhërisë të ballafaqohej që në fillim të shekullit të XIX me urbanizimin dhe kulturën qytetare të qendrave të mëdha urbane të Perandorisë Osmane. Është pikërisht ngritja e një shtrese tregtarësh, mjeshtrish etj që bëjnë të mundur ndërtimin, mirëmbajtjen dhe dekorimin e kishave të krahinës. Mes fshatrave të Lunxhërisë bën pjesë dhe fshati Selckë. Ai shtrihet në dy krahët e përroit të Selckës. Fshati kufizohet nga ana lindore me kreshtën e malit të Rapovicës, ndërsa nga jugu me lumin e Suhës. Nga veriu kufizohet me majën e Spilesë, ndërsa nga perëndimi, me Stegopulin. Selcka zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 1400 hektarësh. Sipas regjistrit osman të sanxhakut të Shqipërisë, në vitet 1431-1432 fshati ka pasur 20 shtëpi, ndërsa sipas regjistrit të vitit 1908, popullohej prej 447 banorësh. Selcka ka pasur dy kisha: kishën e Shën e Premtes dhe kishën e Shën Kollit. Në vendin e quajtur Tabor ka pasur tri paraklise: Shën Vasili, Shën Maria dhe Shën Mitri, prej të cilave kanë mbetur vetëm gërmadhat[4].

Gjatë punës hulumtuese në fondin e Muzeut Historik Kombëtar kemi arritur të evidentojmë një mbulesë prej argjendi me numër inventari 5677, e cila i përket ikonës së Shën Premtes, që ka qenë e vendosur në proskinitarin e kishës së Shën e Premtes në Selckë të Lunxhërisë, Gjirokastër. Kisha e Shën e Premtes gjendet në anën veriore të Selckës. Kulti i Shën e Premtes është mjaft i përhapur në Shqipëri. Atë e gjejmë me emrat Shën e Premte në shqip, Shën Veneranda në latinisht, Shën Parashqevi në greqisht dhe Sfanta Paraschiva në rumanisht. Në dialektin toskërisht emri përdoret me këto sinonime: Parashqevi, Çeco, Çevi, Parnaqe, Via, ndërsa në dialektin gegërisht përdoret si: Prende, Prene, Petka etj.

Kisha e Shën e Premtes në Selckë ka përmasa 15x8.5 m. Është ndërtuar në vitin 1755. Kjo datë gjendet e gdhendur mbi portën jugore të kishës[5]. Në vendin ku është ndërtuar kisha, më parë ka qenë një konizmë me ikonën e Shën Premtes, të cilën e kishin sjellë nga manastiri i Pepelit. Kisha është e tipit bazilikë, me hajat në anën jugore. Mbi hyrjen jugore të kishës ngrihet kambaneria. Kisha përbëhet nga tri kube qendrore dhe dy kube të vogla nëpër qoshe. Altari ndahet nga pjesa tjetër e kishës me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Mbi të është skalitur një shqiponjë dykrenore dhe më lart, Krishti me lugën e kungimit. Gdhendjet e tjera në ikonostas janë shpendë, dragonj, lule etj. Ikona e Shën Kostandinit dhe Elenës daton në vitin 1800, ndërsa mbi ikonën e Burimit Jetëdhënës është mbishkrimi: "Lutje e shërbëtorit të Perëndisë, Vasil Papa Leontiu, 1832". Froni episkopal dhe amvoni i kishës janë skalitur më vonë[6].

Në mbulesën prej argjendi të ikonës, Shën Premtja paraqitet bust duke mbajtur një kryq në dorën e majtë. Ndërsa në dorën e djathtë mban një enë me vaj në mes të së cilës shquhen dy sy. Kjo ka të bëjë me një mrekulli të shenjtores gjatë martirizimit të saj. Në pjesën fundore të mbulesës prej

[3] Johan Georg von Hahn., *Studime Shqiptare,* Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2007, fq. 66.

[4] Beduli, Dhimitër., *Kishë dhe kulturë,* Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2006, fq. 105; Bërxholi, Arqile., *Lunxhëria. Mjedisi-banorët-ekonomia-vendbanimet,* Qendra e Studimeve Gjeografike, Shoqata Shqiptare e Gjeografëve „Pandi Geço", Tiranë, 2007, fq. 290-293.

[5] Popa, Theofan., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* Tiranë, 1998, nr. 585, fq. 241.

[6] Beduli, Dhimitër., *Kishë dhe kulturë, Instituti i dialogut dhe komunikimit,* Tiranë, 2006, fq. 104-105; Beduli, Dhimitër., *Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit*, Neraida, Tiranë, 1996, fq. 41-42.

argjendi të ikonës së Shën Premtes është shkruar në greqisht: “Kjo ikonë e dëshmores së madhe Shën Premte është e katundit Selckë, eparkia e Drinopojës, Gjirokastër dhe është bërë me kontributin e epitropit, Zotit Vasil Gjika, 1823, korrik[7]. Konservimi i mbulesës së ikonës të Shën Premtes u krye në laboratorin e konservimit të koleksioneve të Muzeut Historik Kombëtar nën drejtimin e Prof. Ass. Dr. Frederik Stamatit.

Një objekt tjetër muzeal që i përket kësaj krahine është dhe një mbulesë prej argjendi, me numër inventari 5675, e cila i përket ikonës së Shën Gjergjit, që ka qenë e vendosur në proskinitarin e kishës së Shën Gjergjit në Nokovë të Lunxhërisë, Gjirokastër. Fshati Nokovë është gjithashtu pjesë e krahinës së Lunxhërisë. Nokova shtrihet në rrëzë të shpatit perëndimor të malit të Lunxhërisë, në lartësinë 395 metra nga niveli i detit. Fshati kufizohet nga ana lindore me kreshtën e malit të Lunxhërisë, ndërsa nga ana perëndimore, me kodrën e Valaresë. Në juglindje kufizohet me luginën e përroit të Orovishtës dhe nga veriu, me përroin e Kserolakut. Nokova zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 460 hektarësh. Shpati i malit të Lunxhërisë përbëhet nga gëlqerorë shtresorë me të çara. Ai dallohet për ujëmbajtje të madhe. Ujërat janë të ëmbël dhe të përdorshëm për konsum. Shfrytëzmi i tyre bëhet me anën e burimeve karstike: burimi i Gurrës, prej të cilit furnizohet me ujë Kroi i Madh, burimi i Kroit të Vogël dhe burimi i Maros në Lofate. Nga pikëpamja arkitektonike, fshati është vendbanim i tipit të gropës. Në fshat kultivohen perimet, drithërat, pemët frutore dhe vreshtat. Sipas të dhënave që jep regjistri osman i viteve 1431-1432, Nokova kishte 74 shtëpi, ndërsa sipas regjistrit të vitit 1908 numëronte rreth 309 banorë. Nokova ka pasur katër kisha: kishën e Shën Gjergjit, e cila gjendej në qendër të fshatit, kishën e Shën Illiut mbi shpellën e Ngurëzës, kishën e Shën Kollit, e cila në vitin 1946 u kthye në shkollë dhe kishën e Shën Kollit në Reshan, që u shkatërrua në fillim të shek. XX. Kisha e Shën Gjergjit është ndërtuar në vitin 1772. Pranë kishës ishte shkolla, ndërtuar sipas një fermani sulltanor të vitit 1902. Kisha e Shën Gjergjit gjendet në mes të fshatit Nokovë të Lunxhërisë. Ajo është bazilikë trenefëshe. Kisha ka përmasat 17.17x9.30 metra. Është ndërtuar në vitin 1772. Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi mbi faqen e murit perëndimor të kishës: Ανηστορηθη τε κ(αί) εκαλ(λ)οπήσθη ό θήος κ(αί) πάνσεπτως ναος το(ύ) αγίου / μεγαλομάρτηρος Γεοργίου του τροπεοφόρου δηα σ(υ)νδρομης κοπου / τε δε κ(αί) εξόδου τον τημηότατον Κηρηού Κήρ Κούστα Ηερέος, Κήρ Στωγιου / Δημα κ(αί) Κήρ Δημα ήού Πετρου Προσκηνήτου κ(αί) Κήρ Δημητρηου του Κέν / τρου. Αρχηερατε΄τον ηπο του θεοφηλεστατου Δρη(ι)νουπολεος Κηριου Κηρ / *(Δοσιθέου) έκ χόρας Μεσόβου διά χηρός...1772.* “U pikturua dhe u stolis ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i dëshmorit të madh, Shën Gjergj bukurmundësit, me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e të shumënderuarve, zotit Kir, priftit Kosta, Kir Stogji Dhimës dhe Kir Dhimës, birit të Petro Haxhiut dhe zotit Dhimitër Qendros. Në kohën e peshkopatit të fortperëndidashësit të Drinopojës, zotit Dositheu nga katundi Meçovë, me dorën e...1772”[8].

Kisha është e mbuluar me sistem qemerësh me kupolë sferike. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi e çmërsi. Çatia e kishës është e mbuluar me pllaka guri. Kisha përbëhet nga narteksi, naosi dhe një hajat me çati druri mbi shtylla në anën veriore. Në kishë hyhet nga dera në anën e saj veriore. Kambaneria është ndërtuar vite më vonë. Narteksi ka një shtyllë në mes dhe mbulohet me anën e një tavani prej druri. Narteksi lidhet me naosin me një derë që gjendet në mur. Naosi, me anën e arkadave ndahet në tre nefe. Nefi qendror është i

[7] Popa, Theofan., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* Tiranë, 1998, nr. 707, fq. 271.

[8] Π. Πουλίτσα, Επιγραφαί και Ενθυμήσεις εκ της Βορείου Ηπείρου, Επετηρίς Εταιρείας Βυζαντινών Σπουδών, Αθήναι, 1928, σελ. 84; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* Tiranë, 1998, nr. 598, fq. 244-245.

mbuluar me qemer cilindrik, ndërsa nefet anësore janë të mbuluar me tavan të rrafshët prej dërrase. Naosi ndriçohet prej dy dritareve të mbuluara me arkitrarë druri. Apsida e kishës është zbukuruar me nëntë nike, të cilat përfundojnë me një kornizë në formë dhembë sharre. Altari ndahet nga naosi me një ikonostas prej druri[9]. Në afreskun e Shën Gjergjit mbi portën veriore jashtë kishës është shkruar: Δηά χειρός Δημητρίου Ιερέος τού Δήμα Βύτου 1810 “Me dorën e prift Dhimitrit të Dhimor Vitos, 1810”[10]. Pranë kishës qe shkolla, e cila ishte ndërtuar sipas një fermani sulltanor të vitit 1902[11]. Burrat e fshatit mblidheshin në hajatin e kishës së Shën Gjergjit dhe kuvendonin për problemet që i shqetësonin. Për vlerat që bart, kisha e Shën Gjergjit në Nokovë të Lunxhërisë është shpallur monument kulture në vitin 1963[12]. Pikërisht kësaj kishe i përket dhe mbulesa prej argjendi e Shën Gjergjit. Në mbulesën prej argjendi të ikonës, Shën Gjergji paraqitet hipur mbi një kalë të bardhë, duke goditur me shtizë dragoin. Me dorën e majtë shenjti shtrëngon frerin e kalit, ndërsa në dorën e djathtë mban një shtizë të gjatë, e cila ka përshkuar tejpërtej gojën e dragoit. Tematika e ikonës është marrë nga një mrekulli e shenjtit.

Në pjesën e sipërme të mbulesës prej argjendi është shkruar: Ο ΑΓΙΟΣ ΓΕΩΡΓΙΟΣ “Shën Gjergji”. Ikonografi thekson fitoren e shenjtit. Veshja ushtarake, pozicioni i trupit, duke goditur me shtizë e hedhur mbi supe dhe e lidhur në gjoks tregojnë ndërhyrjen mrekullibërëse të shenjtit. Në cepin e djathtë të ikonës është dora e Zotit, duke bekuar shenjtin. Shenjti vjen në momentin që po sakrifikohej princesha, duke rrezatuar një dritë të bardhë. Ajo ikonizohet në ngjyrën e bardhë të kalit, që është simbolika e fitores[13]. Në pjesën e poshtme të mbulesës prej argjendi, mu nën kokën e dragoit është një mbishkrim i punuar me savat: Η παρουσα ηκονα του αγιου Γεωργιου απ(ο) χοριων Νοκοβο ιπ(α)ρχια Δρ(υ)ι(ω)ουπολλεος δια εξοδου τις τιμιας ζαχαροσπειητις Γγικας Πιρο Θαλασι θηγατερ παπα Σινο Δοκιναης μνημοσηνον αυτων σην γινεξη κε τεκνης: 1819-20 Φλεβαρηου. Δια χιρος εμου ΔΜ. PM. “Kjo ikonë e Shën Gjergjit të katundit Nokovë, eparkia e Drinopojës u punua me shpenzimet e sheqerpunuesit të nderuar, Gjikë Pirro Thallases, e bijës së Papa Sino Dokinaisit për kujtim të tyre me gratë dhe fëmijët, 1819-20 shkurt, me dorën time të Dh.M. -RM”[14]. Mbulesa prej argjendi e ikonës së Shën Gjergjit ka këto përmasa: gjatësi 71 cm, gjerësi 42 cm. Ikonën e rrethon një kornizë rreth 3 cm e gjerë, e cila është zbukuruar me shirit prej kallëzash gruri. Në brendësi të shiritit janë skalitur me mjeshtëri degë tërfili me gjethe, sytha dhe gonxhe. Në katër qoshet e kornizës dhe në dy anët ballore ka figura engjëllore (serafimë). Këto të fundit janë të lara me ar. Edhe aureola mbi kryet e shenjtit, është e larë me ar. Ajo ka një diametër rreth 3 cm. Në brendësi të aureolës janë gdhendur me mjeshtëri dy degëza zambaku, në kulmin e të cilave është një lule dielli. Anash aureolës është gdhendur me mjeshtëri një shirit me kallëza gruri. Figura kryesore e mbulesës është Shën Gjergji me përmasa 49 cm. Ai ka veshur uniformë ushtarake. Më pas vjen kali me përmasa 42 cm. Në vithet e kalit paraqitet një fëmijë, i cili ishte zënë rob nga saraçinët. Kur po shërbente në tavolinën e të zotit, u shfaq shenjti mbi një kalë dhe pasi e rrëmbeu e çoi te prindërit e tij. Djali mban mbi krye një çallmë. Me dorën e djathtë mbahet pas shenjtit. Në dorën e majtë ka një ibrik. Konservimi i mbulesës së ikonës

[9] Meksi, Aleksandër., Thomo, Pirro., *Arkitektura pasbizantine në Shqipëri (bazilikat),* Monumentet, 1/1981 (21), fq. 110-111.

[10] Popa, Theofan., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* Tiranë, 1998, nr. 674, fq. 265.

[11] Arkivi Qendror i Shtetit, fondi 139, dosja 47, fleta 1; *Fermantar, Të shkruash historinë me tolerancë*, TIKA, 2005, fq. 75.

[12] *Trashëgimia kulturore, akte ligjore dhe nënligjore*, Ministria e Kulturës, Tiranë, 2003, fq. 89.

[13] Χριστου Γκοτση, Ο μυστικος κοσμος των βυζαντινων εικονων, Αποστολικη Διακονια, Αθήνα, 1995, σελ. 123-125.

[14] Π. Πουλίτσα, Επιγραφαί και Ενθυμήσεις εκ της Βορείου Ηπείρου, Επετηρίς Εταιρείας Βυζαντινών Σπουδών, Αθήναι, 1928, σελ. 85; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri,* Tiranë, 1998, nr. 694, fq. 269.

SPECIMEN COPY

të Shën Gjergjit u krye në laboratorin e konservimit të koleksioneve të Muzeut Historik Kombëtar nën drejtimin e Prof. Ass. Dr. Frederik Stamatit[15].
Periudha 1755-1823, koha në të cilën ndërtohet kisha e Shën e Premtes në Selckë dhe Kisha e Shën Gjergjit në Nokovë, dekorimet e mbulesës së proskinareve janë vite kur lulëzon arti postbizantin në Shqipëri. Ato korrespondojnë me shthurjen e sistemit feudal osman të timarit, disfatat otomane me Perandorinë e Shenjtë Austriake dhe Perandorinë Ruse dhe fuqizimin e pushtetit lokal shqiptar në formën e Pashallëqeve si ata të Beratit e Janinës. Dobësimi i pushtetit qendror dhe fuqizimi i pushteti lokal autonomist në këto pashallëqe bëri të mundur dhe fuqizimin e klasës së tregtarëve dhe profesioneve të lira që financuan këto vepra të kultit dhe dekorimet e tyre. Kanonet e artit bizantin vazhduan të pulsojnë dhe në periudhën pasbizantine duke krijuar një vazhdimësi të mëtejshme kulturore dhe shpirtërore. Gjurmimi i mëtejshëm i këtyre vlerave muzeale do të na japë mundësinë të ndërtojmë të plotë panoramën e zhvillimit të këtij arti në territoret shqiptare por edhe të nxjerrim në pah veçoritë dhe karakteristikat e çdo krahine të jugut të Shqipërisë.

[15] Stamati, Frederik., Llukani, Andrea., *Restaurimi i mbulesës prej argjendi të ikonës së Shën Gjergjit*, Studime Muzeologjike Nr. 7, Tiranë 2017, fq. 66-67; Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, *Thesare të Muzeut Historik Kombëtar*, Tiranë, 2018, fq. 118-121; Koçi, Dorian., Bushi, Skënder., Llukani, Andrea., *Treasuries of National Historical Museum*, Tirana, 2018, page 118-121.

DO NOT COPY

PhD. Dorian KOÇI

THE SILVER WORKS OF LUNXHËRIA IN THE NATIONAL HISTORICAL MUSEUM THE SILVER COVER OF THE ICON OF SAINT PARASKEVI IN SELCA AND OF THE ICON OF SAINT GEORGE IN NOKOVA

In the pavilion of post-Byzantine icons at the National Historical Museum we distinguish various liturgical objects, such as crosses, icon covers, gospel covers, etc. These gold and silver objects were created by local jewelers. The inscriptions engraved on them, confirm that they belong to the 17th-18th century. A detailed work performed at the museum's fund in 2016 enabled the identification of two silver covers. The first one belongs to the icon of Saint George, (Fig.1), while the second one to the icon of Saint Paraskevi (Fig.2). So little is known about the silver works in specific areas and provinces belonging to the Christian Orthodox faith such as Zagoria and Lunxhëria. The fact that in the funds of the National Historical Museum exist two covers from Lunxhëria leads us to the conclusion that there has been a consolidated tradition of silver working in this province or in Gjirokastra and Ioannina. The French consul in Ioannina wrote in 1881 that the filigree works of southern Albania corresponded to those of Prizren and consisted of the making of chibuks, dessert plates, etc., which in Geneva are more delicate and precious, though containing less silver[1]. In fact the province of Lunxhëria had an important economic activity during the Ottoman period. The settlements of this province are: Antigonea, Asim Zeneli, Dhoksati, Erindi, Gjati, Gjonoshati, Kakozi, Karjani, Këllëzi, Krina, Minguli, Nokova, Qestorati, Saraqinishta, Selcka, Stegopuli, Suha and Tranoshishta. In Lunxhëri passed a spur of the road that leads to Vjosa that connected this province with bigger cities like Gjirokastra, Ioannina, Berat and Vlora. The valley road of Vjosa was one of the most important roads in southern Albania[2]. According to the albanologist Johan Georg von Hahn in his book "Albanian Studies", the inhabitants of Lunxhëria were mainly engaged in handicrafts. The locals were good butchers, gardeners and craftsmen. Some of the inhabitants practice doctor's mastery[3]. It is precisely the establishment of a layer of merchants, craftsmen, etc. that made possible the construction, maintenance and decoration of the churches of the province. Among Lunxhëria is the village of Selcka. It lies on both sides of the stream of Selcka and occupies a total area of 1400 hectares. According to the Ottoman register of the sanjak of Albania, in the years 1431-1432 the village had 20 houses, while according to the register of the year 1908, it had a population of 447 inhabitants. Selcka

[1] Zija Shkodra, *The Albanian city during the National Renaissance*, Academy of Sciences of R.P.S.SH, Institute of History, Tirana 1984, page 154.

[2] Valter Shtylla, *Old roads and bridges in Albania*, Toena Publishing House, Tirana 1998, page 86.

[3] Johan Georg von Hahn, Albanian Studies, Institute of Dialogue & Communication, Tirana, 2007, page 66.

had two churches: the church of Saint Paraskevi and the church of Saint Nicolas. In the place called Tabor there were three chapels: St. Basil, St. Mary and St. Dimitri, of which only ruins were left[4]. During the research work in the fund of the National Historical Museum we have managed to identify a silver cover with inventory number 5677. That belongs to the icon of Saint Paraskevi and has been placed in the proskininar of the church of Saint Paraskevi in Selce of Lunxhëria, Gjirokastra. The Church is located on the northern side of Selca. The cult of St. Paraskevi was quite widespread in Albania. We see it by the names Saint Paraskevi in Albanian, Saint Veneranda in Latin, Saint Parashqevi in Greek and Sfanta Paraschiva in Romanian. The church of Saint Paraskevi in Selcka has dimensions 15x8.5 m and it was built in 1755. This date is found engraved on the southern gate of the church[5]. The church is of the basilica type and the bell tower rises above the southern entrance. It consists of three central and two small domes around the corners. A double-headed eagle and Christ with the communion spoon are carved above. Other carvings on the iconostasis include birds, dragons, flowers, etc. The icon of St. Constantine & Helen dates back to the year 1800, while above the icon of the Life-giving Source lies the inscription: "A prayer of the servant of God, Vasil Papa Leontiu, 1832". The episcopal throne and the pulpit of the church were carved later[6]. On the cover of the silver icon, Good Paraskevi appears as bust holding a cross on the left hand. While in her right holds a vessel of oil in the middle of which two eyes discern. This is about the saint's miracle during his martyrdom. At the foot of the silver cover of the icon of Saint Paraskevi is written in Greek: "This icon of the great martyr Saint Paraskevi is from the village of Selcka, the diocese of Drinopoja and was made with the contribution of the epitrope, Mr. Vasil Gjika, July, 1823[7]. The conservation of the icon's cover of St. Paraskevi was carried out in the conservation laboratory at the National Historical Museum under the direction of Prof. Dr. Frederik Stamati. Another object, belonging to this province, is a silver cover. Its inventory number is 5675 and belongs to the icon of St. George. It was located in the proskinitarist of the church of St. George in Nokova in Lunxhëria. The latter lies at the foot of the western slope of the mountain of Lunxhëria. Nokova had four churches: the church of St. George, located in the center of the village, the church of St. Ilia on the cave of Ngurëzë, the church of St. Nicolas, which in 1946 was turned into a school, and the church of St. Nicolas in Reshan. The latter was destroyed at the beginning of the 20th century. The Church of St. George was built in the year 1772. Alongside the church was the school, built according to a sultan's decree of 1902. The church of St. George is located in the middle of the village Nokova in Lunxhëria. The church measures 17.17x9.30 meters and was built in 1772. This fact is confirmed by the inscription on the western wall of the church: "This divine and glorious temple of the great martyr, St. George the Beautiful, was painted and decorated, with the contribution, efforts and expenses of the esteemed, Mr. Kir, priest Kosta, Kir Stogji Dhima and Kir Dhima, the son of Petro Haxhiu and Mr. Dhimitër Qendros. At the time of the bishop of Drinopoja, Mr. Dositheu from the village of

[4] Dhimitër Beduli, "Church and culture", Institute of Dialogue and Communication, Tirana, 2006, page 105; Arqile Bërxholi, "Lunxhëria. Environment-inhabitants-economy-settlements", Center for Geographical Studies, Albanian Association of Geographers "Pandi Geço", Tirana, 2007, pages 290-293.

[5] Theofan Popa, Inscriptions of churches in Albania, Tirana, 1998, no. 585, page 241.

[6] Dhimitër Beduli, "Church and culture", Institute of Dialogue and Communication, Tirana, 2006, pages 104-105; Dhimitër Beduli, A look at the churches and monasteries of Pogon, Neraida, Tirana, 1996, pages 41-42.

[7] Theofan Popa, Inscriptions of churches in Albania, Tirana, 1998, no. 707, page 271.

Meçova, by the hand of ... 1772 "[8]. The roof of the church is covered with stone tablets. The entrance of the church is through the door on its northern side. The altar is separated from the nave by a wooden iconostasis[9]. In the fresco of St. George on the northern gate outside the church is written: Δηά χειρός Δημητρίου Ιερέος του Δημα Βύτου 1810 "By the hand of the priest Demetrius of Dhimor Vito, 1810"[10]. Next to the church was the school, which was built according to a sultan's decree of 1902[11]. The church of St. George in Nokova in Lunxhëria was declared a cultural monument in 1963[12]. The silver covering of St. George belongs to this church. On the silver cover of the icon, St. George appears riding a white horse and striking the dragon with a spear. The theme is taken from a miracle of the saint. On the upper part is written: Ο ΑΓΙΟΣ ΓΕΩΡΓΙΟΣ «Saint George» and emphasizes the saint's victory. The military garment, the position of the body, the striking with the spear thrown over the shoulder and tied to the chest show the miraculous intervention of the saint. In the right corner of the icon is presentet the hand of the Lord, blessing the saint. The latter comes at the moment when the princess was being sacrificed, radiating a white light. It is iconized in the white color of the horse, which is a symbol of victory[13]. At the foot of the cover, just below the dragon's head lies an inscription made of plaster: of Pope Sino Dokinais in remembrance of them with women and children, 1819-20 February, with my hand of Dh.M. -RM "[14]. The main figure of the cover is Saint George with dimensions of 49 cm. He is wearing a military uniform. On the horse's buttocks appears a child, who was taken captive by the Saracens. While he was serving at his master's table, the saint appeared on a horse and after kidnapping him took him to his parents. The boy wears a turban over his head and with his right hand he is holding the saint and has a kettle on his left hand. The conservation was completed in the laboratory at the National Historical Museum under the direction of Prof. ass. Dr. Frederik Stamati[15].

[8] Π. Πουλίτσα, "Επιγραφαί και Ενθυμήσεις εκ της Βορείου Ηπείρου", Επετηρίς Εταιρείας Βυζαντινών Σπουδών, Αθήναι, 1928, σελ. 84 Theofan Popa, Inscriptions of churches in Albania, Tirana, 1998, no. 598, p. 244-245.

[9] Aleksandër Meksi, Pirro Thomo, "Post-Byzantine architecture in Albania (basilicas)", *Monuments*, 1/1981 (21), pages 110-111.

[10] Theofan Popa, Inscriptions of churches in Albania, Tirana, 1998, no. 674, page 265.

[11] Central State Archive, fund 139, file 47, page 1; Fermantar, Writing History with Tolerance, TIKA, 2005, page 75.

[12] Cultural heritage, legal and sub-legal acts, Ministry of Culture, Tirana, 2003, page 89.

[13] Χριστου Γκοτση, "Ο μυστικος κοσμος των βυζαντινων εικονων", Αποστολικη Διακονια, Αθήνα, 1995, σελ. 123-125.

[14] Π. Πουλίτσα, "Επιγραφαί και Ενθυμήσεις εκ της Βορείου Ηπείρου", Επετηρίς Εταιρείας Βυζαντινών Σπουδών, Αθήναι, 1928, σελ. 85; Theofan Popa, Inscriptions of churches in Albania, Tirana, 1998, no. 694, page 269.

[15] Frederik Stamati, Andrea Llukani, "Restoration of the silver cover of the icon of St. George", Museum Studies Nr. 7, Tirana 2017, pages 66-67; Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, Treasures of the National Historical Museum, Tirana, 2018, pages 118-121; Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, Treasuries of National Historical Museum, Tirana, 2018, page 118-121.

DO NOT COPY

BIBLIOGRAPHY

1. Alexander Meksi, Pirro Thomo, "Post-Byzantine Architecture in Albania (basilicas)", *Monuments, 1/1981 (21), pages 110-111.*
2. *Central State Archive, fund 139, file 47, page 1; Fermantar, Writing History with Tolerance, TIKA, 2005.*
3. Arqile Bërxholi, "Lunxhëria. Environment-inhabitants-economy-settlements", *Center for Geographical Studies,* Albanian Association of Geographers "Pandi Geço", Tirana, 2007, pages 290-293.
4. Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, *Treasures of the National Historical Museum,* Tirana, 2018.
5. Dhimitër Beduli, "Church and culture", *Institute of Dialogue and Communication,* Tirana, 2006.
6. Dhimitër Beduli, *A look at the churches and monasteries of Pogon,* Neraida, Tirana, 1996.
7. Frederik Stamati, Andrea Llukani, "Restoration of the silver cover of the icon of St. George", *Museum Studies Nr. 7,* Tirana 2017, pages 66-67.
8. Johan Georg von Hahn, *Albanian Studies,* Institute of Dialogue & Communication, Tirana, 2007.
9. Π. Πουλίτσα, "Επιγραφαί και Ενθυμήσεις εκ της Βορείου Ηπείρου", Επετηρίς Εταιρείας Βυζαντινών Σπουδών, Αθήναι, 1928.
10. *Cultural heritage, laws and bylaws,* Ministry of Culture, Tirana, 2003
11. Theofan Popa, *Inscriptions of churches in Albania,* Tirana, 1998
12. Valter Shtylla, *Old roads and bridges in Albania,* Toena Publishing House, Tirana 1998.
13. Χριστου Γκοτση, "Ο μυστικος κοσμος των βυζαντινων εικονων", Αποστολικη Διακονια, Αθήνα, 1995.
14. Zija Shkodra, *The Albanian city during the National Renaissance,* Academy of Sciences of R.P.S.SH, Institute of History, Tirana 1984.

DO NOT COPY

Dritan ÇOKU

KULLA E SAHATIT NË KALANË E KRUJËS

1.Hyrja

Kruja përmendet për herë të parë në aktet kishtare të shek. IX si qendër peshkopate, ndërsa si vendbanim i fortifikuar del vetëm nga mesi i shek. XIII[1].

Kalaja e Krujës (Fig. 1) është ndërtuar mbi një kreshtë shkëmbore të shkëputur nga mali Sarisalltëk dhe nga formacionet kodrinore përreth[2]. Përveç mureve perimetrale, në pjesën më të lartë të kodrës është sajuar një ndarje e vogël katërkëndore, që shërbente si një reduit i fortifikuar, seli e feudalit. Nga ana e jashtme e kësaj ndarjeje, që i korrespondon rrethimit të kalasë, shkëmbinjtë bien thikë dhe janë të pangjitshëm, ndërsa në murin e brendshëm ndarës konstatohen dy kulla katërkëndore. Njëra prej tyre, ajo e këndit, ruan disa duar ndërtimi. Së fundi, kur kjo pjesë e fortifikimit e kishte humbur funksionin e saj, u përshtat në kullë sahati[3]. Artisti anglez Edward Lear më 29 dhe 30 shtator 1848, realizon disa vizatime me pamje të qytetit të Krujës, ku kulla e sahatit është e përfshirë te disa prej tyre (Fig. 2-4).

Kulla e sahatit është përmendur nga disa studiues evropianë në botimet e tyre, si nga: albanologu Georg Johann Hahn[4] (në vitet '40 të shek. XIX[5]);



Fig. 1 Skica e kalasë së Krujës. Pa autorësi dhe datë. Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore-Tiranë

[1] Karaiskaj, Gjerak., *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë: Pegi, 2016, f. 139.
[2] *Po aty*, f. 140.
[3] *Po aty*, f. 141.
[4] Hahn, Georg von Johann. *Studime shqiptare*, E përkthyer nga gjermanishtja: Veniamin Dashi dhe Afrim Koçi, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, pa datë, f. 127. Kalaja ka 80 shtëpi, të cilat janë të shkatërruara, gjë që tregon se banorët janë të varfër; pastaj edhe dy xhami, nga të cilat vetëm njëra ka një minare, sarajet e mudirit dhe kulla e sahatit të qytetit, që ngrihet nga ana e perëndimit në majën më të lartë të shkëmbit.
[5] Elsie, R., *Historical Dictionary of Albania*, Second Edition, Lanham • Toronto • Plymouth, UK: The Scarecrow Press, Inc., 2010, p. 180. Gjatë viteve të tij në Janinë (pas 1847-1850, transferohet si zëvendës-konsull), Hahn vizitoi Shqipërinë



Fig. 2 Vizatimi i Edward Lear – Kruja 29 shtator 1848



Fig. 3 Vizatimi i Edward Lear – Kruja 30 shtator 1848

DO NOT COPY



Fig. 4 Vizatimi i Edward Lear – Kruja 30 shtator 1848

Ami Boué[6] dhe H. Hecquard[7] (në vitet '50 të shek. XIX); Edith Durham[8] dhe konsulli austriak Th. Ipen[9] (në fillim të shek. XX). Kjo kullë e ndërtuar në shek. XI – XII (apo edhe më parë), është më e vjetra nga ato që ruhen sot si pikë vrojtimi. Autor të ndryshëm e cilësojnë si kullë kambanash, kurse funksionin për sahat ajo e mori në shek. XVII. Në gjendjen që paraqitej si dhe në vendin ku ngrihej, plotësonte më së miri kushtet e funksionit të ri si sahat qytetar, për t'i shërbyer tregut dhe qytetit[10] (Fig. 5-7).

tri herë dhe mblodhi të dhëna mbi historinë shqiptare, filologjinë dhe folklorin.

[6] Boué, Ami., *Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe*, Détails géographiques, topographiques et statistiques sur cet empire, Vienne, 1854, p. 10.

[7] Hecquard, Hyacinthe. *Histoire et description de la haute Albania ou Guegarie*, Paris, 1858, p. 255.

[8] Durham, Edith., *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë e Shqiptarët*, Ribotim, Tiranë: Naun Veqilharxhi, 1998, f. 94. "Në kështjellë të çon një rrugë që kalon përmes pazarit të varfër të mbuluar. Brenda mureve janë konaku, një ose dy xhami, tre a katër shtëpi dhe një kullë e lartë".

[9] Shkodra, Zija., *Qyteti shqiptar gjatë rilindjes kombëtare*, Tiranë: Mihal Duri, 1984, f. 404. Th. Ipen, më 1907 shkruante, se në akropolin e rrethuar me mura të larta qëndronin në harmoni të plotë kulla masive e sahatit dhe minarja elegante.

[10] Dashi, Sulejman., "Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë", *Monumentet,* 12, 1976, Tiranë: Mihal Duri, 1977, f. 106.



Fig. 5 Pamje verilindore e kalasë së Krujës dhe kullës së sahatit. Foto: Alexandre Degrand, vitet '90 të shek. XIX29 shtator 1848



Fig. 6 Kulla e sahatit në kalanë e Krujës. Foto: Instituti LUCE, 13.01.1940



Fig. 7 Kulla e sahatit në kalanë e Krujës. Foto-kartolinë, viti 1969

DO NOT COPY



Fig. 8 Kulla e sahatit - Pamja jugperëndimore. Foto: Gjergji Gjuraj, dt.25.09.2019



Fig. 9 Kulla e sahatit - Pamja verilindore. Foto: Gjergji Gjuraj, dt.25.09.2019

2. Arkitektura

Nga studimi ynë, sipas analizës tipologjike të kompozimit volumor të jashtëm (TAB. I), rezulton se kulla e sahatit në kalanë e Krujës[11] hyn në tipin e dytë me dy kate dhe në nënvariantin e dytë të variantit të parë të këtij tipi (TAB. II - VI).

Në varësi të terrenit ku është ngritur, lartësia e kullës së sahatit (Fig. 8-11) nuk është gjithkund e njëjtë. Nga pamja me orientim jugperëndimor, kulla e sahatit nga tabani deri në majë të çatisë është 15,75 m (lartësia më e madhe është ana me orientim veriperëndimor, me lartësi 17,2 m). Gjithashtu, duhet thënë se ndryshimi i formës së kullës (fillon piramidale dhe përfundon prizmatike me bazë katrore), ofron përmasa të ndryshme të planimetrisë. Në pjesën e poshtme planimetria është 7,8 x 8,05 m (matja është kryer në anën jugperëndimore të kullës, në një lartësi 1,5 m nga tabani), dhe më pas zvogëlohet deri tek ambienti i hapur i kambanës me përmasa 6,02 x 6,07 m. Përgjithësisht, muratura është e ndërtuar prej guri gëlqeror e lidhur me llaç (me përjashtim të disa pjesëve të muraturës, e cila përmban edhe tulla). Trashësia e mureve në pjesën e poshtme të kullës është 1,9-2,35 m (TAB. III, Plani A-A), ndërsa në nivelin e mesit është 1,16-1,84 m (TAB. III, Plani B-B). Kolonat me seksion katërkëndor në skajet e ambientit të hapur të kambanës janë me përmasa 1 x 1 m, ndërsa ato midis tyre janë me

[11] Rilevimi i kullës së sahatit është kryer nga autori, më dt. 22.02.2017. Skicat dhe përpunimi grafik i autorit.



Fig. 10 Kulla e sahatit - Pamja veriperëndimore. Foto: Gjergji Gjuraj, shkurt 2019



Fig. 11 Kulla e sahatit - Pamja juglindore. Foto: Gjergji Gjuraj, dt.25.09.2019

përmasa 0,7 x 0,8 m (TAB. III, Plani C-C). Kolonat e gurit që mbajnë sipër çatinë me material drusor, e mbyllin këtë kompozim. *"Sipas këtij modeli ajo dhe është restauruar"*[12]. Në kullë hyhet nëpërmjet dy dyerve, njëra në drejtimin jugperëndimor dhe tjetra në atë verilindor. Zakonisht për shkak të funksionit dhe hapësirës, kullat e sahatit janë me një portë të vetme, me përjashtim të asaj të Krujës dhe Gjirokastrës, të cilat në funksionin fillestar nuk ishin ndërtuar si të tilla.

Kalaja e Krujës pati dëmtime të mëdha nga një tërmet i fortë që ndodhi më 1617[13]. Kulla e quajtur e "Sahatit",

[12] Dashi, Sulejman., "Kullat…", f. 106.

[13] Adhami, Stilian., "Gjurmim rreth themelimit dhe ndërtimeve kryesore të kalasë ë Krujës", *Monumentet*, 1, 1971, Tiranë, 1972, f. 94.

ruan të gjitha fazat e ndërtimit të kalasë[14].

Fazën e parë të ndërtimit të kullës e shohim në faqen veriore nëpërmjet muraturës me gurë disi të punuar dhe rreshta tullash, që e datojnë të shek. XI. Kjo faqe si dhe themelet e kullës që dolën nga sondazhet, tregojnë se: bazamenti i kullës ka qenë me përmasa më të mëdha se trupi i sipërm; pjesa e poshtme e kullës është ndërtuar

[14] Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Frashëri, Gjergj. "Projekt restaurimi për kullën e sahatit në kalanë e Krujës", Tiranë, 13.10.1980. Fillimisht, ajo është ndërtuar si kullë vrojtimi dhe sinjalizimi, çka ishte e natyrshme për një kala mesjetare. Më pas, duket se ka ndodhur pas tërmetit të vitit 1617, ajo u adoptua në kullë sahati, siç u pajisën mjaft nga qytetet shqiptare në këtë periudhë.

DO NOT COPY

TAB. I

TIPI / VERSIONI	V 1	NV 1/V 1	NV 2/V1	NV 3/V1
T 1				
T 2				
T 3				
T 4				

TAB. I

TIPI / VERSIONI	NV 4/V1	V 2	NV 1/V2	V 3	NV 1/V3
T 1					
T 2					
T 3					
T 4					

TAB.I. Tipologjia e kullave të sahatit në Shqipëri sipas kompozimit volumor të jashtëm. Dritan Çoku, 2020

fillimisht piramidale. Për formën e sipërme të kullës të kësaj kohe nuk kemi të dhëna[15]. Pjesa e poshtme e anës veriore e perëndimore e kullës së sahatit, është ndërtuar me një muraturë prej gurësh të përzier me copa tullash, që sipas Stilian Adhamit, daton para kohës së pushtimit turk[16].

[15] Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Frashëri, Gjergj. "Relacion i konsultës për punimet e restaurimit në kullën e vrojtimit në kalanë e Krujës", Kjo konsultë u krye më datë 15.X.1980, sipas këtij relacioni.

[16] Adhami, Stilian., "Gjurmim …", f. 88. Vlera historike e këtij reliku të çmuar është pasuruar gjatë kohëve edhe nga vet funksionet e ndryshme, që kulla ka ndërruar sipas nevojave që u janë shfaqur përdoruesve të saj. Nga vet pozicioni i saj, ajo duhet të ketë qenë destinuar si pikë vrojtimi dhe si qendër sinjalizimi. Sipas traditës gojore kjo kullë, ka pas qenë këmbanorja e kishës së Skënderbeut. Shih për këtë: Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun, Tiranë, 1967, f. 43.

Prej vrojtimit të tipit të muraturës nga ana jugperëndimore e kullës, dalim në përfundimin se faza e dytë e ndërtimit të kullës i përket shekujve XIII-XIV. Kemi hasur fragmente të teknikës së kluasonazhit, teknikë kjo mjaft e përhapur në objekte të gjinive të ndryshme ndërtimore në vendin tonë dhe jo vetëm.

Një fazë tjetër në këtë objekt mendojmë se është ajo e shek. XVII, kur kulla mori një funksion të ri si kullë sahati, pas tërmetit të vitit 1617.

Rindërtimi i ambientit të kambanës në hapësirën kohore midis viteve 1849-1866, na ofron një tjetër fazë dhe pamje arkitektonike.



TAB.II. Kulla e sahatit në kalanë e Krujës. Gjendja ekzistuese - Pamja jugperëndimore, Prerja Shk.1:100. Përpunoi: Dritan Çoku



TAB.III. Kulla e sahatit në kalanë e Krujës. Gjendja ekzistuese - Pamja jugperëndimore, Planimetritë A-A; B-B; C-C, Shk.1:100. Përpunoi: Dritan Çoku

Kulla e sahatit[17] në kalanë e Krujës (Fig. 12) ruan edhe sot të njëjtën pamje me dokumentimin më të vjetër deri tani të kullës së sahatit, të cilën na e ofrojnë vizatimet e Edward Lear, më 1848. Në vitin 1866, kalaja e Krujës na vjen e dokumentuar edhe prej një paraqitje grafike, ku janë punuar planimetria e kalasë së qytetit të Krujës dhe pamja veriperëndimore e saj[18] (Fig. 13). Në to gjendet edhe kulla e sahatit. Nëse do ta marrim të mirëqenë saktësinë e paraqitjes së pamjes së kullës së sahatit dhe do të bazohemi në të, atëherë kuptojmë që ambienti i kambanës do të jetë dëmtuar prej faktorësh të cilët nuk i dimë dhe më pas rikonstruktuar, duke na dhënë pamjen e vitit 1866, e ndryshme nga vizatimet e Lear-it (1848) dhe gjendja e sotme. Nga vizatimi duket se ambienti i kambanës është krijuar nga kolona prej druri (tetë kolona në të katra faqet e kullës) të lidhura me nga një hark me të njëjtin material, ndërsa çatia e këtij ambienti ka formën e një kupole gjysmësferike. Mesa duket pas dëmtimit përsëri të ambientit të kambanës, kjo e fundit është rikonstruktuar, duke respektuar pamjen dhe materialet ndërtimore siç kanë qenë në vizatimet e Lear-it, ndërhyrje kjo që përcakton një fazë tjetër. Këtë fakt ne e mësojmë nga një foto e viteve '90 të shek. XIX. Pas këtij rikonstruksioni dhe atij të vitit 1981 (ku u rikonstruktua i gjithë ambienti i kambanës, duke na dhënë fazën e fundit të kullës

[17] Kjo pasuri ndërtimore është shpallur *"monument kulture"* i kategorisë së I-rë me Vendim të Institutit të Shkencave, në mbështetje të ligjit Nr.586, datë 17/3/1948. *AQSH,* Fondi 489, Viti 1948, Dosja 54, fl. 10-12. Dekret-ligji Nr.586, datë 17/3/1948. Kalaja e Krujës, në qytetin e Krujës, në kuotën 608, i gjithë muri i rrethimit, duke përfshirë pyrgjet dhe galerinë që lidh kalanë me burimin e tashllojt, pjesët e mureve që e rrethojnë këtë burim si dhe portën kryesore bashkë me kalldrëmin. Përfshihet edhe kulla e sahatit.

[18] Arkivat Perandorake Osmane "Mijëra fotografi historike, harta dhe dokumente". Plani i kalasë së qytetit të Krujës (Shqipëri), 1866. https://twitter.com/ottomanarchive/status/1096718123749818369?lang=en



TAB.IV. Kulla e sahatit në kalanë e Krujës. Gjendja ekzistuese - Pamja verilindore, Shk.1:100. Përpunoi: Dritan Çoku



TAB.V. Kulla e sahatit në kalanë e Krujës. Gjendja ekzistuese - Pamja juglindore, Shk.1:100. Përpunoi: Dritan Çoku



TAB.VI. Kulla e sahatit në kalanë e Krujës. Gjendja ekzistuese - Pamja veriperëndimore, Shk.1:100. Përpunoi: Dritan Çoku

DO NOT COPY



Fig. 12 Kulla e sahatit në kalanë e Krujës. Pamje në perspektivë. Dritan Çoku, Kullat mesjetare të sahatit në trojet shqiptare – Art & Trashëgimi, Katalog, Tiranë: Millenium i ri, 2017, f. 6



Fig.13 Plani dhe pamja veriperëndimore e kalasë së qytetit të Krujës, 1866. Nr.16 në planimetri është kulla e sahatit. https://twitter.com/ottomanarchive/status/1096718123749818369?lang=en

së sahatit deri në ditët e sotme), pamja e saj nuk ka pësuar ndryshime, ndonëse në këtë objekt janë ndërmarrë punime të ndryshme me karakter mirëmbajtës, konservues dhe restaurues.

Nga historiku dhe dokumentimi kronologjik i kullës së sahatit në kalanë e Krujës, deri tani, mësojmë se ambienti i kambanës është dëmtuar dhe rindërtuar katër herë, duke ndryshuar pamjen e saj vetëm një herë gjatë viteve 1849-1866.

Mekanizmi i vjetër i orës, i cili ka qenë i thjeshtë, u zhduk më 1917, në kohën e pushtimit austro-hungarez dhe nuk dihet ku është dërguar, ndërsa i riu u vendos më 1926[19]. Si sahat thuhet se ka punuar gjer në vitin 1944[20].

Pohimi i traditës se kjo kullë ka qenë kambanore, është e lidhur më tepër me faktin se në pjesën e sipërme të saj, kanë qenë vazhdimisht tri kambanore (rradhazi)… [21] Këto kambana kanë shërbyer fillimisht si mjet alarmi dhe më pas për cilësimin e kohëmatjes.

3.Kambanat

Në vitet 1893-1899 kur A. Degrand ishte konsull francez i Shkodrës, vizitoi qytetin e Krujës. Përveç përshkrimit që i bën kullës së sahatit në kalanë e Krujës, ai na ofron të dhëna mjaft interesante për kambanat e saj. Në dy prej tyre, ai është dëshmitar okular dhe në të tretën, ai informohet prej njerëzve që takoi.

A. Degrand shkruan: *"Prej një kulle katërkëndore fluturon shpejt nga një kambanë një tingull i thekshëm, i egër; unë kërkova ta shoh këtë pirg të shpartalluar, sjellë prej turqve në sahat: por nuk munda të gjeja një shkallë për t'u ngjitur deri tek kjo kambanë, në të cilën*

[19] Korbi, Hysen., "Kruja". Revista *Leka*, Vjeti V, Nr.VIII, Gusht 1933, Shkodër, f. 249-252. Për mekanizmin e vjetër të orës, Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Frashëri, Gjergj. "Projekt restaurimi për kullën e sahatit dhe i murit të akropolit, Tiranë, 6.10.1980.

[20] Dollma, Baki., *Vende dhe ngjarje historike të Krujës e Kurbinit, Historical places and events of Kruja and Kurbin*, botimi i tetë, Dajti 2000, f. 31.

[21] Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Frashëri, Gjergj. "Projekt restaurimi për kullën e sahatit në kalanë e Krujës", Tiranë, 13.10.1980.

DO NOT COPY

vura re disa shkronja; në një skaj pash një tjetër, e plasur, që ka dy monogramë…! Ajo qendronte e qetë, rrëzuar aty; mbi një shtroje dërrasash të kalbura…; një tjetër kambanë ka qenë, më thanë, çuar në Prezë për sahatin e këtij katundi: të tria ishin marrë prej kishave të Krujës kur i pushtoj Mehmeti II"[22] [23]. *"Një ditë u ngjita lart për të parë së afërmi kambanën e sahatit, të cilin mbasi e mata, konstatova, se ka 0,50 cm. gjatësi, 0,47 cm. thellësi dhe 0,40 cm. diametrin. Në rrethin e sipërm përmban*



Fig. 14 Kambana me dy monogramë, prodhuar në vitin 1462 (MCCCCLXII). Foto: Muzeu Historik Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Krujë

[22] Harapi, M. Zef., "Krueja", revista *Leka*, Vjeti IV, Nëntor 1932, Nr.11, Shkodër, f. 352-354.

[23] Shih për kambanën me dy monogramë, "Kruja dhe rrethinat", *Opinga*, revistë e ilustruar në gjuhët shqip e frëngjisht, Mot i parë, Numër 4, mars 1920, f. 67-69. Po ndryshket atje kjo kambanë, e cila kishte lajmëruar më shumë se njëherë fitimin e luftrave nga ana e shqiptarëve dhe që kishte dhënë zë disa herë, për afrimin e armikut!

këto shkronja: 'MAGIST – LVCAS – DE – VENECIIS – ME – FECIT', që d.m.th., "Mjeshtër Luka nga Venediku, më bëri (goditi) mua". Tjetër shenjë, as datë nuk ka fare. Nuk dimë se në ç'kohë ka jetuar ky mjeshtër, që të japim përafërsisht datën e kambanës, a është e kohës së Gjon Kastriotit, apo i përket një kohe tjetër"[24].

Nga kërkimet tona, kemi diktuar të ngjashmet e kambanës së kullës së sahatit në kalanë e Krujës me të njëjtin mbishkrim me kambanat e prodhuara në vitet 1317[25] [26] [27] dhe 1318[28] [29] [30], prej mjeshtrit Luka nga Venecia. Për rrjedhojë, kohën e prodhimit të kambanës e vendosim gjatë gjysmës së parë të shek. XIV. Pra, kambana nuk i përket kohës së Gjon Kastriotit, por rreth gjysmë shekulli më përpara.

Kambana tjetër me dy monogramë (Fig. 14), e derdhur në bronz në vitin 1462 (MCCCCLXII), është bashkëkohëse e epokës së lavdishme të Gjergj Kastriotit. Përmasat e kambanës janë: diametri 0,44 m; lartësia deri te kreu i kambanës 0,47 m; lartësia e përgjithshme së bashku me kulmin në të cilën lidhet kambana 0,58 m[31].

[24] Korbi, Hysen., "Kruja". Revista *Leka*, Vjeti V, Nr.VIII, Gusht 1933, Shkodër, f. 249-252.

[25] Novara, Paola., "Campane ravennati", *Pagani e Cristiani. Forme e attestazioni di religiosita del mondo antico in Emilia*, Volume XII, Firence: All'insegna del Giglio s.a.s., 2013, f. 192. Kambana e parë për kullën e Ravenës u realizua nga Luka i Veneciës në 1317 me urdhër të Guinto da Polenta. Ne kemi përshkrimin që na ka mbetur nga Antonio Beltrami.

[26] Beltrami, Francesco., *Il forestiere instruito delle cose notabili della città di Ravenna*, 1783, f. 142.

27 Ricci, Corrado., *Lúltimo rifugio di Dante Alighieri*, Milano, 1891, f. 35.

[28] Tagliapietra, Valentino., "Mazzorbo festeggia i 700 anni della campana piu' antica in laguna", *Il Ponte*, Anno IV N.2, 21 giugno 2018. Kambana, që daton në 1318 është e vendosur në kambanoren e shekullit të katërmbëdhjetë të kishës të Mazzorbos, është e njohur nga figura në reliev e pranishme në të gjithë lartësinë e saj të kryeengjëllit Mikael (siç shihet në foto), e kapërcyer nga epigrafia që mban nënshkrimin e mjeshtrit të shkritores dhe datën: MAGISTER LUCAS DE VENETIIS ME FECIT + ANNO MCCCXVIII. Mbishkrimi është gdhendur në skajin e poshtëm: XUS VINCIT - XUS REGNAT - XUS - IMPERAT.

[29] Moschini, Giannantonio., *Guida per la città di Venezia: all' amico delle belle arti*, Volume 2, Parte II, Venezia, 1815, f. 447.

[30] Zani, Pietro. D., *Enciclopedia metodica critico-ragionata delle belle arti*, Parte prima, Vol. XII, Parma, 1822, f. 116.

[31] Gjejmë rastin të falenderojmë sinqerisht punonjësin e



Fig. 15 Skica e kambanës bërë nga Gjeçovi në vitin 1924. AQSH, Fondet personale, S-U (N/A), 58 Shtjefën Gjeçovi (1864-1930), 3-Veprimtari krijuese, Dosja 33



Fig. 16 Kambana. DRTK-Tiranë, Foto: Gjergji Gjuraj, 10.01.2019

Në koleksionin e Shtjefën Gjeçovit ishte edhe kjo kambanë, e cila përdorej në kohën e Skënderbeut, për të mbledhur popullin për luftë ose për të përshëndetur fitoret etj[32].

Sipas shënimit të lënë prej Gjeçovit, në fletën ku ka skicuar dy pamjet e kambanës[33] (Fig. 15), përveç të tjerave, është shënuar se kambana është marrë prej këmbanores së kishës së Shën Nnreut*, në Krujë[34].

Muzeut Historik Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Krujë, z. Xhevdet Rama, i cili na lejoi të dokumentonim dhe të merrnim përmasat e kambanës, ditën kur rilevuam edhe kullën e sahatit në kalanë e Krujës, më dt. 22.02.2017.

[32] "Shtjefën Gjeçovi më i pari arkeolog shqiptar", revista *Shkenca dhe jeta*, Viti XI – Nr.1 (56), 1979, f. 43.

* D.m.th., Shën Ndreut (Andreut).

[33] *AQSH*, Fondet personale, S-U (N/A), 58 Shtjefën Gjeçovi (1864-1930), 3-Veprimtari krijuese, Dosja 33.

[34] Vizatim në dy pamjet, që ruhet në AQSH Tiranë, ku ruhet fondi i tij arkivor. Gjeçov Kryeziu, korrik 1924. Gjeçovi ia mori

Kambana sot ruhet në muzeun Kombëtar "Gjergj Kastriot Skënderbeu", në Krujë.

Kambana e tretë e përmendur nga A. Degrand, u dërgua në Prezë për sahatin e saj. Këtë informacion ai e merr nga njerëzit që takoi[35]. Kjo kambanë nuk është gjetur ende deri më sot.

Sipas pohimeve të ish-punonjësve të vjetër të ish-DRKK Tiranë, një tjetër kambanë, e cila vinte nga kisha e Shna Ndout në Laç (u hoq në viti 1967 pas shkatërrimit të objektit të kultit), ishte vendosur në kullën e sahatit të kalasë së Krujës. Ajo ka qëndruar në kullë deri në vitin 1997, kur kulla pësoi një djegie të pjesshme dhe që atëherë kjo kambanë u zhduk. Në vitin 2013, z.Tomorr Merlika, banues në Krujë, e dorëzoi kambanën pranë ish-DRKK Tiranë dhe që atëherë kambana ndodhet aty[36] (në DRTK-Tiranë (Fig. 16).

4.Ndërhyrjet restauruese

Gjatë përshtatjes për kullë sahati, duket se kjo strukturë e gurtë e mori në tri faqet e tjera formën prizmatike, për të cilën u shfrytëzuan bazamentet e vjetra të saj. Koha është e lidhur me humbjen e funksionit mbrojtës, jo vetëm të kullës, por edhe të murit të akropolit ngjitur me të. Pjesa e sipërme, me sa duket, është menduar si një kolonadë tetëshe, e cila është restauruar në vitin 1967[37]. Me restaurimin e kryer nuk pati ndryshime në pamjen arkitekturore të kullës së sahatit[38].

Gërmimet arkeologjike në të tria zonat e kalasë (Fig. 17, 18), u kryen me rradhë në vitet 1977-1983[39]. Gjithashtu, u bë konservimi arkeologjik i rrënojave të cilat dolën në dritë, si dhe konsolidimi i atyre ekzistuese.

Ndërhyrje konservuese për vizitueshmëri ishte gjithashtu restaurimi i donzhonit** sipas pamjes dhe funksionit të tij të shekujve të fundit si kullë sahati[40]. Shkaku i dëmtimit të kullës së sahatit mendojmë se është tërmeti i 15 prillit 1979, i cili shkaktoi dëme edhe në rrethin e Krujës. Duke parë dokumentet arkivore të IKTK-Tiranë dhe projektin e restaurimit, duket se punimet restauruese janë kryer gjatë vitit 1981 (Fig. 19, 20).

Në variantin fillestar të restaurimit, ishte hedhur ideja e rikompozimit të formës piramidale të pjesës së poshtme të kullës dhe rikompozimi i pjesës së sipërme me harkada tetëshe në vend të kolonadës që është sot. Gjithashtu, ishte hedhur ideja e plotësimit në një farë mase të murit të akropolit (në vendin e takimit me kullën), duke e konsideruar edhe këtë fazë të hershme. Por kështilli i organizuar me këtë rast në objekt vendosi që kulla të ruhet në gjendjen e sotme, pa cënuar formën që ka[41].

Ibrahim Kaloshit, krutanit, dhe i dha 15 napolona me anë të dr. Remi de Kwiatkowski, konsullit të austro-hungarisë në Durrës, i cili e kishte në shtëpi të vet. Dr. Kwiatkowski ishte lidhur me Gjeçovin me anë të një letre nga Durrësi, ku thuhej se dhurata për kishën e parë që do të trajtohej në qytetin e Krujës, do të ishte kjo kambanë, e dhënë në emër të shtëpisë së Kwiatkowskit.

35 Harapi, M. Zef., "Krueja", revista Leka, Vjeti IV, Nëntor 1932, Nr.11, Shkodër, f. 352-354.

[36] Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë, "Kambana", Përgatiti kartelën: Gjergji Gjuraj. Materiali: Bronz. Teknika e prodhimit: Me derdhje. Përmasat: Diametri i madh rreth 50 cm, dimetri i vogël rreth 30 cm, lartësia 55 cm. *Përshkrimi*: Kambanë bronzi me përmasa mesatare realizuar me derdhje në kallup. Objekti është i dëmtuar dhe i ndarë në 4 pjesë për shkak të një zjarri. Ai është i zbukuruar më dy reshta me motive floreale si në pjesën e poshtme dhe në pjesën e sipërme, po ashtu në njërën anë ndodhen tri figura kishtare në altoreliev. Në të majtë shën Mëria me Krishtin e vogël në krah, në qendër Krishti i Kryqëzuar dhe në të djathtë, një figurë ndoshta i një Patriarku të kishës lindore që dallohet pjesërisht pasi është dëmtuar nga zjarri, kjo ndoshta për shkak se prodhuesit e kanë pasur kallëp të gatshëm. Po ashtu mbi kambanë rreth e rrotull saj ka dhe një mbishkrim gjithmonë në altoreliev: Rreshti parë: P.FILIP MASREKAJ O.F.M. NË RKUJTIM TË PËRHERSHËM IA KUSHTON NANËS SË VET MARI DEKË LA..5/11/1957. Rreshti dytë: BIJT E SPIRO.V.NACES ZILEXHI I KO.CË 1957.

[37] Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Frashëri, Gjergj. "Projekt restaurimi për kullën e sahatit në kalanë e Krujës", Tiranë, 13.10.1980.

[38] Naçe, Piro., "Kruja përgatitet", revista *Ylli*, Nr.11, Viti VIII, nëntor 1967, f. 19-20.

[39] Frashëri, Gjergj., "Konservime arkeologjike në kalanë e Krujës", *Monumentet*, Nr.31, 1, 1986, Tiranë, 1987, f. 38.

** Kryekullë, shih Kokona, Vedat. *Dictionnaire Francais-Albanais*, Tiranë: Edlor, 2001, f. 309. Kullë (kështjellë), Kokona, Vedat. *Français-Albanais Shqip-fërngjisht Dictionnaire/Shqip*, Tiranë: Kokona, 2002, f. 127.

[40] Frashëri, Gjergji. *Vep. cit.*, f. 45.

[41] Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Gjergj Frashëri, "Relacion i konsultës për punimet e restaurimit në kullën e vrojtimit në kalanë e Krujës". Kjo konsultë u krye më datë 15.X.1980, sipas këtij relacioni.

DO NOT COPY



Fig. 17 Planimetria e kalasë, tre zonat arkeologjiko-konservuese në të cilat u kryen punimet. Fig.2 te Gjergj Frashëri, "Konservime arkeologjike në kalanë e Krujës", revista Monumentet, 1/1986 (31), Tiranë: Mihal Duri, 1987, f. 38



Fig. 18 Planimetria e akropolit të kalasë pas ndërhyrjeve arkeologjiko-konservuese. Fig.29 te Gjergj Frashëri, "Konservime arkeologjike në kalanë e Krujës", revista Monumentet, 1/1986 (31), Tiranë: Mihal Duri, 1987, f. 46

PAMJE TË KULLËS SË SAHATIT



Para restaurimit



Gjatë restaurimit



Pas restaurimit

Fig. 19 Pamje të kullës së sahatit në kalanë e Krujës – para, gjatë dhe pas restaurimit. Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore-Tiranë (a, b, c, Foto: R.Veseli, viti 1966; d, e, f, g, h, Foto: Gj.Frashëri, viti 1981; i, j, Foto: H.Çollaku, viti 1982)

DO NOT COPY

ÇATIA E KULLËS SË SAHATIT



Para restaurimit

Gjatë restaurimit

Pas restaurimit

Fig. 20 Çatia e kullës së sahatit në kalanë e Krujës – para, gjatë dhe pas restaurimit. Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore-Tiranë (a, b, c, Foto: R.Veseli, viti 1967; d, e, f, g, Foto: Gj.Frashëri, viti 1981; h, i, Foto: Gj.Frashëri, viti 1981)

DO NOT COPY



Fig. 21 Kulla e sahatit e dëmtuar nga tërmeti i 26.11.2019. Foto: Gjergji Gjuraj, dt.26.11.2019



Fig. 22 Kulla e sahatit e dëmtuar nga tërmeti i 26.11.2019. Foto: Gjergji Gjuraj, dt.26.11.2019

Punimet që do të kryheshin në të do të kishin karakter konsolidues, sipas përcaktimeve të kryera në relacion[42].

Pas dëmtimeve që pësoi kulla e sahatit me tërmetin e 26 nëntorit të vitit 2019 (Fig. 21, 22[43]), po punohet për hartimin e një projekti për restaurimin e kullës së sahatit dhe problematikave të tjera në murin fortifikues si dhe në formacionin shkëmbor, mbi të cilën është ngritur kulla e sahatit dhe struktura të tjera murore.

[42] Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, "Projekt restaurimi për kullën e sahatit në kalanë e Krujës", Tiranë, 13.10.1980.
Eleminimin e pjesës së sipërme (kolonadës së bashku me çatinë) të restauruar në vitin 1967, pasi nevojitet një ndërhyrje më estetike dhe konstruktive e kolonadës.
Konform studimit fotografik të hershëm i kolonadës do të synojë në rikompozim sipas formës së vjetër që njihet, duke i trashur kolonat dhe duke e ngritur 30 cm, pragun e tyre.
Në brendësi të kolonave dhe përgjatë bazamentit të tyre do të krijohet një skelet b/a i maskuar, i cili do të sigurojë qëndrueshmërinë e duhur ndaj evenimenteve të tjera të papritura.
Së jashtmi kolonat do të punohen me gurë konglomerat i ashpër (grac), sipas teknikës që njohim nga fotografitë.
Çatia do të rikompozohet sipas formës së sotme. Në konstruksionin e saj të brendshëm do të parashihet edhe vendosja e kambanës.
Në faqen jugore të kullës, në pjesën e sipërme do të kryhet prishja e muraturës së jashtme, pasi ajo është krejt e shkëputurm në pamundësi për të krijuar një lidhje tjetër me afat të gjatë.
Pjesa e muraturës kontrafortuese në perëndim dhe jug do të plotësohet me muraturë së bashku me murin e akropolit sipas rastit në 0,8 - 1,2 m.
Në faqen perëndimore (faza e dytë) është parashikuar të kryhet zhveshja e muraturës nga suvatimi.
Punime të tjera evidentimi do të kryhen në kullën jugore.
Gjatë zhvillimit të këtyre punimeve, ato do të ndërpriten në rast gjurmësh të reja. Gjithashtu punimet është e domosdoshme të kontrollohen herë pas here nga këshillimi.

[43] Gjej rastin të falenderoj sinqerisht, kolegun tim, specialistin arkeolog të DRTK-Tiranë Gjergji Gjuraj, i cili më ndihmoi me fotot e kullës së sahatit në kalanë e Krujës, para dhe ditën e tërmetit të 26 nëntorit 2019.

BIBLIOGRAFIA

1. *AQSH,* Fondi 489, Dosja 54, Viti 1948.
2. *AQSH*, Fondet personale, S-U (N/A), 58 Shtjefën Gjeçovi (1864-1930), 3-Veprimtari krijuese, Dosja 33.
3. Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore – Tiranë, Frashëri, Gjergj. "Projekt restaurimi për kullën e sahatit dhe i murit të akropolit, Tiranë, 6.10.1980.
4. Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore – Tiranë, Frashëri, Gjergj. "Projekt restaurimi për kullën e sahatit në kalanë e Krujës", Tiranë, 13.10.1980.
5. Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore – Tiranë, Frashëri, Gjergj. "Relacion i konsultës për punimet e restaurimit në kullën e vrojtimit në kalanë e Krujës", Kjo konsultë u krye më date 15.X.1980.
6. Arkivi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, "Projekt restaurimi për kullën e sahatit në kalanë e Krujës", Tiranë, 13.10.1980.
7. Adhami, Stilian., "Gjurmim rreth themelimit dhe ndërtimeve kryesore të kalasë ë Krujës", *Monumentet*, 1, 1971, Tiranë, 1972.
8. Beltrami, Francesco., *Il forestiere instruito delle cose notabili della città di Ravenna*, 1783.
9. Boué, Ami., *Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe*, Détails géographiques, topographiques et statistiques sur cet empire, Vienne, 1854
10. Dashi, Sulejman., "Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë", *Monumentet,* 12, 1976, Tiranë: Mihal Duri, 1977.
11. Dollma, Baki., *Vende dhe ngjarje historike të Krujës e Kurbinit, Historical places and events of Kruja and Kurbin*, botimi i tetë, Dajti 2000.
12. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë, "Kambana", Përgatiti kartelën: Gjergji Gjuraj.
13. Durham, Edith., *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë e Shqiptarët*, Naun Veqilharxhi, Ribotim, Tiranë, 1998.
14. Elsie, R., *Historical Dictionary of Albania*, Second Edition, Lanham • Toronto • Plymouth, UK: The Scarecrow Press, Inc., 2010.
15. Frashëri, Gjergji., "Konservime arkeologjike në kalanë e Krujës", *Monumentet*, Nr.31, 1, 1986, Tiranë, 1987.
16. Hahn, Georg von Johann., *Studime shqiptare*, E përkthyer nga gjermanishtja: Veniamin Dashi dhe Afrim Koçi, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, pa datë.
17. Harapi, M. Zef., "Krueja", revista *Leka*, Vjeti IV, Nëntor 1932, Nr.11, Shkodër.
18. Hecquard, Hyacinthe., *Histoire et description de la haute Albania ou Guegarie*, Paris, 1858.
19. Karaiskaj, Gjerak., *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë: Pegi, 2016.
20. "Kruja dhe rrethinat", *Opinga*, revistë e ilustruar në gjuhët shqip e frëngjisht, Mot' i parë, Numur 4, mars 1920.
21. Kokona, Vedat., *Dictionnaire Francais-Albanais*, Tiranë: Edlor, 2001.
22. Kokona, Vedat., *Français-Albanais Shqip-fërngjisht Dictionnaire/Shqip*, Tiranë: Kokona, 2002.
23. Korbi, Hysen., "Kruja". Revista *Leka*, Vjeti V, Nr. VIII, Gusht 1933, Shkodër.
24. Moschini, Giannantonio. *Guida per la città di Venezia: all' amico delle belle arti*, Volume 2, Parte II, Venezia, 1815.
25. Naçe, Piro., "Kruja përgatitet", revista *Ylli*, Nr.11, Viti VIII, nëntor 1967.
26. Novara, Paola., "Campane ravennati", *Pagani e Cristiani. Forme e attestazioni di religiosita del mondo antico in Emilia*, Volume XII, Firence: All'insegna del Giglio s.a.s., 2013.
27. Ricci, Corrado., *Lúltimo rifugio di Dante Alighieri*, Milano, 1891.
28. Shkodra, Zija., *Qyteti shqiptar gjatë rilindjes kombëtare*, Tiranë: Mihal Duri, 1984.
29. "Shtjefën Gjeçovi më i pari arkeolog shqiptar", Revista *Shkenca dhe jeta*, Viti XI – Nr.1 (56), 1979.
30. Tagliapietra, Valentino., "Mazzorbo festeggia i 700 anni della campana piu' antica in laguna", *Il Ponte*, Anno IV – N.2, 21 giugno 2018.
31. Zani, Pietro. D., *Enciclopedia metodica critico-ragionata delle belle arti*, Parte prima, Vol. XII, Parma, 1822.

DO NOT COPY

Dritan ÇOKU

THE CLOCK TOWER IN THE CASTLE OF KRUJA

The latest documentation of this construction work, before photos came to be used, is reflected on the drawings of the English artist Edward Lear on September 29, 30 1848.

This tower was probably built in the XI-XII centuries (or even before) and it is the oldest among those preserved as observation points. Different authors classify it as a bell tower, while it acquired its function as a clock tower in the XVII century. Based on its former condition of construction and its location, it fulfilled in the best way the conditions of its new function as a civil clock tower used by the market and the city.

Based on our research and according to the typological exterior voluminous composition, the clock tower in the castle of Kruja falls under the second category with two floors and under the second subcategory of this category. Our research has identified five construction phases: the first in the XI century; the second in the XIII-XIV centuries; the third in the XVII century; the fourth in the time span between 1849-1866 and the fifth between 1866 until the 90s of XIX century. Based on our source data we learn that the old mechanism of the clock disappeared in 1917, while the new was set up in 1926. It is thought that it was functional as a clock tower until 1944.

During the period when A. Degrand was the French Consul of Shkodra (1893-1899), he visited the city of Kruja. His descriptions give us a very interesting information on the clock and its three bells. Two of the bells he had witnessed himself. We think that the one with the Latin inscription dates back to the second half of the XIV century, half a century before the time of Gjon Kastrioti. The second bell had two monograms, and a date written with roman numbers. The date indicated that it was casted in bronze in 1462 (MCCCCLXII) and it is contemporary with the glorious area of Gjergj Kastriot Skenderbeu. The third bell was sent to the clock tower of Preza, according to the information he received from the people he met. Based on the notes that have been handed to us by Shtjefën Gjeçovi on the same piece of paper with the two drawings of the bell tower in 1462, we learn that the bell was taken from the bell tower of the church of Shendreu in Kruja. This bell is preserved today in the National Museum "Gjergj Kastriot Skenderbeu" in Kruja. The location of the other two bells is not currently known. According to former senior employees in the former DRKK Tirana, another bell, originating from the church of Shna Ndou in Lac (removed in 1967 following the destruction of the religious monument) was in the clock tower of the castle of Kruja. Today the bell is damaged and is located in the premises of DRTK Tirana.

The main restoration interventions on the clock tower, after it acquired its legal status as a monument of culture in 1948, were undertaken in 1967 and 1981.

After the damages that the clock tower suffered in the earthquake of November 26, 2019, a project is being designed for the restoration of the clock tower and for addressing the other problems on the fortification wall and the rocky formation over which the clock and the other wall structures are built on.

DO NOT COPY

Sokol ÇUNGA
Arkivist, paleograf

PËRSHKRIMI I MITROPOLISË SË BERATIT NGA ANTHIM ALEKSUDHI SI BURIM HISTORIK

Një nga burimet dokumentare shumë të rëndësishme të shek. XIX që flet për trashëgiminë kulturore të tundshme dhe të patundshme, materiale dhe jomateriale të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut është botimi fort i njohur për studiuesit e historisë së asaj periudhe "*Përshkrim i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit dhe zonave në varësi të saj*" [1], shkruar nga Anthim Aleksudhi, mitropolit i Mitropolisë së Hirshme të Beratit. Teksti u shkrua prej mitropolitit gjatë kohës kur mbante fronin e Mitropolisë së Beratit dhe u botua në Korfuz më 1868 në shtypshkronjën e Vëllezërve Kaon, "Jonia". Teksti është shtypur në 158 faqe 21 cm të larta dhe shtrihet në pesëmbëdhjetë krerë, ku paraqiten, me radhë: **Kreu I**, pozicioni gjeografik i Provincës kishtare të Beratit; **Kreu II**, Peshkopata që kanë ekzistuar përpara në Provincën e Beratit dhe shënime historike rreth tyre; **Kreu III**, paraqitje e temave apo zonave që përbëjnë Provincën e Beratit; **Kreu IV**, përshkrim i manastireve të hirshme të Mitropolisë së Beratit; **Kreu V**, kufijtë e Provincës së Beratit; **Kreu VI**, rendi kanonik i Mitropolisë së Beratit; **Kreu VII**, Krishterimi; **Kreu VIII**, relikte të çmuara fetare; **Kreu IX**, libra të hirshëm të dorëshkruar në pergamenë; **Kreu X**, shenjtorët që kanë shkëlqyer në Provincën e Beratit; **Kreu XI**, kryepriftërinjtë e Provincës së Beratit; **Kreu XII**, letra dhe dokumente zyrtare, kishtare dhe civile, lidhur me emërimin dhe administrimin shpirtëror të Mitropolitit të Beratit; **Kreu XIII**, gradët e Mitropolisë së Beratit në Rregulloren Kishtare dhe fama e Mitropolitit në shërbesat e shenjta; **Kreu XIV**, Për Mitropolinë e Durrësit dhe Gorës ose Gorës-Mokrës dhe kryepriftërinjtë e saj, si dhe përshkrim i shkurtër i qytetit dhe Provincës së Durrësit; **Kreu XV**, pikëpamje të përgjithshme për moralin dhe gjendjen shoqërore të banorëve të Provincës së Beratit.

Anthim Aleksudhi, gjatë 32 viteve që qëndroi në fronin e Mitropolisë së Beratit duket se e dashuroi vendin, krahinën, trashëgiminë dhe njerëzit. Veç librit të sipërpërmendur, shkroi edhe një sërë artikujsh për historinë e vendit, si dhe i kushtoi mjaft kohë studimit dhe katalogimit të dorëshkrimeve bizantine dhe pasbizantine të gjendur në Berat, duke u bërë dhe kataloguesi i parë i tyre. Ndërmori jo vetëm veprimtari mbrojtëse, duke grumbulluar dorëshkrimet e vjetra në Mitropolinë e Beratit, duke krijuar,

[1] Anthim Aleksudhi. *Përshkrim i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit dhe zonave në varësi të saj*, Korfuz, Shtypshkronja "Jonia" e Vëllezërve Kaon, 1868 (Ἄνθιμος Ἀλεξούδης, *Σύντομος ιστορική περιγραφή της Ιεράς Μητροπόλεως Βελεγραδών και της υπό την πνευματικήν αυτής δικαιοδοσίαν υπαγομένης χώρας*, Εν Κερκύρα: Τυπογραφείον "Η Ιονία"Αδελφών Κάων, 1868.)

kështu, një bibliotekë mjaft të pasur me libra të shumëçmuar, por edhe kontribuoi në restaurimin e tyre. Më 1885 mirëpriti të mirënjohurin studiues Pierre Batifol nga Shkolla Arkeologjike Franceze e Romës, i cili studioi dy dorëshkrimet e purpurt të Beratit, Beratinus I dhe Beratinus II. Këtij të fundit, në botimin e tij, Batifol-i i dha dhe epitetin "Aureus Anthimi", ndryshe "Kodiku i Artë i Anthimit", për të ilustruar lidhjen e ngushtë që kishte mitropoliti i përkorë me ata libra të çmuar. Për shkak të kësaj dashurie për librat, për dijen dhe trashëgiminë kulturore, Aleksudhit iu dha prej bashkëkohësve dhe autorëve të mëvonshëm dhe epiteti "miq i muzave".

Anthim Aleksudhi u lind në Maditë të Trakës Lindore më 1824. Me përkrahjen e Peshkopit të Klaudiopojës, Pandeleimonit, shkoi në Konstandinopojë më 1845 dhe studioi në Shkollën e Madhe të Kombit (njohur dhe si Shkolla e ishullit Halki). Në vijim shërbeu si sekretar i Mitropolitit të Efesit, Anthimit. Më 25 dhjetor 1847 u dorëzua dhjakon nga Patriarku Ekumenik Anthimi VI dhe qëndroi për të shërbyer në oborrin patriarkal. Më 5 tetor 1854 u emërua i dyti në radhën e dhjakonëve patriarkalë. Më 27 shkurt 1855 u dorëzua Mitropolit i Beratit, fron të cilin e mbajti deri më 1887. Në 22 korrik të këtij viti u zgjodh unanimisht Mitropolit i Amasisë. Më 31 janar 1908 u pushua nga detyra e mitropolitit dhe fjeti në Konstandinopojë më 11 shkurt 1909.

Librin e sipërpërmendur të Aleksudhit e shfrytëzon çdo studiues që kërkon të ilustrojë me fakte historinë e Shqipërisë Qendrore e Jugore të antikitetit, mesjetës dhe rilindjes. Sidoqoftë, gjuha në të cilën është shkruar nuk pranon t'i bindet çdokujt që mëton ta zbutë atë, prandaj dhe sjellim këtu përkthyer në shqip, duke e lidhur me kontekstin e kësaj reviste të nderuar, Kreun IV të librit, shoqëruar edhe me shënimet tona. Meqenëse vetë teksti i Aleksudhit ka shënime, aty ku i kemi shtuar ne kemi vendosur në kllapa "shënim i përkthyesit".

Anthim Aleksudhi

MANASTIRET E HIRSHME NËN VARËSI TË MITROPOLISË SË HIRSHME TË BERATIT, OSE MANASTIRET E FAMULLIVE[2]

1. Manastiri i së Tërëshenjtës së Ardenicës

Manastiri i Hirshëm i cili nderon Lindjen e së Tërëshenjtës sonë Hyjlindëse, i mbiquajtur "i së Tërëshenjtës së Ardenicës" ndodhet në zonën e Myzeqesë së Madhe, mbi një kodër, e cila me shtrirjen e saj përshkon Myzeqenë e Madhe, e vendosur në lindje të saj, duke filluar që prej anës perëndimore të zonës së Karatoprakut (dheut të zi), duke u zgjatur deri në brigjet e gjirit të Adriatikut.

Nuk dihet pikërisht kur u ndërtua ky manastir i hirshëm, pasi nuk ekzistojnë informacione të sigurta historike, por ngjan se është i vonë, ndoshta i ndërtuar prej hegjemonisë perandorake të kujdestarëve, despotëve dhe dukëve të Konstandinopojës në Epir dhe Shqipëri.

Tempulli i hirshëm i manastirit ka pësuar dëmtime nga koha dhe është rindërtuar më 1743[3], kurse katër krahët e manastirit të hirshëm, dhomat dhe qelitë që ishin rrënuar, u ndërtuan më 1778[4].

Sipër Portës së madhe të manastirit të hirshëm, nga ana e oborrit, shquhet një gur ku është gdhendur data e thjeshtë *",αυοζ. Μαΐου ά"* (pra, 1477)[5], e cila ndoshta më herët ka qenë vendosur në tempull, ndërsa gjatë rindërtimit duhet të jetë vendosur aty ku ndodhet sot.

Kambana e madhe, e varur në kambanore, ka të gdhendur mbi vete fillimin e ekzistencës, datën 1708. Kurse tre kambanat e tjera të vogla kanë të gdhendur me numra latinë datën MDCCXXXVIII, ndryshe 1738.[6]

[2] Ἄνθιμος Ἀλεξούδης. *Σύντομος ιστορική περιγραφή της Ιεράς Μητροπόλεως Βελεγραδών και της υπό την πνευματικήν αυτής δικαιοδοσίαν υπαγομένης χώρας*, Εν Κερκύρα: Τυπογραφείον "Η Ιονία"Αδελφών Κάων, 1868, fq. 73-87.

[3] Th. Popa., *Mbishkrime*, fq. 96-97 (shënim i përkthyesit).

[4] Th. Popa., *Mbishkrime*, fq. 106-107 (shënim i përkthyesit).

[5] Th. Popa., *Mbishkrime*, fq. 106. Popa korrigjon Aleksudhin duke e lexuar datën 1777, si dhe jep argumentimin e tij (shënim i përkthyesit).

[6] Th. Popa., *Mbishkrime*, fq. 96 (shënim i përkthyesit).

Ky manastir i hirshëm i Ardenicës, që prej fillimit të shek. XVII, deri në shek. XIX merrte ndihmë prej vëllazërisë së ndershme dhe shpresëtare në Poloni dhe Hungari, të cilët kishin krijuar një arkë kontributesh në emër të këtij manastiri të hirshëm; emrat e atëhershëm të anëtarëve të shoqërisë, dhe emrat e anëtarëve të rinj që shtoheshin kohë pas kohe, bashkë me kontributet e mbledhura në para, enë dhe rroba të shenjta, mbaheshin shënim në një regjistër prej kujdestarëve të asaj arke. Ato kontribute i dërgoheshin manastirit të mësipërm qoftë drejtpërdrejt, qoftë përmes miqve dhe bashkëfamiljarëve të tyre nga qyteti atëkohë i begatë i Voskopojës, ku ekzistonte dhe një metoq i manastirit të mësipërm, metoq i cili edhe sot ekziston, por i lënë pas dore.

Anëtarë të asaj shoqërie, që prej vitit 1777, deri në vitin 1795, siç paraqitet në korrespondencën që ruhet në thesarin e manastirit, ishin të ndjerët Naum Moska, e motra e tij, bashkë me të birin e saj, Mikail, papa Jorgo papa Simu, Athanas Jorgo Tupu, Nasto Kapu Mare, evreti Nikolla Tupja, Naum Jorgo Tantanis dhe Markos Raiku, banorë të Peshtit dhe Budës së Hungarisë. Kurse në Poloni anëtarë të vëllazërisë ishin të ndjerët Naum Joan Siaguna[7], Adham Kosta, Naum Dhimitriu dhe të tjerë të krishterë shpresëtarë, tregtarë në ato anë gjatë atyre viteve, emrat e ndjerë të të cilëve, si dhe të bashkëfamiljarëve të tyre, janë shkruar në diptikët e manastirit të hirshëm, duke u përkujtuar që prej asaj kohe, deri më sot, gjatë sakrificës pa gjak drejtuar Perëndisë, dhe do të përkujtohen përjetë, sipas rendit të manastirit.

Sipas traditës që ka mbërritur e trashëguar deri më sot dhe vazhdon të ruhet e të thuhet në këtë provincë, në një prej tregjeve të qytetit të Vjenës, kryeqytet i Perandorisë së Austrisë, manastiri i sipërpërmendur zotëronte një peshore (kandar), me leje të qeverisë vendëse, ku peshoheshin mallrat e ndryshëm që tregtoheshin në atë treg. Fitimet që siguronte kjo peshore i mblidhnin kujdestarët e caktuar atje dhe ia dërgonin manastirit. Manastiri merrte të ardhura prej peshimit të mallrave, e drejtë që ishte krijuar prej kontribuuesve krishtdashës në dobi të këtij tempulli të shenjtë që prej kohërave që s'mbahen mend, deri sa rregulli u shfuqizua më 1815; se për ç'arsye ndodhi ky shfuqizim dhe prej kujt, kjo është e paqartë dhe nuk përcaktohet dot.

Urojmë që pasardhësit e atyre të krishterëve të ndjerë, anëtarë të shoqërisë krishtdashëse që përmendëm, si dhe themeluesit e peshores, kudo ndodhen, të kenë në mendje qëllimet e shkëlqyera dhe të virtytshme të krishtera, si dhe shpresëtarinë e paraardhësve të tyre, dhe nën shembullin e tyre t'i imitojnë dhe, si t'u pëlqejë, me çdo mjet dhe mënyrë, të kontribuojnë, kur të dëshirojnë, dhe të ndihmojnë këtë manastir të hirshëm të së Tërëshenjtës së Ardenicës, prej të cilit ushqehen kaq shumë banorë të varfër të çdo kombësie, ku funksionon një shkollë dhe mësojnë e ushqehen, si dhe vishen, fëmijë të varfër, por të zellshëm, të kombit tonë.

2. Manastiri i së Tërëshenjtës së Apolonisë

Manastiri i hirshëm që nderon Fjetjen e Hyjlindëses, i quajtur dhe "e Tërëshenjta e Apolonisë", ndodhet në temën e Myzeqesë së Vogël, në rrënojat e qytetit antik të Apolonisë. Në anën e lindjes ka Omalokastrën (Mallakastër e Poshtme), në perëndim pjesën tjetër të Myzeqesë së Vogël, e cila vazhdon rreth tri orë [rrugë] deri në gjirin e Adriatikut. Në jug-perëndim të këtij manastiri, një orë larg, lumi Aoos (Vjosa) derdhet në bregun e Adriatikut.

Ky manastir i hirshëm është meremetuar së fundmi dhe ndërtuar më herët nga perandorë romakë, çka dëshmohet nga arkitektura e vjetër bizantine e tempullit të hirshëm, e stolisur nga tetë harqe

[7] Mes sërës së ortodoksëve të Perandorisë Austriake vërejmë me kënaqësi të nderuarin maqedonas, zotin Andrea, Baron të Siagunës, Kryepeshkop të Transilvanisë dhe Mitropolit i të gjithë rumunëve të Kishës Ortodokse Greke të Lindjes në Transilvani dhe Hungari.

DO NOT COPY

madhështore, kurse në pjesën e jashtme, në anën perëndimore të tempullit, majtas derës, duket mbishkrimi:

ΑΝΔΡΟΝΙΚΟΣ ΕΝ ΧΡΙΣΤΩ ΤΩ ΘΕΩ ΠΙΣΤΟΣ
ΒΑΣΙΛΕΥΣ ΡΩΜΑΙΩΝ ΚΟΜΝΗΝΟ-ΔΟΥΚ-ΑΓΓ
ΓΕΛΟ-ΠΑΛΑΙΟΛΟΓΟΣ

(Androniku, Mbret i Romakëve, besnik i Krishtit Perëndi, [nga familja] Komneno-Dukë-Angjel-Paleologe).[8]

pas të cilit vijnë dhe shenja të tjera germash të fikura, mes të cilave lexojmë sa më poshtë:

Ο ΚΑΙ ΝΕΟΣ ΚΩΝΣΤΑΝΤΙΝΟΣ ΚΟΜΝΗΝΟ-
*Α*ΓΓΕΛΟ-ΠΑΛΑΙΟΛΟΓΟΣ, Ο ΩΣ ΑΛΗΘΩΣ
ΦΙΛΟΧΡΙΣΤΟΣ ΚΑΙ ΦΙΛΟΜΜΟΝΑΧΟΣ

(si dhe Konstandini i Ri [nga familja] Komeno-Angjelo-Paleologe, krishtdashës dhe murgdashës i vërtetë).[9]

Poshtë këtyre mbishkrimeve paraqitet e pikturuar familja perandorake e përbërë prej tetë anëtarësh, paraqitur me shtat në përmasa të natyrshme, të gjithë veshur me veshje mbretërore. Prej tyre, Perandori me Perandoreshën qëndrojnë në mes, duke mbajtur në duar ikonën e së Tërëshenjtës sonë Hyjlindëse, e cila mban në krahë të Birin e saj, Perëndinë dhe Zotin tonë Jezu Krisht; në këtë paraqitje duket ulur në gjunjë një bir mbreti, duke vështruar ikonën dhe prindërit e tij.

Mbishkrimi i mësipërm në murin e tempullit na jep të kuptojmë se rindërtimi i këtij manastiri u krye në kohën e mbretërimit të Andronikut.[10]

Përpara pesëmbëdhjetë vitesh në këtë tempull patën shkuar ndërtues, të cilët meremetuan një pjesë [ndërtese], aty ku gëlqerja e vjetër kishte rënë, dhe pa asnjë ndjesi estetike lyen me gëlqere të gjithë tempullin, brenda dhe jashtë, duke mbuluar të gjitha pikturat murale, domethënë, edhe ato që ishin punuar në vitet më të hershme, të cilat paraqisnin fantazinë e gjallë të piktorit të asaj kohe dhe bukurinë e artit të tij, elementë që rrëfejnë shpenzimet e mëdha të bëra për këtë vepër, si dhe shpresëtarinë e të krishterëve të asaj kohe.

Shkëlqimin e pikturave të hershme dhe hijeshinë e tempullit lehtësisht e kupton soditësi prej dorës së ndërtuesve, që lanë pas fuqitë e shenjta qiellore dhe figura të tjera të nderuara, punuar me finesë, të ruajtura dhe të dukshme në absidën e jashtme të oborrit, si dhe në sallën e vjetër të ngrënies.

Manastiri i hirshëm duket se është ndërtuar në Apoloni mbi rrënojat e një tempulli ekzistues kushtuar Diellit ose Apollonit, siç e raporton edhe Herodoti në librin IX, kapitullin 93.[11]

Në anën jugore të kësaj kishe shquhet e murosur një pllakë mbi të cilën është gdhendur një shqiponjë fort e madhe, e cila ka vetëm një kokë dhe duket në pozicion fluturimi. Ndoshta simbolizon Zeusin, sipas të lashtëve, në mos qoftë simbol i perandorëve të Bizantit, flamuri i të cilëve stolisej edhe prej emblemave të tjera, por veçanërisht prej imazhit të shqiponjës.

Në një gur të murosur në themelet e anës jugore të tempullit lexojmë mbishkrimin e përmbivarrshëm:

ΕΝΤΑΥΘΑ ΚΕΙΤΑΙ ΜΕΛΕΤΙΟΣ Ο ΘΥΤΗΣ
ΕΚΚΛΗΣΙΑΡΧΩΝ ΤΗΣ ΜΟΝΗΣ ΤΑΥΤΗΣ
ΑΠΟΛΛΩΝΙΑΣ
*Ε*ΚΟΙΜΗΘΗ ΔΕ ΕΝ ΜΗΝΙ ΜΑΡΤΙΩ ΛΑ΄. ΩΝΗ΄.

(Këtu prehet Meleti, prifti meshtar i këtij manastiri të Apolonisë, që fjeti në muajin mars, 31, 858.)[12]

[8] Mbishkrimi jepet edhe në: Theofan Popa. *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, fq. 82 (shënim i përkthyesit).

[9] Th. Popa., *Mbishkrime*, fq. 82-83 (shënim i përkthyesit).

[10] Në një krisobullë, e cila ndodhet në vëllimin e pestë, fq. 340, të *Συντάγμα τῶν Ἱερῶν Κανόνων* dallohet Androniku Plak, dhe poshtë tij shënimi: ΑΝΔΡΟΝΙΚΟΣ ΕΝ ΧΡΙΣΤΩ ΤΩ ΘΕΩ ΠΙΣΤΟΣ ΒΑΣΙΛΕΥΣ ΚΑΙ ΑΥΤΟΚΡΑΤΩΡ ΡΩΜΑΙΩΝ ΔΟΥΚΑΣ ΑΓΓΕΛΟΣ ΚΟΜΝΗΝΟΣ Ο ΠΑΛΑΙΟΛΟΓΟΣ, i cili mbretëroi bashkë me të atin, Mikaelin, nga viti 1266 deri më 1282, dhe pas vdekjes së tij mbeti i vetëm në fron deri më 1328.

[11] Është me vend të sjellim në vëmendje se në kohët e vjetra, ata që prej idhujtarisë vinin tek besimi i Krishtit, zakonisht ngrinin dhe ndërtonin mbi altarët e mëparshëm, duke kthyer tempujt paganë në kisha të hirshme.

[12] Th. Popa., *Mbishkrime*, fq. 83-84. Theofan Popa ka korrigjuar në 1350 datën që Aleksudhi e lexon si 858 (shënim i përkthyesit).

Prej datës së mësipërme kur Meleti, prift dhe igumen i këtij manastiri, në të cilin edhe ka ndërruar jetë në vitin tetëqind e pesëdhjetë e tetë pas Krishtit, si dhe prej vendit ku tani ndodhet guri që mban mbishkrimin, informohemi se ky tempull i hirshëm ekziston që përpara vitit të shënuar 858, vit në të cilin është rindërtuar, fazë gjatë së cilës, tek ndërtohej, është vendosur edhe guri i mbivarrshëm në pozicionin që shihet sot.

Poshtë narteksit ndodhet një depozitë (sternë), në anën perëndimore të së cilës ndodhet e gdhendur data e lyerjes së saj, 30 prill 1473.

Jo larg këtij manastiri kalon rruga që sot quhet në shqip "Udha mbret", njëra prej dy degëve të së lashtës dhe së madhes rrugë romake dhe ushtarake Egnatia. Kjo rrugë fillon prej brigjeve të Gjirit të Jonit, kalon në Albanopolis (Elbasan), ku merr drejtimin për në lindje, kalon me lakore faqet e degëzimeve të Skardit dhe Pindit, që njihen si Malet e Gorës, lë në të majtë lumin Shkumbin tek Tre Hanet (Klukuza), kalon në Luginën e Derrave (Domuz Ovasi), i ngjitet së përpjetës dhe del në qytezën Strugë; kalon ndanë liqenit Lihnidë, ku ndodhet qyteti me të njëjtin emër Lihnidë ose Ahridë, prej nga ku merr drejt qytezave Reshnje, Pelagoni, Banicë, Ostrovë, Bodenë dhe Glanicë, dhe përfundon në Selanik.[13]

Këtë rrugë e përmend gjashtëdhjetë vite përpara Krishtit gjeografi i suksesshëm, Straboni, pas tij Meleti, si dhe autorë të tjerë që përshkruajnë lashtësinë e saj.

3. Manastiri i Shën Kozmait në Kolkondas

Manastiri i hirshëm që nderohet me emrin e dëshmorit të shenjtë dhe të barabartit me apostujt, Kozmait të ri, dhe të Gjithë Shenjtorëve, ndodhet në fshatin Kolkondas të zonës së Myzeqesë së Vogël, në bregun e djathtë, në anën e lindjes, dhjetë minuta larg lumit Apsos (Osum), ose lumit të Beratit.

Dëshmori i shenjtë Kozma e kishte prejardhjen nga fshati Pemë e Madhe i Etolisë. Shkoi në Malin e Shenjtë dhe studioi urtësinë laike prej drejtorit të atëhershëm të shkollës, Panajotis Palamas dhe Nikolaos Xarxuli nga Mecova e Epirit. Më pas iu bashkua klerit dhe nga Konstandin denjësisht u quajt Kozma, duke ruajtur moralin e virtytshëm dhe të shkëlqyer të Urtësisë Ungjillore dhe të Hirit. I stolisur me shkëlqim dhe me lejen e etërve që ushtroheshin me të në Manastirin e hirshëm të Filotheit, ngriti Kryqin e Zotit, ndërmori betejën apostolike për të shumëfishuar talendën e Ungjillit, i frymëzuar nga zelli hyjnor. Duke filluar nga manastiret e hirshme dhe sketat e Malit të Shenjtë, u mësonte të thjeshtëve në mendje, atyre etërve të nderuar, dhe i forconte në betejën e hirshme të ushtrimit I nxitur prej zellit hyjnor përshkoi gjithë Tesalinë, Maqedoninë dhe Ishujt e Jonit, pastaj u hodh në Epir, duke predikuar fjalën hyjnore dhe duke forcuar të krishterët ortodoksë në doktrinën atërore të besimit tonë të panjollë.

Si mbërriti në provincën e Beratit, i lumuri, filozofi dhe krishtdashësi Kozma, duke shpallur predikimin e Ungjillit, dha frymën e fundit si i barabartë me apostujt, duke vuajtur vdekjen prej dëshmori varur në litar në fshatin Mujalli, i cili ndodhet pranë Kolkondasit, më 24 gusht 1779, në motin e gjashtëdhjetë e pestë të moshës së tij, në kohën kur topark i Beratit ishte Ahmet Pasha Kurti nga fshati Lushnje i Myzeqesë së Madhe, i mbiquajturi "Ujk". Këto për shenjtorin.

Ky manastir i hirshëm dhe tempulli i hirshëm që mban emrin e Gjithë Shenjtorëve dhe të Shën Kozmait u ndërtuan dhe përfunduan më 1813-1814, me dëshirën dhe kontributin e nderuar të të gjithë të krishterëve të këtyre anëve, nën kujdesin e Kryepriftit të asaj kohe, të ndjerit Joasaf II, dhe të kujdestarëve Nikolla Mitro Kapedani dhe Haxhi Joan Xhixho nga Berati, të cilët i urdhëroi të kryenin këtë punë hegjemoni nga Tepelena, në

[13] Gjatë gjithë gjatësisë së Rrugës Egnatia kanë ekzistuar shtyll a të vendosura vertikalisht, të cilat kishin të gdhendur shifrën e stadeve të largësisë nga njëri tek tjetri, për të udhëzuar udhëtarët. Dy shtylla të tilla të gurta, çdonjëra prej të cilave mbante numrin 8, i pamë njërën në Strugë dhe njërën në Ohër.

DO NOT COPY

atë kohë pasha i Janinës dhe Epirit, Ali Pasha. Kur mposhti vjehrrin e tij, Ibrahim Pashën, dhe shtiu në dorë qytetin e Beratit, iu kujtuan fjalët që i lumuri Shën Kozma i kishte thënë profetikisht tek kalonte në Tepelenë, duke paraparë të ardhmen e nderuar dhe rritjen e Aliut, i cili ishte vlerësuar nga e larta qeveri e perandorisë.
Në këtë manastir ruhen edhe reliket e të barabartit me apostujt, Shën Kozmait, duke u dhënë shërim për sëmundjet gjithë atyre që i afrohen me nderim. Bashkëngjisim dy urdhra të të sipërpërmendurit Ali Pasha, të cilat lidhen me ndërtimin e këtij manastiri, dhe që ruhen atje, bashkë me të tjera [dokumente].

Vezir Ali Pasha
(Vulë)
Ju romej të nahijes së Beratit, myzeqarë dhe vllehë grabovarë, fshatra dhe çifligje, ju shpall se kam krijuar kështill që të më ndërtojë manastirin e Plakut Kozma; kam ndihmuar unë me aspra, të ndihmoni edhe ju, si t'ju thotë dhespoti, që të ndërtohet manastiri; kush nuk ndihmon, do të më prishë hatërin dhe më pas ka për ta paguar dyfish; siç ju urdhëroj, kështu të bëni dhe të zbatoni vendimet. 12 shtator 1813, Gjirokastër.

Si dhe urdhëresa tjetër:
Aliu
Hair paçi ju lutës të mitropolitit të Beratit, Koli Mitros dhe Haxhi Jankos. Ju ngjatjetoj dhe ju bëj me dije se i kuptova sa më shkruani, ndaj u qartësova edhe nga igumeni, u gëzova shumë që u bëtë mukajet për Plakun Kozma. Prandaj vjen tani për atje igumeni dhe Nikolla, bashkë me kryemjeshtrin, dhe të ndërtoni odat dhe kullën e manastirit, të bëhet më i ploti se gjithë manastiret, dhe kur të vij andej, do të vij atje dhe dua ta gjej gati. Vetëm të punoni të gjithë dhe ta ndërtoni të gjithë ju romej të Beratit, të ndihmojnë të vegjël e të mëdhenj. Do t'i shkruaj Ibrahim Arapit t'ju japë ndihmë në çdo punë. Siç shkruaj, kështu të bëni, dhe qofshi me shëndet. 1814, 12 shtator. Janinë.

4. Manastiri i së Tërëshenjtës, Zvërnec
Manastiri i hirshëm i ndërtuar në një ishull të madh që ndodhet brenda liqenit të Artës në zonën e Vlorës, jo larg bregut të Adriatikut, është i stolisur prej emrit të Ungjillëzimit të së Përmbishenjtës sonë Hyjlindëse, i quajtur dhe "i së Tërëshenjtës së Zvërnecit".
Ky manastir i hirshëm ndodhet thuajse dy orë larg qytetit të Vlorës, që ndodhet në jug-lindje të manastirit, kurse nga Arta është një orë e gjysmë larg. Kurse nga fshati Sembet apo Zvërnec, i cili ndodhet në lindje të manastirit, është gjysmë ore larg. Përballë manastirit, jo fort larg, ndodhet ishulli Sason, apo Akronez, sipas historiografëve bizantinë, sot i quajtur Sazan dhe Sazanos. Thuhet nga të vjetrit e atyre anëve se të krishterët e fshatit Zvërnec më parë banonin në ishullin Sazan, por atje i shqetësonin piratët që vazhdimisht vinin me anije, mësynin dhe u bastisnin arat, banesat dhe bagëtinë. Prej kujdesit njerëzor u pranuan nga etërit e manastirit të Zvërnecit, ndaj dhe braktisën ishullin, banesat dhe pronat, duke u vendosur për të banuar pranë manastirit. Pas ca kohësh u ngulitën përballë manastirit, aty ku ndodhet fshati i tyre, duke ndërtuar banesat në tokat e manastirit, të cilat ua dhanë etërit, me leje të kryepriftit.
Tempulli i këtij manastiri është ndërtuar me tre absida dhe dy gjysmëapsida, është i pikturuar, dhe nga mënyra e ndërtimit duket se u përket viteve të perandorëve të Bizantit.
Ishulli në të cilin është ndërtuar manastiri laget nga të gjitha anët prej liqenit në të cilin ndodhet, kurse ata që ushtrohen në manastirin e hirshëm komunikojnë me tokën përmes varkave. Me po këtë mënyrë vijnë e shkojnë edhe pelegrinët, sa herë vijnë tek kjo strehë e hirshme.
Jo fort larg këtij manastiri ndodhet limani i vogël i quajtur Porto Novo, ku futen për t'u ruajtur nga furtuna anijet tregtare që lundrojnë në Adriatik, sidomos anijet e ishujve Oton që ndodhen pranë Korfuzit. Kapedanët dhe detarët [e ishujve Oton], duke pasur nderim të pafund dhe shpresëtari për

manastirin e Zvërnecit, krijuan dhe mbajtën për shumë vite në atdheun e tyre një arkë në emër të së Tërëshenjtës Hyjlindëse të Zvërnecit, ku kontribuonin me shpresëtari të pakrahasueshme prej të krishteri dhe patrioti, duke mos u kufizuar vetëm në dhuratat monetare, por edhe duke dhuruar sende të argjendta dhe rroba priftërore, fort të dobishme për tempullin e hirshëm, si dhe duke e furnizuar edhe me sasinë e nevojshme të qirinjve dhe llambadheve, kohë pas kohe. Këto dhurata dhe kontributet vullnetare u ndalën, fatkeqësisht, para ca kohësh. Kështu që shpenzimet e nevojshme të këtij tempulli dhe të manastirit përballohen prej atyre pak pronave dhe prej kontributeve vullnetare të banorëve të zonës, si dhe të të krishterëve që vijnë në Vlorë për tregti.
Në dyshemenë e tempullit të hirshëm të manastirit ndodhet një pllakë, mbi të cilën janë gdhendur këto germa:

*KOIYTO*ΣEI*U*TAY
ΘAKΛPAT*SAC* • *PIP*
KATAI + Γενῖα *ACCPI*
ζηρ Θῷν εξευΓεμηβ +
Θῦτελε TŦωνοσTΔΩ +
+ KI[14]

5. Manastiri i Shën Theodhorit në Kadipashaj
Kisha famullitare në fshatin Kadipashaj të zonës së Myzeqesë së Madhe është ndërtuar nën emrin e Shën Theodhorit të Tironit përpara shumë vitesh, gjatë ditës së kujtimit të Shenjtorit. Pas vërshimit të pelegrinëve nga zona të ndryshme të Beratit dhe të zonës së Durrësit aty pranë, të cilët me lavde dhe shpresëtari shkonin tek ajo kishë, mori emrin manastir, po gjë tjetër nuk kemi për të shtuar.[15]

6. Manastiri i Shën Trifonit të Sheqishtës
Në fshatin Sheqishtë të zonës së Myzeqesë së Vogël, në një kodër të vogël ndanë liqenit të Belinës, pothuaj përpara njëzet vitesh një vajze shtatëvjeçare i shfaqej shumë herë dhe në mënyrë të përsëritur në ëndërr një kalorës në moshë adoleshenti, i quajtur Trifon nga Zoiria. Ky i tregoi vajzës banesën e tij dhe e këshilloi që po të gërmonte thellë në një vend të caktuar, do ta gjente.
Me këto të thëna dhe këshilla të të panjohurit, prifti famullitar, Dhimitri, nën drejtimin e vajzës, gërmoi në vendin që i tregoi ajo, dhe u gjet një varr i vjetër, sindonja tre pashë nën dhe, mbuluar në mënyrë të sigurt prej harqesh prej qeramike, ku ndodheshin eshtrat e Shën Trifonit nga Zoiria. Këto sot ndodhen në tempullin e hirshëm, i cili që prej asaj kohe është ndërtuar në atë vend me kontributin e të krishterëve të bekuar, të cilët së bashku ndërtuan edhe qelitë e nevojshme për banim, duke e emërtuar Manastir të Shën Trifonit.
Sipas traditës që dëshmohet prej paraardhësve, banorët e atjeshëm të fshatit Sheqishtë, Novoselë dhe fshatrave përreth, në anën perëndimore të manastirit, përpara viteve që s'mbahen mend, ekzistonte një manastir mbi kodrën që shquhet me sy, i stolisur me emrin e shenjtë të Metamorfozës së Zotit tonë Jezu Krisht.[16]
Në atë vend edhe sot dallohen rrënoja që dëshmojnë ekzistencën e një qyteti të vjetër, si dhe janë gjetur edhe shumë monedha të vjetra helene dhe romake. Me gjasë gjatë viteve të para të krishterimit, ose menjëherë pas tyre, ka ekzistuar manastiri i përmendur, dhe më pas, në kohë trazirash, apo dhe gjatë dëbimeve të të krishterëve, është shkatërruar.

[14] Th. Popa., *Mbishkrime*, fq. 145-146 (shënim i përkthyesit).
[15] Thuhet se një i krishterë nga Myzeqeja që quhej Dano, shkoi në Konstandinopojë. Në ëndërr pa Shën Theodhorin, i cili e urdhëroi që të kthehet në mëmëdhé dhe të gërmojë në aksh vend, pasi atje kishte për të gjetur shenjën ku duhej të themelonte dhe të ndërtonte një kishë. Kështu që u kthye, gërmoi vetë në vendin ku duhej, gjeti një kryq të madh prej bakri (i cili ruhet deri në ditët tona), dhe aty u ndërtua kisha.
[16] Në kohën e gjetjes së relikeve të shenjta, siç përmendëm, paraardhësi ynë (Joasafi II i Beratit, shënim i përkthyesit) u pati thënë shumë vetëve, si dhe edhe Patriarkanës i kishte shkruar, se pat dëgjuar prej paraardhësve të tij, Metodit dhe Joasafit, për ekzistencën në atë vend të një manastiri të Metamorfozës së Shpëtimtarit; por këtë vetëm e kishte dëgjuar.

DO NOT COPY

Në martirologët e Kishës sonë ortodokse të lindjes shënohet një Trifon i martirizuar me varje në shelg, i cili festohet më 19 të muajit dhjetor.
Fshati ku u gjetën eshtrat e këtij shenjtori quhet në shqip Sheqishtë, i cili përkthyer në greqisht do të thotë "vend ku ka shumë shelgje"[17], duke dhënë shkas për të menduar, pas gjetjes së relikeve, se ky është vendi ku u martirizua shenjtori, pasi në këtë vend janë të shumtë drutë e shelgjeve, prej nga ku ka marrë dhe emrin.
Për këtë temë nuk mundem të japim ndonjë mendim, pasi teksa lexojmë në sinaksarin e Nikodhimit, në botimin e ri, se dëshmori Trifon, për të cilin bëhet fjalë, nuk ishte me prejardhje nga ndonjë Itea, por u var në një dru shelgu.
Stefan Bizantini dhe Straboni përmendin një qytet me emrin Itea në zonën e Atikës, banuar nga fisi i Akamantëve (Λεξικῷ Ἱστοριογραφικὸ τῶν κυρίων ὀνομάτων ὑπὸ Ν. Λωρέντη καὶ Ῥεφερενδάρι / Fjalor Historiografik i Emrave të Përveçëm, nga N. Lorenti dhe Referendari, fq. 237), ku, gjithashtu, hasim dhe një Theodhor peshkop të Iteas shënuar në aktet e Sinodeve të Hirshëm, vëllimi II, fq. 930, përgatitur nga S. Milia, botuar në Paris.

7. Manastiri i Shën Nikollës së Palekishtës.
Mes fshatrave Kamçishtë dhe Palekishtë ndodhet manastiri i hirshëm që nderon emrin e atit tonë ndër shenjtorët Nikolla, pothuaj një orë larg Beratit. Ky manastir ka tërhequr respektin dhe shpresëtarinë e banorëve, të cilët shkojnë atje veçanërisht gjatë pranverës. Shumë prej tyre marrin pjesë familjarisht në shërbesat kishtare, duke qëndruar atje gjatë festave, kurse gjatë ditës argëtohen dhe shtrojnë gosti në qilimat e lulëzuar e të bleruar, nën hijet e pemëve, në kohën kur lulëzimit dhe hijeshisë së natyrës sipër u qëndron ushtria e bilbilave dhe gjithfarë lloj zogu, duke rrethuar gjindjen dhe duke bërë garë njëri me tjetrin nëpërmjet cicërimave të tyre se kush t'i gëzohet më shumë natyrës. Pastaj në mbrëmje pelegrinët kthehen në vatrat e tyre.

Përktheu: Sokol Çunga

[17] Në greqisht emri i drurit të shelgut është "ιτέας", përkthyer shqip "shelg", prej nga vjen toponimi Sheqishtë (shënim i përkthyesit).

DO NOT COPY



Fig. 1. Manastiri i Ardenicës



Fig. 2. Kisha e manastirit të Ardenicës



Fig. 3. Manastiri i Apolonisë



Fig. 4. Kisha e manastirit të Apolonisë



Fig. 5. Manastiri i Kolkondasit



Fig. 6. Kisha e manastirit të Kolkondasit

DO NOT COPY



Fig. 7. Manastiri i Zvërnecit



Fig. 8. Kisha e manastirit të Zvërnecit

Sokol ÇUNGA
Archivist, paleographer

A DESCRIPTION OF THE METROPOLY OF BERAT FROM ANTHIMOS ALEXOUDES AS A HISTORICAL SOURCE

One of the most important historical sources of the 19th century that gives information about the tangible and intangible cultural heritage of Central and South Albania is a publication very well-known for the researchers of that period, "Description of the Holy Metropoly of Berat and of the Regions Under its Auspices", written by Anthimos Alexoudes, metropolitan of the Holy Metropoly of Berat. The text was compiled by the metropolitan while he was on the throne of the Metropoly of Berat and was printed in Corfu in 1868 at the printing house "Ionia" of the Kaon Brothers. The text is printed in 158 pages of 21 cm, in fifteen chapters that describe the geographic position of the ecclesiastical province of Berat; the bishoprics that existed before in Berat; the regions that compile the province of Berat; the monasteries and the borders of the Metropoly; the canonic rank of the Metropoly; the history of Christianity in the region; the holy relics preserved in the Metropoly; the manuscripts of Berat; the saints that lived there; the archpriests; official documents regarding the ecclesiastical and civil life of the Metropoly; the ranks of the Metropoly of Berat according to the Canonic Law; the history of the Metropoly of Durrës, Gora and Mokra; different aspects of the social conditions of the inhabitants of the region.

During those 32 years in the throne of the Metropoly seems that Anthimos Alexoudes was in love with the region, the heritage and the people. Except the aforementioned book, Alexoudes also spent much time studying and cataloguing the collection of the byzantine and postbyzantine manuscripts that were found in Berat, being the first cataloguer of that collection, partly still preserved until nowadays.

"Description of the Holy Metropoly of Berat and of the Regions Under its Auspices" is an important source for all those that need to study and illustrate the history of the Central and Southern Albania in the period of antiquity, medieval and renascence. Since this book is written in Greek, we are publishing here the Albanian translation of the Chapter IV that describes the monasteries of the Metropoly of Berat.

DO NOT COPY

Renald META

OBJEKTET E PUNUARA NË STELAT FUNERARE TË PERIUDHËS KLASIKE DHE HELENISTIKE TË APOLONISË DHE EPIDAMN-DYRRAHUT

DO NOT COPY

Stelat funerare përbëjnë një kategori të materialit arkeologjik me shumë interes. Ato nuk janë gurë të thjeshtë varri dhe studimi i tyre sjell shumë të dhëna të vlefshme në njohjen e botës antike. Nga shumë drejtime të ndryshme që mund të trajtohet një stelë, trajtimi i objekteve që janë punuar në relievet sepulkrale është një nga ato më me rëndësi, për vetë domethënien që merr stela bashkë me to. Por çfarë e bën një stelë funerare kaq kuptimplotë dhe funksionale?

Si munden objektet, që janë të paaftë për t'u shprehur, të ndihmojnë në të kujtuarit? Njerëzit shpenzojnë kohë, pasuri e energji në varre dhe i vizitojnë ato shpesh. Në një stelë, çdo gjë është në vendin që i takon dhe gjithçka ka kuptimin e vet, sikurse edhe në ditët e sotme e shohim qartësisht diçka e tillë, në të njëjtin kontekst.

Nga Apolonia dhe Epidamn-Dyrrahu janë gjurmuar për këtë shkrim në tërësi 16 stela, të datuara në periudhën klasike dhe helenistike dhe që përmbajnë objekte në sipërfaqen e tyre. Stelat apoloniate janë të gjendura në disa muze të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit, por ato ruhen edhe në forma të ripërdorura. Nga ana tjetër, stelat epidamnase ruhen të ekspozuara në Muzeun Arkeologjik Durrës.

Në stelat e Dyrrahut shohim qartë ndikimin e traditës atikase në punimin e objektit funerar[1], ku për nga forma arkitekturore gjejmë paralele të shumta në stelat e periudhës klasike e helenistike të Athinës[2]. Stelat atikase kanë të inkuadruar skenën brenda një hapësire *naiskoi* të thjeshtë, ndërsa në anë janë kolonat arkitektonike. Kulmi i stelës ka formën e pedimentit tempullor, të zbukuruar me akrotere. Stelat e Apolonisë paraqiten më të ndërlikuara në traditën e punimit dhe në to shohim ndikimin atikas[3], atë tarentin me *naiskoi*-n tipik[4], ndikimin nga Greqia perëndimore me motivin e gjethes së lisit[5], ndikimin nga Greqia lindore, Maqedonia dhe Azia e Vogël[6].

Ndikimi i traditave të ndryshme duket edhe në zgjedhjen e skenave të gdhendura dhe sigurisht në

[1] Bergmann, J., "Griechische Grabreliefs im südischen Illyrien/ Relieve varresh greke në Ilirinë e Jugut", *Iliria,*1989, 2, Tiranë, f. 121

[2] Shih për stelat atikase në Margariti, K., "On identifying the deceased in two-figured and multi-figured scenes of classical Attic funerary reliefs", *Journal of Greek Archaeology*, 2010, 2, f. 177-192

[3] Pojani, I., "Dy relieve Apoloniate me temë divine / Two Reliefs from Apolonia", *Iliria* 1997, f. 206

[4] Bergmann, J., „Griechische Grabreliefs im südischen Illyrien / Relieve varresh greke në Ilirinë e Jugut", *Iliria,*1989, 2, Tiranë, f. 118-120

[5] Pojani, I., '"Relieve të stelave funerare apoloniate të periudhës klasike dhe helenistike / Reliefs des stèles funéraires d'Apollonie d'Illyrie dans la période classique et hellénistique'', *Iliria,* 1997, Tiranë, f. 211-214

[6] Bergmann, J., „Griechische Grabreliefs im südischen Illyrien / Relieve varresh greke në Ilirinë e Jugut", *Iliria,*1989, 2, Tiranë, f. 117; Alamani-Souri, K.., ''ΕΠΙΤΥΜΒΙΕΣ ΣΤΗΛΕΣ ΚΑΙ ΜΝΗΜΕΙΑ ΑΠΟ ΤΗ ΒΕΡΟΙΑ ΚΑΙ ΤΗΝ ΠΕΡΙΟΧΗ ΤΗΣ'', Tezë doktorature në Univeristetin e Thesalisë, 2008, Thesali, f. 481; 501; Heuzey, L. dhe Daumet, H., ''Mission archéologique de Macédoine 1976'', 1876, Paris

objektet që përfshihen në to.

STELAT E APOLONISË

Stelat me origjinë nga Apolonia gjenden sot të shpërndara në muze të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, disa i gjejmë të ripërdorura (spolie), ndërsa një stelë është e humbur[7]. Më poshtë jepen disa të dhëna për stelat.

1. Stela me figurë femërore – MAA

Kjo stelë (Tab. A - 1) ndodhet në MAA, ku ruhet vetëm një fragment. Ajo është e punuar në gur gëlqeror dhe ka një lartësi të ruajtur prej 24 cm, gjerësi 16.5 cm, trashësi maksimale 7.5 cm dhe një thellësi të punimit deri në 2 cm.

2. Stelë. Zbritja në Hades – MAA 5030

Stela (Tab. A - 2), që daton në periudhën helenistike është e ekspozuar në ambientet e jashtme të MAA. Relievi është punuar në gur gëlqeror dhe ruhet në lartësinë 204 cm, gjerësinë 53 cm, trashësi maksimale 20 cm dhe thellësi punimi deri në 7 cm.

3. Stelë. Lapardha (Berat) – MAT 14503

Kjo stelë (Tab. A - 3) ekspozohet në MAT. Ajo ka një lartësi të ruajtur deri në 83 cm, gjerësi 63 cm, trashësi 25 cm dhe thellësi punimi 16 cm. Stela, që datohet në shek. III p.e.s.[8] është gjetur në Laparadha të Beratit, ndërsa mendohet të jetë një material importi nga Atika[9].

4. Stela e Falakrës dhe Neagenës – MHK 1149

Objekti (Tab. A - 4) është pjesa e sipërme e stelës së plotë në gur gëlqeror, që ndodhet në MHK dhe daton në shek. III p.e.s..[10] Dikur ky objekt ka qenë i ripërdorur si material ndërtimi në shtëpinë e Juan Mitrit në Pojan[11]. Stela ruan një lartësi deri në 102 cm, gjerësi 65 cm, trashësi 20 cm dhe thellësi të punimit deri në 5 cm.

5. Stelë varri me tre kate – MHK 1229

Stela (Tab. A - 5) ndodhet në MHK, është e punuar në gur gëlqeror dhe është stela me përmasat më monumentale e gjetur deri më sot[12]. Ajo ruhet deri në lartësinë 222.5 cm, gjerësinë 57 cm, trashësinë 26 cm dhe ka një thellësi punimi deri në 12 cm. Kjo stelë daton në shek. III-II p.e.s.[13]. Stela ka tre kate, ku zhvillohen tre skena të ndryshme. Të tre katet kornizohen nga kolona korintike, duke dhënë kështu tre *naiskoi*[14].

6. Stela me kavalier[15] në këmbë – FAIA 40

Vendgjetja e stelës është Apolonia, gjë që sinjalizohet nga Praschniker, i cili e kishte parë të ruhej në Lushnje[16]. Stela (Tab. B - 6) është prej materiali guri gëlqeror dhe ruhet në FAIA në vetëm një nga tre fragmentet që e kishte parë Praschnikeri. Lartësia e ruajtur është 42 cm, gjerësia 34 cm, trashësia 12.5 dhe me një thellësi punimi maksimale 6.5 cm. Stela daton në shek. III-II p.e.s.[17].

7. Stelë me kavalier të shaluar – MLV Ma837

Kjo stelë (Tab. B - 7) gjendet sot në fondet e Muzeut të Luvrit, në Francë dhe është sjellë aty nga Léon Heuzey në fund të shek. të 19-të. Ajo është e punuar në gur gëlqeror dhe ruhet në një lartësi masimale 64 cm, gjerësi 60 cm, trashësi 9.5 cm dhe me një punim relievi deri në 5 cm. Stela daton në shek. IV p.e.s.

8. Stelë varri e Parmeniskos (Grabstele des Parmeniskos) – KMW 1024 A. I

Stela e Parmeniskos (Tab. B - 8) ndodhet në ambientet e Kunsthistorisches Museum në Vjenë të Austrisë. C. Patsch, kur vizitoi Shqipërinë në vitin 1903 e pa stelën të murosur në portën e hyrjes së Manastirit të Shën Mërisë, Apoloni[18]. Stela është prej guri gëlqeror dhe ka një lartësi prej 108 cm, gjerësi 55 cm dhe trashësi 24 cm[19].

9. Stelë funerare (spolie) – MSHM

Relievi (Tab. B - 9) ndodhet i murosur në murin sipër hyrjes së MAA. Stela është e punuar në gur gëlqeror dhe ka një lartësi maksimale deri në 72 cm dhe gjerësi 37 cm. Në tre fragmentet që stela gjendet e murosur, ikonografia paraqitet në dy prej tyre, ndërsa fragmenti i tretë (sipër, majtas) s'ka shenja të punimit të relievit (mundet që ky fragment të mos jetë pjesë e stelës). Duke parë ikonografinë dhe stilin e punimit, edhe kjo stelë duhet të datohet në periudhën helenistike.

10. Stelë funerare (spolie) – Kisha e Ungjillizimit, Kozare

Në apsidën e kishës së Ungjillizimit në fshatin Kozare të Kuçovës është ripërdorur një fragment i një stele funerare apoloniate si material ndërtimi (Tab. B - 10). Fragmenti është i punuar në gur gëlqeror, me një lartësi deri në 78 cm dhe gjerësi 58 cm.

11. Stela e Erakleidës me tre personazhe (e humbur)

Kjo stelë (Tab. B - 11) është tashmë e humbur, ndërsa deri në vitin 1903 gjendej e murosur në kishën e Fierit, ku Patsch e kishte parë të vendosur në mes të dy kolonave jonike. Sipas tij, lartësia e stelës shkonte deri në 65 cm, ndërsa gjerësia 46.5 cm[20]. Stela është e punuar në formën e një *naiskoi* me dy kolona dorike dhe daton në shek. III p.e.s.[21].

STELAT E EPIDAMN-DYRRAHUT

Nga Epidamn-Dyrrahu kemi në tërësi pesë stela funerare, që janë në fokus të këtij punimi. Të gjitha stelat ruhen në Muzeun Arkeologjik Durrës.

12. Stela funerare e Titit të Teimenit – MAD 2372

Stela (Tab. C - 12) që vjen nga nekropoli i Kokomanes[22], është e punuar në mermer dhe ruhet në një lartësi prej 82 cm, gjerësi 39 cm, trashësi maksimale 13 cm dhe thellësi maksimale të punimit 5 cm. Në pjesën e poshtme është punuar mbishkrimi në greqisht, që i jep emrin stelës dhe formula përshëndetëse. Stela daton në shek. II p.e.s.[23].

---

[7] Stelat do të paraqiten këtu në formë të koduar, me shkurtimin e vendodhjes dhe numrin e inventarit të secilës.
Këto janë shkurtimet për vendodhjen e tyre:
MAA – Muzeu Arkeologjik Apoloni
FAA – Fondet Arkeologjike Apoloni
MAD – Muzeu Arkeologjik Durrës
MHK – Muzeu Historik Kombëtar
MAT – Muzeu Arkeologjik Tiranë
FAIA – Fondet Arkeologjike të Institutit të Arkeologjisë
MSHM – Manastiri i Shën Mërisë, Apoloni
KMW – Kunsthistorisches Museum Wien
MLV – Muzeu i Luvrit

[8] Ceka, N., "*Archaeological Treasures from Albania*", 2010, I, Tiranë, f. 201

[9] Ceka, N., "dans Albanien... , no. 325, f. 41 – vepër e cituar nga Pojani I., "Histoire de la publication et de la découverte et des sculptures d'Apollonia", *Apollonia d'Illrie 1. Atlas Archeologique et Historique*, 2007, f. 124

[10] Një datim më i ngushtë është sugjeuar nga Pojani, në Pojani I., 1997, 220. Autorja, bazuar në grafinë e stelës shtyn datimin në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. III dhe fillimin e shek. II p.e.s.

[11] Praschniker, C., dhe Schober, A., "*Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*", 1919, Wien, f. 71-72

[12] Pojani, I., "Histoire de la publication et de la découverte et des sculptures d'Apollonia", *Apollonia d'Illrie 1. Atlas Archeologique et Historique*, 2007, f. 122. Sipas autores, kjo është një stelë pa paralele në artin funerar, ndërsa si tip është e panjohur në periudhat klasike dhe helenistike si në Italinë e jugut, edhe në Greqi. Stela të këtij tipi (përfshin edhe stelën e "Zbritjes në Hades") njihen në Bitini, ku relievet ndahen nga ato apoloniate nga cilësia e dobët, mungesa e disa detajeve të arkitekturës dekorative dhe varfëria e temave ikonografike. Mjeshtrat apoloniatë që e kanë punuar, kanë dhënë një formë të re arkitekturore të *naiskos*-it, ku zhvillohen programe ikonografike të huazuar nga mitologjia dhe jeta e përditshme

[13] Bergmann, I., "Griechische Grabreliefs im südischen llyrien/Relieve varresh greke në Ilirinë e Jugut", Iliria,1989, 2, Tiranë, f. 117. Autori sheh mundësinë e datimit deri në harkun kohor të shek. II p.e.s., duke u nisur nga format e shkronjave në mbishkrimet në stelë

[14] Shihen elemente të shek. IV-III p.e.s. dhe ndikimi i *naiskos*-ëve të Tarentit

[15] Pojani, I., "Dy relieve Apoloniate me temë divine/Two Reliefs from Apolonia'', *Iliria* 1997, f. 224 shpjegon përdorimin e termit ''kavalier'' në vend të ''kalorës''. Sipas autores, termi "kalorës" përdoret vetëm për periudhën e mesjetës, duke filluar nga shek. XI, ndërsa termi "kavalier" përdoret për periudhën e antikitetit.

[16] Praschniker, C., 1920, f. 165-166 (vepër e cituar në Pojani, I., "Dy relieve Apoloniate me temë divine/Two Reliefs from Apolonia", *Iliria* 1997, f. 222)

[17] Pojani, I., "Dy relieve Apoloniate me temë divine/Two Reliefs from Apolonia", *Iliria* 1997, f. 222-223

[18] Patsch, C., "Das Sandshak Berat in Albanien", 1904, Wien, f. 159-160 (i shfrytëzuar versioni i daktilografuar në shqip)

[19] Kunsthistorisches Museum Wien (https://www.khm.at/objektdb/detail/50025/?offset=0&lv=list) (vizituar më 28 mars 2020)

[20] Patsch, C., "Das Sandshak Berat in Albanien", 1904, Wien, f. 148-149

[21] Pojani, I., "Dy relieve Apoloniate me temë divine / Two Reliefs from Apolonia", *Iliria* 1997, f. 217-218

[22] Toçi, V., "Inscriptions et reliefs de la necropole de Dyrrah (Dyrrhachium)", *Studia Albanica*, 2, 1965, f. 52-53

[23] Cabanes, P., dhe Drini, F., "Etudes Epigraphiques 2 : Corpus des Inscription greques d'Illyrie meridionale et Epire

DO NOT COPY

13. Stela funerare e Erosit të Alkinosit – MAD 4121
Stela (Tab. C - 13) e quajtur e Erosit sipas mbishkrimit[24] është punuar në gur gëlqeror dhe datohet në shek. II p.e.s., ndërsa ruhet mirë me një lartësi maksimale 59 cm, gjerësi 38 cm, trashësi maksimale 8 cm dhe thellësi të punimit të relievit deri në 4 cm.

14. Fragment stele funerare – MAD 4401
Kjo stelë ruhet e fragmentuar (Tab. C - 14), me një lartësi prej 137 cm, gjerësi 92 cm, trashësi maksimale 30 cm dhe thellësi të punimit deri në 27 cm. Stela daton në shek. V p.e.s.

15. Fragment stele funerare – MAD 4906
Stela (Tab. C - 15) ruhet në lartësinë 50 cm, gjerësinë 35.5 cm, me trashësi maksimale 13 cm dhe thellësi të punimit të relievit deri në 7 cm. Ajo daton në shek. IV p.e.s.[25], ndërsa është në fakt stela me punimin artistik më të arrirë në stelat e trajtuara këtu nga Dyrrahu.

16. Stela funerare e Kritodamit – MAD 2773/3510[26]
Stela e Kritodamit (Tab. C - 16) është gjetur në Shetaj[27], e ruajtur në lartësinë prej 67 cm, gjerësinë 50 cm, trashësinë maksimale 14 cm dhe thellësi punimi të relievit deri në 5.5 cm. Ajo është e punuar në mermer dhe daton në shek. V-IV p.e.s[28].

KATEGORIZIMI DHE PARAQITJA E OBJEKTEVE

Janë në tërësi 76 objekte të identifikuara në 16 stelat e shqyrtuara. Raporti i numrit të stelave që vijnë nga Apolonia me numrin e atyre që vijnë nga Durrësi shihet edhe në numrin e objekteve të paraqitura në relieve. Ky numër për stelat apoloniate është pothuajse gjashtë herë më i lartë se ai për stelat e Epidamn-Dyrrahut. Gjithashtu, edhe kategoria e objekteve që paraqiten në stela është e ndryshme për të dy qytetet, ku ka një shumëllojshmëri të natyrave në stelat apoloniate, ndërsa më monotone paraqitet nga ana tjetër natyra e objekteve të stelave dyrrakione.

Të gjithë objektet mund të ndahen në këto kategori:
I.Armë, objekte luftarake dhe sende të lidhura me luftën (25) [tab. I];
II. Mobilje dhe sende shoqëruese (39) [tab. II];
III.Enë (5) [tab. III];
IV.Objekte të tjera (7) [tab. IV].

Zbritja në Had MAA 5030. Kjo stelë ka të punuara në reliev pesë objekte: skeptri i Hermesit, shkalla në të cilën zbret i ndari nga jeta, varka me një rremë ku pret Karonti, *bathron*-i ku qëndron i ulur gjykatësi dhe kamzhiku që ky i fundit mban në dorë. Duke parë natyrën e skenës, objekt interesant është ulësja e gjykatësit. Ky është një lloj stoli, ku mund të ulesh e të vësh këmbët ose mund të përdoret për t'u ngritur diku. Kështu, gjykatësi qëndron me këmbët gjysmë të shtrira në *bathron* dhe i mbështetur në krahun e majtë.

Stela me figurë femërore MAA. Nga ky fragment i stelës së plotë arrijmë të shohim një *diphros*, i cili ruhet jo i plotë. Në bazën e uljes së *diphros*-it është edhe një *proskefalaion*[29].

Stelë me kavalier në këmbë FAIA 40. Në reliev janë tre objekte: mburoja e rrumbullakët me simbolin e rrufesë, heshta që ruhet vetëm në pjesën e sipërme të anës së djathtë të stelës dhe frerët e kalit. Kjo lloj skene dhe prania e këtyre objekteve nuk është diçka e pazakontë për relievet apoloniate[30].

I", 1995, f. 72
[24] Cabanes, P., dhe Drini, F., 1995, po aty.
[25] Bergmann, J., "Griechische Grabreliefs im südischen Illyrien / Relieve varresh greke në Ilirinë e Jugut", *Iliria*,1989, 2, Tiranë, f. 116
[26] Numri i inventarit 2773 është i regjistrit në MAD, kurse numri 3510 në botimin e Cabanes, P.,dhe Drini, F., 1995, f. 71
[27] Cabanes, P. dhe Drini, F., "*Etudes Epigraphiques 2 : Corpus des Inscription greques d'Illyrie meridionale et Epire I*", 1995, f. 71
[28] Bergmann, J., "Griechische Grabreliefs im südischen Illyrien / Relieve varresh greke në Ilirinë e Jugut", *Iliria*,1989, 2, Tiranë, f. 104
[29] Pritchett, W. K., dhe Pippin, A., "The Attic Stelai", *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens*, 1956, f. 216
[30] Ngjashmëri gjejmë me objektin në FAIA me nr.inventari 13 dhe objektin në MAT me nr.inventari 1116. Në të dy objektet paraqitet një kavalier më një heshtë në njërën dorë dhe me mburojë në tjetrën. Ndryshimi qëndron se në këtë stelë kavalieri është në këmbë, ndërsa në dy objektet e sipërpërmendura, kavalieri qëndron mbi kalë

Stelë me kavalier të shaluar MLV MA 837. Këtu gjejmë dy objekte: një heshtë dhe një përkrenare. Heshta me dy anë është e tipit maqedonas, sikurse edhe përkrenarja me kreshtë të gjatë[31].

Stela, Lapardha (Berat) MAT 14508. Janë në tërësi nëntë objekte në këtë stelë. Në kategorinë e armëve dhe objekteve luftarake futet një mburojë e rrumbullakët me simbolin e rrufesë dhe një topuz. Në kategorinë e mobiljeve dhe sendeve shoqëruese hyjnë një karrige *thronos*[32] me një shilte *proskefalaion* dhe një *hypopodion,* një divan tip *kline*[33] i mbuluar me një *epibletia*[34] e një *proskefalaion* (jastëk) dhe dy tavolina (të tipit *trapeza* për atë pranë poçarit dhe *tripous* për atë me tre këmbë)[35]. *Trapeza* ka si mbështetje dërrasë të vendosur për së gjeri, ndërsa *tripous* ka këmbëza të zbukuruara si putra kafshësh. Në kategorinë e enëve futet vetëm një enë (me trup globular, me qafë të gjatë e të ngushtë dhe që zgjerohet në buzë), që qëndron në bazën e poshtme të *tripous*-it. Ndërsa në objektet e tjera kemi skeptrin e Hermesit dhe çarkun e poçarit. Paraqitja e çarkut këtu është diçka e veçantë, pasi gurgdhendësi e ka paraqitur atë në gjysmën e punës së poçarit, i cili është duke bërë një enë të madhe qeramike[36]. Tavolina *trapeza* është po një objekt i procesit të punës së poçarit.

Stela e Parmeniskos KMW 1024 Ant. I. Në pjesën e poshtme të stelës është vetëm një *kantaros*, ndërsa në friz, aty ku zhvillohet edhe amazonomakia, janë edhe objektet më të shumta. Të gjithë këto objekte hyjnë në kategorinë e armëve dhe objekteve luftarake. Kemi të punuara këtu gjashtë përkrenare, pesë mburoja, dy shpata, një topuz/sëpatë (?). Ky numër objektesh lidhet drejtpërdrejt me skenën e luftimit. Përkrenaret janë me xhufkë të gjatë të tipit athinas. Ndërsa për mburojat mund të thuhet se shihen dy tipe: një mburojë e rrumbullakët hoplite dhe një një tjetër me dy skaje të harkuara. Këtë të fundit e mban njëra prej amazonave, e cila ka edhe topuzin/sëpatën.

Stela e Falakrës dhe Neagenës MHK 1149. Në këtë stelë gjejmë vetëm objekte të kategorisë së enëve. Në tërësi janë tre objekte: dy *unguentarium* dhe një *kiliks*. *Unguentarium*-et prej qeramike janë të zakonshëm si dhurime varri në periudhën helenistike, ndërsa pasojnë *lekitos*-et e periudhës klasike në këtë aspekt[37]. Ndërsa *kiliks*-i, që është enë e pirjes së verës, do të duhet të lidhet me këtë veprim, që në këtë rast e bëjnë dy nga pëllumbat që ndodhen aty.

Stelë me tre kate MHK 1229. Stela është e veçantë për monumentalitetin e saj, por edhe për numrin e objekteve që janë të parqitura në të. Në katin e parë (duke filluar nga poshtë) kemi objekte luftarake (një kamë në mill, një heshtë, një mburojë, një përkrenare) dhe një *hypopodion*. Mbi h*ypopodion* qëndrojnë dy personazhet e këtij kati. Djaloshi i ri mban në brez një kamë të futur në mill, ndërsa të vendosur vertikalisht ai mban heshtën, e cila mbështetet jashtë bazës së *hypopodion*-it dhe shkon deri në kufirin e sipërm të skenës. Mburoja, nga

[31] Patsch, C., "Das Sandshak Berat in Albanien", 1904, Wien, f. 156
[32] Andrianou, D., "*Late Classical and Hellenistic Furniture and Furnishings in the Epigraphical Record*", 2006a, f. 226
[33] Andrianou, D., "Late Classical and Hellenistic Furniture and Furnishings in the Epigraphical Record", 2006a, f. 232
[34] Pritchett, W. K. dhe Pippin, A., "The Attic Stelai", *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens*, 1956, f. 244-254
[35] Pritchett, W. K. dhe Pippin, A., "The Attic Stelai", *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens*, 1956, f. 241-242
[36] Kjo enë është trajtuar si një objekt bashkë me çarkun
[37] Anderson-Stojanovic, V. R., "The Chronology and Function of Ceramic Unguentaria", *American Journal of Archaeology*, 1, 1987, f. 109. Gjithashtu në këtë artikull mund të shihet një ngjashmëri e *unguentarium*-it të tipit B të paraqitur nga kjo autore me atë të punuar në stelën e Falakrës dhe Neagenës

DO NOT COPY

ana tjetër duket në sfond dhe është e tipit *thureos*, një mburojë tipike e periudhës helenistike[38]. Një paraqitje të ngjashme e gjejmë në një afresk në një stelë funerare në Muzeun Arkeologjik të Stambollit[39]. Paraqitja e personazhit në këtë stelë të ashtuquajtur të ‘’Salamamodes’’ është pothuajse e njëjtë, me veshje dhe me armë të njëjta. Përkrenarja, heshta dhe mburoja janë të të njëjtit tip me ato të të luftëtarit në stelën me tre kate. Këto objekte janë armë të një luftëtari *thorakitai*, luftëtar maqedonas, karakteristike për shek. III p.e.s.

Në katin e dytë gjejmë dy objekte; një *thronos* dhe një *hypopodion*. Në *thronos*-in e këtij kati qëndron ulur një grua, e cila mbështet këmbët në *hypopodion*. *Thronos*-i është i tipit me këmbë me bazë katërkëndore[40], është i punuar stilistikisht shumë bukur dhe i zbukuruar me motivin e volutave në dy anët e këmbëve. Mbështetësja e krahëve është e punuar po me të njëjtin stil, ndërsa ka formë paksa të lakuar. *Hypopodion*-i ka një lartësi të ulët, por shtrirje të gjerë horizontale po aq sa gjerësia e *thronos*-it. Këmbët e tij janë të shkurtra, të lakuara dhe të kthyera në formë s-je.

Në katin e tretë janë punuar dy *diphros*, dy *proskefalaion*, një *hypopodion* dhe një kuti bizhuterish. Të dy *diphros*-at janë këtu të pajisur me një *proskefalaion* dhe të mbuluar nga një mbulesë, që i mbulon ata pothuajse të gjithë, duke lënë zbuluar vetëm fundin e këmbëve të tyre. Ata kanë këmbë me bazë të rrumbullakët. *Proskefalaion*-i është i dallueshëm në punim dhe tregon se ai vendosej i veçantë nga trupi i *diphros*-it, ndërsa ky i fundit mbulohej. Kutia e bizhuterive ka një formë drejtkëndore, ndërsa ajo paraqitet e hapur dhe e drejtuar drejt personazhit femër nga një shërbëtor ose skllav. Ka një afërsi me skenën në stelën e Hegesos në Athinë,[41] ku Hegesos, personazhit femër i zgjatet një kuti bizhuterish nga shërbëtorja/skllavja e saj. Edhe paraqitja e kutisë është në pozicion ballor sikurse këtu. Megjithatë, ka një diferencë periudhash midis dy stelave dhe skenat kanë ndryshime mes tyre. *Hypopodion*-i këtu është interesant për vetë faktin që është përdorur si mbështetëse nga të dy personazhet kryesorë. Kjo ndodh edhe te dy personazhet e katit të parë të së njëjtës stelë, por ndryshimi qëndron në formë. Ky *hypopodion* është i shkallëzuar, i ulët në vertikalitet dhe ka shtrirje horizontale nga njëri *diphros* te tjetri. Këmbët i ka sikurse *hypopodion*-i i katit të dytë.

Stela funerare (spolie) në MSHM. Nga kjo stelë, fragmentet e të cilës janë murosur në murin e MSHM kemi vetëm një objekt, që duhet të jetë një *diphros*. Në fakt, në këtë përfundim mund të dilet duke parë pozicionin e personazhit të ulur, figura e të cilit nuk ruhet për fat të keq e plotë. Lartësia e trupit të tij të ulur sjell mendimin e pranisë së *diphros*-it në reliev. Gjithashtu, kjo formë paraqitjeje ka ngjashmëri me atë në stelën 4906 MAD. Në të dyja stelat janë tre personazhe, ku dy janë në këmbë dhe një në anën e majtë gjendet i ulur në një *diphros*.

Stelë funerare (spolie) në apsidën e kishës së Ungjillizimit në Kozare. Në skenën qendrore të stelës dallohen dy *diphros*-a me nga një *proskefalaion* secili dhe një *hypopodion*. *Diphros*-at janë të mbuluar me një copë rrobë nga sipër, ndërsa për shkak të mosruajtjes së plotë të stelës nuk mund të dallohet pjesa e poshtme e tyre për të kuptuar formën dhe dekorimin dhe formën e bazës së këmbëzave. Ndërsa për *hypopodioni*-n nuk mund të thuhet asgjë për formën, pasi dëmtimet nuk e lejojnë njohjen e saj.

[38] Plutarch, *Life of Philopoemen*, 9

[39] Shih në faqen e internetit të “İstanbul Arkeoloji Müzesi” (Muzeu Arkeologjik Stamboll) - http://www.istanbularkeoloji.gov.tr/ (vizituar më 13 prill 2020). Ndërsa imazhi mund të gjehet në faqen tjetër të internetit - https://www.livius.org/pictures/lebanon/saida-sidon/sidon-museum-pieces/sidon-funerary-stele-of-salmamodes/ (vizituar më 13 prill 2020)

[40] Richter, G. M. A., “The Furniture of the Greeks, Etruscans and Romans“, 1962, London, f. 50

[41] Faqja në internet – Muzeu Arkeologjik Kombëtar, Athinë: https://www.namuseum.gr/en/collection/klasiki-+ (vizituar më 04 maj 2020)

Stela e Erakleidës (e humbur). Stela është e humbur tashmë dhe kemi të ruajtur vetëm një vizatim të objektit[42]. Aty mund të vërejmë qartë *hypopodion*-in në formë kutie me katër këmbë, ndërsa tipi i ulëses është një stol *diphros*, që është i mbuluar nga një copë rrobë sipër. Nuk mund të thuhet asgjë në lidhje me tipin e këmbëzave të *diphros*-it, pasi nuk mund të dallohen detaje të imëta.

Fragmenti i stelës MAD 4401. Në të është trajtuar vetëm një *klismos*[43], mbështetësja e të cilit është tipike e punuar në pjesën e mbështetëses me formë të harkuar. Prania e *klismos*-it është diçka e zakontë në stelat e fundit të periudhës klasike e fillimit të periudhës helenistike në Greqi.

Stela e Kritodamit MAD 2373/3510. Në këtë stelë janë 3 objekte; një ulëse, një mbështetëse këmbësh dhe një shilte. Ulësja, mbi të cilën qëndron gruaja është një stol *diphros* me këmbë me bazë të rrumbullakët[44]. Mbi *diphros* është vendosur shiltja apo jastëku (*proskefalaion*-i). *Hypopodion*-i ka formën e një kutie dhe është i vendosur direkt në tokë[45].

Fragment stele MAD 4906. Në reliev janë tre objekte: një *diphros* me një *proskefalaion* mbi të cilin është ulur gruaja dhe një *hypopodion*, ku ajo vendos këmbët. *Hypopodion*-i është i tipit me këmbë të kthyera nga jashtë[46].

Stela e Titit të Teimenit MAD 2372. Edhe në këtë reliev janë tre objekte: një *diphros* me *proskefalaion* dhe një *hypopodion*. Këmbët e *diphros*-it janë me bazë katëkëndore, ndërsa *hypopodion*-i është i tipit me këmbë të shkurtra dhe të kthyera për nga jashtë[47].

Stela e Erosit të Alkinosit (nr. inventari 4121). Stela e Erosit ka tre objekte: një *thronos* me një *proskefalaion* dhe një *hypopodion*. *Thronos*-i, në të cilën qëndron ulur një grua ka një lartësi sa pothuajse lartësia e figurës së personazhit që qëndron në këmbë. Që prej fillimit të mbështetëses sipër e deri te baza poshtë, ka një përthyerje të lehtë për nga ana e brendshme. Duke parë pozicionin e qëndrimit të gruas, pjesa e brendshme e mbështetëses ka qenë e harkuar dhe jo e drejtë dhe nuk duket të ketë patur mbështetëse të krahëve. Baza e *thronos*-it ka formë drejtkëndore, por kjo mund të jetë thjesht ajo çka ne arrijmë të shohim. Nuk duken detaje të bindshme, por mundet që *thronos*-i të ketë qenë i veshur me një tip mbulese. *Thronos*-i ka në vendin e uljes një *proskefalaion*. Ndërsa *hypopodion*-i ka një madhësi të konsiderueshme dhe forma jo të qarta. Ai ngjan të ketë formën e një kutie, por në fakt është i tipit me këmbë të kthyera dhe më bazë katërkëndore.

ANALIZË KRAHASIMORE E OBJEKTEVE

Stelat e Apolonisë

Diphros-at

Në stelat e Apolonisë janë në tërësi pesë stola të llojit *diphros;* një në stelën me figurë femërore nga MAA; dy të tillë në katin e tretë të stelës MHK 1229 dhe dy të tjera nga stela në apsidën e kishës së Ungjillizimit në Kozare.

Diphros-i në stelën femërore duhet të jetë një imitim forme në mënyrë të thjeshtëzur i *diphros*-it të përdorur në periudhën klasike dhe që gjen ripërdorim në periudhën klasike[48]. Paraqitja e tij në reliev të ulët dhe në profil gjen ngjashmëri me *diphros*-in e MAD 2372. Ky *diphros* shoqërohet normalisht me një *proskefalaion*.

Nga Apolonia vijnë dy raste të punimit të dy

[42] Pojani, I., “Dy relieve Apoloniate me temë divine / Two Reliefs from Apolonia”, Iliria 1997, f. 217

[43] Richter, G. M. A., “The Furniture of the Greeks, Etruscans and Romans“, 1962, London, f. 39

[44] Richter, G. M. A., “The Furniture of the Greeks, Etruscans and Romans“, 1962, London, f. 50-51

[45] Pritchett, W. K. dhe Pippin, A., ‘’The Attic Stelai’’, *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens*, 1956, f. 216

[46] Pritchett, W. K. dhe Pippin, A., “The Attic Stelai”, *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens*, 1956, f. 219

[47] Sipas asaj që ruhet, forma e *hypopodion*-it mund të jetë e njëjtë me atë të stelës 4906 MAD

[48] Bergmann, J., “Griechische Grabreliefs im südischen Illyrien / Relieve varresh greke në Ilirinë e Jugut“, *Iliria*,1989, 2, Tiranë, f. 116

DO NOT COPY

diphrosa-ve, që në artin funerar është e rrallë të gjenden në një skenë të vetme. Në të dy rastet (MHK 1229 dhe stela e Kozares) stolat janë të mbuluar me një *epibletia*, ndërsa qëndrojnë të ulur dy personazhe. Gjithashtu, në të dy rastet *diphros*-at kanë një orientim në tre të katërtat. Nga ana ikonografike, stelat anojnë nga tradita tarentine dhe në hulumtimet e bëra nuk është gjetur asnjë shembull i përafërt në stelat atikase. Gjithashtu edhe në *naiskoi*-t në enët nga Italia e Jugut nuk janë gjetur shëmbëlltyra të këtij lloji prezantimi të *diphrosa*-ve. Paraqitja e tyre të mbuluar me një epibletia është një element që duket në stelat nga Azia e Vogël[49].

Thronos-i dhe prosklintron-i

I vetmi *thronos*, që gjendet në MHK 1229 ka një punim të bukur që nuk gjen të përafërt në asnjë stelë tjetër në kërkimet e bëra. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për *prosklintron*-in në MAT 14508. Megjithatë, shembuj të ngjashëm për nga paraqitja dhe punimi gjejmë në *naiskoi*-t e vazove apuliane[50] dhe në një stelë atikase të fundit të shek. II p.e.s.[51].

Hypopodione-t

Hypopodione-t nga stelat e Apolonisë janë më masivë në përmasa se ato të Epidamn Dyrrahut. *Hypopodion*-i i MAT 14508 gjen një analoge në një stelë atikase të fundit të shek. V p.e.s.[52] dhe një tjetër në një reliev të një ndërtese funerare të shek. IV-III p.e.s.[53].

***Hypopodion*-i** kuti është një model i thjeshtë i llojit të vet, që gjen analogë në stelat atikase. *Hypopodione*-t e katit të dytë e të tretë gjejnë analogen e tyre në një stelë nga Smirna[54] dhe në një skenë në një *hidrie* apuliane[55].

Trapeza, tripous-i dhe kline-ja

Për të dy rastet e paraqitjes së tavolinave dhe të *kline*-së, analoget i gjejmë në stelat e Smirnës dhe Ephesus, stela në British Museum.

Armët, objektet luftarake dhe sendet e lidhura me luftën

Prania e objekteve të kësaj kategorie shihet në skenat e amazonomakisë në skulpturën e Parthenonit në Athinë, sikurse edhe në Mausoleumin e Halikarnasit dhe në vazot apuliane[56]. Ndërsa prania e armëve në duart e një personazhi tregon statusin e një ushtari në rastet e stelave tona. Një shembull i armëve të një luftëtari të shek. III *thyreophoroi* është një gur varri i pikturuar, i ndodhur në Muzeun Arkeologjik të Stambollit[57].

[49] Shiko rastet nga British Museum në adresat e mëposhtme (vizituar më 5 korrik 2020) - https://www.britishmuseum.org/research/collection_online/collection_object_details.aspx?objectId=459770&partId=1&images=truehttps://www.britishmuseum.org/research/collection_online/collection_object_details.aspx?objectId=459776&partId=1&searchText=funerary&subject=16761&page=1 https://www.britishmuseum.org/research/collection_online/collection_object_details.aspx?objectId=459774&partId=1&searchText=funerary&subject=16761&page=1

[50] Todisco, L., *''Sulla vexata quaestio dei vasi con naiskoi''*, Rivista di antichità, 2017, f. 165; https://www.metmuseum.org/art/collection/search/248580 (vizituar më 12 korrik 2020)

[51] Grossman, J. B., ''Attic Funerary Sculpture'', *Greek Funerary Sculpture : catalogue of the collections at the Getty Villa*, 2001, Verona, f. 138

[52] Margariti, K., ''On identifying the deceased in two-figured and multi-figured scenes of classical Attic funerary reliefs'', *Journal of Greek Archaeology*, f.59

[53] Grossman, J. B.,, ''Attic Funerary Sculpture'', *Greek Funerary Sculpture : catalogue of the collections at the Getty Villa*, 2001, Verona, f. 141

[54] Karlson, S., "EMOTIONS CARVED IN STONE? THE SOCIAL HANDLING OF DEATH AS EXPRESSED ON HELLENISTIC GRAVE STELAI FROM SMYRNA & KYZIKOS'', Tezë doktorature në Universitetin e Goethenburg, 2014, f. 371

[55] Todisco, L., "Sulla vexata quaestio dei vasi con naiskoi'', Rivista di antichità, 2017, f, 169

[56] Barbagli, D. dhe Cavalieri M., 'Alcune note sui naiskoi funerari tarantini'', *ATHENAEUM, Studi di Lattaratura a Storia dall' Antichiti pubblicati sotto gli auspici dell' Università di Pavia,* 2002, 2, f. 459; POJANI, "Dy relieve Apoloniate me temë divine / Two Reliefs from Apolonia'', *Iliria* 1997, f. 213

[57] https://www.livius.org/pictures/lebanon/saida-sidon/sidon-museum-pieces/sidon-funerary-stele-ofsalmamodes/ (vizituar mw 13 prill 2020)

Enët

Enët duken të kenë lidhje me aspektin religjioz, duke parë *kantaros*-in si simbol të kultit të Dionisit. Ndërsa ena në stelën MAT 14508 ka lidhje me zhvillimin e banketit, gjë që e shohim në praninë e disa enëve të ndryshme në stelat me skena banketi nga Smirna dhe Ephesus, të sipërpërmendura.

Objektet e tjera

Skeptri është një nga atributet e Hermesit, me të cilin ai mund të identifikohet. Shembuj të figurës së Hermesit gjejmë në enë të ndryshme të pikturuara. E njëjta gjë mund të thuhet për varkën e Karontit dhe për çarkun e poçarit. Kutinë e bizhuterive e gjejmë në rastet kur në skena të relieveve është një personazh i ulur, drejt të cilit drejtohet kutia nga një shërbëtor (rasti i stelës së Hegesos)[58].

Stelat e Epidamn-Dyrrahut

Diphros-at

Diphros-i llojit të punuar në stelën MAD 4906 është një model që gjendet i përdorur në shumë raste në stelat atikase. Një shembull e shohim te stela e shek. IV p.e.s. të paraqitur nga Margariti[59]. Orientimi në profil është i njëjtë në këtë stelë sikurse në atë të Dyrrahut dhe forma e punimit është e ngjashme në pjesën e sipërme, që është ajo e ruajtura. Gjithashtu, një stelë me *diphros* të ngjashëm është ajo e Traseas dhe Euanderisë që ndodhet në Berlin dhe datohet në 350-340 p.e.s.[60]. *Diphros*-i i MAD 2372 duket sikur është një formë e thjeshtëzuar e stolit, sikurse edhe mund të tregojë edhe i njëjti tipar për *hypopodion*-in e thjeshtë, mbi të cilin mbështet këmbët personazhi i ulur.

Thronos-i

Thronos- i i vetëm në stelat e Dyrrahut që është i punuar në stelën MAD 4121 mundet të jetë edhe sikurse rasti i *diphros*-it së MAD 2372, përderisa analoge të tilla nuk janë gjetur në hulumtimet e bëra.

Klismos-i

Klismos-i i që në stelën MAD 4401 ruhet vetëm në pjesën e sipërme të tij është një lloj i karriges, që gjen përdorim të shpeshtë në skenat funerare të shek. V-IV p.e.s.. Atë e gjejmë në stelën e Hegesos të shek. V p.e.s. dhe në dy stela të paraqitura nga Margariti.[61] Orientimi është i njëjtë në paraqitjen në profil të *klismos*-it, majtas apo djathtas dhe që shoqërohet me *hypopodion* dhe në disa raste me *epibletia*.

Proskefalaion-et

Proskefalaion-i është i pranishëm në stelat e Dyrrahut aty ku ka prani të *diphros*-it dhe *thronos*-it. Për këtë rast ka plot analogji. Duket se *profeskalaion*-i është një send që shoqëron pjesën më të madhe të ulëseve në periudhën klasike dhe helenistike, kryesisht *diphros*-ave dhe më pak *klismos*-ave dhe *thronos*-eve.

Hypopodione-t

Hypopodione-t, sikurse *proskefalaione*-t janë të pranishëm në rastet e skenave ku një personazh qëndron i ulur. Llojin analog të *hypopodion*-it t; stelës MAD 4906 dhe që ndoshta i përkon edhe *hypopodion*-it të MAD 2773, por që nuk ruhet i qartë e gjejmë në disa stela atikase të shek. V-IV p.e.s.[62]. Ky lloj *hypopodion*-i duket se paraqitet në thellësi, duke dhënë pamje të anës së përparme e të pasme të objektit.

Hypopodion-i i thjeshtëzuar në stelën MAD 2372 dhe ai në stelën MAD 4121 duken si imitime të

[58] Boardman, J., *"Greek Sculpture – the Classical Period"*, New York, 1992, f. 191

[59] Margariti, K., "On identifying the deceased in two-figured and multi-figured scenes of classical Attic funerary reliefs'', *Journal of Greek Archaeology*, 2010, 2, f. 739

[60] Maderna, C., "Tod und Leben an attischen Gräbern der klassischen Zeit'', *THETIS - Mannheimer Beiträge zur Klassischen Archäologie und Geschichte Griechenlands und Zyperns,* 2011, Heidelberg, f. 64

[61] Margariti, K.,*"* "On identifying the deceased in two-figured and multi-figured scenes of classical Attic funerary reliefs'', *Journal of Greek Archaeology*, 2010, 2, f . 541, 573

[62] Boardman, J., "Greek Sculpture – the Classical Period'', New York, 1992, f. 191; MARGARITI, ''On identifying the deceased in two-figured and multi-figured scenes of classical Attic funerary reliefs'', *Journal of Greek Archaeology*, 2010, 2, f. 562, 622

DO NOT COPY

thjeshtëzuara të atij në MAD 4906. Megjithatë, forma më të thjeshta, jo aq fine si në MAD 4906 gjejmë në një stelë të Ikarias, në Ciklade të datuar rreth 460 p.e.s.[63] dhe në një stelë atikase[64]. Në këtë stelë personazhet janë punuar në reliev të ulët sikurse në dy stelat e Dyrrahut.

Aspekte të mobilimit në antikitet

Duke parë kategoritë e krijuara të objekteve, vihet re epërsia numerike e objekteve në grupin e mobiljeve dhe sendeve shoqëruese. Prandaj, shihet si e vendit të trajtohet këtu një aspekt i jetës në antikitet, ai i mobilimit.

Në këtë kategori objektesh përfshihen:

I.Ulëse (*diphros*, *klismos*, *bathron*, *thronos*, *prosklintron*);
II.*Hypopodion*;
III.*Proskefalaion*;
IV.*Kline*;
V.Tavolina (*trapeza*, *tripous*).

Në stelën e vetme të periudhës klasike që vjen nga Epidamn-Dyrrahu gjejmë vetëm një tip ulëse karrige të tipit *klismos*, mobilje që nuk e gjejmë në asnjë stelë tjetër. Në periudhën helenistike ka një shumëllojshmëri të tipit të ulëseve, që nga më e thjeshta, tipi stol i *diphros* e duke vazhduar me tipin e karriges/mbështetëses së këmbëve *bathron*-in, me *thronos*-in në dy raste dhe një tip karrige *prosklintron*. Për *klismos*-in nuk mund të themi në rastin tonë nëse ka qenë apo jo i shoqëruar nga një mbështetëse këmbësh për shkak të dëmtimit të stelës, por në raste të tjera edhe kjo tip ulëseje ka pranë një *hypopodion*. Duke përjashtuar vetëm *bathron*-in, të gjitha tipet e ulëseve të tjera shoqërohen me *hypopodion*. Kjo gjë, në gjykimin tim tregon kujdesin e treguar për çlodhjen e trupit në rastin e përdorimit të një tipi karrigeje apo stoli. Në rastin e stoleve *diphros* kjo vëmendje është më e vogël, krahasuar me tipin e karriges *klismos*, *prosklintron* e *thronos*. Sidomos në këtë të fundit duhet të shtohet edhe elementi dekorativ, i cili tregon edhe statusin e porositësit e zotëruesit, pasi përgatitja e një *thronos*-i ka kushtuar sigurisht më shumë sesa një *diphros*[65].

Shumica e ulëseve kanë një shilte *proskefalaion* në bazën e uljes, ndërsa shumica e *diphrosa*-ve kanë edhe një mbulesë *epibletia*. *Proskefalaion*-i rrit rehatinë e personit të ulur, ndërsa *epibletia* mund të jetë një send i lidhur me ndjenjën e pastërtisë së vendin të uljes dhe sigurisht të personit që do të ulej në të. Në *thronos*-in tjetër në MHK 1229 dekorimi është më i arrirë dhe kemi praninë e mbështetëseve të krahëve. Interesant është fakti që në të dy *thronos*-et qëndrojnë ulur dy gra.

Divani i tipit *kline* në stelën MAT 14508 është i vetmi në llojin e tij në stelat e shqyrtuara këtu[66]. Ky tip divani është i dekoruar bukur me këmbë të profiluara, por nuk mund të shohim shumë detaje për shkak të dëmtimit të stelës në sipërfaqe. Një tip i tillë mobiljeje gjendet rëndom në skenat e banketit[67], teksa një burrë rri i mbështetur në njërin krah të tij dhe në skenë shoqërohet nga personazhe të tjerë. *Kline*-ja jonë ka një *epibletia* sipër, ndërsa në kokë të saj ka një *proskefalaion*, ku burri mbështetet.

Janë vetëm dy tavolina që janë punuar po në stelën e banketit MAT 14508. E para, ajo e tipit *tripous* i shkon për shtat skenës kryesore, asaj të banketit, ndërsa e dyta e tipit *trapeza* i shkon skenës në qoshe të punimit me çark nga ana e poçarit. *Tripous*-i është shumë bukur i punuar në tre këmbët e tij me motivin e putrave të një kafshe

[63] Boardman, J., ‘’Greek Sculpture – the Classical Period’’, New York, 1992, f. 68

[64] Margariti, K., “On identifying the deceased in two-figured and multi-figured scenes of classical Attic funerary reliefs”, *Journal of Greek Archaeology*, 2010, 2, f. 604

[65] Shih më shumë në lidhje me dekorin dhe materialet e përdorura në Andrianou, D., „Late Classical and Hellenistic Furniture and Furnishings in the Epigraphical Record”, 2006a, f. 219-266

[66] Shih Bergamannm J., “Griechische Grabreliefs im südischen Illyrien / Relieve varresh greke në Ilirinë e Jugut“, Iliria,1989, 2, Tiranë, f. 103-123

[67] Pritchett, W. K. dhe Pippin, A., “The Attic Stelai”, *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens*, 1956, f. 211

dhe ka një bazë kryesore rrethore e një të dytë në një nivel të poshtëm. Kjo lloj tavoline sigurisht që i përshtatet përdorimit të saj dhe niveli i punimit të saj tregon rëndësinë që i kushtohej skenave të banketit, duke patur parasysh natyrën e një veprimtarie të tillë dhe pjesëmarrjen e mundshme. Tavolinat e banketit kanë qenë në fakt tavolina personale për secilin të ftuar në vend të një tavoline të madhe të përbashkët[68]. Ndërsa nga ana tjetër, *trapeza* e poçarit është shumë e thjeshtë dhe punimi i saj i përshtatet më së miri funksionit të saj, që siç është përmendur edhe më lart, duhet të ketë qenë për vendosjen e punimeve të tij.

Nëse do të bënim një krahasim me gjendjen e mobilimit në ditët tona, gjendja e mobilimit në periudhën klasike e helenistike mund të duket e varfër. Megjithatë, kjo ngelet në syrin tonë të gjykimit, por duhet të shtojmë këtu se prej studimeve të tjera dhe teksteve antike të ardhura ka të dhëna për praninë e llojeve të tjera të ulëseve, divaneve, tavolinave, sikurse duhet përmendur edhe prania e krevateve të ndryshëm, llambadar*ëve, sunduqeve, kutive dhe* orendive të tjera si tapete, rrugica e batanije, perdeve, dërrasave të pikturuara, qilimave me material papirusi etj..[69] Materiali ka qenë jo vetëm dru, por edhe gur apo metal, si bronz, hekur, ar e argjend[70].

Duhet të theksohet këtu se megjithëse ndikimi i artit funerar është përgjithësisht nga Atika, rajoni veriperëndimor i Greqisë apo nga Tarenti, këto janë stela që pasqyrojnë një aspekt të jetës shpirtërore dhe religjioze të atyre që i porosisnin. Ndërkohe qe sigurisht ka pasur një lidhje me perceptimin për punimin e një stele varri dhe po ashtu, një koherencë fizike për objektet që trajtohen në relieve ka qenë aty. Edhe mobiljet edhe sendet e tjera të lidhura me mobilimin të pasqyruara në stela janë të lidhura me një pjesë të vogël të jetës së komuniteteve koloniale në territorin tonë. Ato janë gjithashtu dëshmia më e mirë e një forme arti të mobilerisë antike, që nuk ka mundur të arrijë në ditët tona në formën origjinale fizike të materialit.

Përfundime

Në të gjitha stelat janë identifikuar 76 objekte, që janë kategorizuar në katër kategori. Numerikisht objektet më të shumta përfshihen në kategorinë e “mobiljeve dhe sendeve shoqëruese‘. Më pas vijnë objektet në kategorinë e “armëve, objekteve luftarake dhe sendeve të lidhura me luftën”. Dy kategoritë e tjera janë ajo e “enëve” dhe “objekteve të tjera”, që përmbajnë një numër të vogël objektesh. Ndërsa në rank origjine, stelat e Apolonisë kanë më shumë objekte sesa ato të Epidamn-Dyrrahut. Kategoria e armëve, objekteve luftarake dhe sendeve të lidhura me luftën japin një ndihmesë për të kuptuar më shumë mbi ndikimin stilistik të ikonografisë në stelat tona funerare. Këto objekte janë gjithashtu të rëndësishme për të përafruar dhe saktësuar datimin e stelës ku ato janë punuar. Po ashtu, prania e tyre tregon për karakterin e personazhit në stelë dhe ndoshta për rrethanat e ndarjes së tij nga jeta. Grupi i mobiljeve dhe sendeve shoqëruese përfshin një gamë të gjerë objektesh e orendish, që janë me të vërtetë interesante për t’u studiuar edhe më tej në mënyrë të veçantë. Këto objekte na njohin me një aspekt të rëndësishëm të banesës në botën antike; atë të arredimit të ambienteve. Objektet që paraqiten në stela si

[68] Richter, G. M. A., “The Furniture of the Greeks, Etruscans and Romans“, 1962, London, f. 66

[69] Shih për këto më shumë në Pritchett, W. K. dhe Pippin, A., “The Attic Stelai”, *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens*, 1956; Richter, G. M. A., “The Furniture of the Greeks, Etruscans and Romans“, 1962, London, f. 179-328; Andrianou, D., ‘’Late Classical and Hellenistic Furniture and Furnishings in the Epigraphical Record”, *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens,* 2006a, f. 561-584; Andrianou, D., “Chairs. Beds, and tables. Evidences for Furnished Interiors in Hellenistic Greece”, *Hesperia: The Journal of the American School of Classical Studies at Athens,* 2006b, f. 219-266;

[70] Richter, G. M. A., “The Furniture of the Greeks, Etruscans and Romans“, 1962, London, f. 122

DO NOT

stolat e llojit *diphros* dhe *bathron*; karriget e llojit *thronos*, *klismos* dhe *proksilontron* shoqërohen me shilte *proskefalaion* dhe në disa raste me mbulesë *epibletia*, si edhe ndodhen në praninë e mbështetëses së këmbëve *hypopodion. Hypopodion*-i prezantohet në relieve në disa forma të ndryshme, që nga ajo më e thjeshta deri në forma elegante dhe fine. Duke shtuar këtu edhe praninë e divanit të llojt *kline*, mësojmë për rëndësinë që i jepej në antikitet rehatisë së qëndrimit në raste normale, apo edhe të veçanta siç janë banketet. Kategoria e enëve përfshin llojet e enëve si *kantaros, kilikse, unguentariume* dhe një enë të paidentifikuar. Të gjithë këto objekte janë nga stelat apoloniate. Në këtë rast, duhet thënë që nuk gjejmë asnjë rast të pranisë së një *loutrophoros-i, lekitos*-i apo *kalpis*-i, që gjenden në stelat atikase apo tarentine. Këto janë enë që janë parë si tregues edhe të statusit të të ndjerit, apo që kanë shërbyer edhe si shenjues të një varri. Objektet e tjera, si skeptri dhe kamzhiku lidhen me mitologjinë dhe besimet. Objektet duhet të shihen si tregues të parapëlqimit të përzgjedhjes së ikonografisë nga familjari i të vdekurit, i cili e zgjedh atë në bazë edhe të natyrës së të ndjerit, gjithmonë në përputhje me mundësitë ekonomike të familjes dhe statusit shoqëror. Gjithsesi, në kaq stela sa janë trajtuar këtu duket se ka një parapëlqim të objekteve që lidhen me banesën dhe qetësinë familjare, sikurse edhe një përzgjedhje të objeteve luftarake për rënët luftëtarë. Analiza krahasuese e stelave tona me ato të rajonit pa se nga vinte frymëzimi ikonografik dhe stilistikor i punimit të stelave apoloniate e dyrrahione. Ndërsa nga ana tjetër, analiza krahasuese e objekteve tregoi se si elementë të ikonografisë të ndjekur nga periudhën klasike vazhdon të ndiqet edhe në periudhën helenistike. Stela funerare, që përmban një kufi të kujtesës fizike lejon njohjen e vetëm një pjesëze të vogël të botës antike, ndërsa studime të natyrave të ndryshme bëjnë bashkë rezultatet e nxjerra dhe plotësohen mes tyre për arritjen e qëllimit të njohjes më të plotë të botës antike.

Ilustrimet[71]

Tabela A – Stelat apoloniate
Tabela B – Stelat stelat apoloniate
Tabela C – Stelat e Epidamn-Dyrrahut
Tabela I – Kategoria 1 – Armët dhe sendet e lidhura me luftën
Tabela IIa - Kategoria 2 - Mobilje dhe sende shoqëruese (*diphros*-e)
Tab. IIb - Kategoria 2 - Mobilje dhe sende shoqëruese (ulëse të tjera)
Tabela IIc - Kategoria 2 - Mobilje dhe sende shoqëruese
Tabela III - Kategoria 3 – Enë
Tabela IV – Kategoria 4 – Objekte të tjera

[71] Imazhet dhe skicat e objekteve janë vepër e autorit, përveç atyre që u është shënuar autorësia dhe burimi. Mungojnë këtu ilustrimi për *diphros*-in në stelën e Erakleidës, *diphros*-i i supozuar në stelën e murosur në Manastirin e Shën Mërisë (Apoloni) dhe *hypopodion*-i në stelën e ripërdorur në kishën e Ungjillizimit në Kozare

DO NOT COPY

TAB A



Fig.1 Stela me figurë femërore MAA



Fig. 2 Zbritja në Hades MAA 5030



Fig. 3 Stelë. Lapardha (Berat) – MAT 14503 (©Jonathan Ritter)

TAB A



Fig. 4 Stela e Falakrës dhe Neagenës – MHK 1149



Fig. 5 Stelë varri me tre kate MHK 1229

DO NOT COPY

TAB B



Fig. 6a Stela me kavalier në këmbë FAIA 40



Fig. 6b Stela FAIA 40 (PATSCH 1904, 163-164, fig. 135)



Fig. 7 Stelë me kavalier të shaluar – MLV Ma837 (HEUZEY 1876. 564, fig. 4)



Fig. 8 Stelë varri e Parmeniskos (© KMW)

TAB B



Fig. 9 Stelë funerare (spolie) – MSHM



Fig. 11 Stela e Erakleidës (PATSCH 1904,163)



Fig. 10 Stelë funerare, Kozare (© Manuel Fiedler)

TAB C



Fig. 12 MAD 2372



Fig. 13 MAD 4121



Fig. 14 MAD 4906



Fig. 15 MAD 4906



Fig. 16 MAD 2773/3510

DO NOT COPY

Tabela I – Kategoria 1 – Armët dhe sendet e lidhura me luftën



1- AP 40 FAIA



2- AP 14508 MAT



3- AP Ma 837 MLV



4- AP 1229 MHK

Tabela IIa - Kategoria 2 - Mobilje dhe sende shoqëruese (diphros-e)



1- DR 4906 MAD - diphros



2- DR 2372 MAD - diphros



3- DR 2773 MAD - diphros



4- AP Stela me figurë femërore MAA - diphros



5- AP 1229 MHK (kati i tretë)- diphros-e



6

6- Stela në kishën e Ungjillizimit në Kozare, Kuçovë – diphros-e

DO NOT COPY

Tabela IIb - Kategoria 2 - Mobilje dhe sende shoqëruese



1- DR 4401 MAD - klismos



2- AP 5030 MAA - bathron



3- DR 4121 MAD – thronos



4- AP 14508 MAT - proksilontron



5- AP 1229 MHK (kati i dytë) - thronos

DO NOT COPY

Tabela IIc - Kategoria 2 - Mobilje dhe sende shoqëruese



1- AP 14508 MAT - kline



4- DR 2372 MAD - hypopodion



2- DR 4121 MAD - hypopodion



3- DR 4906 MAD - hypopodion



5- DR 2773 MAD - hypopodion



6- AP 14508 MAT - hypopodion



7- AP 1229 MHK (kati i parë) - hypopodion



8- AP 1229 MHK (kati i dytë) - hypopodion



9- AP 1229 MHK (kati i tretë) - hypopodion



10- AP 14508 - tavolina

Tabela III - Kategoria 3 – Enë



1- AP 1149 MHK - kanataros

2- AP 1149 MHK - unguentariume

3- AP 14509 MAT

Tabela IV – Kategoria 4 – Objekte të tjera



1- AP 5030 MAA (kamzhik? majtas dhe skeptri i Hermesit djathtas)

4- AP 1229 MHK (kuti bizhuterish) [kati i tretë]

2- AP 14508 MAT (skeptri i Hermesit)

3- AP 14508 MAT (çarku i poçarit)

5- AP 5030 MAA (shkalla sipër dhe varka me rremë poshtë)

DO NOT COPY

Renald META

CRAFTED OBJECTS IN FUNERARY STELES OF CLASSICAL AND HELLENISTIC PERIOD FROM APOLLONIA AND EPIDAMN-DYRRACHIUM

This article addresses 16 steles in total, which are originated from the city-colonies of Apollonia and Epidamnus-Dyrrachium, all with crafted objects in their surfaces. These steles are exposed in different locations, such as in the National Historical Museum, in the Archaeological Museum in Tirana and in the Archaeological Museum of Durrës, in the Monastery of St. Mary and in the Archaeological Museum in Apollonia. There are at least two steles that are now kept or exposed in two foreign countries, specifically in France - in the Louvre Museum in Paris and in Austria - in Kunsthistorisches Museum in Vienna. One last stele is lost, but fortunately some documentation is made in its time of discovery.

While the funerary steles are studied in different times from different persons, different approaches are followed and different interest is in their focus. So, there are studies which focus on the material of stele, artistic quality, in the iconography of the reliefs in general, the inscriptions, etc. What is also interesting to see in these steles is their content in sense of not only what it is shown in the surface of sculptures, but what do these selected elements really want to tell us. These objects are not just simple decorations or applications of one way of making a funerary stele from a raw material. These objects are a really good source of information on ancient times, specifically of Classical and Hellenistic Periods, as in this study.

The steles are briefly represented here with their specific technical information and data, while the 76 objects crafted on their surface are grouped in four categories. These 16 sepulchral reliefs have been used as grave markers for important or rich people from Apollonia or Dyrrachium, this fact is based on by their sizes, quality of material and the fine work done by the engravers.

The steles are not just gravestones. The presence of all these objects, which were very meaningful to the people who ordered their making, reflects the traditions of the society tradition of the time to which these steles belong.

Ina VANDENBERGHE[1]
As. Prof. Dr. Frederik STAMATI[2]

NJË STUDIM (MATERIAL TEKNIK) PËR KONSERVIMIN E FLAMURIT TË KONGRESIT TË LUSHNJËS

DO NOT COPY

Kongresi i Lushnjës

Kongresi i Lushnjës[1]ishte[2]një Kongres kombëtar me rëndësi të veçantë, i cili mori vendime për rimëkëmbjen e shtetit shqiptar, për sigurimin e pavarësisë dhe mbrojtjen e tërësisë territoriale të tij. Kongresi u hap më 21 janar 1920, ndërsa u mbajt nga data 28 deri më 31 janar, 1920. Në Kongres morën pjesë pesëdhjetë delegatë që përfaqësonin të gjitha krahinat brenda territorit të shtetit shqiptar të vitit 1913. Kongresi i Lushnjës u mbajt në një kohë kur Shqipëria ishte akoma nën pushtimin e ushtrive të huaja, ndërkohë që Konferenca e Paqes po hartonte plane për copëtimin e shtetit shqiptar. Në dhjetor 1919 Fuqitë e Mëdha kishin rënë dakort të plotësonin kërkesat e Italisë dhe të Greqisë: Italia do të vendoste Vlorën dhe territoret përqark nën sovranitetin e saj dhe do të merrte gjithashtu mandatin, (protektoratin), mbi shtetin e gjymtuar shqiptar të pasluftës; Greqia do të pushtonte krahinën e Gjirokastrës, si hap të parë drejt aneksimit. Në janar 1920, fuqitë europiane projektuan një coptim më të thellë të territorit të Shqipërisë midis tri shteteve fqinje: Shqipëria veriore i jepej Jugosllavisë, Shqipëria e jugut Greqisë, ndërsa Italia do të merrte në zotërim krahinën e Vlorës dhe mandatin për territorin e mbetur të Shqipërisë. Nga ana tjetër, Qeveria e përkohshme shqiptare, e dalë nga Kongresi i Durrësit, duke ndjekur politikën e nënshtrimit ndaj pushtuesve italianë, po tregohej e paaftë të përballonte situatën. Këto rrethana e bënë të domosdoshme e mbledhjen e një kongresi kombëtar. Për thirrjen e tij u shprehën ato rrethe patriotike shqiptare që e vlerësonin drejt rrezikun e madh të pretendimeve të Italisë për të ardhmen e Shqipërisë. Me organizimin e Kongresit u mor një komision me qendër në Lushnjë. Lajmi për thirrjen e Kongresit të Lushnjës u mirëprit dhe u përkrah nga populli. Kongresi Lushnjës mori vendime me rëndësi të madhe politike. Ai hodhi poshtë planet antishqiptare të Konferencës së Paqes dhe u shpreh për mbrojtjen me çdo kusht të tërësisë dhe të pavarësisë së plotë të shtetit shqiptar në kufijtë e vitit 1913. Ai dërgoi një protestë energjike në Konferencën e Paqes në Paris (kryetarit), në të cilën thuhej se Shqipëtarët ishin gati "të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut të tyre, kundër çdo vendimi që do të vinte në rrezik tërësinë territoriale dhe pavarësinë e tyre të plotë". Kongresi u dërgoi nota proteste edhe qeverive angleze, franceze, italiane etj., ku ndër të tjera pohohej: "Shqipëtarët dinë të vdesin për të mos shkuar nga njëra dorë tek tjetra si tufë delesh e të bëhen plaçka e atyre që drejtojnë sot diplomacinë e Europës". Kongresi i Lushnjës miratoi edhe një akt kushtetues, ku ripohohej sovraniteti i plotë i shtetit shqiptar, i shprehur nga organet e larta të zgjedhura prej tij. Kongresi zgjodhi Këshillin e Lartë

---

[1] Ina VandenBerghe, Textile Research Lab, Royal Institute for Cultural Heritage (KIK-IRPA), Brussels, Belgium (original "KoninklijkInstituutvoor het Kunstpatrimonium") ina.vandenberghe@kikirpa.be

[2] Frederik Stamati, Academy of Albanological Studies, Tirana,Albania (original "Akademia Studimeve Albanologjike") frederikstamati@yahoo.com

prej katër vetash, i cili do të kryente kolegjialisht funksionet e kryetarit të shtetit, derisa ky të caktohej përfundimisht nga një asamble kushtetuese dhe njëherazi krijoi një Këshill Kombëtar prej 37 anëtarësh, që do të kryente funksionet e parlamentit. Bashkë me planet e Konferencës së Paqes, Kongresi i Lushnjës hodhi poshtë edhe vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, që e kishte vendosur shtetin shqiptar nën kontrollin kolektiv të Fuqive të Mëdha europiane.

Qeveria e S. Delvinës ndoqi një politikë në mbrojtje të të drejtave kombëtare të Shqipërisë. Ajo bashkoi nën një pushtet të vetëm qendror pjesën më të madhe të vendit, u kërkoi pushtuesve tërheqjen e tyre nga territoret e shtetit shqiptar dhe përkrahu luftën e armatosur për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Në përputhje me vendimet e Kongresit të Lushnjës, shteti i pavarur shqiptar ndërmori hapa konkrete për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me shtetet e huaja, e veçanërisht me shtetet fqinje, prej të cilave kërkoi të respektonin pavarësinë e plotë dhe tërësinë territoriale të shtetit shqiptar (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 1985).

Flamuri i Kongresit të Lushnjës

Në bazë të studimeve, flamuri i Kongresit të Lushnjës, (Fig. 1), ka qenë në pronësi të Veli Vasjarit, ish zëvendësprefekt i Lushnjës. Ai e çoi



Fig. 1 Flamuri i Lushnjës (imazh nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit)

flamurin në shkollën ku u zhvillua Kongresi (Ferro, 2016). Mbas përfundimit të Kongresit ai e mori flamurin dhe e ruajti.

Një nga vendimet e Kongresit të Lushnjës ishte krijimi i Muzeut Kombëtar. Procesi i krijimit të muzeut filloi në vitin 1922 dhe u përurua më 28 nëntor 1923.

Shteti shqiptar dhe Ministria e Arsimit, nga ku varej Muzeu Kombëtar, i bënë thirrje popullit për të kontribuar për pasurimin e Muzeut Kombëtar, duke dhuruar për muzeun objekte të rëndësishëm. Veli Vasjari iu përgjigj kësaj thirrjeje duke dhuruar flamurin për Muzeun Kombëtar në vitin 1928 (Arkivi Qendror Shtetëror, 1930).

Kompozimi i flamurit

Flamuri është prej një pëlhure të kuqe, nga të dyja anët e të cilit dallohet shqiponja e zezë. Pëlhura e mëndafshtë është përkulur 1 cm nga të gjitha anët dhe qepur me makinë qepëse. Modeli i shqiponjës është qepur nga të gjitha anët me makinë qepëse dhe pe të zi. Në flamur janë qepur tri unaza metalike, me anë të të cilave flamuri mund të varej, ose të lidhej në një litar, për t"a ngritur në një shtizë. Dimensionet e flamurit janë: gjatësia 121 cm dhe gjerësia 70 cm. Ekzaminimet mikroskopike tregojnë se flamuri është prej mëndafshi. Në bazë të teknologjisë së thurjes, pëlhura e flamurit klasifikohet si një thurrje satin i çrregullt, (Fig. 2). Diagrama e thurjes jepet në Fig. 3. Densiteti i thurrjes është 496 fije për 10 cm për bazën dhe 466 fije për mbushjen. Analizat e fibrave dhe të thurrjes janë kryer nga msc Riana Hida në departamentin e tekstileve dhe Modës në Universitetin Politeknik të Tiranës, ndërsa matja e densitetit nga Dr. Olta Çakaj në Laboratorin e strukturës dhe vetive të materialeve pranë Departamentit të Fizikës në Fakultetin e Shkencave Natyrore.

Shqiponja e zezë nga të dyja anët e flamurit është gjithashtu prej mëndafshi. Fillimisht, pëlhura e zezë është vendosur nga të dyja anët e flamurit, është

DO NOT COPY



Fig. 2 Struktura e endjes së pëlhurës së kuqe (imazh nga KIK-IRPA laboratori i studimit shkencor të tekstilit)



Fig. 3 Diagrama e thurjes së anës së prapme (majtas) dhe anës së përparme (djathtas) të pëlhurës së kuqe të mëndafshtë

fiksuar dhe mbi të është vendosur një model shqiponje, në konturet e së cilës ka kaluar tegeli i makinës qepëse. Sytë e shqiponjës janë krijuar nga dy prerje, nën të cilat ndodhet një fragment i bardhë prej tekstili. Këto dy tekstile të bardha kanë formën e dy fragmenteve të rrumbullakët me diameter rreth 2 cm. Nuk ka qenë e mundur të gjendet lloji i fibrës së përdorur dhe mënyra se si kanë qenë qepur në pëlhurën bazë.

Gjendja e konservimit të flamurit

Aktualisht flamuri ndodhet në një gjendje shumë të dëmtuar. Duken shumë të grisura në drejtimin gjatësor, pra në drejtimin e punimit të pëlhurës. Grisjet më të shumta janë në drejtim të fillit mbushës. Në

disa zona mungojnë plotësisht pjesë të pëlhurës, të shkaktuara nga dëmtimi i mëndafshit gjatë kalimit të viteve.
Flamuri është i dëmtuar më shumë në anën e kundërt të hallkave që kanë shërbyer për ta lidhur në litar. Dëmtime të ngjashme janë vënë re nga Stamati në shumë flamuj në shtiza dhe anije në Shqipëri dhe Greqi. Kjo mund të tregojë se flamuri ka qenë ngritur në një shtizë dhe se valëvitjet nga era kanë dhënë shtytjen e parë të dëmtimit të flamurit në anën që është valëvitur më shumë.



Fig. 4 Fille të këputur në drejtimin e bazës dhe të mbushjes. Imazhe me elektrone sekondare të marra me instrument Zeiss Supra 35, (imazhe nga Prof. Dr. Maja Remškar në Institutin Jožef Stefan)

Në përgjithësi sipërfaqja e tekstilit duket e ndotur. Për të shqyrtuar sipërfaqen e fibrave si dhe dëmtimet e mundshme të tyre, u morën foto me anë të SEM, (Fig. 4 – 5). Analizat me anë të SEM u kryen me anë të një instrumenti Zeiss Supra 35 nga Prof. Dr. Maja Remškar në Institutin Jožef Stefan. Jo vetëm që vërehen papastërti në formë pluhuri mbi fibrat e mëndafshta, por gjithashtu vërehen shumë fibra mëndafshi "të thyera". Kjo shpjegon qartë arsyen pse kur flamuri shtrihet mbi një tavolinë, lë nga pas një pluhur të kuq të fibrave të thyera.
U bënë prova edhe përsa i përket qëndrueshmërisë së ngjyruesve në ujë të demineralizuar dhe rezultoi se ato nuk janë të qëndrueshëm. Duket që ngjyruesit nuk janë lidhur mirë me fibrat e mëndafshit. Një fragment i vogël i pëlhurës së mëndafshtë, që kishte rënë dikur nga flamuri u zhyt në një gotë me ujë të distiluar. U mat pH dhe rezultoi të ishte 5.24. Matja e pH u bë nga Dr. Anisa Dhroso, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Kimisë Industriale.
Papastërtitë e pranishme në sipërfaqen e tekstilit, por mbi të gjitha, fijet e "thyera" të mëndafshit dhe rezistenca e ulët e ngjyrave në ujë, janë tregues të rëndësishëm për gjendjen e brishtë të flamurit. Në mënyrë që të kemi një kuptim më të mirë për degradimin e fibrave të përmendura, është e nevojshme të gjejmë se si dhe se me çfarë



Fig. 5 Detaje të fibrave të thyera. Imazhe të marra me elektrone sekondare me instrument Zeiss Supra 35, (imazhe nga Prof. Dr. Maja Remšcar në Institutin Jožef Stefan).

DO NOT COPY

materialesh është trajtuar në të kaluarën. Për këtë arsye në pjesën e mëposhtme paraqitet një studim për identifikimin e komponimeve të pranishëm në fillin e mëndafshtë të flamurit.

Identifikimi i ngjyruesve organikë
Një kampion i vogël nga mëndafshi i kuq u analizua për përcaktimin e ngjyruesve organikë. Analizat u kryen

Tabela 1: Ngjyruesit e identifikuar

Koha e arritjes së pikut në minuta (min)	Absorbimi i dukshëm max.(nm)	Emri i indeksuar i ngjyrës (ku aplikohet)	Numri i indeksuar i ngjyrës	Emri i zakonshëm	Viti i zbulimit
16.2	533	basic red 1	45160	rhodamine 6G	1891/1892
17.3	526	basic red 1 derivative	-		-
19.1	410-542	ngjyrues i kuq i panjohur	-	-	-
20.7	557	basic violet 10		rhodamine B	1887/1888
21.2	498	acid red 9	15635	carmine për mendafsh apo silk scarlet	-
23.6	559	basic violet 10 derivative	-	-	-

me High Performance Liquid Chromatography dhe Photo Diode Array Detection (HPLC-DAD) system Alliance nga Waters, në ngjyruesit e ekstraktuar nga fibrat me anën e acidit klorhidrik, (Vanden Berghe dhe Vandorpe, 2019; Vanden Berghe et al. 2009). U identifikua një përzierje ngjyruesish sintetikë që përmban si kromoforë më kryesorë acid red 9, basic violet 10, një ngjyrues me karakteristika spektrale shumë të ngjashme me basic red 1 dhe një ngjyrues të kuq sintetik të panjohur. Ngjyruesi i fundit, i gjetur në kohën arritjes së pikut prej 19.1 minutash, nuk ka qenë e mundur të identifikohet duke u bazuar me spektrat e referencës në të dhënat e arkivit tonë. Përveç kësaj, një komponim më i pakët është i pranishëm në kohën e arritjes së pikut prej 23.6 minutash, i cili, në bazë të të dhënave spektrale ka mundësi të jetë një derivat i basic violet 10. Rezultatet e analizës HPLC-DAD të kampionit të kuq jepen në Fig. 6, duke shfaqur pikun maksimal (lart), kromatogtramin në 520 nm, që paraqet pikun e kromoforeve të ngjyrës së identifikuar (në mes), dhe spektrin e absorbimit të të gjithë komponimeve të zbuluar (në fund). Një përmbledhje e komponimeve të karakterizuar nga koha e arritjes së pikut dhe maksima e absorbancës së dukshme jepet në tabelën 1, së bashku me emërtimin e tyre dhe numrit në bazë të sistemit të Indeksit të Klasifikimit të Ngjyrave, emërtimin e tyre të zakonshëm dhe vitin e zbulimit.

Identifikimi i elementeve inorganikë
Pëlhura e mëndafshtë u analizua më tej me anë të Spektroskopisë së fluoreshencës së rrezeve X, (XRF) nga Prof. Dr. Niko Civici në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, duke përdorur një Micro-XRF spektrometër ARTAX 800 (Bruker Gmbh). Analizat tregojnë përmbajtjen në elementët kallaj (Sn) dhe kalcium (Ca), si edhe pak fosfor (P), silic (Si) dhe kalium (K). Analizat e ujit të demineralizuar në të cilin u zhyt një fragment i vogël mëndafshi, rënë nga flamuri, treguan se asnjëri prej elementëve të identifikuar me anë tw XRF nuk ka kaluar nga mëndafshi në ujë.

Ndikimi i rëndimit të mëndafshit dhe ngjyrimit në gjendjen e konservimit të flamurit.
Mund të konkludohet se pëlhura e kuqe e mëndafshtë e flamurit të kongresit të Lushnjës ka qenë ngjyer me ngjyrues sintetikë. Janë identifikuar silk scarlet, rhodamine 6G dhe rhodamine B, së bashku me një tjetër ngjyrues të



Fig. 6 Analizat me HPLC-DAD të ngjyruesit të kuq të mëndafshit. Diagrama maksimale e spektrit (lart); kromatogrami në 520nm (në mes) dhe kromoforet e identifikuar (poshtë). (Imazhe nga Laboratori i Kërkimit Shkencor për Tekstilet në KIK-IRPA).

kuq sintetik me përbërje të panjohur. Ngjyruesi i parë plotësisht sintetik, i bërë nga katrani, është zbuluar në vitin 1856, megjithëse përparimet më të shumta në sintezën e ngjyruesve janë bërë në çerekun e fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë (Barnet 2007). Sinteza e rhodamine përshkruhet për herë të parë nga Maurice Ceresole, punonjës në laboratoret e *Badische Anilin und Soda Fabric* (B.A.S.F.), në një patentë të vitit 1887. Procedura e përshkruar referohet te ngjyruesi i njohur më vonë si rhodamine B. Ai ishte një ngjyrues bazik, ngjyrues i shpejtë dhe veçanërisht me një ngjyrë të kuqe të ndezur dhe fluoreshente. Një derivat i kësaj ngjyre është krijuar në vitin 1891, u bë i njohur si rhodamine 6G, (Cooksey 2015) dhe më vonë pati shumë variante. Identifikimi i rhodamine B dhe 6B veçanërisht në flamurin e kuq, nënkupton një datë *post quem* të ngjyrimit të pëlhurës së mëndafshtë mbas vitit 1891 (Colour index 1971). Karmina për mëndafshin, (ose, scarlet silc) është një monoazo ngjyrues i zbuluar nga Durand&Huguenin. Në Indeksin e ngjyrave (Colour Index 1971) nuk përmendet ndonjë informacion për vitin e zbulimit. Të tri ngjyruesit sintetikë të zbuluar bëjnë pjesë në serinë e gjashtëdhjetë e gjashtë ngjyruesve të Rëndësishëm të Hershëm Sintetikë (të datuar midis viteve 1856 – 1892) nga Instituti Smithsonian, bazuar në punën e Helmut Schweppe dhe i njohur si "koleksioni Schweppe", (Schweppe 1987; 1991). Që nga koha e prodhimit të flamurit në fillim të shek. XX, ngjyruesit sintetikë janë përdorur më shumë bashkërisht dhe si rezultat është bërë e mundur të arrihen pamje të hijshme që u a kalojnë tepër në shkëlqim dhe intensitet ngjyruesave natyralë. Ka mundësi që entuziazmi për këta ngjyrues të rinj të ndritshëm të ketë shkaktuar për shumicën e tyre një ulje të vëmendjes përsa i përket dobësisë në ujë ose qëndrueshmërinë në larje (Eiland 1999).

Në rastin e flamurit, ngjyra e ndritshme e verdhë-e kuqe e karminës për mëndafsh, ka mundësi që të jetë forcuar me anë të shtimit të ngjyruesve blu-të kuq të rhodamine për të përftuar një nuancë përfundimtare scarlet-të kuqe me shkëlqim tek flamuri. Vetitë e qëndrueshmërisë së dobët ndaj dritës dhe larjes të këtyre ngjyruesave, siç edhe u konstatuan në provat paraprake të konservimit, fatkeqësisht konfirmojnë studimet e hershme të Schweppe, që raportojnë një qëndrueshmëri 2 ndaj dritës dhe qëndrueshmëri 3 në larje, (duke përdorur metodat ISO të provës) për secilin ngjyrues (Schweppe 1987).

Këto njohuri të reja të marra për ngjyruesit e pranishëm shpjegojnë migrimin e ngjyruesit nga mëndafshi i kuq gjatë provave të qëndrueshmërisë së ngjyrave dhe japin një tabllo të rrezikut të lidhur me kryerjen e pastrimit të njomë gjatë proceseve të trajtimit të restaurimit të flamurit.

Përveç kësaj, ngjyruesit në vetvete nuk janë shkaktarë të degradimit ekstrem të fibrave të kuqe të mëndafshta, që ka çuar në thyerjen e fibrave dhe humbjen e plotë të tyre. Kjo prishje është rezultat i procesit të rëndimit të fibrave të mëndafshit. Në të kaluarën, rëndimi i mëndafshit është bërë në rradhë të parë për të kompensuar humbjen e peshës gjatë procesit të degumifikimit të mëndafshit. Nga ky trajtim rezulton një mëndafsh me pamje më të shkëlqyer, ndonëse ka pasoja negative me një humbje në peshë deri në 25%. Pastaj, rëndimi i mëndafshit me anë të shtimit të agjentëve rëndues rrit volumin e mëndafshit dhe përmirëson çështjen e rrudhosjes dhe të qëndrimit të derdhur. Meqë mëndafshi ishte shumë i shtrenjtë dhe shitej me kile, mund të merret me mend se shtimi i agjentëve rëndues ishte një punë shumë fitimprurëse (Hacke 2008). Fillimisht rëndimi i mëndafshit është bërë kryesisht me anë të tanineve. Që nga gjysma e dytë e shek. XIX dhe edhe më përpara, kripërat e metaleve u bënë më të zakonshme për të përftuar mëndafsh më të rënduar, e gjithnjë e më të rënduar. Gjetja e elementëve kallaj, fosfor dhe kalium tregon se mëndafshi i flamurit ka qenë rënduar me kripëra të kallajit, kombinuar me fosfate të natriumit dhe silikate, proces ky i njohur si procesi "Neuhaus" ose "dinamit", i rëndimit të mëndafshit. Kjo metodë është zhvilluar nga Neuhaus gjatë viteve 1892-

DO NOT COPY

1893 dhe bënte të mundur që të arrihej një rëndim deri në 167% (të peshës fillestare të mëndafshit) për mëndafshin e bardhë dhe atë lehtësisht me ngjyrë (Hacke 2008).

Konditat ekstreme të këtij trajtimi me kripëra të kallait, i cili ishte fare i zakonshëm në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, kanë një efekt negativ në fortësinë e fibrave (Garside et al. 2010a). Në rastin e flamurit kjo ka rezultuar në thyerjen e shumë fibrave dhe në humbjen e fillit të mëndafshtë në të dyja drejtimet. Shkaku i degradimit të avancuar që vërehet shpesh në koleksionet historike prej mëndafshi të rënduar dinamit vjen kryesisht gjatë procesit të rëndimit me kallaj, mundësisht në kombinim me efektet e zbardhjes paraprake dhe jo nga përdorimi dhe ruajtja e mëvonshme. Konditat e ndryshme të pH, (nga 1 deri 10), të përdorura në banjat e njëpasnjëshme të procesit të rëndimit dhe jo agjentët rëndues, janë arsyeja e reduktimit të menjëhershëm të fortësisë në tërheqje të fillit të ri të rënduar. Veç konditave dobësuese fillestare të mëndafshit pas rëndimit "dinamit", stabiliteti afatgjatë duket më pak problematik se sa është konsideruar më parë, (Garside et al. 2010a; 2010b). Lidhur me këtë mund të themi se nuk është konstatuar lidhje midis aciditetit të pranishëm dhe vetive mekanike të mëndafshit të rënduar me kallaj, e kundërta me atë se çfarë është vëzhguar nga shqyrtimi i mëndafsheve të rënduar me kallaj, ose atyre të parënduar, ku vetitë mekanike janë ndikuar nga degradimi i fibrave, i shoqëruar me rritje të aciditetit. Mëndafshi, me rëndimin "dinamit" ka një aciditet më të ulët, (rreth 7), pavarësisht nga konditat e tij. Pra, degradimi i mëndafshit të rënduar me kallaj, i përcaktuar vetëm me anën e matjes së aciditetit, mund të japë përshtypjen e gabuar, se të tillë mëndafshe degradohen më pak se të tjerët, (Garside at al. 2010b).

Vlera prej 5.24 e pH e matur për mëndafshin e kuq të flamurit, është më e ulët nga ajo që mund të pritej nga studimet e mëparshme. Meqenëse mëndafshi është ngjyer pas rëndimit, vlera e pH ndikohet më tepër nga procesi i fundit.

Të dhënat e mbledhura rreth materialeve të përdorura për rëndimin dhe ngjyrimin e mëndafshit të kuq të flamurit dhe ndikimi i mundshëm i tyre në ruajtjen dhe degradimin e objektit, mund të jenë shumë të dobishme për strategjinë e konservimit, të ndjekur nga restaurimi, ekspozimin në të ardhmen dhe ruajtjen në fonde të flamurit të Lushnjës. Një trajtim neutralizues mund të eliminojë çështjen në aciditetin e mëndafshit, lidhur me hidrolizën e peptideve, por nuk mund të restaurojë proteinat tashmë të degraduara. Lidhur me këtë, trajtimi i njomë i mëndafshit mund të përmbajë rrezikun e madh të çngjyrosjes dhe migrimit të ngjyrës së kuqe. Si përfundim është e nevojshme të merret në konsideratë nëse një trajtim i njomë do t'i shtojë vlerat flamurit, krahasuar me një trajtim më konservues[3].

[3] Falenderojmë të gjithë ata që u angazhuan në këtë studim ndërdisiplinor.

BIBLIOGRAFIA

1. Albanian encyclopedic vocabulary (original title "Fjalori enciklopedik shqiptar")(1985), published by the Encyclopedia section of the Albanian Academy of Sciences (original "Akademia e Shkencave e Shqipërisë"), chief editor Alex Buda. Online available athttps://wiki.shqipopedia.org/lushnja
2. Ferro, N. (2016) Lushnje, the days of the Congress (original "Lushnje, ditët e Kongresit").Online article in Gazeta DITA from 22.01.2016 in http://www.gazetadita.al/lushnja-ditet-e-kongresit/
3. Central State Archive "Arkivi Qendror Shtetëror" (1930), fund 195, dossier 122, 20-29.
4. Barnett, J. (2007) Synthetic organic dyes, 1856−1901: an introductory literature review
5. of their use and related issues in textile conservation. Reviews in Conservation 8, 67-77.
6. Colour Index – Third Edition (1971), published by The Society of Dyers and Colourists and The American Association of Textile Chemists and Colourists, Leeds and London
7. Cooksey C. J. (2015) Quirks of dye nomenclature. 5. Rhodamines. Biotechnic& Histochemistry,1052-0295 (print) or 1473-7760 (online).
8. Garside, P., Wyeth, P. &Zhang, X. (2010a) Understanding the ageing behaviour of nineteenth and twentieth century tin-weighted silks, Journal of the Institute of Conservation, 33:2, 179-193
9. Garside, P. Wyeth, P. &Zhang, X.(2010b)The inherent acidic characteristics of silk, part II – Weighted silks. e-PS 7, 126-131.
10. Hacke, M. (2008) Weighted Silk: History, Analysis and Conservation', Reviews in Conservation 9, 3-15.
11. Eiland, M. L. (1999) Problems associated with the dissemination of synthetic dyes in the orient
12. carpet industry. International Committee for the History of Technology (ICOHTEC) 5, 138-159. JSTOR, www.jstor.org/stable/23786082.
13. Schweppe, H. (1987) Practical information for the identification of early synthetic dyes – Practical hints on dyeing with early synthetic dyes. By the Conservation Analytical Laboratory Smithsonian Institution Washington DC.
14. Vanden Berghe, I. and Vandorpe, M. (2019) Report dye identification of the flags from Lushnje and Vlore. Akademia e Studimeve Albanologjike. Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Albania (DI2019.14089, 18.03.2019)
15. Vanden Berghe, I., Gleba, M. and Mannering, U. (2009) Towards the identification of dyestuffs in Early Iron Age Scandinavian peat bog textiles. Journal of Archaeological Science 36, 1910-1921
16. Important early synthetic dyes. Chemistry, constitution, date and properties (1991) Ed. By M. Ballard, Conservation Analytical Laboratory, Smithsonian Institution, Washington DC.

DO NOT COPY

Ina VandenBerghe
Prof. Asoc. Frederik STAMATI

A STUDY (TECHNICAL MATERIAL) FOR THE CONSERVATION OF THE FLAG OF THE CONGRESS OF LUSHNJA

DO NOT COPY

Ina VandenBerghe, Textile Research Lab, Royal Institute for Cultural Heritage (KIK-IRPA), Brussels, Belgium (original "KoninklijkInstituutvoor het Kunstpatrimonium"). ina.vandenberghe@kikirpa.be

Frederik Stamati, Academy of Albanological Studies, Tirana, Albania (original "Akademia Studimeve Albanologjike"). frederikstamati@yahoo.com

The Congress of Lushnja held in 1920 was of particular importance, because it took decisions for the recovery of the Albanian state, to ensure the independence and protection of territorial integrity. The government of S. Delvina pursued a policy in defence of Albania's national rights. It unified most of the country under a single central power, urging invaders to withdraw their troops from the Albanian state territories and supported an armed struggle for the full liberation of Albania. In line with the decisions of the Congress of Lushnja, the independent Albanian state undertook concrete steps to establish diplomatic relations with foreign countries and particularly with neighbouring countries requiring compliance with and respect for the full independence and territorial integrity of the Albanian state".

According to the studies, the flag of Lushnja Congress (Figure 1) was owned by ex-deputy governor of Lushnja, Veli Vasjari. He brought the flag to the school where the Congress took place (Ferro, 2016). After the Congress finished he took and saved it.

One of the decisions of the Lushnja Congress was the creation of the National Museum. The process of building began in 1922, and the museum inaugurated on November 28, 1923.

The Albanian state, the Ministry of Education, and the National Museum itself called on the people to contribute to the enrichment of the National Museum by donating valuable items. Veli Vasjari also responded to this call and handed the flag to the National Museum in 1928 (Central State Archive, 1930).

The flag is made of a red fabric on which the black eagle is visible on both sides. The main fabric is folded 1 cm on all edges and sewn with a sewing machine. The black eagle pattern is sewn all around on the red fabric with a black spun sewing yarn, again using a sewing machine. Three rings have been added to the flag, with which the flag can be hung or attached to a rope to mount it on a flagpole. The flag measures 121 cm wide x 70 cm high. Microscopic examination showed that the flag was made of silk. According to the weaving technology, the flag is classified as an irregular warp satin weave (Figure 2). The weave diagram is given in (Figure 3). A weaving density of 496 threads per 10 cm for the warp, and 466 threads per 10 cm for the weft was found.

The black eagle pattern on both sides of the flag is also made of silk. Initially black fabrics were placed on both sides of the flag, fixed and a template was placed on the outlines of which the sewing machine "walked thru". The eagle's eyes have been created by two incisions, below which a white fabric fragment is present. These white fabrics have the form of two round stamps, about 2 cm in diameter. It was not possible to identify the type of fibre used or to determine how they have been sewn to the base fabric.

The silk flag is currently in a very damaged state. In longitudinal direction a lot of tearings are visible. The largest tearings are present in the weft direction. At some areas complete parts of the fabric are missing, caused by the damage of the silk over the years.

The flag is most damaged on the opposite side of the rings that serve to secure the rope. Similar damage was previously found by Stamati on many flags on spears and ships in Albania and Greece. It likely indicates that the flag was hoisted on a flagpole and that wind waves have given the first impetus to damage the flag on the side where it blows out the most.

SEM images have been taken to examine the surface of the fibres as well as possible fibre damage (Figures 4-5).The SEM analyses were performed with a Zeiss Supra 35 instrument, by Prof. Dr. Maja Remškar at the Jožef Stefan Institute.

The pH of the solution obtained was 5.24.

The impurities present on the surface of the textile, but above all the many 'broken' silk threads and the low water resistance of the dyes present, are very important indications of the fragile state of the flag. It was necessary to find out how and with which materials the silk was treated in the past. Also, a study was done to identify the organic and inorganic components present on the silk filaments of the flag.

The silk fabric was furthermore analysed with X-ray fluorescence spectroscopy (XRF) by Prof. Dr. Niko Civici in the Institute of Applied Nuclear Physics, using a Micro-XRF spectrometer ARTAX 800 (Bruker Gmbh). The analysis showed the content of the elements tin (Sn) and calcium (Ca), as well as a little phosphorus (P), silicon (Si) and potassium (K). Analysis of demineralised water in which a loose fragment of the silk was immersed also showed that none of the elements identified by XRF migrated from the silk into the water.

It can be concluded that the red silk fabric of the flag from Lushjna has been dyed red with synthetic dyestuffs. Silk scarlet, rhodamine 6G and rhodamine B are identified, together with another red synthetic dye from unknown composition.

By the time of the production of the flag in the beginning of the 20th century, synthetic dyestuffs were applied more commonly, and with them, a number of shades have become available that far exceeded in brightness and intensity to the natural dyes. In the case of the flag, the bright yellow red color of carmine for silk was likely tempered by the addition of the blue-red rhodamine dyes, to obtain the final brilliant scarlet-red hue of the flag.

This newly acquired knowledge about the dyes present explains the migration of the dyes from the red silk during the colour persistence test and gives a clear picture of the risk associated with performing some form of wet cleaning during the restoration treatment of the flag.

The extreme conditions of tin salt treatments, which were quite common at the end of the 19th and the beginning of the 20th century, have a negative effect on fibre strength (Garside et al. 2010a). In the case of the flag, this results in the many broken filaments and the loss of silk yarns in both directions. The far-reaching degradation often observed on historical dynamite-weighted silk in historical collections is mainly caused by damage incurred during the tin weighting process itself, possibly in combination with the effects of the previous bleaching, and not by the use and preservation of the textile afterwards.

The new gained insights into the materials used for weighing and dyeing the red silk of the flag and their possible influence on the preservation and degradation of the object can be very useful for the conservation strategy to be followed for the restoration, future display and storage of the Lushnja flag. A neutralising treatment can eliminate concerns about acidic silk peptide hydrolysis but will not restore the already degraded protein. In addition, a wet treatment of the red silk may involve a high risk of decolourisation and migration of the red dyes. To conclude, it will be necessary to consider whether an active wet treatment is desirable at all and can provide added value compared to a more preventative conservation of the flag.

DO NOT COPY

As. Prof. Dr. Armand VOKSHI

PROJEKTET E ARKITEKTËVE DHE INXHINIERËVE ITALIANË NË VLORË GJATË PERIUDHËS 1916-43

Qyteti i Vlorës, ndoshta edhe për shkakun se si kanë rrjedhur vetë ngjarjet historike në harkun kohor midis dy luftërave botërore, mund të konsiderohet si qyteti i dytë pas Tiranës, për sasinë dhe cilësinë e projekteve arkitekturore e urbanistike, të realizuara apo të parealizuara, nga arkitektët italianë në Shqipëri. Kjo periudhe pjellore nga ana urbanistike për qytetin e Vlorës, edhe pse e ndarë përkatësisht në etapa të ndryshme historike, fillesën e ka pasur në vitin 1916 dhe ajo do të zgjaste deri në vitin 1943. Vetëm dy vite pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë prej Perandorisë Osmane, ku të gjithë e dimë që Ismail Qemali në 28 nëntor 1912 ngriti Flamurin në Vlorë, ky qytet u pushtua ushtarakisht nga Italia në vitin 1914. Ky pushtim do të zgjaste deri në vitin 1920, e më pas për t'u rikthyer në pushtimin e dytë, nga viti 1939 deri në vitin 1943, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përtej konsideratave e kritikave nga pikëpamja historike mbi pjesën e pushtimit apo të ndërhyrjeve ushtarake, si dhe politikave ndërshtetërore të atyre viteve, duke veçuar vetëm produktin e ndërhyrjeve urbane dhe arkitektonike të arkitekteve dhe inxhinierëve italianë në Vlorë, mund të themi se ato kanë vlera të veçanta e mjaft të rëndësishme për qytetin edhe në ditët tona. Këto projekte lidhen me tre ngjarje historike:

- Periudha e parë shtrihet në vitet e 1916 – 1920, pra duke filluar kështu rreth dy vite pas pushtimit ushtarak të Vlorës;
- periudha e dytë fillon në vitin 1925 e zgjat deri në vitin 1939 dhe përkon me periudhën e monarkisë të mbretit Zog;
- dhe periudha e tretë fillon në vitin 1939 deri në vitin 1943 me ndërhyrjen e dytë ushtarake këtë herë mbi të gjithë territorin e Shqipërisë.

Qyteti i Vlorës, pas një periudhe rreth 60-vjeçare nga tërmeti i fortë që pat kaluar në vitin 1851, paraqitej si një qendër e vogël urbane, e mbërthyer në këmbët e kodrave të larta që e kufizojnë edhe sot. Kjo qendër urbane kishte një distancë të konsiderueshme, prej afërsisht dy kilometrash, larg nga vija bregdetare e nga porti i saj. Pëlhura urbane e këtij qyteti shpërhapej sipas një sistemi kaotik e rastësor, që ishte edhe derivat i:

- konfigurimit morfologjik të terrenit të pjerrët;
- mënyrës orientale të tipologjisë së ndërtimit deri në atë periudhë;
- aspekteve orientale të mënyrës së jetesës deri në atë periudhë.

Ndërtesat, deri në fillimin e viteve 1900, ashtu si në të gjithë territorin shqiptar, paraqisnin një arkitekturë me elementë të përzier midis arkitekturës vernakolare të traditës autoktone dhe elementëve rajonalë apo atyre osmanë. Teknologjia e ndërtimit limitohej në ndërtimet më gur ose me qerpiç dhe objektet e banimit zakonisht ishin deri në dy kate. Rrugët ishin të ngushta, të tërthorta, të shtruara me kalldrëm dhe nuk kishin një gjerësi standarde

në të gjithë trajektoren e tyre. Objektet e veçanta që mund të bënin diferencën për nga pikëpamja arkitekturore e funksionale ishin objektet e kultit apo ndonjë objekt modest administrativ, të cilat zinin pozicionet kyçe të qytetit. Me interes urban, ekonomik e social paraqitej Pazari i qytetit të Vlorës, si element i rëndësishëm në jetën e qytetit shqiptar për kohën. I çuditshëm është fakti që Vlora ishte zhvilluar larg nga bregdeti e nga porti i tij, i cili kishte premisa të mira zhvillimi për nga pozicioni strategjik që gëzonte në raport edhe me afërsinë me Italinë.

Në korrik të vitit 1916 Pazari i Vlorës shkatërrohet masivisht nga një zjarr që e përfshiu atë dhe ky është momenti i parë i rëndësishëm në historinë e zhvillimit urban të qytetit, ku pas djegies së tij, do të realizohen një seri e madhe studimesh e projektesh nga arkitektet dhe inxhinierët italianë të Xhenios, pjesë e forcave ushtarake italiane prezente në qytet, për punime e objekte të ndryshme në territoret e qytetit të Vlorës. Shumica e ndërtesave të reja apo punimeve me karakter urban ishin brenda qytetit të Vlorës. Këto vepra publike u mbështetën nga financimet të cilat miratoheshin nga qeveria italiane dhe u përgatitën në pak muaj nga zyrat teknike të "*Seksionit Autonom të Xhenios ushtarake italiane*", duke u paraqitur me synimin e nevojshëm të "përmirësimit ndërtimor e higjienik të qytetit"[1].

Duke parë e duke konsideruar edhe konditat e vështira urbane në të cilën gjendej qyteti, si dhe ndërtesat e papërshtatshme për kohën, këshilli administrativ lokal i qytetit vendosi të realizojë një Plan Rregullues e një Rregullore Ndërtimi për të gjitha ndërtimet e reja që priteshin të realizoheshin në atë periudhë në qytetin e Vlorës. Për të parën herë në një qytet shqiptar realizohej një planifikim urban në këtë lloj forme si dhe me parametra të qarta urbanistike dhe kjo është mjaft e rëndësishme për historinë urbanistike shqiptare.

Edhe pse jemi në vitet e lulëzimit urban të qyteteve evropiane, pas planeve të Hausman në Paris, pas planit të Vjenës apo pas atij të Barcelonës, të cilët tashmë ishin bërë shembuj të mirë për mënyrën e organizimit të qyteteve modernë, në Itali, vetëm në fillim të shekullit të XX kishte filluar masivisht higjienizimi urban dhe projektimi i planeve rregulluese urbanistike të zhvillimit të qyteteve. Kështu që edhe Vlora përfitoi nga këto konsiderata të zhvillimit të territorit dhe të instrumenteve të reja urbanistike. Autori i planit të parë rregullues të Vlorës është inxhinieri ushtarak i Xhenjos, Paolo Giannoli[2].

Në ndërhyrjen e propozuar për planin rregullues të vitit 1916, megjithë madhësinë modeste të tij, merreshin parasysh kriteret e sigurisë, të konditave higjienike, të sistemit të qarkullimit rrugor, rregulla të parashtruara për të gjithë qytetin, ndërsa për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara duheshin parashikuar "kriteret e reja të estetikës e soliditetit"[3].

Me sa duket plani i Giannolit pas këtyre kritereve, kur filloi të aktualizohej, nisi me sistemimet e kuartierit të djegur të Pazarit, duke respektuar pjesërisht objektet ekzistuese e sheshet ekzistuese e duke parashikuar ndërhyrje në objekte të vogla e muret e rrethimit, ndërsa pjesa e zhvillimit të qytetit parashikohej të shtrihej në perëndim drejt detit, në vazhdimësi me Pazarin e vjetër në qytetin ekzistues. Rruga kryesore e gjerë 15m lidhte sheshin e Pazarit të Madh në verilindje me rrugën e Skelës, e cila të çonte në Portin e Vlorës. Nga ana tipologjike e konfigurimit urban, Giannoli kishte aplikuar një skemë racionale me objekte e me rrugë ortogonale, për të pasur një shfrytëzim sa më të mirë të territorit si dhe me skema fluide të qarkullimit, për një qytet që ishte në atë moment në një zhvillim të shpejtë demografik.

Gino Stefanon e Poalo Giannoli projektojnë e realizojnë midis viteve 1916 dhe 1918 një masterplan urbanistik për shtatë objekte spitalore një katëshe për të sëmurët, të cilat, nga pikëpamja arkitekturore prezantohen si volume drejtkëndore me muraturë mbajtëse një katërshe e me çati të thjeshtë me tjegulla. Pjesa e dritareve të larta evidentohet me korniza me fashatura të trajtuara me detaje te thjeshtuara. Kompleksi spitalor përmban edhe objekte të tjera më të vogla spitalore, të cilat janë të kompozuara në hapësirën veriore të zonës së përcaktuar për qendrën spitalore dhe janë të vendosura jashtë rreshtit të rregullt të shtatë padilioneve të përmendura më lart. Struktura, e cila pas disa ndërprerjeve u inaugurua në qershor të vitit 1918, fillimisht do të ishte destinuar për karantinë, më pas u konvertua përfundimisht në një spital të thjeshtë civil.

Një tjetër projekt që projektohet nga Gino Stefanon, i vitit 1916, ka të bejë me Zyrën e Doganave të Vlorës. Objekti i ri, i cili do të vendosej përgjatë rrugës Vlorë – Port, do të funksiononte si zyrë doganore por dhe njëkohësisht edhe si kazermë e "*Guardia di Finanza*". Nga ana volumetrike objekti ka një trup qendror dykatësh me çati dhe dy pjesë anësore njëkatëshe, të cilat shërbejnë edhe si ballkone të gjera. Edhe në këtë ndërtesë shohim një gjuhë neoklasike të thjeshtuar, që për më shumë anon nga stili "*Librety*", por që me siguri ka të bëjë me zgjedhje projektuese, ndoshta për të reduktuar kostot e për të pasur një realizim sa më të shpejtë e sa me korrekt në raport me projektin.

Një projekt me dimensione të konsiderueshme, por që nuk arriti të realizohej, i ishte dedikuar Bashkisë së re të Vlorës. Projekti në këtë rast ka një planimetri kuadratike me një kënd harkor e me oborr të brendshëm. Vendndodhja e këtij objekti, nuk njihet e nuk kuptohet nga planet, por nga mënyra e trajtimit të pjesës së harkuar, që përkon dhe me hyrjen kryesore të godinës që duhet të ndodhet në një kryqëzim të rëndësishëm rrugësh, ose në një shesh kryesor të ri të qytetit të Vlorës. Godina dykatëshe paraqet një frymë stilistike me karakter neoklasik me diferenca të ndryshme nga pjesa e harkut dhe dy fasadat anësore, por diferencat shihen edhe në trajtimin e çarjeve të katit përdhe dhe atij të katit të parë si në aspektin e konfigurimit formal ashtu edhe në atë të konfigurimit të fashaturave perimatrale.

Edhe projekti ambicioz i dedikuar për Gjykatën Civile të Vlorës mbetet i parealizuar dhe sikurse për projektin e Bashkisë edhe vendndodhja e saj është e panjohur. Nga ana planimetrike, objekti ka një formë "C" dhe është i ngritur në dy nivele. Objekti neoklasik me elementë të pasur dekorativë, është në simetri të plotë sipas aksit qendror dhe në pjesën e hyrjes kryesore në fasadën qendrore, për të evidentuar hyrjen, si dhe kemi një shkëputje të lehtë volumore në pjesën qendrore thuajse kuadratike në raport me lartësinë e objektit. Hyrja për në objekt kryhet nga një shkallë monumentale me dy shkallare anësore, të cilat shkojnë në katin përdhe të ngritur me gjashtë këmbe shkalle nga niveli i tokës.

Një projekt mjaft interesant është Merkata e mbuluar, e cila u inaugurua në vitin 1918. Objekti ishte tejet i veçantë në raport me shumë objekte të cilat ishin ndërtuar më parë në Vlorë por edhe me godinat e kohës të ndërtuara në Shqipëri. Ai paraqitej me një planimetri në formë trapezi dhe kishte një pozicion strategjik. Ai do të shërbente si elementi i rëndësishëm i një pjese tregtare të mbuluar, që do të tregonte fillimin e dy rrugëve të rëndësishme të Pazarit, i cili po restaurohej në ato vite pas zjarrit të madh që e përfshiu. Në pjesën e hyrjes kryesore, objekti shfaqej me një segment në formë harku të shkurtër e jo të plotë. Edhe pse me një madhësi jo fort të madhe e me lartësi një katëshe, ndërtesa është mjaft e artikuluar dhe me një sasi shumë të pasur detajesh të shpërndara në mënyrë homogjene në të gjitha anët e saj. Në vitet e mëvonshme, pas ikjes se trupave italianë, Merkates do t'i shtohej një kullë sahati e do t'i ndryshonin disa elemente të vegjël nga projekti fillestar.

Përpos Pallatit të Komandës, që u transformua në Konsullatën italiane e sot është Bashkia e Vlorës, për të cilin do të ndalemi më pas në veçanti, në

[1] L. Posca, *Architetti Italiani in Albania*, CLEAR, Roma, 2013, f. 51.

[2] Po aty, f. 57.

[3] Po aty, f. 58.

DO NOT COPY

këtë periudhe kohore kemi edhe disa objekte të projektuara si: godina e Postë – Telegraf, godina e Frigoriferit të qytetit që shërbente për prodhimin e akullit si dhe ndërtesa "*Casa alloggio ufficiali di passaggio*" ("Strehimore për zyrtarët në lëvizje"). Kjo e fundit, që filloi të ndërtohej në vitin 1917, sot është selia e Muzeut Historik të qytetit të Vlorës dhe ndodhet në afërsi të zonës së Pazarit, në rrugën që lidh me ish Konsullatën Italiane. Edhe pse me një formë të thjeshtë drejtkëndore e me një madhësi jo fort të madhe, gjuha e mbështetur në elementë historikë, kornizat që nxjerrin në pah elementin e dritareve dhe të dyerve, i japin objektit një rol të rëndësishëm përfaqësimi në raport me funksionin që kishte. Çatia me tipare rilindëse është në koherencë edhe me motivet orientale të objekteve ekzistuese përreth.

Projekteve të mësipërme u duhet shtuar një sasi e konsiderueshme e objekteve private që u ndërtuan në Vlorë, duke filluar që nga viti 1916 e që vazhduan e kompletuan edhe më vonë pjesën ekspansive që shkonte drejt portit. Në periudhën e Monarkisë, kjo pjesë ishte mjaft evidente, e cila i dha Vlorës një karakter urban ndryshe nga ajo e parë deri në momentin e Shpalljes së Pavarësisë. Në kohën e Monarkisë, në vitet tridhjetë, objekti që përfaqëson më së miri këtë periudhë është Banka Kombëtare Shqiptare e Vlorës, e projektuar nga Vittorio Ballio Morpurgo, arkitekti që projektoi Bankën Kombëtare në Tiranë dhe shumicën e filialeve në qytetet kryesore shqiptare. Objekti duket sikur është një restaurim e adaptim i një objekti ekzistues dhe është i vendosur në një shesh të rëndësishëm të Vlorës që quhet "Sheshi Pavarësia". Me një stil eklektik jo shumë të ngarkuar, që thjeshtohet nga kati përdhe drejt dy kateve te tjera më lart, Banka ka një fasadë qendrore të decentruar dhe një hyrje kryesore të dekoruar me korniza e tambur, e cila duket sikur është element më vete në raport me të. Me objektin e Bankës[4], Morpugo do merrej edhe pas vitit 1939 me një sasi të konsiderueshme vizatimesh, ku ripropozohej një fasadë e re për objektin, tashmë me terma të arkitekturës së ideologjisë totalitare, e cila u kthye në gjuhë shtetërore e qeverisë fashiste për kohën. Ai mendonte të zgjeronte ndërtesën nga pjesa anësore e saj, ku natyrisht u shoqërua me disa propozime për trajtimin e ri të interierit të Bankës, ku në katet e larta vendoseshin apartamentet e drejtorit e nëpunësve të saj. Hyrja kryesore në mes të fasadës ballore, në projektin e ri, ndodhej në raport të plotë simetrie me aksin qendror të saj. Kjo e fundit, së bashku me trajtimin e travertinit dhe tullës dekorative në dukje, do t'i rrisnin monumentalitetin objektit e mbi të gjitha do ta lidhnin me objektin tjetër akoma më të madh të bankës që mendohej se do ndërtohej përballë tij, në të njëjtin shesh, me të njëjtin stil, nga i njëjti arkitekt.

Në harkun kohor prej 1939 deri në vitin 1943, panorama urbanistike dhe arkitektonike dominohet nga projekti për planin rregullues që arkitekti fiorentin Gherardo Bosio[5,6,7] përgatit për qytetin e Vlorës. Në fakt plani i paraqitur është një plan mjaft modern e i adaptueshëm, ku edhe pse mbeti në nivelin e një plani të papërfunduar në detaje, ai kishte koncepte mjaft konkrete e të zgjidhura drejtë. Bosio mendonte që e ardhmja e qytetit të ri do të ishte bashkimi natyral me bregdetin, duke pasur një lidhje integrale e funksionale me pjesën e vjetër ekzistuese. Pasi zgjidh problemet e qarkullimit parësor me sistemimin e rrugëve kryesore që futeshin në qytet, Bosio propozon një rrjet të pastër drejtkëndor, që ndërthuret në mënyre ortogonale me rrugën që lidhte pjesën e qytetit të vjetër me Portin e tij. Ajo ishte projektuar e ndërtuar po nga italianët në vitin 1916, për të lehtësuar këtë lidhje. Ky aks merr vlerën e një elementi të fortë e

[4] A. Vokshi, *Tracce dell'Architettura Italiana in Albania*, DNA Editore, Firenze, 2014, f. 112-115.

[5] M. Giacomelli, A. Vokshi (a cura di), *Architetti e ingegneri italiani in Albania*, Edifir, Firenze, 2012, f. 81-87.

[6] C. Cresti, *Gherardo Bosio, architetto fiorentino*, Angelo Pontecorboli Editore, Firenze, 1996.

[7] Vep. Cit., f. 230-131.

gjenerues urban në formën e një bulevardi thuajse monumental në projektin e Bosios. Në pjesën bariqëndrore të këtij bulevardi të pjesës së re, Bosio propozonte një qendër të re moderne, me një shesh të madh e me objekte fetare e administrative, të cilën e quan "Piazza della Catedrale" ("Sheshi i Katedrales"). Katedralja katolike dhe godinat e tjera pasqyrojnë në vizatimet e tij një karakter të fortë të teorisë së re mbi arkitekturën italiane të "Terre d'Oltremare" ("Tokave përtej Detit"). Konfigurimi dhe shpërndarja e shesheve në të gjithë pëlhurën urbane të re apo të vjetër ishte një element mjaft pozitiv në propozimet e planit, gjë që kishte munguar në zhvillimet urbane të qytetit deri në atë kohë. Ato zakonisht ishin të konfiguruara përpara disa objekteve me funksione të veçanta apo me një arkitekturë interesante në qytet.

Qyteti i të ardhmes në raport me aksin mendohej të zhvillohej më shumë nga ana jugore e tij, e cila ishte pjesa më piktoreske nga pikëpamja e peizazhit, duke shfrytëzuar edhe pjesën me interesante të bregdetit. Vlora ishte edhe në atë kohë porti i dytë për nga rëndësia, pas atij të Durrësit dhe për pozicionin që ka, paraqiste potencial të lartë strategjik për Italinë. Për këtë, një rëndësi të madhe i jepet portit të qytetit, i cili në aksonometrinë e vizatuar me mjeshtri zë një hapësirë të madhe në raport me qytetin, nga ana e zonës së "Ujit të Ftohtë".

Pas Luftës së Dytë Botërore, projekti i Bosios, ashtu si të gjitha planet rregulluese të qyteteve të tjera të realizuara në këtë kohë, u cilësuan si projekte fashiste e u hodhën poshtë si të pavlera. Por në rastin e Vlorës, pjesë të këtij plani u ripropozuan në heshtje, ku me një shikim të shpejtë dallohen mbi hartat e sotme konfigurimi i rrugëve apo dhe prezenca e stadiumit në atë pikë.

Ndërkohë, veprat arkitektetonike të ndërtuara në ato njëzet e shtatë vite vazhdojnë të ndërthuren bukur me arkitekturën autoktone apo atë pjesë të qytetit të ndërtuar në vitet e diktaturës komuniste. Padyshim që kjo trashëgimi ruhet nga shteti e nga qytetarët e Vlorës, të cilët e vlerësojnë shumë prezencën e tyre në qytetin e tyre edhe si një bashkim i dy kulturave të dy vendeve, pavarësisht kohës apo kontekstit kur u ndërtuan. Përgjatë këtij rrugëtimi, arkitektët dhe inxhinierët italianë treguan një kujdes të madh për kulturën dhe shpirtin e vendit "Genius Loci", për të cilin ata po ndërhynin, ku edhe pse me financa të reduktuara, kualiteti estetik e funksional i ndërtesave ishte i një niveli mjaft të lartë.

Pallati i Komandës / Konsullata Italiane e Vlorës / sot Bashkia Vlorë

Selia e Bashkisë së sotme të Vlorës, edhe në momentin që flasim, vazhdon të jetë godina më e spikatur e qytetit, edhe pse në nëntor të vitit 2016 mbush plot një shekull që nga dita e fillimit të projektimit dhe të realizimit të saj. Edhe në historinë e arkitekturës shqiptare të shekujve të fundit mund të themi që ka qenë objekti i parë i këtyre përmasave jo vetëm në Vlorë, por edhe në Shqipëri, i realizuar sipas një stili neoklasik rilindës. Objekti fillimisht lindi si nevojë e domosdoshme funksionale e ekonomike për një seli të re përfaqësimi për Komandën ushtarake italiane prezente në Vlorë, e cila deri në atë moment ndodhej në një godinë ekzistuese të marrë me qira që nga viti 1914. Pas tërheqjes së trupave ushtarake në vitin 1920, ajo u kthye në Konsullatën Italiane të Vlorës deri në vitin 1943 dhe pas çlirimit ajo u kthye në Bashkinë e Qytetit.

Godina u mendua të ndërtohej në një zonë qendrore strategjike në raport me qytetin e vjetër, të vendosur në një kryqëzim rrugësh që shkonin për Drashovicë e Beshtrovë, të cilat më pas do të linin hapësirë edhe për formimin e një sheshi para vetë godinës. Njëra prej rrugëve të çonte në mënyrë direkte në Pazarin e Vjetër, i cili në ato momente po rikonstruktohej pas zjarrit të rënë. Projekti i selisë së komandës i besohet arkitektit ushtarak Luigi Berretti[8] në nëntor të vitit 1916. Me sa shihet, arkitekti është i detyruar të ndjekë linjat e kufirit të pronës të vënë ne dispozicion, duke nxjerrë kështu një planimetri

[8] L. Posca, *Architetti Italiani in Albania*, CLEAR, Roma, 2013, f. 63.

DO NOT COPY

lineare të shtrirë në mënyrë simetrike në të dy anët në raport me aksin qendror, duke formuar një "U" me krahë me kënde mjaft të gjëra të shtrira përgjatë rrugëve, në raport me fasadën kryesore.

Godina u projektua me një lartësi të njëtrajtshme me tre kate, ku së bashku me çatinë arrinte kuotën rreth 17m. Vetëm pak më vonë objektit, gjatë momentit të ndërtimit, do t'i shtohej edhe një ndërtesë njëkatëshe në harmoni të plotë me godinën trekatëshe dhe do të shërbente nga pikëpamja funksionale si mensë në katin përdhe dhe si tarracë e katit të parë në anën lindore të saj. Ndërtesa në vetvete është më e tërhequr në raport me volumin drejtkëndor tek pjesa e fasadës kryesore, ku ndodhet hyrja kryesore për në objekt. Ai është i mbështetur mbi një lozhe mjaft të artikuluar me pesë çarje në ballinë, 3 me harqe të plota e dy drejtkëndore, si dhe me dy harqe të plota nga pjesa anësore, ku pjesa e hyrjes nga para kryhet vetëm në harkun qendror e në dy çarjet drejtkëndore anësore. Kati i përfaqësimit është i ngritur rreth 50 cm në raport me tokën tek pjesa e hyrjes, duke e mundësuar atë me 4 shkallë dhe 75 cm në brendësi të objektit.

Në raport me të gjitha objektet e ndërtuara në atë periudhë, kjo godinë, edhe për vlerat formale dhe estetike që duhej të paraqiste, u zgjodh si objekti që duhej të mishëronte më së miri stilin dhe ekselencën e artit italian të të ndërtuarit e të përfaqësimit. Gjuha e saj arkitektonike e tejet e ngarkuar me elementë të ndryshëm dekorativë të tipeve të ndryshme rridhte nga një eklektizëm që më së shumti derivonte nga stili i rilindjes italiane, i bashkuar me elementë floreale dhe skulptoreske të kohëve të ndryshme. Përveç pjesës së artikuluar e të detajuar në trupin e dalë tek hyrja qendrore, në të tre fasadat kryesore me pamje nga sheshi kemi trajtim të njëjtë në të gjithë gjatësinë e tyre perimetrale.

Ndryshojnë në rregulla brenda stilit trajtimet e dekorit dhe fashaturat e dritareve në katet e ndryshme, të cilat janë trajtuar edhe në baze të rëndësisë së përfaqësimit të katit. Në katin përdhe, kornizat e dritareve ndajnë "*bunjaton*" e vazhduar e të lehtë me prezencën e tyre të kombinuar me elementë florealë, si dhe me kolonat jonike në pjesën e hyrjes. Në katin e parë, po në pjesën e hyrjes kemi prezencën e kolonave korintike dhe dritares me hark të plotë e me guackë sipër dhe në pjesët anësore kombinohen me dritare dekore me timpanet e arkitrarë me kokën e Minervës në qendër. Një fashë dekorative tejet e ngarkuar me elementë të ndryshëm gjeometrikë e florealë ndan katin e parë dhe atë të fundit, i cili ka një trajtim më të thjeshtuar në raport me dy katet e mëposhtme. Me të njëjtat elementë janë trajtuar edhe dy fasadat anësore, të cilat kanë respektivisht nga tre çarje secila. Vetëm në pjesën lindore, trupi i cili u shtua më vonë për mensë, ka një trajtim me dritare me harqe të plota të ndryshme nga ritmi e nga konfigurimi i dritareve të tjera në ballinë të godinës. Ato kanë një trajtim akoma më të detajuar e të pasur së ajo që ndodhet në pjesën ngjitur në të njëjtin kat, që shërben për t'i dhënë më shumë vlerë funksionit që ka.

Pjesa e çatisë ka një dalje në formë strehe prej afro 240 cm nga objekti dhe shtrihet vetëm në dy pjesët anësore. Në pjesën qendrore është lënë një tarracë e praktikueshme e përmasave të konsiderueshme, e cila korrespondon me volumin e dalë në pjesën e hyrjes. Ndërkohë që nga pjesa e brendshme ai korrespondon edhe me pjesën e atriumit të brendshëm, i cili fut dritë në të tre katet. Atriumi është i mbuluar në mbarimin e katit të parë me një *"lucernar"* me xham dhe hekur, duke krijuar në katin përdhe një hapësire me volum dyfish bosh, i cili lejon depërtimin e dritës zenitale nga sipër, duke krijuar lojë dritë-hijesh në momente të ndryshme të ditës. Loja volumore në brendësi të atriumit kombinohet midis kolonave jonike dhe parmakëve të trashë e të trajtuar me kolona të vogla ne forme birilash, ku edhe këto i shërbejnë idesë së krijimit të një tjetër loje dritë-hijesh e këndvështrimesh të ndryshme.

Tre katet mbi tokë ishin të sistemuara me 53 ambiente për zyra dhe një sallon të madh prej 63m^2 për mbledhje. Kati gjysmë nën dhé ndodhet

në kuotën 170 cm më thellë se kuota e terrenit dhe nuk ka dritare në fasadë. Në pjesën e pasme fasada është e trajtuar në mënyrë më të thjeshtuar se në fasadat e tjera. Dritaret në këtë anë janë të konfiguruara shumë më thjeshtë se të tre llojet e dritareve që gjenden në fasadat që shohin në rrugë. Nga pikëpamja konstruktive, ky objekt, së bashku me Merkatën dhe disa objekte të tjerë, po ndërtoheshin me beton të armuar nga inxhinieret italianë, gjë që ishte një gjë mjaft inovative për kohën, por edhe për kushtet shqiptare në të cilat për të parën herë operohej më këto materiale e teknologji, të kthyera në normalitet në vitet e mëvonshme.



Fig.1 Planimetria e Vlorës, 1916

DO NOT COPY



Fig.2 P.Giannoli, Plani Rregullues i Vlorës, 1916



Fig. 3 P. Giannoli, G. Steffanon, Spitali Civil i Vlorës, 1916 - 18



Fig. 4. L. Berretti, Selia e Komandës në Vlorë (sot Bashkia e Vlorës), foto e kohës, 1916 - 18



Fig. 4.a L. Berretti, Selia e Komandës në Vlorë (sot Bashkia e Vlorës), plani i katit përdhe, 1916 – 18

DO NOT COPY



Fig. 5 Tregu i Mbuluar i Vlorës, 1916-17



Fig. 6 Bashkia e Vlorës, kati përdhe, 1918



Fig. 7 Projekti i Gjykatës së Vlorës, kati përdhe, 1918



Fig. 8 Shtëpia e Oficerëve, Vlorë, 1916-18



Fig. 9 V.B. Morpurgo, Banka Kombëtare e Shqipërisë, 1928-29

DO NOT COPY



Fig. 10 V.B. Morpurgo, Banka Kombëtare e Shqipërisë, 1941



Fig. 11 G. Bosio, Plani i Qytetit të Vlorës, perspektiva e qytetit, 1939



Fig. 12 G. Bosio, Plani i Qytetit të Vlorës, skema e trafikut, 1939

DO NOT COPY



Fig. 13 G. Bosio, Sheshi i Katedrales së Vlorës, perspektivë, 1939



Fig. 14 G. Bosio, Plani i Qytetit të Vlorës, Panel me një seri projektesh të ekspozuara në një ekspozitën e organizuar nga Bosio, 1940



Fig. 15 G. Bosio, Plani i Qytetit të Vlorës, perspektiva e rrugës së portit, 1939



Fig. 16 L. Berretti, Selia e Komandës në Vlorë (sot Bashkia e Vlorës), foto 2017 (A.Vokshi)



Fig. 17 L. Berretti, Selia e Komandës në Vlorë (sot Bashkia e Vlorës), foto 2017 (A.Vokshi)



Fig. 18 Vlora, foto ajrore Selia e Komandës në Vlorë (sot Bashkia e Vlorës) e vitit 1936, (Arkivi i IGM)

DO NOT COPY



Fig. 19 Vlora, foto ajrore e strukturës urbane të qytetit e vitit 1936, (Arkivi i IGM)

DO NOT COPY

Prof. Asoc. Armand VOKSHI

PROJECTS OF ITALIAN ARCHITECTS AND ENGINEERS IN VLORA DURING THE PERIOD 1916-43

Abstract

This research seeks to identify urban and architectural developments in a very important part of the city of Vlora, realized at the beginning of the last century. They are closely related to the historical and political developments in this city, directly after the declaration of independence of Albania, where Vlora, after the act of raising the flag, had taken the role of the Albanian capital until its occupation in 1914 by the Italian army. Leaving aside the critical moments of the military vacation of Vlora from Italy, which has been repeated in 2 different periods, the years 1916 - '20 and 1939 - '43, at the end of professional considerations, from the point of view of urban and architectural developments, they were a significant moment also for the identity and urban character of today's city.

First the research deals with urban studies of the city at two different times through urban plans. Vlora turns out to be the first city in the urban history of Albania for which an urban plan is realized in 1916 by Italian engineers. This plan also forms the core of the old city center.

Secondly, the system of typical traditional autochthonous and oriental constructions built until the twenties, where a part was burned by the fire that fell in that period, was then added to a series of public buildings and villas designed by Italian architects, as well as by talented Albanian architects, who had been trained in Western schools. The architectural and functional values of these villas are an important leap in the history of Albanian architecture and already constitute the main memory base of the city of Vlora today. The architectural language used also determined the future of architecture in this city as well as that of the way of life.

This research highlights all the key moments of these important objects and elements, integral parts of our history and the spirit of the country. Knowing their characteristics pushes their conservation and consolidation in the city of Vlora.



Prof. Dr. Aleksandër MEKSI

PIRRO THOMO, PËRMBLEDHJE STUDIMESH E KUMTESASH
Tiranë, 2020

DO NOT COPY

Nëpërmjet këtij botimi i bëhet e njohur opinionit shkencor shqiptar veprimtaria studimore e studiuesit Pirro Thomo të kryer jashtë shtetit nga viti 1991 deri në vitin 2015, i cili përmbledh artikuj e kumtesa të referuara në konferenca e simpoziume kombëtare e ndërkombëtare e të botuara në periodikë, akte e praktika të aktiviteteve shkencore. Boshllëqet në përditësimin e bibliografive, vështirësia e sigurimit të periodikëve nga bota e rajoni, mosbotimi gjithmonë i praktikave të konferencave dhe simpoziumeve shkencore, por dhe, sidomos, vonesa e hedhjes në internet e literaturës dhe veprimtarive shkencore, sidomos ato të viteve të hershme, i justifikojnë mungesat e informimit për këtë veprimtari. Është një nismë që e kam menduar gjithnjë këto vitet e fundit sepse nga autorë të këtushëm po dërgohen e botohen jashtë artikuj studimorë, ndërkohë që auditori vendas njihet me vonesë ose aspak me to. Dhe në këtë aspekt kjo përmbledhje artikujsh do përgëzuar si një nismë pozitive dhe do të urojmë të shërbejë si model.

Në këtë përmbledhje prej 350 faqesh dhe mbi 300 ilustrimesh grafike e fotografike janë përfshirë 14 artikuj e kumtesa me subjekte trashëgiminë kulturore të vendit tonë, por edhe disa të tjera që ilustrojnë punë të kryera nga autori në Greqi.

Një numër artikuj e kumtesash në këtë përmbledhës kanë synuar promovimin e pasurive kulturore të Shqipërisë, pak të njohura nga opinioni shkencor i huaj, si kumtesat mbi Arkitekturën Pasbizantine, Pikturën e shpellave eremite të liqenit të Prespës, Ndërtimet prej druri, Banesat me kullë, Kishat e Voskopojës etj. Kumtesa "Tiparet ε arkitekturës pasbizantine në Shqipëri dhe inkuadrimi i saj në arkitekturën pasbizantine të Ballkanit", mbajtur në Simpoziumin në Universitetin e Minnesotës, USA, ***An Unknown Territory,*** *The Art and Architecture of Albania in a Balkan Context,* ishte një sprovë para opinionit shkencor ndërkombëtar para botimit të monografisë *Kishat Pasbizantine në Shqipërinë e Jugut.* Krahas dhënies së një tabloje mbi pasurinë e shembujve të ruajtur të kësaj gjinie, në kumtesë përqendrohet vëmendja në klasifikimin tipologjik, shpërndarjen gjeografike të tipologjisë, si dhe bëhet një përpjekje për përcaktimin e rrathëve më të gjerë tipologjike në bazë të ngjashmërive me monumentet e vendeve fqinje.

Në kumtesën mbi Monumente Bizantine në Prespën e Madhe, mbajtur në Konferencën *Byzantine Macedonia. Art, Architecture, Music and Hagiography* në Melborn të Australisë, trajtohen pikturat murale të shpellave eremite. Piktura e kishës së Shën Marisë në ishullin e pabanuar të Maligradit me kohë kishte tërhequr vëmendjen e studiuesve të huaj, nga të cilët, autorët e fundit si G. Millet dhe V. Llazariev e kanë cilësuar si përfaqësuese tipike e rrymës artistike të Rilindjes Paleologe, ndërsa akademiku serb Djuric e klasifikon pikturën e

Maligradit si të së njëjtës atelieje që ka ekzekutuar dhe pikturën e Mborjes dhe të Shën Thanasit të Muzakajve të Kostur. Por një analizë të plotë të pikturës së kishës së Maligradit i ka bërë studiuesja Dh. Dhamo dhe ato të shpellave eremite, Th. Popa në shtypin shkencor vendas, ndërsa kësaj radhe bëhen të njohura edhe në shtypin shkencor botëror. Në kumtesë jepet një interpretim i ri për pikturën e shpellës së Shën Marisë dhe një saktësim mbi datimin e pikturës së shpellës së "Arhangjelit".

Dy kumtesa janë mbajtur mbi historinë e Voskopojës. Në simpoziumin kushtuar Voskopojës në Selanik, ku ishin ftuar dhe shumë personalitete me origjinë voskopojare nga e gjithë bota, u dha një tablo e plotë mbi vlerat arkitektonike e artistike të kishave të Voskopojës. Në simpoziumin tjetër mbi Komunikimin dhe transportin në periudhën paraindustriale opinioni shkencor u njoh me marrëdhëniet ekonomike e tregtare të Voskopojës me botën e jashtme, me Venedikun në krye dhe më pas me qendrat e Evropës Qendrore, me kryeqendrën në Vjenë.

"Ndërtimet me dru në Shqipëri" ishte tema e zgjedhur për të referuar në *Table ronde* organizuar nga Instituti Francez i Studimeve Anatolike dhe Universiteti Teknik i Stambollit. Banesat në Shqipëri njiheshin nga ndërtimi i tyre përgjithësisht me gurë, me arritje të dukshme në banesat e Gjirokastrës apo në kullat e Veriut, ndërkohë që ndërtimet me dru ishin shumë pak të njohura, Në kumtese u vu theksi në realizimet e larta të përdorimit të drurit si element konstruktiv, siç i gjejmë në banesat e Hasit, apo në konstruksionet e çardakëve në tipin e banesave të hapura në Shkodër, Berat e gjetkë p.sh., por dhe si përpunime dekorative të elementeve konstruktive, ose thjesht si elemente dekorative në tavanet, musëndrat, dollapët e murit etj.

Tema të tjera lidhur me arkitekturën popullore është kumtesa "Tiparet e reja në arkitekturën fshatare të gjysmës së dytë të shek., XIX, fillimit të shek. XX", mbajtur në Kongresin Ndërkombëtar të Arkitekturës Vernakulare në Ballkan, në Veria të Greqisë, Ndryshe nga arkitektura e banesës qytetare e kësaj periudhe që është gjerësisht e trajtuar, ndikimi i kushteve të reja ekonomiko-shoqërore që manifestohen në mbarë vendet ballkanike në arkitekturën fshatare ishte lënë jashtë vëmendjes së studiuesve.

Kumtesa tjetër "Banesa me kullë në Shqipëri", mbajtur në Simposiumin Ndërkombëtar *Arkitektura Tradicionale Ballkanike* në, Selanik, trajton një mënyrë të veçantë të fortifikimit të banesë me anë të kullëzave ngjitur ose mbi banesën e familjes. Ky fenomen nuk është i lidhur me ndonjë tip të caktuar banese, por e gjejmë të aplikuar në tipa të ndryshme banese dhe në çdo periudhë.

Në të tjera artikuj vihen në dukje marrëdhëniet kulturore midis popujve fqinjë, siç ishte Inkuadrimi i arkitekturës kishtare në atë të Ballkanit, Veprimtaria e piktorëve pasbizantinë në hapësirën ballkanike etj.

Në këtë të fundit, mbajtur në Simpoziumin Ndërkombëtar, *Kultura dhe Hapësira në Ballkan në shek. 17-20*, vihet në dukje veprimtaria e piktorit të njohur të shek. XVI, Onufrit, edhe në kishën e Apostujve të Shenjtë në Kostur, të piktorit të shek. XVIII, David Selenica në Manastirin e Lavrës së Madhe në Malin e Shenjtë, në Selanik e Kostur, të piktorëve të tjerë të shek. XVIII vëllezërve korçarë Kostandin e Athanas Zografi në manastiret e Malit të Shenjtë të Filotheut, Krsiropotamit, skitit të Shën Anës etj. Po kështu, piktorë nga trevat e Greqisë, si piktorët nga Linotopi që kanë stolisur shumë kisha në rajonin e Gjirokastrës, nga Zerma që kanë pikturuar kishat e rajonit të Sarandës, apo nga Agrafa si autorë të pikturës së kishës së Shën Marisë në Voskopojë etj.

Diskutimi në aktivitetet ndërkombëtare mbi problemet aktuale të kritereve të vlerësimit të Qendrave Historike, apo të rijetëzimit, janë kumtesat mbi Vlerësimin dhe vënien në mbrojtje të Qendrës Historike të qytetit të Korçës, mbajtur në Kongresin Ndërkombëtar *Ndërhyrje arkitektonike në Qendrat Historike të qyteteve*, në Veria të Greqisë, apo

Problemet e restaurimit dhe rijetëzimit të pazarit të Korçës, mbajtur në Simpoziumin Ndërkombëtar *Restaurimi dhe Rrjetëzimi i Ndërtesave Historike dhe Qyteteve),* Selanik me bashkautor Ark. Rest. K. Kallamata, shtjellojnë praktikën shqiptare në vlerësimin e Qendrave Historikë dhe kriteret për rijetëzimin e ansambleve të vëna në mbrojtje.

Përvoja personale mbi problemet e restaurimit, janë objekt i një grupi të tretë artikujsh e kumtesash. Kumtesa Restaurimi i varrit të Hortaxhit-Rotonda, Selanik, referuar në simpoziumin me temë shumë aktuale, *Ndërhyrje të përmbajtura dhe mbrojtja e ndërtesave historike,* tërhiqte vëmendjen në ruajtjen e një prej parimeve bazë të restaurimit, në ruajtjen e autenticitetit të monumenteve. Në rastin konkret kjo është arritur me rikthimin në pozicionin fillestar të elementeve konstruktive të deformuara.

Kumtesa "A mund t'ia zgjasim jetën elementëve prej druri?", temë e trajtuar në simpoziumin *Druri në konstruksionet ekzistuese, teknologji të vjetra dhe të reja,* nisur nga përvoja e viteve të fundit jepen disa mendime për konservimin e elementeve konstruktive e dekorative dhe bëhet gjithashtu një apel specialistëve të fushave të tjera për bashkëpunim për mbrojtjen e kësaj vlere madhore të trashëgimisë ndërtimore.

Në artikullin "Dokumentimi arkitektonik i kishës Fjetja e Shën Marisë në Zervat të Gjirokastrës", botuar në revistën *Monumentet dhe Mjedisi*, i cili përbën një pjesë integrale të projektit të restaurimit, jepet puna për dokumentimin arkitektonik të objektit, sondazhet e kryera, përcaktimin e fazave historike, të cilat do të shërbenin si bazë për të përcaktuar dhe masat e propozuara për ndërhyrjet restauruese.

Temat e artikujve e kumtesave përfshijnë një diapazon të gjerë, që tregojnë njëherazi detyrat dhe interesat e autorit në kërkimet e tija në fushat e ndryshme të studimit, mbrojtjes e restaurimit, përherë të trajtuara me të njëjtin kërkesa e nivel të hulumtimit, çka flet për përgatitjen e tij dhe përkushtimin ndaj trashëgimisë kulturore të vendit tonë.

Shpreh bindjen se ky botim, një shembull që duhet ndjekur, do të jetë i dobishëm për probleme që mbetën edhe sot aktuale, si për njohjen e studimin e gjinive të ndryshme të trashëgimisë sonë kulturore, ashtu dhe për praktikën restauruese.

DO NOT COPY

Prof. Aleksandër MEKSI

PIRRO THOMO, "COLLECTION OF ARTICLES AND PAPERS 1991-2015", Tirana, 2020

New publication entitled: "Collection of articles and papers 1991-2015", authored by Prof. Dr. Pirro Thomo, is a summary of the author's scientific activity outside Albania, during the years in emigration.

Articles and papers published or held in scientific activities during the years 1991-2015, included in this summary have aimed at promoting the cultural assets of Albania, little known by foreign scientific opinion, such as: papers on Post-Byzantine Architecture, Cave Painting hermitages of Prespa Lake, wooden constructions, dwellings with towers, churches of Voskopoja, etc.

In other articles included in this publication, the cultural relations between the neighboring peoples are noted, such as: The incorporation of the ecclesiastical architecture in that of the Balkans, The activity of the post-Byzantine painters in the Balkan space, etc. Discussion in international activities on the current problems of the criteria for the evaluation of Historic Centers, or revitalization, are the papers on the Evaluation and Protection of the Historic Center of the city of Korça, or the problems of restoration and revitalization of the Korça Bazaar.

Personal experience on restoration problems, such as the preservation of authenticity or historical stages were the topics touched in the papers on the restoration of the Hortage tomb in Thessaloniki, the church of Zervat, or the Conservation of wooden elements. This publication contributes to the further fulfillment of the requests of colleagues in the field and becomes extremely useful for a series of issues that remain current today.

Dr. Era XHAFERAJ

DRITAN ÇOKU, GENCI SAMIMI, *KISHAT E KALASË SË BERATIT. ARKEOLOGJI – HISTORI – ARKITEKTURË – RESTAURIM*, BOTIMET "PEGI", BERAT, 2019

Rëndësia e Beratit, si një qendër e madhe kulturore shqiptare përgjatë gjithë periudhave historike është theksuar nëpërmjet një morie publikimesh, të cilat kishin si qëllim të prezantonin publikun me historinë e qytetit[1], arkitekturën e tij mjaft të ruajtur kishtare[2], vernakulare[3], të kultit mysliman[4], programet e gjera me pikturë murale që zbukurojnë kishat e tij[5], dekorimet e pasura skulpturore që gjenden të integruara në muraturën e monumenteve të mëvonshme, si dëshmi unike të fazave të shumta historike të qytetit[6], ikonostasët dhe elementët e tjerë të brendësisë, ikonat[7], si dhe kodikët e rrallë[8] dhe dëshmitë e shumta epigrafike[9].

Vitet e fundit kanë dalë në dritë disa publikime dhe janë organizuar aktivitete të rëndësishme, si ekspozita tematike si ajo e titulluar "*Uji në Arte dhe Zejtari në Rajonin e Beratit, nga shek. IV para Krishtit deri në shek. XIX pas Krishtit*", të cilat kanë kontribuuar në prezantimin thesareve artistike të Beratit në veçanti dhe të Shqipërisë në përgjithësi[10]. Megjithatë, përqendrimi i dendur i monumenteve arkitekturore dhe artistike të Shqipërisë, historia e pasur dhe e larmishme, nuk ezaurohet asnjëherë dhe mbetet gjithmonë për t'u

[1] Ndër titujt kryesorë rendisim: A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, *Berati, historia dhe arkitektura*, Tiranë, 1988; F. Duka, *Berati në kohën osmane (shek. XVI – XVIII)*, Tiranë, 2001; A. Sulo, *Qyteti Muze i Beratit*, Berat, 1997; P. Xhufi, *Nga Paleologët tek Muzakajt. Berati dhe Vlora në shek. XII – XV*, Tiranë 2009; *Muzakajt e Beratit* (I Musachi di Berat / përkth. Mark Gjergji), Istituto Universitario di Studi Euroafricani, Paris, Lecce, 1996; A: Sulo, *Berat - shek.XV: historia në Defterin Turk*, Tiranë, 2005; C. Patsch, *Das Sandschak Berat in Albanien*, Wien, 1904; A. Alexoudis, *Σύντομος ιστορική περιγραφή της ιεράς μητροπόλεως Βελεγράδων και της υπό πνευματικήν αυτής δικαιοδοσίαν*, Korfuz, 1868; etj.

[2] Monumentet kishtare kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, vendas dhe të huaj, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në publikime të ndryshme. A. Meksi, "Kishat bizantine të Beratit", *Monumentet* 2, 1990, f. 37 – 43; Po ai, *Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VI – XV)*, Tiranë

[3] G. Strazimiri, *Berati qytet – muze* [Album], Tiranë, 1987.

[4] Objektet e kultit islam në Berat janë trajtuar qoftë nën kuadrin e monografive kushtuar arkitekturës së xhamive, qoftë në artikuj të veçantë. Shih: A. Meksi, *Xhamitë e Shqipërisë. Historia, Arkitektura (shek. XV – XIX)*, Tiranë, 2015; Së bashku me një histori të qytetit të periudhës osmane shih: M. Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri 1385 – 1912*, (përkthyer nga Holta Vrioni) Stamboll 2012, f. 59 – 113.

[5] I. Vitaliotis, "Από την Κύπρο στην Αλβανία: Ο μεταβυζαντινός ζωγράφος Ονούφριος ο Κύπριος θεωρούμενος στο πλαίσιο της "Σχολής του Βερατίου"", Επετηρίδα Κέντρου Μελετών Ιεράς Μονής Κύκκου 12, Λευκωσία 2019, 233 – 278; H. Nallbani, "Pikturat mesjetare dhe piktorët në kishat e kalasë së qytetit të Beratit", *2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri*, Tiranë, 2003, f. 179 – 186; Berati dhe piktura në krahinën e Myzeqesë në shek. XVIII – XIX, *Monumentet* 2, 1990, f. 163 – 166.

[6] G. Koch, "Dëshmi të periudhës së hershme bizantine në Berat", *Monumentet* 2, 1990, f. 113 – 120.

[7] Y. Drishti, L. Çika, *Ikona të Beratit: koleksioni i Muzeut Kombëtar Onufri, Berat, shekulli XIV-XX*, Tiranë, 2004.

[8] P. Battifol, *Les manuscrits grec du Berat d'Albanie et le Codex Purpureus*, Paris, 1886; *Kodikët e Shqipërisë*, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë, 2003; Sh. Sinani, *Beratinus: Antropologji kulturore*, Tiranë, 2004;

[9] Th. Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë, 1998.

[10] *Water in Arts and Crafts of the Berat Region, 4th c. B.C. to 19th c. A.D. – Uji në Arte dhe Zejtari në Rajonin e Beratit, nga shek. IV para Krishtit deri në shek. XIX pas Krishtit*, cat. exp., éd. K. Giakoumis, Tirana 2015.

DOKUMENT



njohur nga publiku vendas dhe i huaj, studiuesit e historisë, artit dhe arkitekturës.

Libri "Kishat e Kalasë së Beratit" vjen si një ndër monografitë më të fundit kushtuar një aspekti të veçantë dhe njëkohësisht shumëfish domethënës dhe interesant të historisë së qytetit, siç janë ndërtimet e kultit të krishterë. Në këtë botim, kisha, si monumenti më përfaqësues i trashëguar nga periudha bizantine, por dhe një institucion që vazhdoi të influenconte dhe të kishte ndikim të pakundërshtueshëm në shoqërinë e shekujve të sundimit osman në Shqipëri, synohet të vlerësohet si nga pikëpamja e të dhënave arkeologjike, historike, edhe në pikëpamje të elementeve dekorative - si piktura dhe skulptura, tipologjisë, trajtimit teknik dhe materialeve ndërtimore. Këto pretendime të autorëve evidentohen edhe në organizimin e librit në dy kapituj, secili prej të cilëve paraqet një entitet të pavarur.

Kapitulli i parë merr në konsideratë historinë e përgjithshme të Krishterimit dhe zhvillimin e tij në qytetin e Beratit, duke u përpjekur të sintetizojë pjesë të veçanta, për të krijuar një panoramë të përgjithshme rreth këtij fenomeni.

Kapitulli i dytë i kushtohet në pjesën më të madhe monumenteve të veçanta. Fillimisht janë renditur në mënyrë të përmbledhur të dhëna të përftuara nga arkeologjia, të cilat na japin informacione mbi një periudhë të pa dokumentuar mirë të historisë së qytetit, siç është ajo e Antikitetit të Vonë, e varrosur në të shumtën e rasteve nën ndërtimet e fazave të mëvonshme, dhe zbuluar në mënyrë sporadike dhe fragmentare në formën e gjetjeve rastësore, siç është rasti i gjurmëve të mozaikut në kala, me motive tipike të repertorit paleokristian, i cili sugjeron ekzistencën dikur të një bazilike. Elemente të tjera të skulpturës dekorative, qoftë të ripërdorura si material ndërtimor në ndërtimet e mëvonshme pasbizantine, përbëjnë një tjetër dëshmi të fazave historike që ka përjetuar qyteti. Pjesa e mbetur e tekstit i referohet kishave bizantine dhe pasbizantine, me një fokus në arkitekturën e tyre dhe elementëve të tjerë si piktura, ndërhyrjet restauruese, etj.

Në një këndvështrim të përgjithshëm, libri meriton të përshëndetet si një mundësi për një audiencë më të gjerë, e cila do të ketë mundësi nëpërmjet leximit të tij të vlerësojnë atë që në pamje të parë mund të duket vetëm si një trashëgimi e krishterë, por në fakt, mund të trajtohet edhe më gjerë si një dëshmi historike, një dokument, një qëndrim social, një koncept individual ose një lexim personal i kontekstit apo ngjarjeve të caktuara historike, marrëdhënieve ose skemave ekonomike, tregues pushteti etj. Një tjetër risi e këtij botimi mund të konsiderohet përfshirja e monumenteve, të cilat tashmë janë zhdukur ose ruhen pjesërisht, duke krijuar një panoramë më të plotë rreth objekteve të

kultit të krishterë të ndërtuar në lagjen kala, madje duke plotësuar në disa raste të dhënat dokumentare. Këto të dhëna i japin publikut një vështrim tërësor jo vetëm mbi shpërndarjen e kishave, por shërbejnë si një lloj statistike e shenjtëve që ato i blatoheshin dhe që veneroheshin më tepër ndër banorët e lagjes me shumicë të krishterë të Beratit.

Megjithatë, pavarësisht kontributit të këtij botimi, do të kishim disa sugjerime, të cilat mund t'i shërbenin autorëve në rastin e një ribotimi apo në studimet e tyre të ardhshme.

Në monografi, do të dëshironim të ishte më i plotë kujdesi ndaj burimit parësor. Gjithashtu, do t'a konsideronim më të udhës ndjekjen e një kuadri kronologjik, nga mozaikët paleokristianë te kishat mesjetare/bizantine dhe më pas te ato pasbizantine. Arkitektura dhe dekorimet e brendshme janë prezantuar nga një numër i gjerë fotografish dhe skicash të shkëlqyera, por mendojmë që monografia mbi kishat e Beratit do të pasurohej së tepërmi edhe nga vlerësimi i rolit të pikturës murale, si komplementare dhe e pandashme me arkitekturën. Kjo kërkesë vjen nga konsideratat që i japin Beratit pozicioni si qendër e rëndësishme e veprimtarisë artistike në shumësinë e "shkollave" ose rrymave të ndryshme stilistikore/tipologjike, qoftë nga pikëpamja e arkitekturës edhe e pikturës, si dhe duke i dhënë rëndësi aderimit të qytetit dhe rolit të tij në promovimin e stilit paleolog të shek. XIII-XIV.

Së fundmi, pavarësisht sugjerimeve të shprehura në këtë recencë, monografia e Genci Samimit dhe e Dritan Çokut mbi kishat e Beratit përfaqëson një vlerë të shtuar në korpusin e literaturës së arkitekturës dhe artit bizantin dhe pasbizantin në qytetin e Beratit, duke i shërbyer lexuesit të interesuar si një manual orientues për të përfituar të dhëna të përmbledhura jo vetëm rreth kishave, evoluimin dhe zhvillimin e tyre arkitekturor dhe tipologjik, por edhe ndërhyrjeve restauruese ndër vite. Njëkohësisht libri është i pasur me material ilustrues, si fotografi, planimetri, të pasqyruara në cilësi, të cilat ndonëse në disa raste lipsej verifikimi nga ana e autorëve për saktësinë e emërtimeve, dokumentojnë dhe promovojnë në mënyrë adekuate trashëgiminë kishtare të Beratit.

DO NOT COPY

PhD. Era XHAFERAJ

DRITAN ÇOKU, GENCI SAMIMI, "CHURCHES OF THE CASTLE OF BERAT. ARCHEOLOGY - HISTORY - ARCHITECTURE - RESTORATION", BOTIMET "PEGI", BERAT, 2019

BOOK REVIEW

The book "Churches of the Castle of Berat" comes as one of the latest monographs dedicated to a special and at the same time multiple significant and interesting aspect of the history of the city of Berat, such as the Christian cult constructions.

In this publication, the church, as the most representative monument inherited from the Byzantine period, but also as an institution that continued to influence and have undeniable influence on the society during the centuries of Ottoman rule in Albania, is intended to be evaluated from the point of view of archaeological and historical data, even in terms of decorative elements - such as paintings and sculptures, typology, technical treatment and building materials. The book is organized into two chapters, each of which represents an independent entity.

The first chapter considers the general history of Christianity and its development in the city of Berat, trying to synthesize specific parts and to create a general overview of this phenomenon.

The second chapter is devoted to the individual monuments. The rest of the text refers to the Byzantine and post-Byzantine churches, with a focus on their architecture and other elements such as paintings, restoration interventions, etc.

In a general view, the book deserves to be valued as an opportunity for a wider audience, which will have the opportunity through its reading to appreciate what at first glance may seem only as a Christian heritage, but in fact, it can be treated even more broadly as a historical evidence, a document, a social attitude, an individual concept or a personal reading of certain historical context or events, economic relations or schemes, indicators of power, etc.

Another novelty of this publication can be considered the inclusion of monuments, which have already disappeared or are partially preserved, creating a more complete panorama about the objects of Christian cult built in the castle neighborhood, even supplementing in some cases the documentary data. These data give the public a holistic view, not only on the distribution of churches, but serve as a kind of statistic of the saints to whom they were offered.

The monograph of Genci Samimi and Dritan Çoku on the churches of Berat represents an added value in the corpus of Byzantine and post-Byzantine architecture and art literature in the city of Berat, serving the interested reader as an orientation manual to obtain summarized data not only about churches, their architectural and typological evolution and development, but also about restoration interventions over the years. At the same time, the book is rich in illustrative material, such as photographs, planimetry, reflected in quality, which adequately documents and promotes the ecclesiastical heritage of Berat.